

TOMÁŠ ZMEŠKAL

**LETËR DASHURIE
NË SHKRIMIN KUNEIFORMË**

Përktheu: Xhemile Zyka

SHTËPIA BOTUESE “FAN NOLI”
TIRANË, 2017

TOMÁŠ ZMEŠKAL

Milostný dopis klínovým písmem

© Literary Agency Pluh

© i botimit shqip “Fan Noli”



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

“This project has been funded with support from the European Commission. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.”

**Ky projekt u mundësua me mbështetjen e Komisionit European.
Ky publikim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mban
përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që përmban
publikimi.**

Redaktor Rexhep Hida

Art grafik Aida Kumi

ISBN 978-9928-203-97-7

1. Dasma

Para se të ngrihej, Alisa pa në ëndërr sikur fluturonte ose notonte. Sigurisht të gjitha ato vegime ishin shumë të varfra për të shprehur ndjenjat që e kishin kapluar. Për pak kohë ajo e harroi veten. Zemra e saj, e ndalur në një fluturim zogjsh, e bëri të përmendet. Por edhe ajo vetë u ngul në shtegun e kolibrave të mendimeve të saj, pastaj mori frymë thellë dhe, më në fund e tha: *e Martë*. Kjo ishte gjithçka që ajo mundi të mendonte, e shkrirë, brenda atij çasti.

Dita e saj kishte ardhur dhe po mësohej me aromën e saj. Ndërmjet frymëmarrjes e frymënxjerrjes, ndërmjet mbajtjes së frymës dhe rritjes shkumëzuese të dhimbjes në pjesën e poshtme të barkut të saj, ndërmjet vullnetit të palëvizshëm që nxihet në diell dhe lotëve të djersës që njomnin me shpejtësi çarçafët – dy pika iu shfaqën para syve të saj.

Asaj iu desh të sforcohej për të marrë frymë. Me pak shqetësim. Nuk ishte e qartë, nëse dy pikat që kërcenin prapa kapakëve të syve të mbyllur fort ishin shkaktuar nga kontraksioni i muskujve dhe presioni i tyre në retinën e syrit apo ato mund të vështrohen si të shkaktuara nga diçka tjetër për momentin... diçka metafizike. Pasi u mendua pak, Alisa vendosi të konsideronte hipotezën e dytë. Ajo plotësoi ciklin e frymëmarrjes e frymënxjerrjes dhe u ndie e pasigurt, nëse duhej të lëvizte nga krevati. Ajo rrinte shtrirë, ndërkohë që dy pikat vërtiteshin para syve të saj. Njëra ishte e shkuara dhe tjetra – e tashmja. Nuk ishte e qartë cila prej tyre mbante të shkuarën, cila të tashmen.

Gjithsesi, ajo e ndjeu që ajo ishte dita më e tashme, më perfekte dhe, sigurisht – dita me kundërmim më të këndshëm që kishte provuar ndonjëherë. Dhe, pastaj, ajo, papritur, u kujtua. Po. Ajo ishte aromë! Po të mos ishte në krevat do t'i merreshin mendtë. Aroma! Ishte, pikërisht, ajo që e kishte zgjuar.

Po të mos ishte aroma, ajo do të kishte menduar se ishte muzika që vinte nga dhoma ngjitur. Pikërisht, në atë çast, Alisa humbi kontrollin mbi trupin e saj aq, sa u drodh dhe mori frymë thellë. Tërësisht kundër vullnetit të saj, në mushkëri hyri më shumë ajër nga ç'mendonte ajo dhe më shumë se ç'mund të përballonte ajo. Ajo u drodh, e trembur, por kjo gjë po ndodhte. E ndjeu veten si të zhytur duke thithur ujin e lumit brenda mushkërive të saj.

Ajo kishte pushuar së perceptuari të shkuarën dhe të tashmen, kishte harruar cilat ishin ato pika, kishte harruar domethënien e secilës prej tyre. Ndërsa hapte sytë ajo ndjeu, lehtësisht, një gudulisje qetësuese në shputën e këmbëve të saj. Hapi sytë dhe nga laringu i saj doli një dënesë. Pastaj, u ndje një eksplozion, plasje, shpërthim, një erë diellore, ortek, rrebesh, përsëri ortek, rrëshqitje dheu, mjegull... lot. Përreth saj, përreth krevatit të saj, në çdo drejtim, kudo ishin hedhur trëndafila. Nga të gjitha ngjyrat, nuancat, aromat. Nga e kuqja e errët, tek roza shumë e çelët, e ndritshme, nga e verdha në kafë të errët, tek e verdha e çelët e fluturës. Ato gjendeshin kudo rreth e rrotull, mbi çarçafë, mbi mbulesë, mbi velin e saj. Trëndafilat e rrethonin duke e shtrënguar, sikur nuk donin ta linin të ikte. Dhe, përveç tyre, përveç territorit të trëndafilave, pranë derës dhe dritareve kishte zambakë dhe krizantema. E gjithë dhoma mbante erë të këndshme. Kishte lule ngado që hidhte sytë dhe mund të prekte trëndafila ngado të zgjaste duart. Ishte e Martë. Ishte dita e dasmës së saj.

Ajo ndjeu muzikë që vinte nga dhoma tjetër. Kjo do të thoshte se babai i saj ishte ngritur. Para së gjithash, ai ishte nervoz, prandaj dëgjonte muzikë kaq herët në mëngjes. Së dyti, ai përpiquej të

qetësohej duke dëgjuar diskun e tij parapëlqyer, Hajdnin, edhe pse rrezikonte ta gërviste, sepse në mëngjes herët, gjithmonë, i dridheshin duart. Dhe së treti, ajo s'e kishte dëgjuar të gjallonte, të këndonte me vete nëpër shtëpi dhe kjo do të thoshte se ai po hante mëngjes.

Alisa vështroi përreth dhe qëndroi, për pak minuta, ulur në krevat. Trëndafilat e rrethonin nga të gjitha anët duke i gudulisur shputat e këmbëve. Dhe ishin të gjitha të freskëta. Ajo habitej si nuk e kishte dëgjuar dashurinë e saj të hynte në dhomë dhe si, ai, e kishte lënë të flinte deri tani. Ajo doli nga dhoma e gjumit në korridor dhe hyri në kuzhinë.

“Ku është ai?” pyeti ajo të atin, i cili po rrinte në kuzhinë duke vështruar jashtë nga dritarja.

“Ku është ai?” – pyeti Alisa përsëri.

“Po rri në dhomën e ndenjes dhe, ndoshta, po dremit pak”, i tha babai. Ajo hyri shkoi tek ai dhe e gjeti aty gjysmë ulur, gjysmë shtrirë.

“Maksimilian” thirri ajo dhe, në atë kohë, Maksimiliani i hapi sytë. Ajo mendoi se gjatë muajve të fundit, fjalori i saj ishte reduktuar në pasthirrma, eufemizma, përemra vetorë i imi, i yti, e jona, i yni, kryesisht, të lidhur me foljet në kohën e ardhme.

Edhe babai i saj ia kishte vënë në dukje këtë, së fundmi. Maksimiliani i hapi sytë, por pas një buzëqeshjeje. Ajo e besonte veten të imunizuar ndaj buzëqeshjes së tij pas atyre muajve, por magjia e saj iu kthye përsëri. Pastaj erdhi përqafimi.

“Maksimilian!” thirri ajo përsëri. “Maksimilian!”

Maksimilian – emri i bamirësisë, Maksimilian – emri i diellit. Një emër perandori. Një emër me shkëlqim dhe rreze drite të shpërndara në të gjitha drejtimet. Në varësi nga mënyra dhe forca e kordave vokale të saj, në varësi nga lodhja, energjia ose gëzimi, emri i tij merrte shkëlqim dhe vezullim. Ishte emër loretan, ajo e kishte të qartë këtë. Vezullues që do të thotë si një diamant i fortë

nga Anversi. Rrëzëllues që do të thotë dashuri. I artë që do të thotë përqaqim. Ai ishte, ai ishte, ai ishte... loretan – çdo artikulum i këtij emri do të thoshte një nga kutitë me xhevahire vezullues, të dukshëm qartë dhe fisnikë, me arin dhe gurët e tyre të çmuar. Ai e përqafoi pa i hapur sytë.

“Maksimilian” e shqiptoi ajo emrin e tij edhe një herë.

“Unë nuk dua ta them këtë” tha babai i saj që nga dhoma tjetër. “Jo vetëm që s’dua ta them, por është edhe e çuditshme që e mendoj ... por, para se të vijë mamaja, keni një rast të fundit të paharrueshëm të hani mëngjes me mua. Dua të them si njerëz të respektuar, akoma të pamartuar... Pra ta vë ujin për kafe? Pasi priti pak e nuk mori përgjigje, ai lëvizi në karrige duke vështuar nga dera dhe kontrollloi, sa kishte mbetur akoma nga sonata e Hajdnit. Ai nuk donte ta dëgjonte sonatën tjetër, një nga të Bethovenit, e cila, sipas mendimit të tij, ishte mbivlerësuar prej njëqind e dyzet vjetësh. Dhe për çfarë? Habitej babai i saj. Për çfarë? Për shkak të *Odës së gëzimit*. Nëse do të kishte ndonjë gjë për të vënë në dukje, përveç faktit që ajo shënoi fundin e festivalit muzikor klasik të pranverës së Pragës, do të ishte mungesë totale e humorit. Plotësisht tipike Gjermane, mendoi ai. Një *Odë gëzimi* pa humor.

“S’ka humor të paramenduar – ky është problemi” tha ai me zë të lartë. “Gjërat, njerëzit, idetë me tituj pompozë dhe me mungesë të plotë humorit, gjithsesi, kanë bërë karrierë”.

“Çfarë baba? Çfarë the?” pyeti Alisa duke hyrë në dhomë.

“Humor i munguar, thashë unë. Por kjo nuk ka rëndësi tani”, u përgjigj ai. “Nëse mund të presësh pak, sa të mbarojë disku, do të vish të hamë mëngjes bashkë? E kisha fjalën...doja të thoja... para se mamaja jote të kthehet”.

“Epo mirë, ndoshta. Nuk e di akoma,” tha Alisa. “Ja të pyes Maksin.”

Ndërkohë i ati u ngrit dhe hyri në dhomën e gjumit për të fikur gramafonin. Por ai nuk ishte shumë i shpejtë për ta kapur sonatën

e Bethovenit nga fillimi. Babai e zhvendosi me kujdes gjilpërën nga disku dhe tha: “As Shnabel s’na ndihmon dot. Ai ka treguar një mungesë të theksuar talenti për një të lindur në Bon dhe një tendencë të tepruar për *patos*.”

“Kush është Shnabeli? pyeti Alisa që nga kuzhina.

“Një pianist shumë interesant, i cili do të harrohet shumë shpejt në këtë erën tonë progresive”.

“Aha,” tha Alisa duke ecur për nga dhoma e ndenjes. “A dëshiron të hash mëngjes me tim atë?”

“Kjo varet prej teje, Ali. Varet plotësisht prej teje” u përgjigj Maksimiliani.

“Po mirë atëherë, pse jo?” vendosi Alisa. Ndërkohë i ati vazhdonte fillin e mendimeve të veta: Por Hajdni është i mprehtë. O Zot, po gjithmonë i tillë është. Madje... më shumë se Moxarti. Por Hajdni është gjerman apo austriak? Kjo është çështja. Ka të bëjë me kombësinë? Jo, unë nuk mendoj kështu, kjo, ndoshta, s’ka kuptim. Unë nuk qesh më as me shakatë e mia, e përfundoi fillin e mendimeve të veta babai i Alisë. Ai e vuri me kujdes diskun në vendin e vet dhe shkoi të vinte ujin për kafe.

Teksa Maksimiliani dhe Alisa uleshin në vendet e tyre, Maksimiliani po shpresonte që vjehri i tij i ardhshëm të mos e derdhte të gjithë kafën nëpër tavolinën e bukës. Ai habitej se si babai i Alisë kishte gjithmonë, aty afër, një leckë të pastër, me të cilën ai fshinte, shpejt e shpejt, gjithçka sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ai, tashmë, kishte filluar të mësohej me faktin që vjehri i tij i ardhshëm derdh gjithçka nga pak. Atij – ashtu si edhe ekzistenca rudimentare e martesës që ruanin me këmbëngulje prindërit e Alisë – nuk i bënte më kurrfarë përshtypeje.

“Si i solle gjithë ata trëndafila? Nga kanë ardhur? pyeti Alisa.

“Është sekret” i tha Maksimiliani.

“Hajde pra, më thuaj, nga i gjete? nguli këmbë ajo.

“Është top sekret” i tha ai.

“Aroma e tyre më zgjoi,” tha Alisa.

“Edhe unë këtë shpresë kisha,” tha Maksimiliani. Ai e puthi lehtë në qafë dhe filloi të qeshte.

“Alisa më tha se ishe në Gjermani për disa ditë. Çfarë pune kishe atje?” ndërhyri babai i Alisë.

“Duhej të takoja xhaxhain tim,”

“Shumë mirë, si shkoi?” pyeti babai i Alisë. “Solle ndonjë gjë të mirë nga jashtë?”

“Asgjë të veçantë, në fakt. Xhaxhai kishte meremetuar shtëpinë dhe donte të ma tregonte, por, nja dy ditë para se të shkoja unë, ai kishte thyer këmbën. Unë, thjesht, shkova dhe e pashë në spital. Gjithsesi, unë akoma jam nipi i tij i varfër,” tha Maksimiliani.

“Mm – hm,” i ati i Alisë tundi kokën.

“Por, u fut në bisedë Alisa, “Maksi tha se ishte vonuar treni”.

“Është e vërtetë,” aprovoi Maksimiliani. “Në fakt, dy trena qenë me vonesë.”

“Domethënë në Gjermani trenat vonohen” tundi kokën babai i Alisë dhe, pas një pauze, shtoi:

“Kjo përputhet me vërejtjen time.”

“Me cilën prej vërejtjeve të tua?” pyeti Maksimiliani.

“Oh jo, kur babai fillon kështu, ti e di do të jetë diçka pesimiste,” tha Alisa.

“Epo, në fakt, pas një vëzhgimi të kujdesshëm, unë kam arritur në përfundimin se, jo vetëm që kapelani i kishës sonë nuk është shumë i zgjuar, por është krejt mesatar.”

“Epo, nuk mund të jenë të gjithë Ajnshtajni, baba,” ndërhyri Alisa.

“Sigurisht që jo, për hir të Zotit, unë vetë jam një njeri mjaft mesatar dhe s’më vjen turp ta them, por ai është anëtar i Shoqatës së Jezusit, është jezuit dhe një jezuit me inteligjencë mesatare, Ali, mos ma merr për keq, por të gjendesh para një jezuiti si ai, me inteligjencë mesatare ose, akoma më keq, një jezuiti mendjelehtë,

është vërtet e sikletshme dhe e papranueshme. Epo, vetëm të mendosh pak”, babai i Alisë u kthye nga Maksimiliani dhe filloi të numëronte me gishta.

“Nga njëra anë - një jezuit budalla. Nga ana tjetër – trenat në Gjermani nuk arrijnë sipas orarit. Gjëja tjetër, mungon vetëm që anglezët ta rrëzojnë mbretëreshën dhe do të shpallin republikën. Në Europë diçka nuk shkon mirë. Po ta them unë. Diçka nuk shkon mirë.”

Nga ana e hyrjes u dëgjua tingulli i çelësit në bravë, pastaj u hap dera dhe dy zëra.

“Është mami,” i tha Alisa Maksimilianit, duke i shkuar gishtat nëpër flokët e tij. “Jo, prit, është edhe dikush tjetër.” Ajo u ngrit dhe u drejtua nga dera. U dëgjua zvarritje këmbësh, një zë gruaje dhe një zë burri.

“Ahhh, duhet të jetë doktori,” i tha Maksimilianit babai i Alisë. Maksimiliani, thjesht, buzëqeshi me mirësjellje. Ai nuk e kishte idenë për çfarë po fliste i ati i Alisë.

“Dhe Kvéta,” shtoi babai i Alisë, duke u ngritur nga karrigia.

E ëma e Alisë hyri në kuzhinë me një burrë, i cili ishte pak më i ri se babai. Ai i hodhi krahun e majtë rreth mesit Alisë dhe diçka i pëshpëriti në vesh.

“Përsëndetje doktor. E dija që ishe ti” tha i ati i Alisë duke i shtrënguar dorën. “Ky është Maksimiliani,” shtoi ai. Maksimiliani u ngrit dhe i zgjati dorën doktorit.

“Antonin Lukavski,” u prezantua doktori.

“I njohur gjithashtu,” ndërhyri Alisa, “si xhaxha Tonda, i quajtur doktor.”

“Po, unë i përfaqësoj të gjithë këta emra” tha ai.

“Maksi” tha Maksimiliani.

Nëna e Alisë hyri në kuzhinë.

“Mirëdita Kvéta,” përsëndeti gruan i ati i Alisë.

“Mirëdita, Jozef,” u përgjigj ajo.

Xhaxhai i Alisë, akoma me krahun rreth mesit të saj, qëndronte me Alisën duke vështruar prindërit e saj.

“Çfarë po bënit ju?” pyeti nëna e Alisë.

“Duke pritur ju, çfarë mund të bëja tjetër unë?”

“Çfarë po dëgjoje?” pyeti mamaja duke vështruar përreth në dhomë.

“Bethovenin, më duket,” tha Maksimiliani. “Kështu apo jo?”

“Jo, absolutisht, jo. Unë, thjesht, nuk arrita ta hiqja diskun në kohë. Kam qenë duke dëgjuar Hajdnin, Jozef Hajdnin!”

“Unë shpresoj të mos e keni gërvishtur, duke e vënë që në mëngjes, e di që të dridhen duart” e qortoi mamaja e Alisë.

“Meqë ra fjala, mos keni lidhje gjaku me Esterhazys, Maksimilian?”

“Jo,” tha Maksimiliani. “Ata janë më të hershëm se ne, që nga viti 1238. Në atë kohë ata kanë qenë princër, ndërsa ne kemi qenë oborrtarë, në rastin më të mirë.”

“E shikon!” tha nëna e Alisë. “Ja, e shikon!”

“Çfarë të shikoj?” tha Alisa.

“Shtupën e enëve. Diçka ka derdhur prapë. Ti do t’i gërvishtësh ato disqe, Jozef!”

“Dhe çfarë pastaj? Ato janë disqet e tij,” tha Alisa.

“S’do t’i lash ti ato, kështu që mos u shqetëso për këtë,” i tha babai. “Ju e dini, Hajdni është varrosur atje, kështu, Maksimilian?”

“Ku?”

“Në tokën e pronave të atyre, ju e dini. Prit një sekondë, si e kishin emrin...”

“Ai do t’i gërvishtë disqet, do të mërzhitet e do të ndiejë keqardhje” tha Kvéta duke iu drejtuar Alisë dhe Antoninit, i cili përpiquej shumë të vështronte në një drejtim tjetër.

“Unë po të them, mos kij merak çfarë bëj unë me disqet e mia dhe s’ka nevojë të shqetësohesh, nëse mërzhitem unë apo jo, sepse

unë s'jetoj më me ty dhe as që e kam ndërmend të planifikoj të jetoj me ty kurrë më! Prandaj, të lutem, Kvéta, mos u shqetëso për mua. Mirë? Në rregull? Unë po ta kërkoj këtë me mirësjellje, po të vë në dijeni!”

“Oh?” tha Kvéta. “Nuk e kisha kuptuar. Mendoja se do të lëvizje përsëri në vjeshtë, pasi të mbarojë riparimi i shtëpisë në fshat?”

“Jo, jo,” tha babai i Alisës dhe ngriti supet.

“Më vjen keq që po e dëgjoj këtë.”

“Jam i sigurt që të vjen keq.”

“Pra, ku e kanë varrosur atë?” pyeti Antonini.

“Kë?”

“Hajdnin.”

Ndërkohë që Antonini po përpiquej ta ndërronte temën e bisedës, Alisa e mori të ëmën për dore dhe e tërhoqi për në dhomën e gjumit.

“O Zot, kjo është një mrekulli, Ali. Është një mrekulli. Gjithë këto lule. Dhe çfarë arome! Të mrekullueshme! Kanë një aromë kaq të mirë!” Mamaja u ul mbi krevat. “Pra ata janë zambakë apo jo? Po ato atje, çfarë janë? Po ku keni mundur t'i gjeni të gjitha këto lule, në Mars?”

“Të më vrasësh, nuk e kam idenë,” tha Alisa. “Ai thotë që është sekret. Kur më thotë kështu, unë as që përpiqem të nxjerr gjë prej tij. Vetëm po t'i qepem një javë ose dy mund t'i rrëshqasë sekreti.”

“Kjo po, këtë unë e quaj dashuri. Po si quhen ato lule?”

“Cilat prej tyre?” pyeti Alisa duke u përpjekur të mos shpohej vetë, ndërsa mblidhte trëndafilat nga qilimi. Kur u kthye, mamaja po qante. Alisa u afrua dhe u ul pranë saj duke vënë me kujdes tufën e trëndafilave mbi jastëk dhe e mbështolli me krahët e saj mamanë e mbytur në lot.

“Ti e dije apo jo?”

“Jo, në fakt, unë nuk e dija.”

“Oh, lëre tani, Ali...”

“Vërtet, nuk e dija, por e kisha një ndjesi”.

Dënesat e nënës, dalëngadalë, u qetësuan. “Kanë një aromë aq të mirë,” tha ajo përsëri, pas pak. “Të paktën ti je e lumtur. Të paktën vajza ime e vogël është e lumtur”.

“Domethënë unë s’do të jem e vetmja që do të qaj në dasmën time?” pyeti Alisa.

E ëma tundi kokën: “Epo, e shikon, mund t’i kenë marrë gjithçka, por mirësjellja mbetet. Kaq shumë trëndafila, është e pabesueshme”. Pas një çasti, ajo tha: “Me të vërtetë s’të ka thënë gjë ty?”

Alisa ngriti supet dhe tha: “Hajde, më jep një dorë. Ne do t’i vëmë lulet në ujë, mirë?”

Ndërkohë erdhën ca njerëz: dy shokë të Alisë, djem shumë të mirë, dhe një xhaxha tjetër, këtë herë, nga familja e Maksimilianit. Alisa u ndërrua, veshi rrobat e dasmës dhe doli t’i përshëndeste. Fustan i kaltër, bluzë e kaltër e çelët dhe kapele me vel. Fustani i bardhë do të kishte qenë pa vend në ato kohë shprese e progresi.

Pas kafes, amaretave, njohjeve dhe ca fjalive rreth motit, familja dhe të ftuarit në dasmë hipën në dy makinat e tyre dhe në një tjetër që e kishin marrë me qirë. Pastaj ata u nisën për një shëtitje të shkurtër në një qytezë të vogël jashtë Pragës. Prindërit e Alisë udhëtonin në makina të ndryshme. Pas gjysmë ore ata zbritën në sheshin e qytetit. Në njërën anë të sheshit ngrihej një kalë e vogël, përballë së cilës, pranë një stoli, ishte prifti.

Maksimiliani, fillimisht, iu afrua atij, të dy burrat shkëmbyen përshëndetjet dhe, pastaj Maksimiliani prezantoi të ftuarit një nga një. Prifti ua shtrëngoi dorën të gjithëve, pastaj priu përpara në rrugën drejt kishës, ku kishari, donte të ndërronte letrat e ngjitura në vitrinë afër derës kryesore. Duke i mbajtur letrat e mbështjella nën sqetull, ai, gjithashtu u shtrëngoi dorën të gjithëve. Ai hapi derën, priti sa hynë brenda të gjithë dhe ishte gati të mbyllte derën,

kur u shfaq një grup turistësh.

Kishari u përpoq t'u shpjegonte se e kishin mbyllur, megjithëse, normalisht, kisha mbyllej të Hënave dhe atë ditë ishte e Martë, kështu që duhej të ishte hapur. Një turist, më energjiku, ishte veshur me kilota dhe xhaketë shiu blu, u tregua veçanërisht i vështirë. Fliste me zë aq të lartë, saqë fjalët e tij arrinin deri në sakristi, ku prifti po i hidhte një sy sekuencave të ceremonisë, për të fundit herë. Papritur, pa e mbaruar fjalinë që kishte filluar, prifti pëshpëriti diçka që tingëllonte si “më falni” dhe doli nga kisha jashtë të takonte turistin, zëri i të cilit iu duk si i njohur.

Turisti i doli përpara, i gjendur ballë për ballë me priftin, heshti. Prifti e vështroi drejt në sy dhe tha: “Kisha është mbyllur sot për një rast të veçantë. Keni pyetje të tjera, djalosh?”

Turisti i trembur vështroi përreth shokët e vet, të cilët qëndronin aty gojëmbyllur dhe shikonin atë: “Ne nuk do t’ju ndërpresim. Dëshëm vetëm t’u hidhnim një sy afreskeve.”

Prifti vuri dorën në gojë, pastroi grykën dhe tha: “Nëse ju do të ndërroheni, në mënyrë që të keni një veshje ceremonial, brenda pesë minutash, unë do t’ju pres. Përndryshe është e pamundur. Keni ndonjë veshje ceremoniale me vete?”

“Veshje për ceremoni?” pyeti turisti.

“Po” iu përgjigj prifti.

Turisti këqyri veshjen e vet, pastaj vështroi shokët pas tij, dhe tha: “Nuk e di.”

“Kam frikë se nuk keni,” tha prifti. “A kam të drejtë?”

“Më falni?” tha turisti.

“Mendoj se nuk keni rroba të tjera, përveç atyre që unë po shikoj tani.”

“Po, vërtet, vetëm këto kemi marrë. Ne erdhëm këtu për një ditë.”

“Kështu që frika ime vërtetohet. Pra, duke parë që ju s’keni veshje formale, me keqardhje ju informoj, për shkak të ceremonisë

speciale që do të fillojë pas pak minutash, unë s'mund t'ju lejoj të hyni në kishë. Ju jeni të mirëseardhur të vizitoni kishën tonë një herë tjetër”.

“Pra, ju nuk do të na lejoni të hyjmë sot, eh?”

“Këto janë rregullat, djalosh. Përndryshe do të kishte qenë kënaqësi të njiheshim me ju,” u përgjigj prifti. Ai fliste me vendosmëri, pa kurrfarë ironie.

Turisti u kthye dhe, teksa ai largohej, kishari mbylli derën kryesore. Ceremonia mund të fillonte.

Prifti u mbajti një ligjëratë të gjatë nuses e dhëndrit, tema qendrore e së cilës dukej të ishte: gruaja përfaqëson trupin e familjes, ndërsa burri është koka e saj. Duke dëgjuar predikimin e tij, doktor Lukavski, mik i familjes, habitej sa shumë përvojë kishte pasur prifti me gratë, ndërsa nëna e Alisë, Kvéta, shpresonte që sytë e saj të mos ishin shumë të fryrë nga të qarët. Ajo gëzohej që drita në kishë nuk ishte shumë e fortë, kështu që hijet ishin të zbehta dhe askush s'mund t'i shikonte mirë sytë e saj. Nga fundi i asaj ligjërate, prifti vuri në dukje se më 1716 stërgjyshi i dhëndrit, Jindrik, ishte ngritur në rangun e kontit nga Karli VI, Perandori i Shenjtë Romak dhe, shumë shpejt pas kësaj, djali i tij Mikulash, kishte blerë kalanë lokale dhe ndërtoi, jo vetëm një famulli të vogël, por këtë kishë, ku jemi ne sot.

Megjithëse titujt aristokratikë nuk njihem më, tha ai, sepse janë rrëzuar nga qeveria Çekosllovake, në kohën e presidentit të parë, Tomash Masaruk, nuk ishte e kundraligjshme të përmendeshin ditët, kur njiheshin jo vetëm titujt dhe manierat e mira, por, veçanërisht fjala e Zotit, e interpretuar nga Kisha Katolike Apostolike e Shenjtë. Ai foli mbi unitetin e fronit dhe altarit, dhe një buzëqeshje e pavullnetshme ia ndriçoi fytyrën gjatë pasazheve më të guximshme të ligjëratës së tij, të përgatitur gjatë.

Pastaj Alisa dhe Maksimiliani këmbyen unazat dhe puthjet, firmosën dokumentin që vërtetonte se martesë ishte, para së

gjithash, një rregullim kontraktual, i cili, në atë moment, ishte gjëja e fundit që çifti kishte në mendje. Pas ceremonisë, prifti i ftoi dasmorët në sakristi. Tani Alisa dhe Maksimiliani ishin tërësisht vetëm në botë, donin apo s'donin ata. Ata iu përgjigjën pyetjeve të secilit, duke folur për cilësinë në rënie të verës së kungimit gjatë regjimit komunist. Alisa bënte shaka e qeshte me miqtë e saj, Maksimiliani piu një dolli me një shishe shlivovice, të cilën, zakonisht, në raste si ky, dikush e prodhonte menjëherë s'dihej se nga, por gjatë gjithë kësaj, rrjeta metalike e situatës së tyre të re, dalëngadalë, filloi t'i rrethojë ata. Pak nga pak, rrjeti zbriti mbi ta duke i rrethuar, duke i mbrojtur e duke i shtrënguar.

Një ceremoni tjetër i priste nusen dhe dhëndrin, meqenëse shteti nuk i quante legale martesat fetare. Ata duhej të udhëtonin drejt Pragës për martesën civile. Gjatë rrugës, xhaxhai i Alisë ra në mendime lidhur me predikimin që prifti u kishte bërë sot. Ai dukej i papërshtatshëm në atë kohë të emancipuar të vonshme, të vitit 1960, siç mendohej të ishte më e mirë, të paktën, në çështje esenciale si këto. Koha që zuri ligjërata e priftit nuk kishte qenë e padobishme. Karakteri i papranueshëm i përmbajtjes së saj kishte shkuar mjaft larg në pikën e intolerancës, saqë momenti, kur nusja me dhëndrin vunë unazat në gishtat e njëri-tjetrit, u duk shumë më tepër se një moment fluturak i një gjendjeje të hareshme. Rrotullimi i velit, puthjet, nënshkrimet, kishin qenë shpërblimi për atë masë vertikale të intervaleve intolerante nga të cilat predikimi ishte bërë si një obelisk pengues.

Më në fund, Antonini nuk mundi të rezistonte dhe, meqenëse ishte ulur në të njëjtën makinë me të porsamartuarit dhe babain e Alisë që ngiste makinën, pyeti çfarë mendonin ata për predikimin. Maksimiliani tha se ishte dakord me Antoninin, duke shtuar me një ton pak shfajësues se ai kishte marrë vesh që prifti e kishte përgatitur ligjëratën e vet për një kohë të gjatë dhe shpresonte shumë që atyre t'u kishte pëlqyer. Megjithatë fjalët e Alisë, e

habitën.

“Çfarë mendoni ju, xhaxha? Se ai do të mbronte hipitë dhe LSD-në? Ai është prift apo jo? Çfarë prisnit ju prej tij?”

“Është e drejtë, Tonik, ai është prift,” shtoi i ati i Alisë. “Gjithçka është siç duhet të jetë. Ashtu duhet të jetë”.

Kur arritën në Pragë, ata kishin edhe një orë para se të fillonte ceremonia civile, meqenëse salla ku do të bëhej ajo nuk ishte larg dhe askush nuk e merrte aq seriozisht, sa atë në kishë. Alisa, Maksimiliani dhe mamaja kishin sjellë ca sandviçë, verë dhe ëmbëlsira. Mysafirët u shpërndanë nëpër apartament që të pushonin e të përgatiteshin deri sa të vinte koha për t’u nisur përsëri për ceremoninë.

Një burrë i gjatë, me trup të lidhur, me një pardesy të bardhë dhe me një beretë ngjyrë kafe që binte mbi ballin e tij të djersitur i binte ziles me këmbëngulje. Pranë tij qëndronte një burrë i shkurtër biond me një përparësë të bardhë përmbi pantallonat e tij në ngjyrë të çelët dhe kapuç të bardhë në kokë. Dëshmitari i nuses qëndronte më afër derës. Burri shtatlartë u përkul tek ai dhe e pyeti nëse mund t’i thoshte një fjalë doktor Lukavskit. Dëshmitari ngriti supet dhe i tha se ai s’njhihte njeri - ai kishte harruar, tashmë, emrat e atyre me të cilët ishte prezantuar, por nëse do të priste, do të gjente Maksimilianin e do t’i thoshte atij. Maksimiliani e gjeti doktorin dhe ai erdhi tek dera. Burri i gjatë, me beretë, u përkul dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Doktorin i buzëqeshi dhe i bëri shenjë të hynte brenda. Ata çanë përmes të ftuarve dhe dolën tek babai i Alisë.

“Jozefi është këtu,” i tha doktorin.

“Çfarë është, Tonik?” pyeti i ati i Alisë.

“Një surprizë, siç të thashë.”

“Oh, mirë, mirë. Pra ju doni një dhomë për tortën, kështu?”

“Mos bërtit, Jozef,” e qortoi Antonini. “Është surprizë”

“Ah po, sigurisht. Epo mirë, vendose në dhomën time të vjetër. Gjithçka është e pastër aty, madje ka dhe një tavolinë.”

Ata hynë në dhomë. Aty ishte një tavolinë druri e errët, mbi të cilën ishte një gazetë e palosur, e hapur tek një fjalëkryq gjysmë i përfunduar, dy gota dhe një stilolaps. Burri me përparëse vështroi tavolinën, hoqi gazetën, gotat dhe stilolapsin, nxori një metërshirit nga xhepi dhe mati tavolinën – burrat e tjerë bënë sehir.

“Tamam një metër me një e gjysmë,” tha burri me përparëse, disi i pakënaqur.

“Nuk është e madhe sa duhet?” pyeti doktori.

“Unë u shpreha qartë: Unë kam nevojë për një tavolinë tre çerekë metri me dy metra. Fola shumë qartë!” tha, me pezmatim, burri me përparëse.

“Mirë, ne mund ta rregullojmë atë” tha babai i Alisë. Ai vështroi doktorin dhe i tha: “Unë mendova se ju thatë që do të jetë një tortë?”

“More, është tortë apo jo?” pyeti doktori duke u kthyer nga burri me përparëse.

“Sigurisht, vëlla,” u përgjigj burri me përparëse, i cili, tashmë, po përpiquej të imagjinonte si mund të zgjerohej tryeza. Doktori i hodhi një vështrim tjetër pyetës, por burri me përparëse, nuk ia vuri veshin dhe po provonte hapjen e krahëve të palosur të tryezës.

“Kjo tavolinë nuk është përdorur shumë, në fakt,” i tha babai burrit me përparëse.

“Prandaj është kaq e ngurosur.” Ai filloi të ndihmonte për të hapur pjesët e tjera të tavolinës.

“Do të jetë tamam. Po, kështu do të jetë mrekullisht e përshtatshme,” tha burri me përparëse duke matur tavolinën, së bashku me pjesët e shtuara.

“Tani, unë kam një kërkesë,” ai hodhi sytë përreth, “të mos hyjë askush në këtë dhomë për tridhjetë minuta.”

Babai i Alisë vështroi doktorin, i cili vështroi burrin me

përparëse dhe tha:

“Unë mendoj... kjo mund të rregullohet. Apo jo, Jozef?”

“Po,” u përgjigj babai. Pas pak minutash, burri me përparëse u vendos në dhomë dhe burri i gjatë, truplidhur me pardesy të bardhë, së bashku me doktorin filluan të sillnin brenda kutitë me përmasa të ndryshme. Çdo herë, ata duhej të trokisnin, ai duhej t’u hapte derën dhe ata i jepnin një ose më shumë kuti. Kur kjo punë mbaroi, ata qëndronin para derës që të mos hynte ndonjëri aksidentalisht.

Fiks, pas njëzet e nëntë minutash, dera u hap: doktori, burri me beretë dhe i ati i Alisë u lejuan të hynin brenda. Ata hynë në dhomë dhe hodhën sytë në tryezë. Aty qëndronte një pallat marzipani që ngrihej në lartësinë një metër e gjysmë.

Burri me përparëse ishte pastičer mjeshtër - tashmë ishte shumë e qartë dhe ajo që qëndronte mbi tryezë ishte një kombinim i një katedraleje gotike, i një kështjelle dhe i një pallati me shumë kopshte.

“Vërtet, nuk e prisja këtë, zoti Svoboda,” tha doktori.

“Doktor vëllai,” tha pastičeri, “një dasmë dhe një tortë dasme bëhen një herë të vetme në jetë, në mënyrë që nusja, dhëndri dhe të ftuarit e tyre ta gëzojnë plotësisht atë.”

Pas një pauze të shkurtër ai tha: “Unë shpresoj, eh-ehm... që, unë mendoj... do të më pëlqente shumë, nëse mund t’u thosha të sapomartuarve nja dy fjalë.” Ai u kollit. “Po të jetë e mundur, natyrisht.” Ai hodhi sytë përreth duke vështruar të tjerët. Doktori u kthye nga babai i Alisë, i cili nuk po ia shqiste dot sytë krijimit marzipan.

“Mund të bëhet kjo, Jozef?” pyeti doktori, por babai nuk e dëgjoi. Ai i vinte rrotull tavolinës me pallatin-katedrale marzipani, duke tundur kokën dhe duke murmuritur, “Kurrë s’kam parë diçka të tillë,” dhe duke buzëqeshur me vete. Në vend që t’i përgjigjej pyetjes së doktorit, ai vetë pyeti, “Po figurat si janë? A janë edhe

figurat të ngrëshme?”

“Natyrisht,” tha pastičeri, disi i fyer. “Gjithçka që ju shikoni në tryezën, para jush, është e ngrëshme”.

“E pabesueshme!” murmuriti i ati i Alisë. “Me të vërtetë, e pabesueshme. Kjo është vepër arti.”

“Natyrisht,” tha pastičeri.

“A mendon se Z, Svoboda mund t’u thotë dy fjalë nuses, dhëndrit dhe të ftuarve të tyre?”

“Sigurisht, sigurisht, Tonik,” u përgjigj ai. “Vetëm prisni një minutë, sa t’i sjell ata brenda”.

Dalëngadalë, dhoma u mbush plot. Në mënyrë që secili të mund të shikonte, ata duhej të qëndronin në rreth anash tavolinës me pallatin prej marzipani. Secili hynte në dhomë në heshtje. Bisedat u shuan fare, jashtë, kambanat e kishës filluan të binin, por askush nuk përqendrohej dot për të numëruar tingëllimet e tyre. Kur dhoma u mbush plot, babai vështroi përreth dhe tha:

“Të dashur Alisa dhe Maksimilian, këtu, para jush, është dhurata e xaxha Antoninit dhe unë besoj se ai do të donte t’ju thoshte dy fjalë. Për sa më përket mua, zotëria këtu që ka bërë tortën, më tha se edhe ata minijerëzit e vegjël aty janë të ngrëshëm.”

“Pra, të dashur Alisa dhe Maksimilian, të dashur miq,” mori fjalën doktori. “Kjo është dhurata ime e martesës për ju dhe, duhet të them se është më e bukur dhe më e madhe, sesa e prisja. Para shumë vitesh unë i kam bërë një vaksinë Alisë kundër... kundër...”

“Tetanoz, xaxha, kundër tetanozit,” e ndihmoi Alisa.

“Po, tamam, kundër tetanozit” tha doktori. “E shikoni unë e mbaj mend akoma”. Ai ndaloj për të vështruar rreth dhomës. “Por unë nuk do t’ju mërzis me histori familjare, unë, thjesht, doja të thosha se, kur ia bëra atë injeksion, ajo pati aq frikë, sa u rras në një dollap të mbushur me dokumente dhe s’ishte e mundur ta bënim të dilte jashtë. I përzjeu e i bëri aq rrëmujë, saqë më është dashur

një javë për t'i renditur e sistemuar. Nuk është një histori shumë e vjetër, prandaj unë ju uroj të dy, tani, në këtë ditë të lumtur, të cilën, unë shpresoj ta kujtoni në momentet, kur jo çdo gjë do të shkojë ashtu si do të donit ju. Pra, edhe një herë, unë ju uroj gjithë të mirat dhe do të doja të falënderoja edhe pastiçerin mjeshtër Svoboda, i cili më dha idenë për t'ju dhuruar të sapomartuarve një tortë. Kjo është, me të vërtetë, një vepër arti dhe është më e madhe nga sa e imagjinoja. Tani, krijues i saj, vetë mjeshtri pastiçer Svoboda dëshiron t'ju thotë dy fjalë. Dhe mos u habitni, nëse ai do t'ju quajë vëlla ose motër. Kështu, zoti Svoboda?"

Pastiçeri doli para krijesës së tij prej marzipani, u përkul në shenjë përshëndetjeje, nxori nga xhepi një copë letër të palosur disa herë dhe filloi të lexonte me zë të dredhur:

"E nderuar nuse, i nderuar dhëndër, i nderuar doktor, të nderuar e të dashur miq, të dashur vëllezër e motra! Rrallë më qëllon të marr një porosi, të cilën kam qenë i lumtur ta përmbush, si kjo nga i respektuari zoti Lukavski, të cilin shpresoj të mund ta quaj mikun tim. Megjithatë unë s'ju kam takuar asnjëherë personalisht, motër nuse dhe vëlla dhëndër, ose ndoshta, pikërisht për këtë arsye, unë i dhashë vetes liri të shprehja në krijesën time cilësitë simbolike universale të martesës".

Pastiçeri u përkul përsëri dhe u kthye në mënyrë që të kishte nga një anë audiencën dhe në anën tjetër krijesën e tij.

"Siç e keni vënë re, me siguri, ky pallat ka tri histori. Më e larta simbolizon qiellin, prandaj ajo përmban shenjtoret, engjëjt, Zotin dhe qenie të tjera të mbinatyrshme dhe ju e shikoni, është ndërtuar e tëra në të bardhë duke përdorur marzipanin dhe kremin e rrahur, panën për zbukurim. Kjo është e ashtuquajtura fushë mbitokësore, e cila është përtej nesh dhe përmbi unin tonë. Ndoshta ne do të arrijmë aty dikur. Tani, ju lutem, vini re – çdo shtresë mund të hapet, në mënyrë që ju të shikoni brenda."

Mjeshtri pastiçer vështroi të pranishmit dhe ngriti çatinë e

tortës që ata të mund të shikonin figurat e vockla brenda, të cilat dukeshin si të përfshira në bisedë me njëri-tjetrin.

“Niveli tjetër është i yni, niveli tokësor. Këtu ne kemi nusen të stilizuar, dhëndrin dhe dasmorët gjithashtu. Ju e shikoni që ngjyra është gri që, natyrisht, është krijuar me një përzierje kafeje. Pra është sfera jonë tokësore, siç jua thashë. Dhe tani, kemi shtresën e fundit ose katin përdhes. Siç mund ta shikoni, ai është ngjyrë kafe e errët, kjo është historia çokollate dhe, po të doni, ata që parapëlqejnë çokollatën duhet ta kenë vëmendjen këtu. Përmes dritareve ju mund shikoni djajtë, satanatë, një ose dy dragonj. Kjo simbolizon nëntokën, nënbotën, jetën e përtejme. Unë ju rekomandoj, në mënyrë të veçantë, këtë nivel. E kam përgatitur krem-çokollatën sot në mëngjes duke përdorur recetën time personale” tha zoti Svoboda. Tani, ai nuk e shikonte më letrën, ku kishte shkruar ligjëratën e tij.

“Duke e këqyrur nga prapa, këtu, më kujton edhe diçka tjetër, zoti Svoboda” tha doktor Lukavski.

Pastiçeri u përkul përsëri dhe tha: “Vëzhgim shumë i vëmendshëm, doktor vëllai, shumë i vëmendshëm. Nuk duhej të prisja më pak, pas të gjithave. Sigurisht s’duhej të prisja asgjë më pak.”

“Pra, kam të drejtë apo jo?” këmbënguli doktori. “Më kujton diçka, por nuk e di se çfarë.”

“Si mund të ishte ndryshe, vëlla doktori është një person shumë i vëmendshëm” u përgjigj pastiçieri. “Unë personalisht mendoj se ai, këtu është në nivelin më të lartë, vërtet mendoj kështu, ai është në krye. Shpirti i tij është i mbushur me dhembshuri, mmh... dhembshuri. Unë e di dobësinë e tij dhe unë besoj se ai parapëlqen çokollatën para panës, e cila është në katin më të poshtëm, në strofullën e Djallit, kështu që ai duhet të zbresë në nënbotë, mmm... Por, për t’iu përgjigjur pyetjes së vëllait, kush prej jush është vëzhgues më i mprehtë, mund të ketë vënë re se pjesa ballore

është frymëzuar, nëse mund të shprehem kështu, nga kisha e Shën Injacios në Sheshin e Karlit dhe zbukurimi e frymëzimi për shenjtorët vazhdojnë po në atë frymë. Natyrisht, dhe kjo është e papritur, pjesa kryesore, pjesa kryesore, nëse do të keni mirësinë, ajo që ju tërhoqi vëmendjen, doktor vëllai, është katedralja e papërfunduar në Pragë, ajo që u la papërfunduar nga Vinklavi. Unë s'jam i sigurt cili – i Treti apo i Katërti, që kanë mbetur të papërfunduara prej qindra vjet në kopshtin, prapa statujës së Jungmanit. Ju e dini për cilën e kam fjalën. Pra, kjo katedrale është aty dhe unë mendoj se do t'ju pëlqejë të gjithëve. Gjithashtu, unë do të doja të theksoja se e tërë ajo katedrale e kombinuar, pallati dhe kështjella e tortës është ndërtuar në vazhdimësi, kështu që, siç e shikoni, ajo nuk mund të çmontohet. Pikërisht këtu, pranë saj, unë kam vendosur një turrë kutish portative dhe çdo kuti vendoset, saktësisht, një pjesë të tortës. Pra, kini mirësinë, mos e prisni në feta! Vërtet, jo me feta, sepse mund të shembet e gjithë struktura. S'ka nevojë ta prisni, vetëm çmontojeni. *Çmon-to-je-ni!* Motër nuse, vëlla dhëndër, unë ju uroj gjithë të mirat” pastiçeri përfundoi ligjëratën e tij me një përkulje.

Teksa të gjithë duartrokisnin, Alisa u afrua dhe e puthi në faqe. Pasiçeri dukej i habitur. “Është në dorën tuaj, motër nuse, në cilin kat do ta përfundoni. Gjithçka varet prej jush.”

“Oh, lëreni tani,” tha Alisa. “Varet nga të dy ne, nga unë dhe Maksi.”

“Po, natyrisht, këtë doja të thosha, këtë kisha parasysh,” tha pasiçeri.

Pastaj, Alisa iu hodh në qafë doktorit dhe të ftuarit filluan t'i vinin rrotull tortës duke vështuar brenda dritareve, këqyrnin shenjtorët në kamaret e fasadës dhe thithnin aromën e këndshme të kakaos, të kafes, të arrave të kokosit. Ndërkaq pasiçeri mjeshtër dhe ndihmësi i tij u përshëndetën me të pranishmit, ndërsa Alisa, Maksimiliani dhe doktor Lukavski dolën që t'i përcillnin deri në

rrugë. Mjeshtri me ndihmësin e vet hipën në makinën që ishte parkuar përballë ndërtesës dhe u nisën.

Kur ata u larguan, Alisa pyeti: “Po si i gjete, ku i peshkove, xhaxha?”

“Cilët? pyeti doktori. “Pastiçerin apo tortën?”

“Të dy,” tha Maksimiliani, duke mbajtur Alisën për dore.

“Oh, ai është i yni,” tha doktori. “Është një pacient shumë interesant. Një herë tjetër do t’ju tregoj më shumë për të, nëse ju, vërtet, jeni të interesuar” Ai vështroi Alisën dhe shtoi: “Do t’ju tregoj më shumë, sapo unë vetë të mësoj diçka më shumë për të.”

Ndërkohë, i ati i Alisës i mblodhi të ftuarit bashkë dhe ata dolën për të shkuar në sallën e ceremonisë së martesës.

Nëpunësi i gjendjes civile kishte veshur me kostum të zi dhe mbante një zinxhir floriri në qafë. Ai doli jashtë që të mirëpriste të ardhurit dhe t’i tregonte secilit vendin, ku duhej të qëndronte dhe, brenda pak minutash, do të fillonte ceremonia. Megjithëse ata kishin porositur sallën më të vogël – më shumë se gjysma e vendeve ishin bosh.

“Bukur, ju keni menduar një ceremoni martese të vogël dhe të këndshme, kështu?” vuri në dukje nëpunësi.

“Po të vinin të gjithë të afërmit e mi këtu, zotëri,” u përgjigj Maksimiliani, “një familje e ngritur në statusin e kontit që në 1716 nga Perandori Karli VI, pasi ishte konfirmuar si aristokrate që në 1578, ne s’do të na merrte as salla më e madhe në Pragë.”

“E kuptoj,” tha nëpunësi fare thatë. Buzëqeshja e tij u zhduk.

“Falë Zotit, republika jonë socialiste ka siguruar barazi për të gjithë, zotëri. Lavdi Zotit!”

“Uh, oh,” Alisa i pëshpëriti babait me buzë të rrumbullakosura. “Nuk më duket një fillim i mbarë.”

“Çfarë nuk shkon?” pyeti ai.

“Maksi po i jep atij komunistit leksion aristokracie.”

“Ah, lufta e klasave në praktikë” ndërhyri xhaxhai.

“Mirë, por ai ka të drejtën e vulës që na duhet neve” tha Alisa, e vrenjtur.

“Unë s’kam asgjë kundër republikës,” dëgjoi Maksin të thoshte. “Ajo që më shqetëson mua është se emblema e shtetit iu kundërvihet rregullave themelore të heraldikës.”

“Cilat rregulla?” pyeti nëpunësi.

“Të heraldikës,” përsëriti Maksimiliani. “Është shkenca që studion sistemin e krijimit të emblemave familjare dhe të emblemave të shtetit”.

“Pra, si i kundërvihet shteti ynë këtij sistemin heraldik apo si quhet ai?”

“Është një fakt, përgjithësisht, i njohur që luani çek nuk mund të ketë emblemën sllovaqe në gjoksin e tij, sepse në qendër gjithmonë duhet të jetë emblema e dinastisë sunduese”

“E dinastisë sunduese?”

“Po”.

“Më falni, zotëri, por ne s’kemi dinasti sunduese. Ne kemi qeverinë e popullit, nëse ju nuk e keni vënë re.

“Sigurisht, ky është problemi.”

“Cili është problemi?”

“Përderisa ne nuk kemi një dinasti sunduese, emblema e shtetit duhet të ndahej në gjysma ose çerekë, kështu pjesa çeke dhe sllovaqe të ishin të barabarta.”

Nëna e Alisës po ndiqte debatin nga qoshja e sallës. Kur e kuptoi për çfarë po flisnin, ngriti sytë lart dhe u drejtua për nga Jozefi. E kapi pas mëngës dhe i bëri shenjë me sy të dilte, sepse kishte diçka për t’i thënë.

“Çfarë po bëhet këtu, Jozef?”

“Asgjë, Kvéta. Thjesht, një diskutim, vërtet, interesant”.

“Një diskutim interesant? Ti nuk e harruar se vajza jonë ka ardhur këtu për martesën apo jo?

“Po, dhe çfarë do ti të bëj unë?”

“T’i japësh fund në ndonjë mënyrë, që ata të mos arrijnë në betejë.”

“Po si të bëj, saktësisht?”

“Nuk e di!”

“Çfarë t’u them unë atyre?”

“Çfarëdo, s’ka shumë rëndësi se çfarë. Oh, Jozef!” Kvéta u kthye dhe përplasi thembrat në dysHEME, duke ndërprerë Maksimilianin dhe nëpunësin.

“Zotërinj, a mund të fillojmë? Martesa është një ngjarje e madhe – nusja dhe të gjithë ne jemi disi të shqetësuar. A nuk jeni i shqetësuar edhe ju, zotëri? Po ti Maksimilian çfarë po bën? Unë mendoj se nuses gati po i bie të fikët. Meqë ra fjala, zotëri, unë jam...”

“Ju jeni nëna e nuses.”

“Keni një kujtesë të shkëlqyer, zotëri. Si i mbani mend të gjithë, kaq shumë njerëz që vijnë këtu çdo ditë. Unë s’mbaj mend shumë gjëra as pas një dite, por, natyrisht, unë tani po plakem.”

“Nuk e besoj, zonjë, gjithsesi, ju jeni një grua shumë e hijshme” kundërshtoi nëpunësi. Kvéta e zuri për krahu dhe e shoqëroi për nga tavolina e pijeve.

Dalëngadalë, pjesa tjetër e të ftuarve u bënë grupe grupe dhe hynë në sallën e ceremonive nën tingujt e muzikës që vinte nga një kasetofon. Nëpunësi i gjendjes civile zuri vendin e vet pas tryezës ceremoniale; medaljoni i tij zyrtar me emblemën shtetërore të gdhendur në të, varej në zinxhirin e larë me ar që mbante në qafë. Një farë nervozizmi ndihej akoma – nëpunësi u mëshonte shumë të gjitha fjalëve që kishin të bënin me socializmin në ligjëratën e tij drejtuar të sapomartuarve. Maksimiliani dhe Alisa ndërruan unazat për herë të dytë, puthën njëri-tjetrin edhe një herë dhe nënshkruan dokumentin e martesës për herë të dytë. Pastaj, edhe dëshmitarët bënë të njëjtën gjë dhe, kështu, ceremonia u krye.

Ndërkohë që po ndaheshin, nëpunësi u afrua tek Maksimilianit.

“Ishte interesant debati për atë emblemën shtetërore. Ishte një histori interesante!”

“Përse” e pyeti Maksimiliani. “Çfarë keni parasysh?”

“Epo, unë kam lindur në Banska Bistrica dhe jam sllovak.

Të gjithë u kthyen në shtëpi, nusja dhe dhëndri ndërruan veshjet e tyre, burrat liruan kravatat dhe Kvéta u ul pranë burrit të saj në divan, në dhomës e ndenjes. Sapo u mbledhën shumica e të ftuarve, Maksimiliani tringëlli me një lugë në gotë dhe, në emër të vet e të gruas falënderoi të gjithë që kishin nuk e kishin denoncuar ceremoninë e martesës në kishë. Pastaj Alisa u ngrit dhe i ftoi të gjithë për darkë në një restorant aty afër. Pas Alisës, u ngrit halla e saj, Ana dhe, me lot në sy, filloi të kujtonte fëmijërinë dhe adoleshencën e mbesës. Ajo sapo kishte nisur të tregonte historinë, kur xhaxha Antonini e ndërpreu menjëherë duke thënë se prindërit e Maksimilianit nuk jetuan për të parë dasmën e tij dhe të gjithë ngritën një dolli për nder të tyre. Halla e Alisës u përpoq të rifillojë kujtimet e saj pas dollisë, por të ftuarit, tashmë, e kishin humbur interesin për historinë e saj dhe filluan bisedën në grupe të vogla.

“Po ti, përse nuk the ndonjë gjë, Jozef?” e pyeti Kvéta të shoqin. “Tek ceremonia, përse nuk ndërhyre, kur e more vesh se ai ishte komunist?”

“Ç’rëndësi ka tani? Nuk ndodhi ndonjë gjë.”

“Por mund të ndodhte. Ti qëndroje aty si gur kilometrik”

“Unë nuk dëgjova as gjysmën e atyre që thoshin ata.”

“Epo duhej të kishe shtuar volumin e aparatit dëgjimor në vesh.”

“E kisha e bërë edhe këtë.”

“Mendoj se duhet të sigurohesh që bateritë janë të rregullta.”

“M’i ka sjellë Alisa. Kam edhe disa rezervë.

“Pra, ti, me të vërtetë, nuk munde të dëgjoje?

“Po, dëgjova një pjesë.”

“Nuk e dija... A fole me Tondën për këtë?”

“Tonda është psikiatër, jo neurolog dhe as otorinolog.

“E di, por jam e sigurt se ai mund të gjejë dikë. Ai ka shumë të njohur”.

“Janë probleme pleqërie, Kvéta. Askush s’mund të bëjë gjë, as të njohurit e Antoninit”.

“Oh, të lutem, lëri këto... Pra ti nuk ke ndërmend të kthehesh Jozef?”

Jozefi u kthye vështroi sytë e saj të thellë jeshilë dhe tha: “Nuk e bëj dot, Kvéta. Akoma nuk mundem”

“Po përse nuk the gjë? Unë po bëja gati gjithçka që ti të kesh një dhomë për vete.”

Jozefi i vuri Kvétës dorën në sup, u ngrit nga divani dhe doli nga dhoma. Dalëngadalë mysafirët filluan të dalin e të drejtohen për tek restoranti dhe në orën tetë, në kohën e duhur, pas disa dollish, u shtrua darka. Aty s’kishte më shumë se dymbëdhjetë ose pesëmbëdhjetë vetë. Dhoma u boshatis rreth orës dhjetë. Ishte e martë dhe njerëzit duhej të shkonin në punë të nesërmen. Ky ishte shkaku për pjesën më të madhe të mysafirëve që u larguan, megjithëse ata do të kishin dashur të rrinin më gjatë me çiftin e ri. Personi i fundit që u largua ishte i ati i Alisë. Ai pagoi faturën dhe ata të tre u kthyen në shtëpi. Kur arritën në hyrjen e pallatit, Maksimiliani dhe Alisa i uruan natën e mirë babait duke i thënë se ata do të bënin një shëtitje para se të binin për të fjetur.

“Dita e martesës suaj një herë vjen dhe, për çdo rast, ju i keni çelësat. Ceremonia në kishë ishte shumë e këndshme. Ajo ishte një ide e mirë, një ide e shkëlqyer. Pra, gjithçka në rregull?”

“Absolutisht, zoti inxhinier” tha Maksimiliani.

“Absolutisht? Më bëhet qejfi. Po ti Alisa?”

“Unë jam e kënaqur si ai, baba”

“Ishte, vërtet, këndshëm”

“Po, ishte diçka që ia vlente, baba”

“Po përse nuk e la të hynte brenda atë turistin e shkretë?” pyeti babai. Maksimiliani ngriti supet.

“Nga e njihje ti atë priftin? Unë desha ta pyesja, por e pata të vështirë për disa arsye.”

“Nuk m’u desh shumë për ta bindur. Ishte ai që varrosi babain tim. Ishte i lumtur ta bënte këtë. Në fakt, ishte një ide e tij. Unë desha ta ftoja në dasmë dhe ai shfaqti dëshirën ta bënte vetë ceremoninë.”

“E kuptoj” tha babai. “Mirë atëherë, unë po shkoj të shtrihem tani dhe mos harroni: ka shumë ushqime aty dhe gjërat më të mira i kanë vënë në një frigorifer të vogël. Mos harroni t’i hani. Madje edhe sonte, nëse doni. Unë do ta fik makinën time të vogël të dëgjimit dhe kambanat s’më zgjojnë dot. Vetëm mbylleni me çelës dhe merrni çfarë të doni.”

“Mos kij merak dhe shko shtrihu tani, baba,” tha Alisa dhe e puthi të atin në faqe. Ai ia shtrëngoi dorën Maksimilianit, u kthye dhe hyri brenda, ndërsa të sapomartuarit dolën për shëtitje. Ata kaluan nëpër ca rrugë përmes parkut, por, shumë shpejt, filluan të ndiejnë të ftohtë dhe vendosën të kthehen. Babai i Alisë, tashmë, kishte fjetur.

Alisa përpiquej të qëndronte zgjuar, teksa Maksimiliani lante dhëmbët në banjë, që t’i thoshte natën e mirë dhe... Kurrë s’do ta imagjinoja... se të qenët e lumtur... do të më bënte... mua... pra... duke qenë... e lumtur... mund... të isha... kaq... e lodhur...

2. Pasticëri

Shoferi i makinës së policisë i tundi dorën rojës, i cili preku flokët e tij në ngjyrë hiri me gishtin tregues si shenjë e një përshëndetjeje simbolike të zakonshme dhe, meqenëse kishte dalë dielli, në vend që të shtypte butonin që lidhte kabllon dhe çonte rrymën elektrike në mekanizmin që ngrinte portën, roja e portës, u ngrit vetë nga karrigia. Ishte këndshëm jashtë, dielli shkëlqente dhe ai mund të lëvizte pak. Eci nëpër trotuarin prej betonit, të zbukuruar me vazo lulesh, u përkul që të arrinte të prekte prapa portës që nga jashtë butonin dhe e shtypi. Ishte e premtë dhe ora mbi kokën e tij tregonte fiks pesë e dyzet e tre e mëngjesit. Tundja e ngadaltë e dorës së policit dhe përshëndetja e ngadaltë e rojës u bënë aq lehtë, saqë as mjellmat në liqenin po me atë emër, nuk do të turbulloheshin. Gjesti dembel i policit që nga timoni, paraqiste një shprehje të një stili të lartë lodhjeje nga turni i natës, megjithëse ai e kishte lënë pas, pothuajse po mbaronte turnin, njëfarë shpërfilljeje e lehtë dhe, në të njëjtën kohë, një këndvështrim demokratik autoritar, i cili, megjithatë, dallonte nga barazitizmi.

Përgjigja e rojës në kohën e duhur, gjesti i tij, pikërisht, në kohën e duhur, tregonte një respekt të matur për autoritetin e shoferit të makinës së policisë që po sillte *ata* - po *ata*, meqenëse, siç e dinë të gjithë, portieri është, gjithashtu, pjesë e procesit terapeutik – jo pacient, si në të kaluarën, por klient, siç quhen ata tani. Pjesë e qenësishme e koreografisë së rojës ishte lëkundja rastësore e gjunjëve - meqë ra fjala, roja kishte hyrë për shtatëdhjetë këtë vit dhe kishte vitet të tëra që bënte këtë punë dhe

kishte shumë në jetën e tij – komponenti thelbësor i lëkundjes së rastësore të gjunjëve të rojës ishte një tundje e parëndësishme, gati e paperceptueshme, mbi taka, çështje sekonde. Kjo gjë e bënte të qartë, cili komandonte ishte aty.

Dhe, natyrisht, në fund, erdhi karta e fortë - atu, ai nuk do të qëndronte në kabinën e tij të rehatshme duke vështruar botën jashtë, do të dilte nga kabina jashtë dhe pa denjuar t'u hidhte sytë policit, as oficerit të SNB-së, që ishte ulur në timon, ai, thjesht, u kthye ngadalë anash dhe shtypi butonin nga jashtë, gjë që bëri mekanizmin elektrik të ngrinte portën. Sigurisht roja nuk mendoi dy herë për të, ashtu si Paganini nuk mendoi dy herë, si do ta luante vibraton në koncert, ajo erdhi automatikisht, si rezultat i përvojës virtuoze të jetës së tij. Ti s'ke çfarë të bësh fare për këtë, djalosh, edhe nëse ti solle një major nga regjimenti i parashutave. Dhe ecja elastike drejt kabinës së rojës në mjegullën është një kartë atu dyfish e garantuar, ose një xhol, po të doni. Ajo tregon ju që ju keni kontrollin në portën kryesore në orën pesë e dyzet e katër minuta fiks, i dashur!

Dhe kështu porta e hekurt e hyrjes kryesore në qendrën e trajtimit psikiatrik nisi të ngrihej, falë mekanizmit elektrik të prodhuar jashtë shtetit: tingëllimi i tërheqjes së vajisur mirë në mëngjesin e mjegullt ishte elegant. Ai i kujtonte disi turbull rojës macen e Angorës, gjithmonë të ushqyer mirë, të fqinjit, e cila, aq sa mundej, s'bënte gjë tjetër, vetëm hante, pinte qumësht, flinte dhe gërhiste. Dembelja e përkëdhelur s'bënte asgjë tjetër gjatë gjithë ditës. Makina e policisë hyri në kompleksin e spitalit – roja u rrotullua mbi taka përsëri dhe tani, më në fund, dita mund të fillonte me sukses.

Makina u tërhoq mbrapa dhe ndaloj tek pavijoni ngjyrë rozë. Oficeri i sigurimit doli nga makina, e përplasi derën, u kthye dhe vështroi dy kolegët e tij, të cilët ishin ulur në vendet e pasme me një burrë të vogël ndërmjet tyre, pastaj u kthye përsëri nga godina,

u afrua tek dera kryesore dhe i ra ziles. Ai priti pak duke rënduar sa në një këmbë – në tjetrën. Nga mënyra se si lëvizte dukej qartë se përqendrimi i tij po pakësohej. U dëgjua zhurma e hapave dhe, pastaj, një burrë me pardesy të bardhë dhe pantallona linoje hapi derën, duke nxjerrë jashtë një rrymë ajri me erë të theksuar institucionale në fladin e butë të mëngjesit. Ajo hyri në flegat e hundës së policit pa u merakosur të pyeste, nëse ai e pëlqente apo jo, duke i kujtuar korridoret e gjata të institucionit.

Korridoret me muret e ndara nga një brez i lyer me bojë vaji që shkonte horizontalisht në nivelin e syrit. Muret që lahen, dyshemetë me pllaka, ngjyrat jeshile e të verdha i dhanë dhimbje koke oficerit të policisë. Ai s'kishte menduar ndonjëherë gjatë për këtë, por ajo erë iu duk e pakuptimtë. Dezinfektuesi i lirë e ndaloi trenin e mendimeve të tij dhe e çoi në skaj. Po të mundej, ai do të shndërrohej në një kafshë ekzotike joekzistuese dhe të bënte diçka për të mos e thithur atë bombë ajri mashtrues të dezinfektuar keq. Ai do t'i kishte mbyllur rrugët e frymëmarrjes si një zhytës ose si një kafshë nga një planet imagjinar, ose të mbushte sternën e tij të oksigjenit plot dhe të vendoste një periskop, në mënyrë që ai të mund të ecte nëpër korridoret e gjata jeshile e të verdha si një zhytës nënujor. Megjithatë, tani, polici i komunikoi burrit me të bardha fakte, të cilat përbënin perandorinë e universit institucional.

Ai e informoi personin që qëndronte përballë tij, për fakte të pakundërshtueshme, fakte për mbërritjen e një qytetari të ndaluar, fakte që vërtetojnë ekzistencën e një trupi të gjallë të ndaluar, tre persona nga autoritetet dhe një makinë. Këto përcaktime dhe përrshkrime lanë, i dhanë bisedës së shkurtër shijen e një takimi të ndërmjetësve mesjetarë nga një perandori e zhdukur prej kohësh, të cilët, papritur dhe para kohe, nën qeverisjen e ca autoriteteve perandorake ose hyjnore, të panjohura për ta, mendojnë të prezantojnë e të organizojnë implementimin e ligjit të Keplerit mbi lëvizjen planetare, të cilin asnjëri prej tyre nuk e kuptonte

mirë ose të dy ata e kuptonin vetëm disa, pak a shumë. Ata duhej të organizonin bashkimin e dy perandorive të ndara, në përputhje me ligjet që ata as nuk i njihnin, as nuk i kuptonin. Duhej të siguronin dorëzimin e një dhurate të veçantë, një ritual special fejeje midis zogjve, në të cilin s'kishte kërcime ose lutje. Dhe, ndërkohë, të dy pragmatistët e vjetër, madje edhe kur diskutonin detajet e instruksioneve, mendjen e kishin larg prej aty.

Të dy burrat hynë dhe, nga brenda, u dëgjua zhurma e mbylljes së derës. Infermieri që shoqëronte oficerin e policisë, ecte përpara. Pas disa metrash ata ndaluan para një dore, të cilën e hapi burri me pardesy të bardhë. Ai e futi policin brenda, pastaj u fut dhe vetë dhe mbylli derën me çelës. Polici kishte qenë këtu disa herë dhe ishte i kënaqur që kishte, jo vetëm uniformën e tij, por edhe armën. Arma e tij me numrin shtatë në depo, megjithëse në siguresë dhe e vendosur në këllëfin e saj, e mirëmbajtur dhe e dashur, i jepte atij një ndjesi të vërtetë fuqie, të cilën, kohë pas kohe, ai e ndiente të përhapej në shpirtin e tij. Fuqi e vërtetë, jo letra dhe vula gome, jo plotësime formularësh, jo trajnim dhe mësim rregullash e ndryshimesh përmendësh: pistoleta e tij, e mirëmbajtur, e dashur për të – kjo ishte fuqia e vërtetë.

Nëse eprorët e tij do të dinin më shumë mbi botën e ideve të tij dhe, mos e dhëntë Zoti, për mendimet e tij private, me siguri do të kishin arsye për t'u shqetësuar. Megjithatë ai kishte mësuar diçka themelore. Kishte mësuar se forca e vërtetë, nëse mjekët e mbyllin ose hapin derën, ishte duke dremitur në këllëfin që varej nga rripi i mesit të uniformës së tij dhe ajo ishte forca e vërtetë me numrin shtatë. Numri i fishekëve në karikator ishte thelbi i forcës së tij. Pastaj ai u kujtua që oficeri komandues, tashmë, ka ndërmjetësuar gjithçka që më parë dhe ia ka ngulitur në mendje nevojën për t'i folur doktorit shkurt dhe qartë. Dhe polici këtë kishte ndërmend të bënte.

Megjithatë, minutën e fundit, diçka kishte ndryshuar dhe,

para se të largoheshin nga rajoni i policisë, dikush telefonoi nga spitali dhe u tha atyre të mos shkonin tek pranimet, por drejt e këtu, në pavijonin ngjyrë trëndafili. Dikush, diku ua kishte kujtuar menjëherë se ata kishin kartelën mjekësore të të arrestuarit, kështu që ata erdhën këtu dhe polici, tani, ishte aty. Procedura nga njëra anë, gjithmonë e habiste oficerin e sigurimit, nga ana tjetër – ia shteronte forcat, por, në të njëjtën kohë, e bënte të ndiente se puna e tij është e rëndësishme. Ai ishte i vetëdijshëm prej kohësh që nuk ishte vetëm kapja e kriminelëve, ose ruajtja e rendit, ose ndonjë ide abstrakte e ligjit. Ai gjithnjë e më tepër i ngjante një funksionari dhe nuk ishte i sigurt, nëse duhej të ishte ashtu. Mungesa e qartësisë, me të cilën s'merrej askush, e pezmatonte. Të dy burrat u afruan tek një derë tjetër e mbyllur, e cila ndodhej në mes të korridorit të gjatë. Njeriu që shoqëronte trokiti në derë dhe po priste. Nuk pati përgjigje dhe, pas pak ai i hodhi një vështrim shfajësues. Kur trokiti herën e dytë, dera u hap. Në anën tjetër ishte një burrë tjetër me pardesy të bardhë dhe me pantallona të bardha lino, doktori. Ai e hapi derën fort, i tha infermierit se mund të largohet dhe i tregoi policit një karrige. Ai u ul, falënderoi doktorin me një shenjë me kokë, zbërtheu xhepin e brendshëm të uniformës së tij dhe nxori një *bloc-notes* të vogël. Doktori i ofroi atij cigare dhe kafe, por ai i refuzoi të dyja. Megjithëse polici kishte menduar se ai, thjesht, do t'i dorëzonte doktorit të arrestuarin, doli që çështja ishte më e ndërlikuar, sesa e mendonte ai. Zëvendësshefi i SNB-së së rajonit të zonës ia kishte shpjeguar rastin në detaje, në telefon, njërit prej doktorëve të këtushëm, por, në atë moment, nuk gjendej askund ai doktor. Duke parë e dëgjuar disa telefonata të doktorëve të tjerë që përpiqeshin ta gjenin atë, polici filloi të kuptonte se nuk kishte zgjidhje tjetër, përveç se të përpiqej ta shpjegonte vetë të gjithë problemin. Atij nuk i pëlqente kjo, sepse kjo do të thoshte ndërlikim të çështjes, por në atë kohë, ai rrinte indiferent, duke shtrënguar bllokun e tij në dorë dhe duke vështruar nga dritarja e

madhe me shufra, degët e pemës që valëzonin jashtë. Ai nuk mund ta dëgjonte erën. Mund vetëm të shikonte lëvizjen e gjetheve, degët dhe, më tej, rrugën e asfaltuar.

Nga sa kishte raportuar në proces-verbal zonja Marhulova, fqinja e pastiçerit Svoboda, tashmë i arrestuar, i kishte telefonuar rajonit të SNB-së, sipas dosjes së policisë, në orën dy e tridhjetë e tre të mëngjesit. Duke pasur parasysh se ajo ishte një grua e moshuar – mbi shtatëdhjetë vjeç dhe s’kishte thënë ndonjë gjë të pazakontë, askush nuk i kushtoi vëmendje. Zonja Marhulova ishte një vejushë, e cila jetonte me një qen pinsher të vogël dhe korridori i shtëpisë së saj i ngjante një muzeumi të vogël fshati. Aty ishin rafte me mostra mineralesh të ekspozuara dhe një tjetër me shishe të vogla kristali të ngjyrave të ndryshme. Në mure vareshin disa piktura dhe vizatime që tregonin pamje të qytetit nga perspektiva të ndryshme dhe një vizatim i pambaruar i stacionit të trenit në ndërtim që aty dukej pa vend.

Znj. Marhulova u uroi mirëseardhjen oficerëve, por ajo nuk i ftoi në dhomën e ndenjes, as në kuzhinë dhe i informoi ata që kishin ardhur më shumë se njëzet minuta më vonë nga ç’i kishin thënë kolegët e tyre në telefon. Të dy oficerët u ndien ngushtë, të shtrënguar midis rafteve. Së pari sepse qeni i saj filloi t’u vinte rrotull duke i nuhatur dhe së dyti, sepse xhamat e rafteve dukeshin të brishta, të rrezikshme dhe gati për t’u thyer në mijëra copa të vogla në çdo moment. Ishte e vështirë të shmangeshe pinsherit me raftet-vitrina nga tri anë dhe zonjën Marhulova nga e katërta. Pastaj zonja e moshuar vendosi t’u jepte një leksion mbi koleksionet minerale dhe bazat gjeologjike të qytetit e të rrethinave.

Fillimisht, polici mendoi se ajo, thjesht, po tregohej e sjellshme, por ndërkohë që po kuptonin çfarë po ndodhte, atyre u erdhën deri në grykë shpjegimet e shtresave tektonike, frakturat dhe bazat gjeologjike. Nuk ishte e lehtë ta ndërprisnin leksionin e saj dhe jo

më ta refuzonin. Oficeri që kishte më shumë përvojë me vështirësi u përpoq ta kthente temën e bisedës tek shkaku, për të cilin ajo u kishte telefonuar. Asaj nuk i pëlqeu ndërrimi, por e përfundoi bisedën e saj, duke thënë që, siç mund ta shikonin, këto mostra, të cilat i kishte koleksionuar burri i saj dhe pikturat që ka bërë ai, tregojnë se qyteti dhe rrethinat e tij ishin unike. Unike! Ajo e përsëriti fjalën disa herë duke ngritur përpjetë gishtin tregues. Unike! Ndërkaq mostrat e mineraleve ndriçonin si llamba përmes xhamit të rafteve, pothuajse sikur të ishin fosforeshente. Çdo pjesë ishte vënë në një çentro të vogël dhe secila kishte një etiketë, që tani mezi lexohej, me emrat e tyre çekë e latinë.

Para se polici të gjente mundësinë të pyeste, ajo u tha se arsyeja që vizatimet e hekurudhës së pambaruar ishin varur në mur ishte se burri i saj i ndjerë nuk pati mundësi t'i përfundonte ato. Kur u duk sikur ajo do të përshkruante muajt e fundit të jetës së saj në spital, oficeri më me përvojë vendosi ta udhëzonte atë ta mbyllte qenin në dhomën tjetër ose ata do të largoheshin. Kjo gjë provokoi reagimin që shpresonte ai. Zonja e moshuar u fye nga mungesa e respektit të tij për një të moshuar dhe, më në fund, doli aty ku duhej. Kur foli për vdekjen e të shoqit, s'kishte më asnjë aluzion emocioni, kurrfarë ndjenje dhimbjeje ose trishtimi – ishin shuar me kohë. Ajo që përshkroi plaka shtatëdhjetëvjeçare ishte më shumë si një leksion në një muzeum historik, sesa një përshkrim i zakonshëm. Dëshira e saj për ta mbajtur ish-martesën e saj të admirueshme ishte shumë e madhe dhe, njëkohësisht, ishte objekti më pa interes për të dy oficerët. Asaj nuk i shkante ndërmend të formalizonte gjendjen e saj si vejushë, ajo ishte një bashkëshorte e braktisur përkohësisht nga burri i saj i papërgjegjshëm, i cili në një moshë të avancuar në “vitet e arta” të rrjedhjes së tij, kishte humbur sjelljet e mira që ai kishte pasur gjithë jetën e tij dhe, papritur, ishte larguar. Ajo, akoma, e konsideronte këtë si fajin e tij dhe, akoma, e përmbante rrebeshin e qortimeve që ai meritonte

t'i dëgjonte dikur.

Rreth orës një pas mesnate, nga apartamenti ngjitur u dëgjua një ulërimë, ndoshta një grindje, pastaj një qetësi e papritur. Kur njëri nga oficerët e pyeti me një ton skeptik, si ishte e mundur që plaka nuk e kishte dëgjuar, ai mori një shikim qortues dhe një leksion – jo të gjithë njerëzit e moshuar janë të paaftë, siç mendon brezi i ri dhe nuk janë as të çmendur, as komplet të shurdhër.

Kjo e detyroi oficerin të kërkonte ndjesë, të cilën zonja Marhulova e mori si avantazh për t'u thënë atyre t'i hidhnin një sy gurit ndriçues, duke shtuar se argjendi ishte nxjerrë në rrethinat e qytetit në mesjetë. Polici që nuk kishte më oreks për komente të tjera, e ndërpreu duke e falënderuar, doli jashtë në korridor, i raziles dhe trokiti në derën e apartamentit të fqinjit. Kjo e qetësoi atë dhe përmirësoi humorin e saj, më vonë, ajo as që e pranonte të kishte ndonjë kundërshtim ndaj brezit të ri. Gjithçka kishte shkuar siç e priste ajo, siç kishte shpresuar ajo. Ajo qëndronte duke vështruar jashtë përmes hapësirës së derës për pak kohë, por, kur nuk erdhi askush të hapte derën për dy policët, ai me përvojë më të paktë i tha asaj se ata duhej të kontrollonin ndërtesën dhe kopshtin edhe një herë, kështu që ajo duhej ta mbyllte derën në rastin që ndonjë i rrezikshëm ndodhej aty afër. Kjo mund të ndodhte dhe ajo bëri siç i tha polici.

Policët kontrolluan të gjithë pallatin, por nuk gjetën njeri. Kur po kalonin përmes kopshtit, ata panë copa të një gote të thyer, të hedhura nga dritarja e apartamentit, për të cilin u kishte folur e veja. Ata po “krihnin” kopshtin duke e drejtuar dritën e fenerëve elektrikë brenda kaçubave që rriteshin përgjatë murit të kopshtit, kur dëgjuan zhurmën e një gulçimi, një ngushtim e zgjerim dihatjeje kafshe ose organi frymor njerëzor, ndoshta dhe gërvishtje e një “fizarmonike” të mushkërisë. Papritur, pa paralajmërim, ajri i natës u ça prej një tende resh të zeza që u varën mbi tokë. Një dënësë, një britmë, një dihatje, një zbrazje. Çka i habiti policët

më shumë ishte se ajo dënese u drejtohej atyre. Po, kërkonte ata. Kërkonte ndihmë, duke u lutur ta shpëtonin, duke gërthitur diçka si – ata s'mund ta linin vetëm atë, jo vetëm. Zëri lutej, premtonte, ulërinte dhe ankohej, i rraskapitur.

Policët ua hoqën armëve siguresën dhe drejtuan rrezet e dritave të sinjalizimit tek kaçubet, nga vinte zëri. Ata mund ta dëgjonin zërin që vinte nga frymëmarrja, po të mos ishte ndërprerë, dukej se nuk kishte rezistuar dot më gjatë. Rrezet e dritës së dy ndriçuesve të tyre u kryqëzuan, ndërkohë që policët i afroheshin gjithnjë e më shumë burimit të ulërimës. Pa e parë, ata gjykuan se njeriu që bërtiste ishte fshehur pas shkurreve pranë murit të kopshtit. Çdo moment, njëri nga ata kthehej të shikonte mbrapa se mos kishte njeri atje. Kur ata larguan nga rruga edhe degën e fundit të zabelit, para tyre u shfaq një burrë i kruspullosur, me një pallto të pistë ngjyrë kafe.

“Jemi policia,” tha oficeri me më shumë përvojë. “Ç’është gjithë kjo zhurmë që bëni?”

“Policia? tha burri. “Vërtet? Po, ju i keni uniformat.” Kaq munda të thoshte ai, para se t’i binte të fikët. Ndërkohë shumë drita u shfaqën në dritaret e ndërtesës, me pamje nga kopshti.

Kur po e përpiqeshin ta nxirrnin nga shkurret, oficerët e policisë e kuptuan se ai kishte një këmbë të thyer. Pastaj u përpoqën ta kontrollonin, por burri ishte rrasur kaq keq ndërmjet shkurreve dhe murit, saqë ishte e vështirë ta nxirrnin prej andej. Kur, më në fund, ia dolën, oficeri më i vjetër, hapi radiotransmetuesin dhe raportoi se kishin gjetur një burrë të plagosur – kërkoi një ambulancë dhe udhëzimet. Ambulanca dhe një makinë policie arritën shumë shpejt. Për shkak të natyrës së dyshimtë të individit të plagosur dhe dritares së thyer në katin e dytë, pranë apartamentit të zonjës Marhulova, ata vendosën të kontrollonin edhe një herë ndërtesën, kopshtin dhe vendin përreth. Njëri nga oficerët shkoi me të dëmtuarin, kur e çuan në spital, sepse mund të kërkonin të

mbahej protokolli mbi incidentin dhe të merrej një deklaratë prej tij.

“Thyerja e dyfishtë e këmbës së tij mund të jetë rezultat i një rënijeje fatkeqe nga kati i dytë” i tha doktori policit, i cili ishte mërzhitur gjithë mbrëmjen në një zyrë të rajonit të policisë, i nevrikosur që e kishin izoluar aty, në kirurgji, për të ruajtur një njeri që s’kishte kurrfarë mundësie të lëvizte. Ai s’kishte ç’të bënte tjetër pas përshkrimit të thyerjes së dyfishtë dhe, pasi mjeku ia përsëriti dy herë, ai mendoi se s’kishte asgjë të keqe për të dyshuar dhe nxori përfundimin në mendjen e vet: këmba e thyer në dy vende – s’ka ku shkon! Sapo u bë kontrolli i të ndaluarit, polici hyri në dhomë. Burri me këmbë të thyer ishte i shtrirë në shtrat me disa jastëkë të mëdhenj nën kokë dhe, kur pa oficerin, buzëqeshi i kënaqur. Aty ishin edhe pacientë të tjerë meshkuj në atë dhomë, njëri që po përpiquej të kthehej në krahun tjetër në shtrat dhe një tjetër, frymëmarrja e qetë e të cilit u ndërpre nga një gërhitje e rastësishme.

“Do t’ju rrëfej gjithçka” i tha burri këmbëthyer oficerit. “Ju falënderoj shumë. A e kapën atë? Duhet të jetë diku jashtë atje” Polici tundi kokën, tërhoqi një karrige afër shtratit dhe u ul.

Burri që buzëqeshte në shtrat quhej Karel Soushek. Ai ishte hajdut dhe e pranonte që kishte dashur të vidhte në apartamentin e katit të dytë. Ai kishte hyrë në pastiçeri në anë të rrugës, kishte kaluar përmes tij dhe kishte hapur me levë derën që të çonte në katin e dytë, në apartamentin pastiçerit dhe gruas së tij. Hajduti deklaroi, gjithashtu, se ai kishte bërë një dëm minimal, meqenëse kishte sforcuar vetëm një bravë me çelësin kopil që ai kishte përdorur në dyert e tjera. Gjatë bisedës së tij me policin që merrte deklaratën, ai e theksoi disa herë se nuk e kishte e parë kurrë të zotin e apartamentit, pastiçerin Marek Svoboda. Hajduti iu drejtua policit duke i kërkuar, nëse mund të merrte hua një makinë shkrimi – sigurisht që do të gjendej një diku në spital, të cilën s’do ta kishte

përdorte askush gjatë natës apo, tashmë, ishte mëngjes?

Vetëm t'i jepnin një makinë shkrimi dhe ai do t'ia tregonte oficerit të gjitha, do të rrëfente gjithçka, t'i nxirrte nga shpirti i tij. Ai tha se nuk kishte të bënte fare me ndonjë çështje të vështirë. Nuk e njohte fare atë, s'e kishte takuar kurrë në jetën e tij. Kurrë s'i kishte ndodhur diçka e tillë. Kishte qenë në burg dy herë për vjedhje, pra ai ishte shkelës i përsëritur, por vetëm për vjedhje - asgjë më të rëndë se kaq. Gjithçka që duhej të bënte oficeri ishte të shkruante raportin paraprak, ai nuk priste ndonjë rrëfim, askush nuk kishte bërë ndonjë kallëzim për vjedhësin. Por ai s'mund të mos vinte re se, pavarësisht nga buzëqeshja e rastësishme që dukej, herë pas here në fytyrën e tij, hajduti dukej nervoz. Kështu që ai i tha se do të prisnin mëngjesin për t'i marrë pjesën tjetër të deklaramit, sepse ai do të shqetësonte dy pacientët e tjerë që flinin. Vjedhësi pranoi, megjithatë i këshilloi policin, në paktën të bënte disa shënime me dorë që të kishte diçka për të nënshkruar dhe, më vonë, ai mund të provonte që kishte bashkëpunuar që në fillim të hetimit, që në fillim fare, siç e theksoi ai, përsëri, disa herë.

Karel Soushek kishte hyrë në pastiçeri nga ana e rrugës që quhej Hlavsova. Në atë rrugë ndodheshin vetëm tri ndërtesa; pjesa tjetër ishte muri dy metër i lartë përreth kopshtit të ndërtesës, ku kishte hyrë ai. Kështu që atij iu desh ta shqyente derën dhe ky ishte i vetmi dëm që i kishte bërë asaj prone. Ai kishte kaluar përmes pastiçerisë, kishte provuar dy a tri torta, por s'kishte gjetur para në arkë. Ai gjeti derën që të çonte në apartament, në katin e dytë dhe e hapi me levë. U ngjit nëpër shkallë dhe, ndërkohë që po shikonte përreth, pastiçeri Svoboda e kishte kapur duke dalë nga kuzhina. Në fillim hajduti u tremb, por, pastaj, për habinë e tij, pastiçeri e përshëndeti, kaloi pranë tij, hyri në tualet dhe urinoi, madje pa e mbyllur as derën. Pastaj ai hyri në banjë, lau duart me kujdes, i kaloi pranë përsëri, e përshëndeti edhe një herë dhe u kthye në kuzhinë. Hajduti u hutua dhe, i shqetësuar se diçka nuk shkonte, ai

e ndoqi pastiçierin në kuzhinë. Kishte frikë se ai do të lajmëronte policinë. Ndërkohë që hajduti po mendonte si duhej të vepronte, pastiçieri Svoboda doli nga kuzhina për të tretën herë dhe e pyeti, nëse kishte ngrënë gjë akoma dhe, nëse do të donte të hante diçka. Ai kërkoi falje që s'kishte gjë tjetër vetëm djathë, qëkur gruaja e tij kishte ikur, s'kishte pasur mundësi të blinte ndonjë lloj sallami ose diçka tjetër për mëngjes. Hajduti tha se ai e kishte habitur aq shumë, saqë ai vetë e kishte pyetur pastiçierin – si nuk kishte frikë prej tij.

“Përse duhet të kem frikë nga ju?” i tha pastiçieri. “Ne të gjithë jemi vëllezër në vuajtje, unë si pastiçer, ti si hajdut. Dielli nga ngroh të gjithë njësoj.”

“Por dielli nuk ndriçon tani. Është natë” reagoi hajduti.

“Keni të drejtë, vëlla” i tha pastiçieri. “Është natë edhe në shpirtin tim, gjithashtu.”

Pas një pauze, ai shtoi: “Shërbeji vetes, vëlla. Merr çfarë të duash ose çfarë mendon se të pëlqen” Pastaj pastiçieri i kërkoi hajdutit ta linte radion në dhomën e ndenjes, sepse kur dëgjonte fatkeqësitë e botës – përqendrohej më mirë. Dhe ai duhej të ishte i përqendruar për të qenë i aftë në punën e tij. Kështu që hajduti mori ca para, por ai ishte akoma i nevrikosur, meqenëse kjo gjë s'i kishte ndodhur kurrë më parë. Ai mendoi se pastiçieri ishte i krisur, prandaj duhej të merrte ato për të cilat kishte ardhur dhe të zhdukej. Këtë duhej të kishte bërë: ta godiste në kokë dhe të zhdukej. Po të kishte vepruar kështu ai s'do të rrinte shtrirë këtu në spital me këmbën e thyer në dy vende dhe një mori telashesh të tjera.

“Çfarë telashesh të tjera?” e pyeti polici.

“Epo këtu qëndron problemi,” u përgjigj hajduti.

Para se të ikte, ai mori të gjitha paratë që gjeti, por, teksa po zbriste poshtë, pati një ndjesi se kishte diçka që nuk shkonte në gjithë këtë meselë, prandaj u kthye, vështroi përreth, edhe një

herë dhe hapi derën e kuzhinës – e vetmja dhomë, në të cilën s’kishte hyrë. Ai e hapi me kujdes, por pastičeri ndjeu kërcitjen e menteshave dhe iu drejtua atij, me shpinën nga dera, i përkulur mbi tavolinën e bukës, ku diçka po bënte:

“Hyr brenda, vëlla,” i tha ai. “Eja të shikosh laboratorin tim, ku i bëhet jehonë dhe reflektohet kotësia e botës. Eja në guaskën time, në shenjtërinë time. Eja të të përqafoj, para se të nisesësh”

Hajduti nuk e kishte idenë çfarë po thoshte pastičeri apo përse donte ai ta përqafonte dhe nuk e dinte fare, përse po e quante kuzhinën laborator dhe guaskë.

“Mendoj se duhet të iki tani,” tha ai, duke e këqyrur dhomën me shikimin preciz e të stërvitur të hajdutit. Fillimisht ai mendoi se nuk po e kuptonte dot atë që shikonte. Pastaj mendja i tha se kjo s’mund të ndodhë. Aty kishte pjesë trupi të njeriut të shpërndara në të gjithë kuzhinën. Duar, këmbë, gjokse... Kur ai hapi gojën për të marrë frymë, pastičeri u kthye ngadalë nga ai duke mbajtur në dorë një kokë gruaje.

“Kjo ka qenë gruaja ime, vëlla,” tha ai. “Ajo nuk është këtu më, kështu mua më duhet ta rikrijoj atë. Në këtë mënyrë, të paktën, do të mbetet kujtimi i saj. E shikon?” Ndërkohë që hajduti po kuptonte në ç’ferr kishte rënë, pastičeri u ngrit nga karrigia me kokën e gruas në dorë dhe eci në drejtim të tij. Oh Zot i madh! bërtiti hajduti me sa kishte në kokë. Oh, o Zot! Jo! Dontë të ikte me vrap, por nuk mund të lëvizte, sikur thembrat e tendinat e Akilit, kishin lëshuar rrënjë që po e ankoronin në tokë. Ai nuk i hiqte dot sytë nga pamja e morgut të kuzhinës.

Më në fund, kur pastičeri po i afrohej, ai gërthiti:

“Ndalo aty, ku je, djalli ta marrë! Asnjë hap më këtej!”

“Po pse jo, vëlla i dashur?” pyeti pastičeri. Hajduti nuk ishte në gjendje as të mendonte më dhe, teksa i afrohej pastičeri, ai filloi të prapsej, pastaj ai u kthye dhe vrapoi përmes derës më të afërt, ku ai dalloj një dritare që të nxirrte nga ky apartament tmerri

jashtë për në kopsht dhe, duke menduar se po ndiente frymën e pastiçerit në zverk e në shpinë – megjithëse, në të vërtetë, ishin qimet e veta të ngritura përpjetë nga frika në qafë e në shpinë, ai mbrojti kokën me duar dhe kërceu jashtë nga dritarja. Kërcitja e xhamave të thyer. Fluturimi poshtë...

Një dhimbje therëse në këmbë e solli në vete. Për njëfarë kohe dhimbja shkuli instinktin e vetëmbrojtjes jashtë nga sirtari i vetëdijes. Pastaj, gjithsesi, frika e tij nga ai njeri i çmendur u kthye dhe hajduti e kuptoi se tani gjendej në kopshtin e rrethuar me murin e lartë, ta paktën, dy metër, në një situatë krejt të pafavorshme dhe jeta e tij pa vlerë, shumë shpejt do të merrte fund. Ai kuptoi se duhej të fillonte të pendohej. Meqenëse nuk ishte besimtar, ishte ateist, ai nuk e njihte fjalën *pendesë*, o Zot, por e njohu tani përmasën e saj. Më e mira që mund të bënte, të paktën – si ateist, pa besuar, pa shpresë, t'i jepte fund jetës së tij fatkeqe, të pafat e të mallkuar me diçka si lutja ose me një thirrje ateiste për ringjalljen e shpirtit. Atij iu kujtua një film mbi revolucionin që kishte parë kohët e fundit, në të cilin një njeri i dënuar u ekzekutua nga një skuadër zjarri. Krahët e hapur gjerësisht, melodia e një kënge, dhimbja e plumbave. Një vdekje e tmerrshme e priste, ndoshta tortura, ai e njihte atë, prandaj dhe shpirti i tij tani duhej të përgatitej; ishte gjëja e vetme për të cilën ishte i sigurt, për të cilën s'kishte dyshim në mendjen e vet. Ai s'kishte armë, s'mund të ngrihej dhe, kur përpiqej, dhimbja pothuajse i shkaktonte të fikët. Kështu që ai ngadalë, gradualisht u zvarrit deri tek muri, ku, të paktën nuk dukej. Duhej të tërhiqte zvarrë këmbët pas vetes, duke bërë përpjekje të madhe të mos qante nga dhimbja. U përpoq shumë, por kuptoi se gulçimet e tij tingëllonin me metra larg në të gjitha drejtimet. Mund të mos e shikonte, kur përbindëshi të vinte tek ai, t'i bënte atë që i kishte bërë gruas së vet! Duhej të ishte i përgatitur, këtë e dinte. Nuk e dinte saktësisht se si, por, gjithsesi, duhej të ishte gati.

Oficeri që dëgjoi rrëfimin e hajdutit u trondit dhe u argëtua, njëkohësisht. Ishte e llahtarshme, natyrisht, por, në të njëjtën kohë, mund të ishte edhe një bonus i rëndësishëm, ose ndoshta... ndoshta... madje dhe një promovim. Ai u ngrit nga karrigia, instinktivisht, urdhëroi hajdutin të mos dilte nga dhoma dhe u largua drejt korridorit. Atje ai zuri për dore infermieren e parë që kaloi aty pranë, e futi brenda në dhomë, i tha të mos dilte nga dhoma dhe të ruante pacientin; pastaj njoftoi me telefon eprorin e tij.

Një tjetër makinë policie erdhi tek pallati dhe, prej saj, ca oficerë policie kërcyen jashtë, këtë herë, me një energji të pazakontë. Ata e rrethuan pallatin, kopshtin dhe siguruan të gjitha daljet, përmes të cilave mund të ikte personi i kërkuar. Në kontrast me hetimin e një skuadre origjinale të shkeljes së rendit, mënyra ishte krejtësisht e ndryshme. Ishte i pranishëm edhe zëvendës komandanti i zonës. Ai kishte zgjuar, gjithashtu, edhe shefin, eprorin e tij direkt, i cili e kishte udhëzuar të siguronte terrenin, të ndiqte të dyshuarin ose të dyshuarit dhe, më vonë, të njoftonte Departamentin e Hetimeve Kriminale. Koha avancoi, para se kjo të ndodhte. Pas një ore do të fillonte të zbardhte.

Polici e gjeti atë që po kërkonin, i hoqën siguresën pistoletave: njëri do të mbulonte tjetrin dhe ecën me qetësi drejt hyrjes anësore të pasticherisë. E kontrolluan qetësisht duke lënë dy anëtarë të skuadrës poshtë, ndërkohë që ekipi u ngjit lart nëpër shkallë. Dera ishte e mbyllur. Pas një çasti ankthi, ata vendosën ta hapnin me forcë. Përpjekja e dytë që e suksesshme. Disa policë rendën brenda, me fenerët elektrikë dhe pistoletat në duar dhe filluan të kontrollojnë.

Apartamenti ishte i qetë. Të gjitha dhomat të qeta, përveç dhomës së ndenjes, në të cilën zëri i radios po komentonte çështje të politikës ndërkombëtare. Pas një momenti mëdyshjeje, polici që qëndronte më afër e fiku. Shtëpia dhe qiraxhinjtë e saj ishin

akoma në gjumë. Dyert ishin plotësisht ose pjesërisht të hapura në të gjitha dhomat që ata kishin kontrolluar. E vetmja dhomë me derë të mbyllur, me një dritë të dobët, e cila vinte që poshtë derës, ishte kuzhina. Dy oficerë, zunë pozicionin në të dyja anët e derës. Polici i parë, i cili qëndronte në të djathtë, hapi derën dhe dy policë, nga e majta, hynë brenda me nxitim duke bërë titur “Duart lart dhe asgjë nuk do të ndodhë!” Pasticëri, në çast, u gjend i shtrirë në dysheme. Duart e lidhura pas shpine me pranga.

S’kishte njeri tjetër në dhomë. Një polic e shoqëroi atë për tek makina dhe e nisën menjëherë në rajonin e policisë; oficerët e tjerë, të cilët kishin për detyrë të siguronin pallatin derisa të vinte policia kriminale, filluan të kontrollojnë gjithçka që gjenin në kuzhinë. Hajduti kishte të drejtë, mbi tavolinën e bukës ishte një kokë gruaje. Një palë sisa ishin në krye të frigoriferit dhe një pjesë nga shputa e këmbës ishte në raftin e vogël mbi sobë. Por, kur ndezën dritat, ata u shtangën. Vështruan njëri tjetrin dhe njëri prej tyre thirri: “A mund ta besoni dot djema? Gjithçka është e bërë me marzipan”.

Ai kishte të drejtë. Vetëm, nën dritën e fortë të llambës së kuzhinës u bë e qartë se masa e krahëve njerëzorë, e gjinjve, e këmbëve ishte gdhendur mjeshtërisht me marzipan dhe ingredientë të tjerë. Realizimi qoftë edhe i një detali të vogël ishte magjepsës, disa prej tyre edhe të frikshëm. Për shembull qimet në krahun e majtë ishin krijuar nga fibra të lyera karameli. Ishte një nishan në parakrah dhe në kyçin e këmbës së majtë që kishin një tatuazh të vogël në formën e hardhucës dhe një rrip me motive indiane.

Megjithatë, gjëja më impresionuese, ishte koka e gruas, e mbështjellë me një shall me qime të trasha, të zeza, që dilnin nga poshtë. Buzët e saj disa të qeshura dhe sytë që të shikonin drejtpërdrejt. Të gjallë dhe rrëzëllues - e vetmja gjë që u mungonte ishte kapsitja e tyre. Oficerët ecnin me ngathtësi përreth kuzhinës, të pasigurt në procedurën që duhej të ndiqnin në këtë situatë. Pastaj, zëvendëskomandanti i zonës hyri në dhomë.

“O Zot!” thirri ai duke hapur derën dhe u ndal. “Pra, është e vërtetë” shtoi ai. “Ne kemi kapur një maniak këtu.” Pastaj ai vuri re tri fytyrat që e shikonin dhe i zuri syri të katërtin anëtar të ekipit, i cili nuk e kishte vënë re fare ardhjen e tij - ai ishte i përqendruar në lëpirjen e dorës së njeriut.

“Ju duhet të jeni i çmendur,” ulëriti zëvendësshefi. “Jeni i pezulluar nga puna, menjëherë.” Në atë moment, oficerët që qëndronin në mes të kuzhinës u mblodhën bashkë dhe filluan t’i shpjegojnë zëvendësshefit se gjithçka që ai shikonte, ishte vetëm një iluzion. Se ai nuk shikonte atë që pa, ai vetëm mendoi se pa, atë që po shikonte. Se ne nuk shohim, ne presim, duke mbushur, në këtë mënyrë, jetët tona me zhgënjime të panevojshme; me pak fjalë – gjithçka është vetëm një tortë shumë e madhe. Kur shpjegimi dhe kontrolli gjithandej i apartamentit nuk nxorën ndonjë gjë të pazakontë, përveç bravës që kishte prishur hajduti, prania e policëve ishte e pavend dhe e pajustificueshme. Banori i apartamentit i ndaluar, hajduti në spital, s’kishte kallëzim për vjedhje, s’kishte trup të vdekur.

“Pra çfarë po bëjmë ne tani?” pyeti njëri nga oficerët. “S’ka asgjë këtu, kështu që, vërtet, s’kemi ç’të bëjmë këtu”

Këtë mendim e kishte pasur zëvendësshefi pak më parë, por ai shpresonte se ata do të nxirrnin diçka ose vetë zëvendësshefi do t’ua tregonte. Ai mori një vendim dhe tha:

“Unë e dua gjithçka të fotografuar. Thërrisni CSI-në ose unë do të bëhem karagjozi i zonës. Të sigurohet lokali përkohësisht dhe të sqarohet ky ferr” Duke ikur, ai u hodhi një vështrim të fundit, vjedhurazi, në kuzhinë, gjinje prej marzipani, kyçeve me tatuazhe dhe, veçanërisht, kokës së gruas, bebëzave të syve të saj të fiksuar mbi këdo që hynte në derë.

“Ajo është një grua e bukur,” tha ai. Por, para se fjala e fundit t’i dilte nga goja, ai e kuptoi se nuk duhej ta kishte thënë atë. Ishte disi... e papërshtatshme. E gjithë ndodhia, në fakt, ishte disi e

papërshtatshme.

Pastiçeri e kishte emrin Marek Svoboda. Trup mesatar, gjatësi mesatare, flokë me ngjyrë të paqartë, sjellje e zakonshme, madje e këndshme. Ishte një tip njeriu që vështirë mbahej mend. Megjithatë, megjullnaja e papërcaktueshme u zhduk, në çastin që ai foli. Për një gjë ai s'kishte vepruar natyrshëm, vuri në dukje zëvendësshefi. Çdokush në vendin e tij do të trembej fillimisht, pastaj, do të inatosej. Dikush tjetër, pasi hynë policët në apartament, e shtrinë përtokë, i vunë prangat dhe e mbyllën në qelinë e paraburgimit, do të kishte kërkuar një avokat, do të kishte kërkuar të bënte një ankesë, do të kërkonte një falje verbale ose me shkrim. Ai jo. Ai, thjesht, buzëqeshi, kur ia hoqën prangat nga duart dhe tha se nuk do të bënte asgjë kundër vëllezërve policë. Ata të gjithë ishin vëllezër në vuajtje, tha ai. Ata, sigurisht, nuk mund ta mbanin nën mbikëqyrje, sepse ai i quajti vëllezër, nuk ishte as shkelje, as fyerje – arsyetoi zëvendësshefi.

Megjithatë ai kuptoi që pastiçeri nuk ishte normal, kishte diçka të dyshimtë tek ai. Kur e pyeti përse kishte vendosur të bënte një grua prej ëmbëlsirash, ai tha – për arsye se gruaja e vet e kishte lënë. Kur e pyeti përse nuk e raportonte gruan si të humbur, ai tha se nuk e kishte humbur ngaqë e kishte lënë atë me një tjetër ose për një tjetër. Kur i kërkoj, nëse mund ta lexonte letrën e saj të lamtumirës, pastiçeri psherëtiu dhe tha se nuk ishte e mundur ta shikonte, sepse ai e kishte ngrënë atë. Kur e pyeti pse e kishte ngrënë, pastiçeri tha se donte të kishte, të paktën një pjesë të saj brenda vetes. Kur e pyeti, nëse e kishte vlarë ai gruan dhe nuk e pranonte, pastiçeri vetëm u zgërdhi dhe tha që nuk e kishte vlarë gruan e vet, sepse ai e donte dhe e pyeti zëvendësshefin, për çfarë akuzohej ai.

Në fakt, ky ishte problemi që zëvendësshefi i zonës po përpiqej tani të zgjidhte. Burri, përfundimisht, nuk ishte mirë, ai ndiente mungesën e gruas, e cila kishte ikur me një tjetër ose e kishte lënë për një tjetër. Ai po bënte një version të saj me marzipan dhe i

quante të gjithë vëllezër. Asnjëra nga këto nuk konsiderohej shkelje ose fyerje kriminale. Por, pastaj, e gjeti zgjidhjen. Ekzistonte një ligj, sipas të cilit një person që përbënte rrezik për vetveten mund – madje edhe kundër dëshirës së tij – të çohet në një spital psikiatrik. Zakonisht kjo përdorej në raste vetëvrasjeje, po përse jo edhe në këtë rast të çuditshëm.

Kur dëgjoi doktori historinë e pastičerit Marek Svoboda, të rindërtuar për të, nga shënimet e oficerit të policisë që e solli atë në spitalin psikiatrik, ai nuk u ndje aspak i bindur. Sjellja e veçantë nuk mjaftonte për ta vendosur aty kundër vullnetit të tij. Natyrisht, tha ai, oficeri duhet ta kuptojë këtë. Polici tundi kokën. Nëse do të gjykonin kështu, ata do të duhej të mbyllnin këtu gjysmën e banorëve të qytetit. Nuk ishte sëmundja mendore aq e madhe sa rastet që konsiderohen të skajshme – diku midis çrregullimit dhe sjelljes së çuditshme të padëmshme. Polici mbeti i pakënaqur. Ata s’kishin asgjë për atë burrin, gjë që do të thoshte se jo vetëm do ta lironin, por duhej t’i kërkonin edhe falje dhe sigurisht ai dështoi në përpjekjen për ta trajtuar si të sëmurë mendor. Biseda nuk po shkonte në drejtimin e duhur. Mjeku po rrëmonte në një sirtar duke u përpjekur të gjente formularët për pranimin e pacientëve të rinj, kur oficeri e ndërpreu atë duke u kapur pas mundësisë së fundit.

“Më falni, doktor,” filloi ai, “por shefi më tha se personi në fjalë ka qenë këtu për trajtim edhe më parë. A është e vërtetë?”

“Po, ashtu është,” u përgjigj doktori.

“Po për çfarë problemi është trajtuar?” pyeti oficeri.

“Ky është sekret mjekësor,” i tha doktori. Jam i sigurt që e kuptoni. Unë s’mund t’jua them.”

“Epo mirë,” polici vendosi ta zinte nga një tjetër anë. “Po, gjithsesi, pse nuk shkoni t’i hidhni një sy vetë? Ai, me të vërtetë, sillet në mënyrë të çuditshme”.

Mjeku mbylli sirtarin, në të cilin, më kot, po kërkonte formularët e pranimin dhe pohoi me kokë. Tashmë po zbardhte dita.

Pastiçieri Marek Svoboda u ul në karrige duke vështruar doktorin, i qetë dhe i përqendruar.

“Përshendetje zoti Svoboda, apo duhet t’ju them mirëmëngjesi? i tha mjeku. “Unë jam doktor Lukavski. Duket që keni pasur një natë të ngarkuar.”

Pastiçieri ia nguli sytë, por nuk dukej i prirur për t’u përgjigjur.

“Mirë pra, zoti Svoboda, polici mendon se sjellja juaj nuk është krejt tipike, prandaj më duhet t’ju vlerësoj nën dritën e ndodhisë së mbrëmshme. Cili është mendimi juaj lidhur më këtë?”

Pastiçieri nuk u përgjigj – sodiste degët që lëkundeshin në erë, jashtë dritares. Ai dukej sikur po mendohej çfarë të thoshte, të jepte një përgjigje të matur. “Ju mendoni se polici ka të drejtë?”

Pastiçieri buzëqeshi lehtë, duke e vështruar mjekun drejt në sy dhe tha: “Emri im nuk është Svoboda”.

“Pardon,” tha mjeku. “Ndoshta nuk e kam parë mirë. Këtu thuhet: zoti Marek Svoboda me profesion pastiçer”.

“Ai ka qenë emri im” tha ai. “Kështu më quanin më parë”

“Aha,” tha mjeku. “Po cili është emri juaj tani, pra? Në këtë mënyrë unë do të kem të dhëna të drejta”.

“Emri im tani është Jezu Sokrat Amenhotep Hitler, vëlla i dashur,” i tha ai.

“Mirë,” tha mjeku dhe shkroi emrin të plotë në një fletë pa viza, në të cilën ai po merrte shënime. Gjithsesi, ai do të kishte nevojë për formularët e pranimit. Ai vështroi orën dhe mendoi se kryeinfermierja duhet të jetë aty tani; u ngrit hapi derën dhe iu drejtua njërit që po kalonte në korridor. “Më falni, a mund të më sillni disa formularë nga dhoma e infermierëve? Numër: tre-një-pesë, faleminderit.”

Polici që po rrinte në stolin pranë zyrës, mendoi me vete: me sa duket diçka po lëviz. Tani ne mund të shpëtojmë nga ai burrë, ta mbylлим këtë çështje pa ndonjë skandal.

3. Pas martesës – takimi i parë me babain

Pas dasmës, Maksimiliani dhe Alisa u vendosën të jetonin tek shtëpia e prindërve të Alisë. Ndërkohë që babai riparonte vilën dhe ata të gjithë shikonin të mahnitur, teksa ai sharronte trarët, ngulte gozhdët me çekiç dhe meremetonte çatinë me lëvizje të sakta, kristal të qarta, lëvizje të cilat cifloheshin veç e veç brenda qindra fragmentesh të pasqyruara aty, duke e transformuar saktësinë e tij në një film pa zë, me xhirim të ngadalshëm, momentin, kur ai zbriste nga çatia dhe i vinte veglat e punës me kujdes e rregull në dollapin prej druri.

Sapo pushonte së punuari në vilë, duart e tij fillonin të dridheshin si gjethet e një peme në vjeshtë, para se të shkëputen nga dega dhe të fillojnë zbritjen në tokë, duke u rrotulluar si në një vals. Të sapomartuarit kishin planifikuar muajin e mjaltit në fund të verës, por në gusht, tanket ruse vërsjuan në vendin e tyre, duke i detyruar ata, si shumë të tjerë, të merrnin në konsideratë largimin nga Çekosllovakia. Ishte beteja e tyre e parë. Maksimiliani donte të ikte, ndërsa Alisa nuk e imagjinonte dot të linte pas vendin ku kishte lindur e të mos kthehej më. Të mos kishte mundësi të shikonte më kopshtin e tyre, lehet me lule, rrepat krenare, domatet, tulipanët dhe vilën e tyre? Të lindnin fëmijën në një vend tjetër? Natyrisht, fëmija i lindur në Gjermani, Angli ose Kanada do të ishte gjerman, anglez ose kanadez, nuk ishte kjo shumë e rëndësishme, por ajo kurrë nuk do të ishte e aftë të kuptonte plotësisht djalin ose vajzën e saj. Ishte gjithashtu edhe një fakt: ajo ishte e ftohtë dhe indiferente ndaj tankeve e demonstratave

kundër pushtimit. Fillimisht ajo vuri re se dhimbja reumatizmale e saj ishte qetësuar. Dhe ajo ditë pas dite ndihej më mirë. Dhe, ditët e fundit, ajo e kishte kuptuar që ishte shtatzënë. Një ditë, kur po vendoste kavanozat me komposto në bufenë e kuzhinës, ajo hapi një prej tyre, futi gishtin tregues dhe nxori një copë kajsie të verdhë, erëmirë. Maksimiliani, që e pa të kalonte nëpër dhomë, hapi bufenë, nxori një lugë dhe ia dha. Por ajo vetëm tundi kokën me një mospërfillje arrogante. Pak nga pak Alisa filloi të kuptonte diçka që asnjëherë, më parë, nuk e kishte vënë re. Çdo fillim, fillimi i vërtetë i një ndonjë gjëje pa paraprirje, është pak si një lindje, tamam si çdo fund është një vdekje e vogël. Ndjenja si ato, kanë fituar kualifikimin *cliché* mendoi ajo, një titull nderi të fituar në betejë, në fushën e luftës të trupit dhe të mendjes.

Përvoja e zakonshme, e llojit që ka pothuajse çdo njeri, përsëritet pafundësisht derisa i humb të gjithë veçantitë e veta dhe ishte, pikërisht kjo që ndiente ajo. Ajo e shikonte dëshirën për origjinalitet krejtësisht absurde, tmerrësisht të padobishme. E vetmja gjë e rëndësishme, qoftë fëmija vajzë ose djalë, ishte ecuria e shëndetshme. Duke shfletuar një revistë të pamoralshme, e të pakujdesshme me racionin e saj të përjavshëm të kurioziteve nga India, përparimet më të fundit në teknologji nga SHBA dhe njoftimet mbi gjuetarët në Siberi që kishin provuar mishin e mamuthëve viganë të ngrirë njëmijëvjeçarë, Alisa gjeti një artikull për pikturat mesjetës. Dy nga ilustrimet përshkruanin shenjtorët krenarë dhe i treti, virgjëreshën Mari në momentin Shpalljes. Koka e Madonës ishte rrethuar me një aureolë oleografike me një formë që Alisës i kujtoi një fluskë. Po, ajo është një fluskë, mendoi Alisa duke këqyrur pikturën, madje mund të thuhej - ishte fluskë e mirësisë së hyjnore.

Këtë ndiente Alisa: fluska e shtatzënisë ishte, gjithashtu, një fluskë e mirësisë së Zotit. Gjëja më e keqe nga ato që mendonte ishte se ajo nuk ndihej më fajtore, sepse s'ndihej fajtore. Vendi

i tyre ishte pushtuar, nëpër rrugë kishte tanke. Burri i saj donte të emigronte, nëna dhe babai i saj ishin të trembur e të trishtuar dhe, pas pak javësh zemërimi të papritur, ata, shumë shpejt dhe frikshëm, u plakën. Por asaj nuk i bënte përshtypje të keqe asgjë, sepse ajo priste një fëmijë.

Kur Alisa vështroi pikturën me engjëllin që njoftonte Marinë se ajo do të bëhej Nëna e Zotit, për të ishte e qartë se piktori i lodhur, i kërrusur i mesjetës që kishte bërë këtë pikturë kishte studiuar gratë mesjetare, të dashura të tij, të dashurit e tyre dhe nënat e fëmijëve të tij, kjo ishte mirësia e Zotit, aktualisht dhe në fakt ai kishte qenë i mirëinformuar, se si dikush si ai – një njeri i thjeshtë – provonte dhe vizatonte atë fluskë të mirësisë së Zotit që ajo vetë e kishte ndier. Alisa nuk dinte asgjë rreth vlerësimeve të mistikës mesjetare; ajo s’dinte asgjë mbi ekstazat, mbi errësirën rrezatuese dhe paaftësinë e tyre për të bërë dallimin ndërmjet atyre vetë dhe lavdisë së Zotit që shtrihet brenda galaktikave të pafund. Maksimiliani e vinte re ndryshimin që kishte shkaktuar kjo gjendje tek ajo dhe, duke qenë një burrë i thjeshtë, ai përpiqej ta kuptonte thjesht.

Alisa, ende nuk dinte si t’ia thoshte atij. Si t’ia shpjegonte gjendjen e shtatzënisë dikujt që e donte shumë dhe pa rezerva, si t’i shpjegonte atij diçka që kurrë s’mund ta provojë. Ajo vrapoi kundër barrierës së gjuhës, humnerës së gurtë që shtrihej ndërmjet tyre nga lart poshtë. Më vonë, një ditë, papritur, sapo u zgjuan, i erdhi fjala: “Lumturi, Maksimilian. Të mbash fëmijën tonë është lumturi. Unë mendoj se kjo është diçka si ajo që njerëzit, akoma, besojnë tek qielli. Megjithëse në realitet... është, ndoshta, shumë më mirë!” Ishte muaji i nëntë në fluskën e Zotit dhe Alisa dëshironte të mos mbaronte kurrë. Kështu që, kur Maksimiliani i zgjati atë lugën e vogël, teksa gishti tregues i saj futi një masë reçeli kajsie ngjyrë portokalli në gojën e saj, ajo vetëm i hodhi një shikim të qetë fytyrës së tij të habitur dhe një kënaqësi indiferente

e la atë masën aromatike të shpërndahet, fillimisht, në buzët e saj, pastaj në gojë, para se ta linte shijen e saj të ëmbël, me një kontakt të thekshëm, të depërtojë brenda qiellzës së saj dhe ta gëlltiste ose, për të qenë më të saktë, ta linte të rrëshqiste butë dhe me kënaqësi të dukshme brenda grykës.

Maksimiliani qëndronte para saj, me dorën e shtrirë për një ndihmë të panevojshme. Ai ia kishte ngulur sytë gruas së tij tërheqëse që ishte përkulur mbi kafën e saj të mëngjesit, pa u shqetësuar aspak ç'mund të mendojnë të tjerët për të, çfarë ndiejnë të tjerët, absolutisht e kënaqur me veten dhe jetën e saj. Pasi e gëlltiti reçelin, ajo e lëpiu gishtin tregues me shije, duke bërë një zhurmë me gojën e saj që mund të klasifikohej ose si kënaqësi, ëndje, ose si një përplasje apatike buzësh. Maksimiliani, papritur, u gjend në mëdyshje – si ta quante atë zhurmë ose si mund të interpretohet. Kur ajo mbaroi, ai tha:

“Mendoj se s’ke nevojë për lugë apo jo?” Dhe, në çastin, kur pa Alisën që ngriti sytë drejt burrit të saj të dashur, ai tha, “Po përse?”

Ajo tha: “Unë dua ta shijoj atë me të gjitha ndijimet e mia, Maks.”

Nëse, ndonjëherë më vonë, Maksimiliani do të kthehej me mend prapa në jetën e tij me Alisën, nëse ai do të donte të analizonte marrëdhënien e tyre – ai do të arrinte këtu, në gëlltitjen e reçelit me atë përplasje buzësh depërtuese, të cilën ai nuk e kuptoi dhe me të cilën Alisa filloi të bëhet e pakuptueshme për të.

Nëpërmjet ëmbëlsisë së fluskës-opium që ishte ekzistenca e shtatzënisë së saj, Alisa, dalëngadalë, pushoi së qeni e dashuruar dhe u bë nënë, në mënyrë të përhershme e të pakthyeshme. Gjendja e atësisë, sigurisht, nuk mund të krahasohej me diçka kaq thelbësore si kjo dhe ky ishte realiteti, me të cilin Maksimiliani kishte frikë të përballej. Ashtu si dhe Alisa, ai nuk i fshihte ndjesitë e veta dhe, kur ai foli për këtë me mikun e tij Honza, inxhinier

projektues transistorësh për radio dhe kasetofonë, i krishterë, baba me moral të fortë i katër fëmijëve, ai i tha Maksimilianit:

“E di, Maks, çdo femër shtatzënë dhe pret fëmijë është si një diodë. Unë e kuptoj që kjo tingëllon si e çuditshme, por unë jam i specializuar në elektroteknologjinë me voltazh të ulët dhe nuk gjej mënyrë më të mirë për ta shpjeguar”. Meqenëse Maksimiliani nuk e njihte funksionin e diodës, pyeti çfarë donte të thoshte miku i tij me këtë analogji të çuditshme.

Dioda vetëm e lë të kalojë energjinë në një drejtim dhe gruaja sapo të bëhet me fëmijë, nuk do të jetë, kurrë më, njësoj si më parë. Që në atë kohë, ti do të jesh personi i dytë për të, gjithmonë. Honza shtoi: “Është normale, është shumë mirë. Mësohu me këtë, Maks! Sa më shpejt ta bësh këtë, aq më shpejt do të jesh i aftë për ta konsideruar këtë si diçka të zakonshme”. Maksimiliani ndihej aq i lodhur nga analogjia e gjatë elektro-etike, saqë nuk po përpiqej më as ta kuptonte, megjithëse ai e ndiente se ajo çka nuk kuptoi ai do ta bënte më të vështirë ta pranonte e ta donte gjithë këtë. Kur lindi djali, ishte një zgjim i pakëndshëm i Alisë nga një lumturi e gjatë nëntëmujore. Papritur, ajo filloi të shqetësohej për gjëra, për të cilat Maksimiliani ishte shqetësuar, tashmë, prej muajsh të tërë. Ajo shikonte ëndrra të frikshme, dëshironte të largohej nga vendi i saj përgjithmonë dhe habitej nga një dhimbje reumatizmale kronike, në periudha të shkurtra, të papritura, në momentet më të papërshtatshme. Ajo dëshironte të ikte, të largohej që andej së bashku me fëmijën dhe burrin e saj dhe të fshihej në ndonjë vend, ku do të kishte paqe e qetësi dhe jo ushtarë rusë.

Mirëpo problemi ishte se, kur të gjithë përpiqeshin ta bindnin atë gjatë shtatzënisë, ajo kërkonte t’i bindte ata për të kundërtën, dhe tani, askush s’kishte vullnet dhe energji të ruajtur për të bërë diçka të papritur apo të çuditshme.

Fëmijës ia vunë emrin Kristof dhe, pas pak muajsh, Alisë i lindi ideja të bënte një fëmijë tjetër. Nuk ishte fëmija që donte, në

fakt, ajo kishte mall për gjendjen e shtatzënisë. Xhaxha Antonini që ishte mjek, pasi i kërkoi të bënte disa teste dhe kontrole, i tha diçka mbi hormonet dhe nivelin e disa substancave në gjak etj, por kjo tingëllonte shumë skolarese, shumë latine, që të mund të shpjegohej diçka.

Alisa kishte lindur më 1950, pak muaj para se të arrestohej i ati, i dënuar dhe i burgosur. Megjithatë Alisa s'mbante mend ndonjë gjë prej këtyre; ajo i kishte mësuar të gjitha nga tregimet dhe kujtimet e të afërmeve të saj. Nëna e saj shkonte ta vizitonte çdo muaj. Nganjëherë Alisa shkonte me të, por atë nuk e linin të hynte brenda, kështu që ajo rrinte me hallën e saj diku në periferi të qytetit. Por, një ditë, pas dhjetë vjetësh, ia ati u shfaq në shtëpi. Alisa e njohte atë nëpërmjet tregimeve dhe fotografive. Ajo merrte letra prej tij, të cilat ia lexonte nëna, derisa ajo mësoi dhe mund t'i lexonte vetë. Ajo nuk ishte e gëzuar që ai u dërgonte letra, sepse e ëma, kur i shikonte, pjesën më të madhe të kohës qante dhe Alisa e dinte, sado që e ëma përpiquej që ajo të mos e shikonte duke qarë. Pastaj, pas ditëlindjes së nëntë të saj, babai u lirua. Ajo tani shikonte përpara, ato shikonin përpara dhe ishin fortë e të lumtur.

Dhe kishte kohë që nëna e saj sillej nëpër zyra të ndryshme dhe, prej ca kohësh, shumë të afërme e të njohur, gjithnjë e më shpesh, i vizitonin ato; së bashku me mamaneë lexonin grumbuj me letra e dokumente, të cilat ata, pastaj, i plotësonin dhe i diskutonin në një gjuhë që Alisa nuk e kuptonte.

Dhe ja, një ditë, nëna e saj tha se kishte një surprizë të madhe për të: babai i saj do të kthehej në shtëpi pas dy javësh, më në fund, do ta lirojnë pas dhjetë vjetësh burg, në vend të trembëdhjetë që parashikonte dënimi, dhe ai do të jetonte me ta përsëri. Alisa nuk e kuptoi dot të ëmën, kur tha se babai po kthehej në shtëpi, sepse Alisa nuk mbante mend asgjë nga koha, kur ai jetonte me to.

Për mendimin e saj, ky s'mund të ishte një kthim, përderisa ajo nuk e kishte parë kurrë të largohej. Babai do të kthehej në

shtëpi, nga burgu, ditën e martë. Ato dy javë me nënën, u bënë të padurueshme. Alisa nuk e imagjinonte dot çfarë nuk shkonte me të, çfarë kishte. Nëse jo më shumë, ajo ishte e gëzuar që i ati kthehej në shtëpi, sepse ata s’kishin pasur mundësi të flisnin shumë për qëndrimin tij në burg. Alisa e kishte kuptuar, nga fjalët e xhaxha Antoninit se babai i saj ishte një burrë i guximshëm, i cili nuk lejonte padrejtësi dhe ky ishte shkaku që e kishin arrestuar e futur në burg, sepse ky regjim, vazhdoi xhaxha Antonini, është një bandë kriminelësh, nga i cili nuk pritet asgjë e mirë. Alisa nuk e kuptonte çfarë regjimi ishte ai, por e imagjinonte që duhej të ishte dikush i rëndësishëm si inspektori i shkollës, nga i cili kishte frikë jo vetëm mësuesja Svobodova, por edhe drejtoresha e shkollës. Alisa, gjithashtu, mësoi se ka gjëra, për të cilat mund të flitet vetëm në shtëpi, jo në shkollë, as në dyqane apo në rrugë. Ajo po priste që i ati të vinte në shtëpi, edhe pse nëna e saj gjithë kohën lante rroba, pastronte shtëpinë, sistemonte gjërat, fshinte pluhurat. Një ditë ajo e dëgjoji nënën tek pyeste xhaxha Antoninin nëse duhej ta lyente shtëpinë. Ai e bindi që s’kishte nevojë ta bënte duke i thënë:

“Mos u shqetëso, Kveta. Jozefi po kthehet tek ti, më vonë, ju mund ta lyeni të dy bashkë, po të doni”. Si përgjigje, e ëma u mbyt në lot, siç bënte zakonisht. Po përse vallë, mamaja qante për lyerjen e shtëpisë? Alisa, vërtet, nuk e kuptonte dot.

Xhaxha Antonini i solli mamasë disa pilula, të cilat ajo i merrte nganjëherë dhe e qetësonin, megjithatë, herë pas here, për shembull, kur ato rrinin në radhë tek furra e bukës, papritur, lotët i rridhnin nëpër faqe dhe, kur Alisa e zinte për mënge, mamaja ose nuk fliste fare, ose thoshte ndonjë gjë të tillë si – në furrë kishte parë tortën Sacher që babait i pëlqente shumë. Çdo gjë që lidhej me babain e saj ishte e trishtueshme, kështu që, dalëngadalë, Alisa nuk e donte më atë, sepse çdo herë që e kujtonte, e ëma fillonte të qante dhe nuk ishte shumë e qartë përse. Apartamenti ishte i pastër, dritaret të lara, lulet të sistemuara, madje mamaja kishte

kontrolluar edhe gjithë lodrat e Alisë, të paktën katër herë. Alisa kalonte shumë kohë, aq sa mundej tek shoqja e saj, Tereza. E ëma e linte shpesh të rrinte atje, sepse gjyshi i Terezës, gjithashtu, ishte në burg, por ndryshe nga babai i Alisë. Në dhomën e ndenjes ishte një fotografi e tij: një burrë i mbushur, i fuqishëm, me bark të madh, me mustaqe të mëdha dhe me vështrim që të depëronte deri në kockë. Një dorë e kishte në xhepin e jelekut me zinxhirin e orës që varej jashtë dhe gjyshja e Terezës thoshte gjithmonë se ai ishte njeri shumë i mirë dhe nuk e meritonte atë fat. Alisa nuk i besonte asaj, gjithsesi, sepse në fotografi ai dukej shumë i rreptë dhe aspak miqësor. Përveç kësaj, barku i tij ishte aq i madh dhe dukej aq i ashpër, sa mustaqet dhe vështrimi i tij i rreptë.

Të martën, Tereza shkoi tek Alisa pasdreke, kështu që ato mund të bënin detyrat e shtëpisë së bashku. Javët e fundit, nëna e Alisë kishte blerë gjithfarë gjërash që ato, kurrë nuk i kishin pasur në shtëpi më parë: buzëkuqë, krehëra, kuti pudre, madje edhe ca shishe të vogla parfumi. Alisa dhe Tereza i provuan të gjitha. Ato kishin leje nga mamaja e Alisë, megjithëse ajo i kishte udhëzuar të kishin kujdes për çdo gjë, sepse kushtonin shumë. Kur ra zilja e derës, ato ishin të sigurt që ishte fqinja Polačkova për të kërkuar hua miell, vezë, ose diçka tjetër apo për të kthyer miell, vezë, qumësht etj. Të dyja vajzat vështruan njëra-tjetrën dhe nënqeshën.

“Polačkova?” tha Tereza. Alisa nënqeshi përsëri. “A do të keni pak tharm, zemër?” tha ajo dhe doli të hapte derën. Vështroi jashtë përmes syrit magjik dhe nuk pa askënd. Pra nuk ishte Polačkova. Ajo, gjithmonë, qëndronte para derës që të mund ta shikonin. Kështu që Alisa u kthye tek Tereza.

“Kush ishte?” e pyeti Tereza.

“Askush,” tha Alisa. “Atje s’ka njeri dhe, nëse s’ka njeri ne s’mund ta hapim derën, prandaj...”

Pas një çasti, zilja e derës ra përsëri. Të dyja vajzat u ngritën dhe u afruan tek dera të shikonin.

“Dikush është atje,” tha Tereza. “Pa vështro edhe ti”. Alisa pa një burrë, i cili qëndronte me shpinë nga dera, me një çantë në dorë. Vajzat vështroan njëra-tjetrën prapë; Alisa hapi derën dhe pa babain e saj aty. Ajo e njohu, ishte pikërisht ai, sepse ajo kishte parë fotografitë e tij nëpër gjithë shtëpinë – shumica në dhomën e gjumit të mamasë. Por ai ishte shumë, shumë më i dobësuar sesa në fotografi.

Ai e pa Alisën dhe i tha:

“Përshëndetje, Alisa.”

Alisa qëndronte duke u mbajtur pas dorezës së derës. “Përshëndetje, zotëri”.

“Unë jam babai yt, Alisa,” tha burri.

“E di, zotëri,” tha Alisa.

“A mund të hyj brenda?” e pyeti babai.

“Po, zoti... baba” tha Alisa duke vështruar, e pasigurt, nga shoqja e saj. Tereza qëndronte në qoshe të korridorit duke ndjekur gjithçka. I ati i Alisës hyri në korridor dhe i tha asaj:

“Ti duhet të jesh Tereza, kështu?”

“Po, zotëri,” u përgjigj Tereza. Dhe, pas një çasti mëdyshjeje, ajo pyeti:

“Ju jeni babai i Alisës?”

“Po,” u përgjigj ai.

“Aha,” tha Tereza. Burri e mbylli derën, u përkul, e mori Alisën në krahë dhe e ngriti lart, deri në tavan. Alisa s’dinte ç’të bënte, por, kur xhaxha Antonini, teto Sharka ose xhaxha Bedriku e ngrinin lart kështu, ajo u hidhte krahët në qafë. Edhe tani ashtu bëri. Burri filloi të qeshte, gjë që Alisës i pëlqeu, megjithëse, nga ana tjetër, ai po ia njomte faqen - kjo gjë nuk i pëlqeu, sepse ajo dhe Tereza sapo ishin lyer me një krem-pudër të mamasë. Pas pak, ai e uli poshtë, nxori një shami të madhe nga xhepi dhe fshiu hundët. Kjo gjë i tërhoqi vëmendjen Alisës, sepse as ajo, as nëna e saj, nuk përdornin kurrë shami aq të madhe. Ajo e dinte se kishte të tjera

si ajo, të hekurosura, të palosura dhe të vendosura në dollapin e nënës, së bashku me gjërat e tjera të babait. Ato shami ishin ruajtur që të përdoren për gjunjët e gërvishtur ose kur prisnin gishtin duke qëruar qepë ose karrota; nuk mund të shfryheshin hundët në to. Më vonë ato vendoseshin tek rrobat e palara, ziheshin, pastaj hekuroseshin, paloseshin dhe vendoseshin në raft, në dhomën e nënës.

Alisa u kthye dhe vrapoi në dhomën e gjumit të mamasë, hapi raftin dhe mori dy shami të mëdha të hekurosura që akoma mbanin erën e detergjentit, erdhi me to në dorë tek babai në korridor dhe ia dha atij. I ati u hodhi një sy, tani pa buzëqeshje, pastaj, papritur, vështroi Alisën drejt në sy aq ngultas, saqë e bëri të drithërohej. Nëse ajo do të shihte duke ngrënë, do t'i mbetej kafshata në fyt. Vështrimi i syve të tij ishte aq i ashpër, saqë ajo nuk guxonte as të merrte frymë. Ajo mendoi se duhej të fliste për këtë me Terezën. Gjithsesi, ai nuk duhej ta shikonte ashtu – një vështrim aq i ashpër e i çuditshëm, kur ajo s'kishte bërë asgjë të keqe. Pastaj burri i hoqi sytë prej saj, vështroi përreth korridorit dhe i kaloi duart e tij në flokët e saj. Alisa e dinte se të rriturit e bëjnë këtë, kur duan të tregohen të dashur me fëmijën dhe s'dinë çfarë të thonë. Ndërkohë Tereza veshi këpucët, u përshëndet me Alisën e babain e saj dhe u nis për në shtëpi. Ajo nuk e dinte, saktësisht, përse, por u ndje e tepërt aty.

Babai hyri në kuzhinë, hapi bufenë, mori një filxhan qeramike të madh nga rreshti i dytë, të cilin nuk e përdorte askush dhe, pa gabuar, u zgjat tek sergjëni, ku ruhej kutia e madhe e kafes. Ai është i ambientuar me gjithçka këtu, mendoi Alisa. Im atë. Ai njihte gjithçka këtu. Këtu në shtëpi, këtu në kuzhinën time.

Ajo e kishte pritur aq shumë, kishte qenë e aq e frikësuar, aq e inatosur me të dhe, tani, nuk dinte fare çfarë të bënte me këtë burrë madh, të hollë e të gjatë. Kështu që ajo qëndronte aty me sytë e ngulur tek ai dhe ai me sytë e ngulur tek ajo - ai ishte goxha më i

gjatë ë se nëna e saj; vështrimi i tij i gjatë, tashmë, po e bezdiste dhe ajo filloi të hutohej.

“Ku është mamaja?” pyeti ai, pasi kishte bërë kafën. Ai u ul në tavolinë dhe vështronte të bijën.

“Diku jashtë, me punë,” tha Alisa. “Gjithsesi, gjithsesi, ajo më tha se ti nuk do të vije deri të enjten”. Asnjëri prej tyre nuk mbante mend sa gjatë qëndruan ashtu në kuzhinë. Pastaj, ajo i tregoi atij gjithë shtëpinë. Nuk kishte ndryshuar shumë gjatë dhjetë vjetëve. Ai u habit sa formalisht sillej ajo me të duke e krahasuar me mënyrën se si shprehej në letrat, ku vajza i drejtohej gjithmonë me “ti” dhe mrekullohej, sa ishte rritur ishte e bija. Në fotografinë e fundit që kishte parë ai, vajza ishte vetëm gjashtë muajshe. Alisa, nga ana tjetër, habitej me faktin që ai, pavarësisht nga gjatësia e tij, nuk ndeshej me ndonjë gjë me kokë, i shmangte me zhdërvjelltësi, llambadarët e kuzhinës, të dhomës së ndenjes dhe me mënyrën se si, nganjëherë, ai e fuste dorën në flokët e saj – pëllëmba e tij ishte aq e thatë, flokët e saj ngeceshin në kallot e tij. Ajo, gjithashtu, vuri re se si lëkura e tij kapej pas materialit të bluzës së saj, kur ai ledhatonte krahët dhe shpatullat e saj dhe kishte pak frikë se mund t’ia griste. Duart e tij ishin të ashpra si rende - ato kishin nevojë për trajtim kozmetik ose, të paktën, për një krem vajor të butë, të tipit që përdornin mamaja dhe teto Sharka, por ajo nuk guxoi ta thoshte këtë me zë. Ajo mund t’ia thoshte ndonjë tjetri, po ai ishte babai i saj dhe kjo ishte diçka krejt tjetër.

Asnjëri prej tyre nuk kujtonte sa kohë kaloi duke i treguar atij dhomën e ndenjes, kuzhinën, korridorin ashtu si nuk kujtonin sa herë Alisa i përsëriste emrat e tri kukullave të saj që atij i dilnin nga mendja po me atë shpejtësi që ajo i thoshte. Alisa vuri re se ai bënte ca gjëra të çuditshme: ulej e rrinte poshtë, disa herë, në dyshtet dhe dhomës së gjumit, për pak çaste dhe mbështetej në krevat gjë që, siç dihet, nuk e bën çdo njeri. Dyshtet nuk është për të ndenjur, megjithëse aty është qilimi, njeriu ulet në karrige

ose në kolltuk. Ju mund të luani rreth e rrotull në dysHEME, por vetëm, kur jeni të vegjël, jo sa ajo. Alisa s'dinte si t'ia thoshte, sepse ai ishte aq i madh dhe ajo, akoma, ishte pak e trembur prej tij. Pastaj, fare papritur, erdhi mbrëmja dhe ai ishte ulur në dysHEME në errësirë, mbështetur pas krevatit dhe ajo e ulur mbi gjunjët e tij - kjo ishte shumë e këndshme, edhe pse ajo, zakonisht, kishte pak frikë të rrinte në dhomë në errësirë, tani nuk trembej, por, në të vërtetë, kishte pak frikë nga ai burrë i gjatë e hollë, megjithatë ndihej mirë. Pastaj, fare papritur, çelësi kërciti në derë dhe, ajo, papritur, ndjeu zemrën e tij të rrihte fort, përmes këmishës dhe xhaketës së tij dhe, fare papritur, ai e pickoi aq fort, duke e kapur nga të dyja kyçet e duarve, mori atë pamjen e çuditshme përsëri, dhe vështroi derën që të çonte në kuzhinë, e lënë pak hapur.

Ai u ngrit rrëmbimthi dhe pa i thënë asnjë fjalë, e mori në krahë, duke e shtrënguar pak më shumë se ç'duhej. Alisa filloi të lëvizte këmbët, duke u ndier si një flutur e kapur në rrjetë. Ai mbylli edhe derën e kuzhinës dhe, nëpërmjet një dore të dytë gjysmë të hapur nga hyrja, ata dëgjonin mamanë në korridor, kur hoqi këpucët dhe veshi pantoflat, thirri Alisën dhe pyeti, nëse kishte ikur Tereza. Pastaj ajo u kthye dhe i pa të dy tek qëndronin në prag të derës: të shoqin që mbante në krahë të bijën. Ajo u përkul, edhe një herë, nga forca e zakonit, për të rregulluar rripat e pantoflave, pastaj u afrua tek ai duke thënë vetëm: "Jozef, Jozef..." pa e mbaruar fjalinë, në atë mënyrë siç bënte gjithmonë, kur qortonte të bijën. Ajo u afrua tek ata, i ledhatoi Alisës flokët dhe mbështeti faqen e vet tek e tija; Alisa pati ndjesinë se mamaja do të fillonte të qante përsëri, por, për çudi, ajo nuk qau - thjesht i shtrëngoi krahun burrit të saj dhe përqafoi vajzën.

Alisa vuri re se zemra e babait të saj që, para pak çastesh, po rrihte aq shpejt si një kope gazelash, të cilat ajo i kishte parë një herë në zoopark, tani rrihte ngadalë, pothuajse lirshëm, por, pastaj përsëri, ajo mundi të ndiente një rrymëz të vogël, të ngrohtë, që

pulsonte në dorën e nënës dhe çonte gjakun në gishtat e saj, të cilët shtrëngonin e ledhatonin Alisën; rrymëza ndryshoi duke u bërë më e fortë dhe duke buçitur si një stuhi. Pastaj babai e uli atë në tokë dhe ishte e qartë që do shtrohej darka, prandaj ajo shkoi të ulet në karrigen e saj, ndërsa ai u ul përballë saj dhe nëna filloi të përgatiste pashtetin – babai e shikonte duke i kushtuar të njëjtën kohë gruas e vajzës së tij; herë pas here, nëna vinte e më ledhatonte flokët mua edhe atij, gjithashtu, siç bëjnë me fëmijët e vegjël, por, nganjëherë – tamam sikur donte të mos e shikonte njeri – ajo shumë shpejt, pa rënë në sy, i përkëdhelte atij duart që kishte vënë mbi tavolinë, shumë më të mëdha se duart e mamasë.

Ata do të hanin diçka dhe, meqenëse mamaja nuk e kishte llogaritur që babai të vinte dy ditë më parë, ajo s’kishte përgatitur asgjë – i kishte rezervuar të gjitha në dyqane për të nesërmen që të ishin të freskëta; kështu që ata hëngrën pashtet djathi me bulb qepe, ose siç e quante teto Sharka, *shnitlik*. Megjithëse Alisës nuk i pëlqente shija e tij, sot s’kishte rëndësi, sinqerisht, ajo mezi e kuptonte çfarë po hante. Ishte shumë e zënë duke vështruar babain dhe mamanë e saj, e cila dukej krejt ndryshe nga ç’ e kishte parë deri tani.

Kur mbaruan së ngrëni, ata shkuan të ulen në dhomën e ndenjes dhe mamaja i tregoi babait dy disqe, të cilët, me siguri, i pëlqenin shumë atij, sepse në ballë iu bë një rrudhë, u duk pak si mbledhje vetullash, por, më vonë, ajo u bind se vetëm u duk ashtu, në të vërtetë, kjo do të thoshte se ai ishte shumë i lumtur. Në kapakun e njëres prej disqeve ishin ca njerëz me kostume që i bënin të dukeshin si pinguinë të stolisur për një darkë feste, siç tha më vonë babai që dukej shumë serioz, por duke ia bërë me sy në një mënyrë që askush s’e vuri re përveç saj, gjë që e bëri të buzëqeshë; në kapakun e diskut tjetër ishte një kokë burri me kaçurrela, me syze të vogla qesharake dhe një piano e pruar. Babai i Alisës i kërkoi mamasë ta vinte diskun me atë burrin me syze të qesharake dhe tha:

“Nuk e kam dëgjuar për kaq vjet, Kvetushka” Dhe mamaja tha:

“Tani do të kesh mundësi ta dëgjosh nga dy herë në ditë po të duash, Jozefik.” Alisë nuk i pëlqeu që mamaja e quajti Jozefik, prandaj ajo u afrua pranë tyre, vështroi të ëmën dhe u tha të dyve:

“”Ky është babai im dhe emri i tij nuk është Jozefik”. Babai e vështroi përsëri me atë shikimin, por këtë herë, ajo nuk u drodh, sepse, tashmë, e kishte parë një herë dhe ajo ishte e guximshme. Ai e vuri në prehrin e vet dhe tha:

“Mama, Alisa ka të drejtë”. Ajo ishte e kënaqur që ai e mori në prehër, sepse muzika që erdhi nga disku me burrin me syze qesharake po fillonte ta trishtonte, me të vërtetë, megjithëse ajo mendonte se ishte e bukur dhe frymëzuese, prapë se prapë, ajo muzikë po e bënte gjithnjë e më të trishtuar. Dhe pas kësaj, gjithçka që ajo kujtonte ishin dy duar të mëdha e të forta që e hidhnin lart, e çonin në krevat, e shtrinin dhe dy duar më të vogla që e zhvishnin dhe që i fusnin në kokë këmishën e natës. Sa shumë i pëlqente hedhja lart, megjithëse nganjëherë kështu bënte me të edhe xhaxha Ollrik, por këto ishin duart e babait të saj dhe kjo ishte diçka krejtësisht e ndryshme dhe, tamam, para se ta zinte gjumi plotësisht, mendoi se duhej ta pyeste të ëmën, çfarë lloj kremi të blinin për duart e babait, sepse ai që kishte mamaja e saj ishte shumë i parfumuar dhe, me siguri, atij s’do t’i pëlqejë, meqenëse ai vinte erë duhani dhe, ajo, e ndiente atë kur e zinte gjumi. Mamasë nuk i pëlqente duhani dhe, kush donte të pinte duhan, duhej të dilte në ballkon, por babai nuk mund të dilte në ballkon – ajo ishte e sigurt për këtë. Kjo ishte gjithçka që Alisa kujtonte nga ajo ditë.

Të nesërmen në mëngjes, ajo u zgjua dhe vështroi orën, tashmë, ishte tetë e gjysmë. E trembur, ajo qëndroi disa sekonda nën vatinë, derisa sa dëgjoji nënën dhe babanë e saj që bisedonin në kuzhinë, dëgjoji të qeshurën e mamasë. Nuk mbante mend që ajo të kishte

qeshur kështu ndonjëherë. Njëkohësisht, Alisa mendoi se ishte e çuditshme që mamaja nuk e kishte zgjuar atë si zakonisht. Ajo u ngrit, lëshoi këmbët në dysHEME dhe vrapoi në kuzhinë. Nëna ishte ulur pranë babait, karrigia e saj ngjitur me të tijën, dora e tij në të sajën. Ata buzëqeshën të dy, kur e panë, por nuk folën. Alisa i mbajti këmbët duke menduar, përsëri, sa vonë ishte. Ajo duhej të kishte qenë në shkollë, shumë më herët. Mamaja e vështroi dhe i dha fytyrës shprehjen e zakonshme, kur ato të dyja ishin vetëm në shtëpi; mamaja ishte, vërtet, me humor të mirë dhe i tha:

“Ke fjetur shumë, Ali, eh?” Alisa tundi kokën disa herë në shenjë pohimi. Ajo, akoma, po nuk dinte çfarë të thoshte.

“S’ka gjë, zemër. Ti s’do të shkosh në shkollë deri në fund të javës. Kam folur me mësuesen tënde”.

“Tani dua një puthje nga ti” i tha babai dhe Alisa rendi, fillimisht, tek ai, pastaj u kthye nga e ëma dhe i puthi të dy me kujdes.

4. Vizioni i Hitlerit

Dr. Lukavski s'kishte kohë për pacientin tani, prandaj ai plotësoi kartelën për shtrim në spital dhe kjo ishte e gjitha për momentin. Pacienti i sjellë brenda nga polici, pastičieri Marek Svoboda, i cili thërriste, jo vetëm doktorin, por të gjithë “vëlla” ose “motër”, duke përfshirë pacientët dhe punonjësit - dukej i qetë dhe i përmbajtur.

Nuk ishte e nevojshme të përcaktohej diagnoza – doktori kishte kohë për këtë. Personi që u paraqit vetë si Jesus Sokrates Amenhotep Hitler dhe, të cilit prindërit i kishin vënë emrin Marek Svoboda, ishte në vendin e duhur, mendoi doktori. Atë pasdite ai do ta pyeste z.Svoboda që të shpjegonte emrin e tij të ri. Pastičieri ia nguli sytë mjekut dhe tha:

“Unë s'jam i sigurt që ju do ta kuptoni shpjegimin tim, doktor vëllai.”

“Para së gjithash,” i tha mjeku “unë do të parapëlqejë që ju të më quanit, thjesht, doktor Lukavski”

“Por, doktor vëllai, nuk ju pëlqen ta dini se ne të gjithë ngrohemi nën një diell?”

“Zoti Svoboda, ju lutem,” i tha doktori. Zoti Svoboda heshti për pak çaste dhe doktori bëri një përpjekje tjetër.

“A mund të më thoni, përse e ndërruat emrin tuaj, zoti Svoboda?”

“Po, vëlla doktor, mundem,” tha pastičieri. “Por, fillimisht, do të kërkoja një favor vëllazëror, nëse mund ta hapni dritaren dhe të lini të hyjë pak erë vëllazëri, për të ndihmuar dashurinë

vëllazërore”.

Mjeku bëri një shënim që s’kishte lidhje me zotin Svoboda në dosjen e hapur para tij, e la stilografin në tavolinë, u ngrit dhe e hapi pak dritaren. Zhurma e erës në degët e gjëra, plot gjethe të dendura të pemëve, që rreshtoheshin anash rrugës kryesore të kompleksit të spitalit, depërtoi në dhomë. Pasticieri u ngrit, u afrua tek dritarja dhe i nguli sytë jashtë, pas hekurave.

“Sa larg është që këtu deri në kryeqytet, doktor vëllai?”

“Ju keni parasysh deri në Pragë?”

“Po vëlla, e kisha fjalën, pikërisht, për atë,”

“Rreth dy orë e gjysmë me makinë,” u përgjigj Lukavski.

“E shikoni, vëlla, dy orë e gjysmë me makinë, është distancë e madhe dhe ne, qeniet njerëzore, jemi akoma më larg njëri-tjetrit.”

“Çfarë doni të thoni, zoti Svoboda?” e pyeti mjeku.

“Vëlla i dashur, e dija që s’do të më kuptonit,” tha pastičieri.

“E keni fjalën për distancën në marrëdhëniet njerëzore?”

“Ra peshku, tani do ta tërheq lart” u përgjigj pastičieri.

“Zoti Svoboda, çfarë ka ndodhur me gruan tuaj?”

“I dashur vëlla doktor, motra ime gruaja më braktisi dhe gjithçka që më ka mbetur prej saj është një letër lamtumire,”

“Përse ju braktisi ajo, zoti Svoboda?”

“Gjeti një dashnor fisnik, doktor vëllai,” u përgjigj pastičieri.

“A e keni atë letër, zoti Svoboda?”

“Vëlla doktor, unë e gëlltita letrën.”

“Oh, e kuptoj,” tha mjeku.

“Epo, ja kështu” tha pastičieri. “Tani ajo është larguar dhe po lundron larg që këtej.”

“Pardon?” i tha mjeku. “Më duket se nuk e kuptova.”

“Oh, doktor vëllai, doktor vëllai. Unë ju mërzita, sepse ndiej një thyerje durimi në zërin tuaj.”

“Keni të drejtë z.Svoboda. Po e humb durimin. Kam një turn të gjatë përpara dhe do të doja të sqaroja disa gjëra rreth jush”.

Pastiçieri, i cili qëndronte akoma tek dritarja me hekura, fërkoj fytyrën me duar, sikur po fshinte ndonjë shtresë pluhuri u afrua tek tavolina dhe u ul në karrige përballë mjekut.

“Përse e quani veten Jesuse Sokrates Amenhotep Hitler, zoti Svoboda?”

“Kam pasur vegime, vëlla... kam pasur vegime.”

“Vegime?”

“Po, vëlla. Vegime.”

“Çfarë vegimesh?”

“Të tmerrshme, vëlla, të tmerrshme.”

“Nuk po ju kuptoj, zoti Svoboda. A mund të më ndihmoni pak, ju lutem?”

“Unë po përpiqem, vëlla doktor. Me të gjithë forcat e mia... me të gjitha forcat që mund të mbledh.”

“Me çfarë lidhen këto vegime, vëlla – desha të thosha, zoti Svoboda?”

“Gjithsesi, më mirë më thërrisni vëlla, i dashur vëlla doktor” tha pastiçieri i lehtësuar. “Në fund të fundit, ju e dini, këtu nën diellin, hënë dhe kometat e tjera, ne jemi të gjithë të barabartë...”

“Sigurisht që jemi të barabartë,” tha doktori duke buzëqeshur. “Kështu thuhet në kushtetutë,” shtoi ai, pas pak.

“Ah, sa e papërshtatshme, doktor vëllai. Sa e papërshtatshme” tha pastiçieri.

“Çfarë është e papërshtatshme, zoti Svoboda?” pyeti mjeku.

“E papërshtatshmja është e papërshtatshme – kjo është e papërshtatshme. Të jesh ironik, sarkastik dhe t’i referohesh një copëze letre në vend të një vështrimi brenda shpirtit njerëzor, vëlla”.

“Oh, kjo është” i tha mjeku. “Kjo është” përsëriti ai. “ju kërkoj ndjesë, nëse ju lëndova.”

“Doktor vëllai, një rrugë e gjatë shtrihet para jush, një rrugë e gjatë. E vetmja që mund të lëndojmë është vetja jonë, jo një

tjetër, një të tretë, të pestë, të shtatë, të trembëdhjetë apo të shtatëmbëdhjetë...”

“E kuptoj, zoti Svoboda. Pra, më flisni për vegimet,” tha doktori me një theks më të fortë. Kryepastiçieri vuri duart para fytyrës, sikur po lutej dhe tha:

“Secili nga emrat e mi, më është shfaqur në një vegim”

“Përse nuk më tregoni diçka për mbiemrin tuaj, Hitler?”

“Ka qenë një vegim i egër, vëlla doktor. I gjatë dhe i egër... kryesisht i egër”.

“Ne kemi kohë, z.Svoboda. Sot, për fat të mirë, unë jam në turnin e natës”.

“Ke turnin e natës, vëlla, por nuk je as nën yje, as nën re. Sa e trishtueshme, vëlla, sa e trishtueshme. Sa e shpërfillur, sa e trishtueshme është jeta jote. A e kupton këtë, vëlla?”

“Natyrisht,” tha doktori duke u kollitur. “Natyrisht, ashtu është, por, përse nuk më tregoni diçka për vegimin tuaj, zoti Svoboda? A mendoni se mund ta bëni këtë?” Pastiçieri, dukshëm, po e vlerësonte pyetjen duke mbledhur e hapur gishtat disa herë dhe tha:

“Edhe shtazët e egra janë më të sjellshme me njëri-tjetrin sesa njerëzit, mbajeni mend këtë, dhe, mjerisht e fatkeqësisht duhet të them, unë s’jam ndryshe, kështu që, të paktën, përpiqem të jem i sjellshëm me veten time”. Ai ndaloi për një çast, pastaj shtoi. “Do t’jua tregoj vegimin tim, por vetëm me një kusht, doktor vëllai. Me një kusht.”

“Unë s’mund t’ju premtoj asgjë, zoti Svoboda” i tha mjeku me kujdes. “Po çfarë kushti është ai?”

“Është një kusht absolut, në të vërtetë... po, po, absolut” tha pastiçieri. “Sidoqoftë, ju mund ta pranoni ose ta quani pa vend, vëlla”.

“Shikoni këtu, zoti Svoboda. Unë nuk mendoj se ju mund të vini kushte. Në fund të fundit, unë nuk po ju imponoj ndonjë kusht.”

“Po hekurat e nuk janë kushte, vëlla i vogël?”

“Zoti Svoboda. Tani, ju e dini...”

“Kushti im është... absolut dhe nuk mund të diskutohet” e ndërpreu pastiçieri. “Po të doni ta dëgjoni vegimin, imazhin e së vërtetës sime, edhe nëse universi do të fajësohet, gjë që është njësoj si të lavdërohet, ju s’do të më ndërprisni. Përndryshe ju s’do të merrni vesh gjë. Gjë që as nuk do ta ndihmojë e as do ta dëmtojë kozmosin. Por, mos u përpiqni të bëni pazar me mua! Madje unë e meritoj aq respekt nga bluza juaj e bardhë, e cila ka nevojë të lahet. As brumin s’do të mund ta zija me një bluzë të tillë, cuk, cuk, cuk!”

“Sigurisht, unë s’kam ndërmend t’ju ndërpres, z.Svoboda.” tha doktori, disi i befasuar. Ai e kuptoi se po bënte përpjekje për të mos e vështuar bluzën e vet. “Ju mund të ma kishit thënë këtë që në fillim” shtoi ai me një ton pakënaqësie.

“Ju vetëm duhet të dëgjoni, doktor. Vetëm të dëgjoni, vëlla” tha pastiçieri ashpër.

“Filloni, z.Svoboda. Filloni menjëherë, nuk do t’ju ndërpres. Në fund të fundit, unë jam shumë i interesuar për atë që do thoni.”

“Më premtoni?” i tha pastiçieri.

“Sigurisht”.

“Nuk do të më ndërprisni fare?”

“Ju premtoj” i tha doktori.

“Epo mirë, pra. Më dëgjoni nga afër, vëlla” tha kryepastiçieri duke vënë duart përpara si në lutje.

“Unë po flija. Po bëja gjumë të thellë, i qetë dhe i kënaqur, gruaja ime kishte ditëlindjen. Ne e festuam siç deshë ajo, vetëm me një çift shokësh. Më vonë, atë natë, ne bëmë dashuri dhe fjetëm në krahët e njëri-tjetrit. Kur u zgjova, e ndieja kokën aq keq, dukej sikur po më merrte flakë. U ngrita nga krevati, por, në çast, u godita nga valë tjetër dhimbjeje. Ndoshta ishte ajo që quhet migrenë. Unë lëkundesha, lëkundesha aty përreth, pastaj u

përplasa në tavolinën afër krevatit me kërcirin e djathtë. Ndjeva një zë të përgjumur gruaje të thoshte: “Shpirt, përsëri?”

Unë s’mundesha as të dalloja gjë nga dhimbja. Shikoja konstelacione dhe galaktika dritash me dhimbje therëse. Pastaj, dikush më kapi për dore me delikatesë dhe më foli. Ishte i njëjti zë që më kishte folur më parë, por, tani, në formë pëshpëritjeje. Dy duar rreth belit tim dhe unë i ulur prapë në krevat, nga i cili sapo isha ngritur. Dikush vuri një gotë në dorën time. E kuptova se duhej ta pija dhe e piva. Kishte shijen e mangos. E piva, duke menduar se kishte një shije të çuditshme – shijen e mangos, më pëlqente, por nuk e kisha provuar kurrë më parë. Duart që më ulën në krevat ngritën këmbën që kisha përplasur, e vunë në krevat dhe filluan të pastrojnë plagën. Pas pak, unë i ndjeva duart që lidhnin kërcirin e plagosur me fashë. “Vetëm shtrihu, shpirt,” tha zëri përsëri. “Shumë shpejt do të ndihesh më mirë.” Por unë u ngrita dhe thashë jo, më duhet të shkoj në banjë për të urinuar. Kështu që dy krahët më ngritën pak, unë kuptova se po më ndihmonin të ngrihesha në këmbë dhe, qorrazi, sepse nuk i hapja dot sytë, i ndoqa. Hyra në banjë duke kërkuar rrugën me duar, me të prekur, u ula, bëra urinën dhe mbeta ulur aty. Ndërkohë dhimbja po qetësohej, mora guximin t’i hapja pak sytë. Rrija ulur në banjë. Jashtë po lindte dielli që dukej nga një dritare e madhe; unë nuk e kisha idenë, ku ndodhesha. Nuk e njihja atë vend. U mbështeta tek muri duke marrë frymë ngadalë dhe thellë. Këqyra kërcirin tim dhe pashë fashën në vendin që e kisha përplasur.

Dhimbja kishte pushuar, kështu që u ngrita, mbështolla kofshët e zbuluara me peshqir dhe dola nga banja. Jashtë në korridor ishe ulur një grua. Kur hapa derën ajo zgjati kokën dhe, duke gjykuar nga sytë, unë kuptova se ajo më donte. Më pyeti, nëse ndihesha mirë dhe unë pohova me kokë. Nuk e dija, kush ishte. Por, më vonë, kuptova se e doja edhe unë. Në fakt, kështu mendova, por nuk isha i sigurt. Ajo u afrua pranë meje dhe më pyeti përsëri, si

isha, pastaj më shoqëroi për tek krevati, në të cilin isha zgjuar. U ula në krevat, ndjeva që s'kisha më dhimbje dhe po prisja të shikoja çfarë do të bënte ajo gruaja. S'bëri asgjë të veçantë, vetëm u shtri pranë meje. Pastaj më vështroi dhe më tha: "I dashur, përsëri?" Nuk e dija çfarë donte të thoshte, kështu që unë mblodha supet. "Prapë?" përsëriti ajo. "Ti kishe migrenë, kështu?" tha ajo. Pohova duke tundur kokën dy tri herë, meqenëse kjo m'u duk gjëja më e arsyeshme që mund të bëja në atë moment. "Është era që vjen nga shkretëtira," tha ajo. "Faleminderit, Marta," thashë unë dhe, vetëm, kur shqiptova emrin e saj, kuptova se e njihja. Ishte njësoj sikur të hipnit në biçikletë dhe të zbulonit se dini ta ngisni atë, megjithëse nuk e keni mësuar kurrë. "Kryesorja është që ti të ndihesh mirë, Albert" më tha "në mënyrë që të mund të shkosh në qytet nesër, siç e kishe planifikuar."

"Në qytet?" pyeta unë.

"Po, në qytet, për ata zhardhokët që ke porositur. Ata morën në telefon për të njoftuar se kanë ardhur dhe pyetën, nëse mund t'i dërgojnë.

"Po, zambakët" thashë unë automatikisht. Teksa i ngriheshin cepat e gojës, fytyra e saj, më në fund, filloi të më duket pak më e afërt dhe, kur ajo tha, "Po, shpirt, zambakët. Duhet të jetë skëterra e migrenës që ke. Vërtet, dukesh shumë keq". Unë thashë se gjithçka do të shkojë mirë dhe duke përdorur kujtesën, mora portofolin, çelësin dhe patentën e makinës nga tavolina pranë krevatit, pas të cilës kisha përplasur kërcirin. Pashë patentën dhe aty ishte shkruar: Albert Hegel. Isha unë, ishte patentë ime. Albert Hegel – kopshtar dhe botanist amator.

Dola jashtë dhe eca nëpër kopsht duke parë format e çuditshme të lulesave të zambakëve në lehet e luleve. Një kanal i madh për vaditje, dheu i përhapur përreth ndërtesës së madhe, gjysma e banueshme, gjysma depo. Pra, unë mendoj se, tashmë, e kam mbaruar. E kam mbaruar dhe më duhet vetëm të instaloj pompën.

Unë isha kopshtar dhe botanist amator, një ekspert për speciet e reja të zambakëve dhe orkideve. Prandaj ishte kanali aty, mendova unë. Nuk ishte e lehtë për t'u bërë diçka si kjo në kufi me shkretëtirën, por unë kisha trashëguar vendin aty, që do të thoshte se ishte falas. Marta ishte gruaja ime dhe të nesërmen do të shkonim në qytet.

Udhëtimi zgjati rreth tri orë. Shkretëtira, si gjithmonë, ishte e mrekullueshme. Sapo arritëm në qytet, shkuaam në fidanishte, ku ishin bërë gati disa arka me zhardhokë zambakësh për mua. Arkat ishin përshtatur qëllimisht për të mbajtur nivelin e duhur të lagështirës, megjithëse kuptova që sapo të arrinim në shtëpi, duhej t'i njomja në një solucion antifungal. Pronari, i cili, gjithashtu, punonte si shitës, m'u drejtua me emrin tim të pagëzimit. Emri i tij ishte Shtefan dhe unë thërrisja Shtefko. Unë ndjeva njëfarë simpatie për mua në fidanishte, por nuk ishte e qartë përse. Marta më vështronte në të njëjtën mënyrë si dhe ata – me respekt të dukshëm – kjo gjë e lumturonte atë plotësisht. Kur po ktheheshim në shtëpi, ajo tha diçka për efektin që pata atje – ata më shikonin si superman. “Po përse, vallë?” pyeta unë, në mëdyshje. “Po, sepse askush, më parë, nuk ka mundur të kultivojë specie të reja zambakësh dhe orkidesh në shkretëtirë. Sikur nuk e dije ti” tha ajo, duke rrudhur ballin. Sigurisht, e dija, por unë, akoma, nuk ndihesha plotësisht vetvetja. Ndërkohë që ndodhesha në fidanishte, Marta shkoj në supermarket, në floktore, në zyrën e postës dhe mori me qira rreth njëzet video. “Përse kaq shumë?” e pyeta gjatë rrugës për në shtëpi.

“Epo, kur mendon ti se do të vijmë prapë në qytet?” i tha ajo.

“Zakonisht, ne vijmë një herë në tri javë,” thashë unë.

“Po, vërtet, çdo tri javë” tha ajo. Papritur, unë kuptova se shoferi nuk kishte bërë tri orë e gjysmë rrugë, por shumë më tepër, nuk e kisha vënë re, sepse kisha fjetur pjesën më të madhe të rrugës. Ne u kthyem në shtëpi në mbrëmje vonë. Marta hyri, menjëherë,

të bënte dush dhe unë solla brenda arkat me zhardhokët, i lava një nga një dhe i vura në një rezervuar të gjatë, të cilin e mbusha me solucion antifungal. Me këtë punë u mora deri në mbrëmje. Atë natë ne u takuam në kuzhinë dhe u ndjeva disi i trishtuar, por fillova të mendoj se kjo, ndoshta, ishte një nga gjërat tona rutinë. Mbi frigorifer ishin disa letra, me ca deklarata bankare, fletushka reklamimi, disa revista dhe një zarf me një letër me stemën e universiteti. E hapa atë, fillimisht - ishte një letër kortezie nga një nëpunës në departamentin e regjistrimeve që më informonte mua, gjoja me keqardhje se, për shkak të numrit të madh të aplikuesve, nuk kishin mundur të më pranonin. Unë eca lart e poshtë nëpër kuzhinë për pak minuta, pastaj dola jashtë, u mora pak me përkujdesjen e disa bimëve – ndërkaq ndjeva uri. Kur hyra unë, Marta po merrej me sistemimin e kutive të ushqimit në frigorifer, por, sa më pa mua, ndaloi, u ul në tavolinë dhe po priste çfarë do të bëja, ose çfarë do të thosha. Unë s'dija çfarë të bëja, as çfarë të thosha – vetëm isha shumë i inatosur. Ajo tha vetëm kaq:

“Kij kujdes mos të përplasësh kërcirin prapë, shpirt.” Askush, më parë, nuk më ishte drejtuar me atë fjalë – shpirt. Dukej se ajo e dinte që mua s'më kishin pranuar. “Unë, vërtet, kisha shpresë për ty,” tha ajo, pas pak, “por ndoshta është koha që të heqësh dorë. Kjo është dërmuese për ty. Është hera e pestë që të kanë refuzuar.”

“Jo, e gjashta,” e korrigjova. “E para ka qenë para se ne të njiheshim”.

“Ti e di se sa e dëshiroj këtë për ty, por refuzimet të bëjnë të vuash dhe mua më vjen, kur të shoh kështu”.

Unë s'kisha ç'të thosha. Ne i kishim planifikuar saktësisht filmat e huazuar nga Marta që të zgjasnin derisa të shkonim përsëri në qytet, por atë natë ne pamë, të paktën, katër prej tyre dhe unë piva dy shishe rumi xhamaikian. Të nesërmen, nuk u zgjova deri në drekë dhe nuk kisha fare dëshirë të flisja. Një javë e kaluam kështu.

Të hënën një blerës nga një kompani, për të cilën unë punoja në atë kohë, një burrë me emrin Uinter, do të vinte aty. Nuk e dija çfarë mendonte ai, duke ardhur në skaj të shkretëtirës për të më takuar mua, megjithatë ai erdhi. Ndërsa po i uroja mirëseardhjen, u bë e qartë se ai kishte sjellë këtu nipin e vet për të parë lehet e mia me lule.

U tregova gjithçka deshën. Teksa po iknin, nipi i tij pyeti, “A po bëhet ndonjë ndërtim këtu rrotull, zoti Hegel?” Ishte qesharake që ai më quajti mua zotëri. Mendoj se nuk do të ketë qenë më shumë se dhjetë vjet më i ri se unë, ndoshta gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë. “Këtu rrotull, askush nuk mendon të ndërtojë ndonjë gjë” i thashë. “Ne do ta kishim marrë vesh, si thua Marta?” “Jo, sigurisht, jo. Patjetër, do ta kishim marrë vesh” përsëriti ajo pas meje. Por djaloshi këmbënguli. Nuk u mendova për çka tha ai, për ca kohë pas asaj dite, por pak javë më vonë, u ndesha me të. Para ca muajsh, kisha përfunduar projektin tim të vaditjes. Ai më kushtoi mua të gjitha kursimet e mia, të gjitha fitimet dhe Marta, gjithashtu, më dha të gjitha kursimet e saj. Ne tani duhej të jetonim në mënyrë shumë modeste për katër ose gjashtë muajt e ardhshëm, ndërkohë që, dalëngadalë, do të paguanim borxhet, por, me siguri, do të fillonim të kishim edhe fitimet e investimit tonë. I isha mirënjohës Martës që vazhdonte të më përkrahte në këtë nismë, por edhe për faktin që asaj i pëlqente çka po bënim këtu.

Nuk ka shkretëtirë pa erë. Era dhe shkretëtira janë vëllezër të një gjaku. Njëri i qetë, i përhershëm, tjetri një vagabond që hidhej këtej herë pas here, me një thes dhuratash nga të gjitha vendet e mrekullueshme që kishte vizituar për të qetësuar ndërgjegjen e tij të keqe. Shkretëtira është e shkretë dhe e vetmuar dhe i merr njohuritë e saj për botën e jashtme me anë të erës. Dhuratat që sjell era janë të vogla, pjesë mikroskopike të tokës. Pjesëza të tokës të gërryera nga dheu dhe nga shkëmbinjtë. Pjesëza të tokës aq të vogla, saqë edhe një flad i lehtë mjafton t’i ngrejë ato fluturim

si re ose si zepelin. Për ato rëndesa nuk luan rol. Ato mbesin në ajër përgjithmonë, të shkëputura si shpirtrat në purgator, derisa të zbresin në parajsë ose të bien në ferr. Ato janë pa peshë dhe të lira nga angazhimet, udhëtojnë me lehtësi, ngrihen në rrymat e ajrit, depërtojnë përmes shakullinave të erës, zvarriten, kërcejnë nga njëra tek tjetra, kacavirren tek e treta. Një kokërr rëre me diametër sa një e pesta e milimetrit hidhet në erë si mjegull ose si pluhur. Zakonisht era ngre një pjesëz rëre dhe e tërheq vetëm një centimetër ose dy përmbi dunat, me shpejtësi sa gjysma ose një e treta e vetë erës. Pas pak, kokrra e rërës përplaslet me një tjetër, e cila, niset pastaj, dhe e gjithë kjo përsëritet prapë. Rreth çereku i të gjitha kokrrave të rërës në shkretëtirë zhvendosen prapa dhe shtyhen në këtë mënyrë, në varësi të shpejtësisë dhe drejtimit të erës. Procesi njihet si transport aeolian dhe, nëse ju mund ta kuptoni këtë – ju keni mundësi, të paktën, të kuptoni pafundësinë e kohës. Çdo shkretëtirë është si një orë gjigande me rërë, ku rëra rrjedh nga njëra dunë tek tjetra, para e prapa, lart e poshtë. A duhet të them unë se e dua shkretëtirën? Isha shtatë e tetë vjeç, kur jetoja me prindërit në kufi me shkretëtirën, si tani, dhe mora si dhuratë për ditëlindje një enciklopedi. Aty unë mësova se ka shkretëtira jo vetëm në Tokë, por edhe në planetë të tjera, gjë që më kënaqi e më magjepsi aq shumë, sa që shkova me vrap tek babai me këto të reja. Mund të them se ai u lumturua, sepse më pa të lumtur, por nuk mendoj që ai e kuptoi arsyen. Kryesore për mua ishte se ekzistonte diçka që lidhte Tokën dhe Marsin. Unë i imagjinoja të dy planetët si orë me rërë të lidhura me njëra-tjetrën. Më vonë, me të vërtetë, fillova të imagjinoj sikur jetoja në Mars, i rrethuar nga stuhitë e kuqe të rërës. Cili djalë nuk do të donte ta shikonte këtë? Dhe tani unë jetoja në shkretëtirë. Pika më e afërt, vërtet, e rëndësishme, me shtëpinë tonë ishte mali Shën Aloisis, i cili ngrihej në lartësinë 1, 085 metra. Këtu jetonim unë dhe Marta këtu kishim shtëpinë tonë, këtu unë vadisja lehet e luleve.

Kur përfundova pjesën e fundit të sistemit të vaditjes, puna ime, pak a shumë, ishte kryer. Kisha investuar para për pompat, kisha hapur disa puse të reja dhe, e vetmja gjë që duhej të bëja akoma, ishte mirëmbajtja. Isha shumë krenar për projektin tim të vaditjes artificiale të luleve, sepse askush nuk kishte provuar ta bënte këtë më parë. Lulet u bënë më të mira se kurrë ndonjëherë më parë, gjë që do të thoshte më shumë prodhim dhe shlyerje më të shpejtë të borxheve të mia. Pastaj, një ditë, kur të mos kisha asgjë më të mirë për të bërë, unë kisha ndërmend të shkoja e t'i hidhja një sy atij vendit në shkretëtirë, për të cilin kishte folur nipi i Uinterit. Unë doja që edhe Marta të vinte me mua, por ajo tha se nuk kishte kohë. S'kishte kohë? Për ne? Unë krijova përshtypjen se ajo, thjesht, po justifikohet dhe, kur unë, një ditë pasi hëngra mëngjes, vendosa të nisem për tek ai vendi, për të cilin kishte folur nipi i Uinterit, Marta tha që, gjithsesi, duhej të vinte edhe ajo. U nisëm herët. Kur nisesh për rrugë në shkretëtirë, duhet të nisesh herët në mëngjes, në mënyrë që të mos të të zërë rrugës dielli i mesditës. Ne udhëtua për disa orë dhe, kur arritëm në vendin e përshkruar, unë pashë një gardh të gjatë teli me gjemba që shtrihej në largësi. Përtej tij ishte një rrugë gjithë pluhur që të çonte drejt një grupi ndërtesash të mëdha. Ne u afuam tek një ndërtesë e vogël, e cila ngrihej në hyrje të gardhit dhe dukej si kabina e rojës. Ne ndaluam përballë portës, i rashë borisë disa herë dhe dola jashtë. Marta qëndroi në makinë. Ajo dukej pak e lodhur, balli i saj ishte mbuluar me bulëza djerse, megjithëse, gjithë rrugës, kishim hapur kondicionerin. Pas pak minutash, erdhën dy burra. Njëri prej tyre qëndronte në derë, ndërsa tjetri më vështroi në mëdyshje. Të dy ata mbanin një lloj uniforme.

“Përshëndetje,” iu drejtova burrit që qëndronte përballë meje. “Jam fqinji juaj. Unë dhe gruaja banojmë rreth tri orë larg që këtej”. I zgjata dorën. Ai më këqyri mua dhe dorën time të shtrirë dhe tha:

“Ju keni hyrë në zonë ushtarake pa autorizim. Ju lutem lironi vendin menjëherë!” Vrazhdësia e tij më habiti. U ktheva tek Marta në makinë, por ajo rrinte ulur aty duke vështruar pas një palë syzesh dielli të mëdha, të padepërtueshme.

“Jam i sigurt se ju gaboheni” thashë unë. “Unë e njoh hartën e zonës me hollësi dhe kjo zonë është pronë shtetërore, jo ushtarake, siç thatë ju”.

“Ju lutem lironi këtë zonë ushtarake, menjëherë, ose do të më duhet t’ju arrestoj” tha burri me uniformë. Tani unë u inatosa.

“Ky është një vend i lirë dhe nuk do të më thoni ju çfarë të bëj a të mos bëj. Unë i njoh të drejtat e mia si qytetar dhe...”

Burri me uniformë më ndërpreu: “Jeni në zonë ushtarake këtu, në mes të shkretëtirës, z.Hegel dhe kushdo, në territorin e kësaj zone, i nënshtrohet autoritetit të policisë ushtarake.

“Të më arrestoni?” përsërita pa e besuar.

“Po, zotëri! Tani, ju lutem, urgjentisht largohuni nga zona ushtarake!”

“Po kjo nuk është zonë ushtarake...” fillova unë përsëri. Burri nxori nga xhepi i brendshëm një bllok, e hapi dhe filloi të lexonte:

“Ju keni shkelur një zonë ushtarake dhe keni qëndruar aty pa autorizim në kundërshtim me paralajmërimet e përsëritura. Është në autoritetin e policisë ushtarake t’ju arrestojë në përputhje me kompetencën që i jepen policisë ushtarake sipas ligjit përkatës, veçanërisht ligjit të mbrojtjes së zonës ushtarake, të pronës ushtarake dhe...” Unë nuk prita më gjatë. U ktheva, shkova tek makina jonë, hipa, përplasa derën, ndeza motorin dhe e ktheva makinën në rrugë, në drejtimin e kundërt. Marta më vështroi dhe tha:

“Çfarë mënyre e këndshme për të filluar javën tonë.” Duke vluar akoma nga nervat, e vështrova dhe i thashë:

“Mos u mundo të më mbushësh mendjen se ajo është zonë ushtarake. Unë e kam studiuar çdo detaj në hartën e kësaj zone, kur

po kërkoja ndonjë alternativë për rezervat ujore për lehet e luleve dhe s'kishte asgjë që kishte të bënte me ndonjë zonë ushtarake askund!”

“Oh, e di, shpirt. Në fund të fundit, ti ke jetuar këtu që kur ishte fëmijë,” tha Marta. “Por ti i shikon vetë telat me gjemba, ushtarët, portën. Pra, përse e diskuton?”

Kthimi u duk sikur zgjati një shekull. Pothuaj në gjysmën e rrugës ne u ndërruam – makinën e ngiste Marta; një gjë nuk më dilte nga mendja. Isha i sigurt se roja, në një moment, m'u drejtua me emër. Ai tha, qartësisht, zoti Hegel. Fillova ta rimarr të gjithë situatën mirë e mirë, por nuk e dija ç'kuptim kishte. Para se të arrinin në shtëpi, unë ia thashë këtë Martës. I thashë se njëri nga rojet apo ushtarët më thirri me emër. Ajo tha që ishte e pamundur, sepse ne s'kishim qenë ndonjëherë atje. “Ke të drejtë,” i thashë. “Edhe unë kështu mendova, por ai e shqiptoi qartë emrin tim”.

“Po kjo nuk është e mundur,” përsëriti ajo. “Nuk ka si të jetë ashtu. Do ta kesh dëgjuar gabim”.

Të nesërmen unë shkova në garazh për diçka dhe vura re se xhipsi, me të cilin kishim udhëtuar ishte gërvishur në parafango, teksa Marta e kishte futur në garazh. Për ca ditë të tjera nuk pati ndonjë gjë të pazakontë, por, kur Shtefko më thirri nga mesi i kopshtit, unë i tregova çfarë kishte ndodhur. “Duhet të bësh një ankesë për ata maskarenj. Kush e di çfarë bëjnë atje! Kur Ia thashë këtë Martës në drekë, unë s'mund të mos vija re që kjo e bëri nervoz.

Unë nuk e ngacmova duke bërë sikur s'kisha vënë re gjë, por, pas gjashtë vjet bashkëjetese, është vështirë të fshehësh diçka plotësisht, duke përfshirë këtu edhe ndjesitë. Dhe unë kisha ndjesinë sikur Marta dinte diçka që nuk e thoshte. Ishte një ndjesi e çuditshme të mos i besoja asaj. Mendoja që do të ishte diçka vërtet për të qeshur, ndoshta një shaka. Atë natë, pikërisht, kur mua gati po më zinte gjumi, Marta shkoi në kuzhinë për diçka. Doja t'i

thosha të më sillte diçka për të pirë, por ndjeva që e mbylli derën e kuzhinës dhe m'u desh të ngrihesha vetë. Isha gati për të hapur derën, kur kuptova se ajo po fliste me dikë në telefon. Por nuk ishte kjo që më bëri të ndaloja, sesa toni i zërit të saj. Kushdo që të ishte, ajo po i fliste duke pëshpëritur me nervozizëm. Unë ndalova dhe po dëgjoja me dorën në dorezën e derës, por nuk nxora dot gjë nga ato që thoshte ajo:

“Absolutisht. Oh, absolutisht. Ti s'duhet ta kishe bërë këtë. Mm, unë nuk mendoj kështu. Ti nuk e kupton. Ai donte t'i sqaronte gjërat. Me të vërtetë! Po, shoku i vet i tha që duhet të ankohet. Sigurisht që është gjë e ngatërruar! Sigurisht! Nuk e di. Kjo mund t'i ndryshojë fare gjërat. Këtë mund të të them. Oh, natyrisht.” Unë hapa derën dhe hyra në dhomë. Menjëherë zëri i saj ndërroi nga një pëshpëritje nervoze në një ton të qetë, të zbutur dhe tema e bisedës, gjithashtu, mori një kthesë të papritur.

“Është shumë vonë tani. Mirë. Do të të telefonoj nesër. Do t'ia jap mesazhin”. Ajo e vuri në vend telefonin dhe u kthye nga unë: “Ishte vëllai im, të bën të fala, shpirt.” Tunda kokën, hapa frigoriferin rrëmbeva një lëng frutash dhe u ktheva në dhomë të gjumit. Nuk e kisha idenë çfarë po ndodhte, por dija që Marta po më gënjente. U përpoqa të fle. Ashtu siç kisha kuptuar unë çfarë mendonte dhe ndiente ajo, e kishte kuptuar edhe ajo. Ndihesha i turbulluar. Në vend që të flija, rrija shtrirë duke pyetur veten për çfarë po fliste ajo. Ajo më zuri në gojë mua dhe ankesën, gjë që mund të kishte të bënte edhe me përpjekjen time të dështuar për të hyrë në universitet përsëri ose për zonën ushtarake të rrethuar me tela me gjemba që nuk ekzistonte në asnjë hartë. Të nesërmen unë shkova në garazh dhe, sapo pashë gërvishtjen në parafango, gjërat filluan të lidhen. Së pari, Marta ishte përpjekur të më bindte të mos shkonim tek ndërtimet, për të cilat na kishte folur nipi i Uniterit, të cilat i përkisnin ushtrisë. Së dyti, gjatë gjithë kohës që ne qëndruam atje, ajo nuk e nxori këmbën nga makina dhe ajo që

unë e konsiderova si lodhje, ka qenë stres dhe nervozizëm. Unë po habitesha si nuk më kishin shkuar në mëndje më parë këto gjëra. Tjetër: ajo e kishte gërvishtur xhipin duke hyrë në garazh, pikërisht, kur unë i thashë se roja m'u drejtua me emër, megjithëse s'kisha qenë ndonjëherë më parë atje. Përsëri nervozizëm. Dhe në fund – telefonata.

Të nesërmen, unë u ngrita pa lindur dielli, me kujdes që të mos zgjoja Martën. E vështrova disa herë. Flokët e saj, çehrja e saj përjetësisht apatike. Teksa e shikoja, gati sa nuk u përkula ta prekja e ta puthja, siç bëj zakonisht. Dashuria mund të çojë në veprime të sëmura. U ndalova, sepse nuk doja ta zgjoja. Isha brenda një aventure. Qëkur mbarova sistemin e vaditjes, isha pak i mërzitur, ngaqë s'kisha me çfarë të merresha. Sapo u veshja, unë kuptova se gjithçka po shkonte sipas planit. Shumica e aventurave, nëse e mbaja mend mirë, nisin në agim. Mora ca ushqime dhe ca kuti me lëng frutash nga frigoriferi. Mbusha një kuti plastike me ujë të pijshëm.

Më në fund, unë i ngarkova të gjitha në makinë dhe e shtyva ngadalë jashtë nga garazhi me qetësi. Nuk desha ta ndizja motorin menjëherë, sepse zhurma do të zgjonte Martën. Kisha lënë një shënim në tavolinën e bukës, ku i shkruaja se po shkoja në qytet të merrja diçka tek Shtefko. Gjë që ishte e vërtetë dhe e bëra. Ajo që s'bëra dhe ishte në pjesën e dytë të shënimit, ishte se do të qëndroja tek ai atë natë, bëra të kundërtën. Në mbrëmje unë kisha ndërmend të shkoja në zonën ushtarake dhe të zbuloja çfarë bëhej aty. Pasi shtyva me dorë për një dhjetë minuta makinën, ndeza motorin, u futa në makinë dhe u nisa në rrugën time. Pas disa orësh arrita në qytet. Ndalova tek Shtefko, pastaj prej aty, shkova në librarinë e qytetit, ku bëra një kopje të hartës së fundit shtetërore. Ishte tamam ashtu siç mendoja unë: harta nuk tregonte asgjë në faqen, ku ishte vendosur zona ushtarake. E pyeta librashitësin, nëse ishte e mundur të kishte diçka që nuk tregohej në hartë. Pasi u mendua

pak, më tha se ka mundësi, prandaj më rekomandoi të shkoja në bashki, sepse ata i kishin ndryshimet e reja në hartat e tyre. Rrugës për në bashki, unë kuptova se gardhi që rrethonte zonën, ndërtesat që i kisha parë në largësi dhe vetë kabina e portierit nuk ishin struktura të reja. Të ruajtura mirë po, por jo të reja. Gjithçka aty kishte qenë për disa vite më parë. Kur arrita në bashki, nëpunësi i informacionit më dërgoi në katin e tretë. U ula në stol, në korridor duke pritur radhën time. Kur më thirrën brenda, unë ia shpjegova zonjës për cilën zonë isha i interesuar dhe ajo më tha, menjëherë, se atje s'kishte asgjë të re, por ajo do të kontrollojë. Pas pak, ajo erdhi me një hartë kadastrale. Ashtu siç e prisja unë, aty nuk tregohej asgjë. Pagova taksën për një kopje dhe, para se të largohesha, e pyeta si mund të tregohej një zonë ushtarake në hartë. Ajo u përgjigj:

“Me ngjyrë të verdhë. Duhet të shënohet me të verdhë, por duhet të tregohet edhe në legjendën e hartës.” E pyeta edhe një herë, nëse kishte ndonjë zonë ushtarake në rrethin tonë. Përgjigja ishte: jo! Ndoshta nëpunësja e kishte të qartë për çfarë e kisha fjalën, sepse zonja vazhdoi duke thënë se ka ligje dhe rregulla specifike për gjithë këtë dhe ato nuk ju lejojnë të hyni aty. Gjithsesi, çfarëdo që të bëjnë ata, është puna e tyre. Por çdo gjë duhet regjistruar dhe ky është ligji, prandaj është njësoj në çdo rreth. Unë dola që andej i kënaqur, megjithëse jo dhe aq. Isha i vendosur për një aventurë, por, pasi mësova se, në të vërtetë, s'kishte asgjë atje dhe, tani, duke pasur dokumentin në dorë për ta vërtetuar këtë, rreziku i përfshirë në operimin tim të planifikuar, ishte zvogëluar shumë.

Në valixhen time unë kisha provën që ata ushtarë të çuditshëm s'kishin punë fare të gjendeshin aty. Atë pasdite unë qëndrova tek Shtefko dhe ia shpjegova edhe një herë çfarë kisha marrë vesh. Ai tundi kokën dhe tha se kjo nuk i dukej gjë e pastër. Ai, gjithashtu, më premtoi se, po të telefononte Marta, do të sajonte diçka që ajo të mos shqetësohej. Mund të them që ai ishte i shqetësuar,

përderisa më pyeti, nëse shkonte gjithçka mirë midis nesh, pra, midis meje dhe Martës. I thashë po, por nuk dita si t'ia shpjegoja ndjesinë time se ajo diçka më fshihte, kështu që nuk e zgjata më tej.

U largova nga qyteti atë pasdite. Unë kisha vizatuar një skicë të përafërt të kompleksit ushtarak, me laps në hartë dhe u përpoqa t'i afrohesha nga mbrapa. Plani im ishte të ngjitesha mbi telin me gjemba dhe të hyja në njërën prej ndërtesave. Gjithçka shkoi sipas planit. Unë ndoqa rrugën siç e kisha shënuar në hartë dhe arrita tek vendi gjysmë ore pas perëndimit të diellit. Isha pak kilometra larg gardhit me tela me gjemba, makinën përreth vendit, në mënyrë që asnjë nga ushtarët të mos më shikonte, derisa arrita në anën e kundërt të gardhit, ku kisha qenë me Martën më parë. Nxora pajisjet e mia dhe i kontrollova përsëri. Dorezat dhe batanijen e rëndë për ta hedhur përsipër telave me gjemba. Një litar, dy elektrikë dore, thika të vogla dhe të mëdha në mill. Dy palë lidhëza këpucësh. Fiks fare! Dy termusa të mëdhenj me kafe. Një kamera. Dy shirita filmi. Ndërresa të pastra. Tri palë çorape. Kutinë e ndihmës së shpejtë. Më dukej se gjithçka që një botanist kompetent duhet të ketë në një ekspeditë si kjo e imja. Kontrollova gjithçka me një binokël. Perimetri kishte formën e një katërkëndëshi kënddrejtë, rreth pesë ndërtesa të gjata, në qendër. Ato dukeshin të gjitha njësoj. Njëra prej tyre kishte një shenjë në formë katrori të verdhë me germën H në qoshe. Afër njëres prej ndërtesave kishte ca si pajisje elektrike. Gjërat e vetme që dallova ishin dy helikoptere dhe një dy antena. Ca burra me uniformë shkonin nga një bllok tek tjetri, teksa unë i shikoja me binokël.

U errësua një orë pas perëndimit të diellit. I vura të gjitha në një çantë shpine, përveç fenerit elektrik dhe batanijes, që i mbaja në dorë, dhe dola jashtë. M'u desh të përkulesha, kur u afrova tek gardhi, sepse dy vetë përsëri po kalonin nga një ndërtesë tek tjetra. Gardhi ishte tri metër e gjysmë i lartë dhe në krye kishte tela me

gjemba. M'u deshën dy përpjekje për ta hedhur batanijen përmbi të. Vura dorezat dhe fillova të ngjitem. Ishte më vështirë nga sa e mendoja. Edhe pse me batanije, mua më ngecën pantallonat në një gjemb, kur u hodha sipër. Dukej më e lehtë në filma. E kuptova se më mungonte praktika ose, në përgjithësi, ndonjë lloj stërvitjeje. Zbrita poshtë dhe u përpoqa ta tërhiqja batanijen, në mënyrë që të mos dukesha e të mos tërhiqja vëmendjen e padëshiruar. Në këtë proces, preva lëkurën në parakrah përmes këmishës, në një tel që s'e kisha vënë re më parë. Nxora shishen e dezinfektuesit dhe një fashë katërkëndëshe nga çanta e shpinës. E hapa shishen, e hodha dezinfektuesin mbi plagë, ia vura kapakun përsëri, e futa shishen në çantë, pastaj vura fashën. Aventura në zhvillim të plotë, mendova unë. Madje pata edhe dëmtimin e parë. Fillimisht, duhej të lija batanijen, por, pastaj, vendosa ta marr me vete.

Ndërsa po qëndroja në tokë, duke u përpjekur ta rrasja në çantë batanijen, ndjeva një tingull metali. I befasuar, u ngjesha pas tokës. Pas pak, disa llamba e prozhektorë, të cilat unë nuk i kisha vënë re deri tani, filluan të ndriçojnë dalëngadalë. Unë ndodhesha, tamam, poshtë njëres prej tyre. Nëse ndonjëra do të binte direkt mbi mua, unë do të isha plotësisht i zbuluar. Llambat ishin montuar në gardh në distancë prej rreth gjashtëdhjetë metrash nga njëra-tjetra. Më shumë llamba, që fillonin të ndriçonin ngadalë në errësirë, ishin vënë në konturet e turbullta të ndërtesave në largësi rreth treqind metra që këtej. U nisa me shpejtësi drejt tyre. Diku në gjysmë të rrugës, ndjeva disa zëra dhe u shtriva përdhe duke mbajtur edhe frymën. Nga tensioni po më fillonte dhimbja e kokës. Zërat kaluan nga ana tjetër e ndërtesës. Pastaj u dëgjua zhurma e mbylljes së dyerve dhe – qetësi. U ngrita dhe vrapova tek ndërtesa më e afërt. Duke kaluar fshehurazi rreth e rreth vura re se godinat kishin formë U – je. Kalova qoshen dhe kapa një dorezë dere. E mbyllur. Provova tjetrën. E njëjta gjë. Kalova tek një godinë tjetër. Ajo i kishte dritaret me xhama akulli, kështu që

s'mund të shikojë brenda. Më në fund, një derë qëlloi e hapur. Hyra brenda dhe u gjenda në një korridor me dyer që të çonin në zyra individuale. Të gjitha ato kishin një panel të sipërm prek xhami të qartë e transparent. Në dy dhoma, në fundin e largët të korridorit, dritat ishin të ndezura. Provova dorezën e dhomës më të afërt. Ishte e mbyllur. Lëviza më tutje duke provuar çdo derë. Më në fund, e gjeta njërën prej tyre të hapur. Hyra dhe u ula në dysHEME, në mënyrë që të mos dukesh nga jashtë, përmes xhamit. Vështrova përreth. Dy tavolina dhe disa pajisje elektronike. Në anën tjetër të zyrës ishin disa monitorë me ekran të drejtuar larg. Nga gumëzhima dhe shkëlqimi i bardhë e i zi që ndriçonte anën tjetër të zyrës, ishte e qartë se ata funksiononin. Akoma i shtrirë, unë u zvarrita përmes zyrës që të mund t'i hidhja një sy. Fillimisht, me të vërtetë, s'dija të tregoja çfarë po shikoja. Dy nga pesë monitorët s'kishin sinjal, ekranet e tyre tregonin vetëm një gri me kokrriza. Tre të tjerët riprodhonin pamje nga disa dhoma të ndryshme, të regjistruara nga kamerat e sigurisë. Kishte diçka të çuditshme lidhur me ta. I këqyra edhe një herë më nga afër. Monitorin e parë, pastaj tjetrin... pastaj prapë.

“S’e kisha parë kurrë shtëpinë time në bardh e zi. Fillimisht s’po kuptoja gjë dhe, kur u përmenda, u shtanga, mezi po qëndroja në këmbë. Nuk është e mundur! Ajo që po shikoja ishte shtëpia ime: dhoma ime e gjumit, dhoma e ndenjes, studimet e mia. E pamundur, mendova. Jastëkët në divan në dhomën e ndenjes dukeshin të huaja në ekranin bardhë e zi, meqenëse ato, në realitet, ishin jeshilë. Mund të thosha që janë ata, vetëm nga modeli i tyre. Rafti i librave që shikoja në monitor ishte, gjithashtu, në shtëpinë time. Monografia e Asisit që po shfletoja dje dhe kisha harruar ta vija në raft, ishte pikërisht aty, ku unë e mbaja mend që e kisha parë në mëngjes.

Më zuri paniku. Duhet të kishte shpjegime për këtë, ishte e pamundur. Për të qeshur! Është e pamundur, sepse është

antikushtetuese. Kjo është paranojë. Unë jam një aventurier i keq dhe truri im nuk di si të veprojë me këtë, po më krijon halucinacione! Jo, kjo është e pamundur, ky është spiunim dhe është i jashtëligjshëm. Po si është kjo punë? Panik përsëri. Rrahje të forta zemre, duart e djersitura, fytyrë të thatë. Si mund të jetë?

Fillova të hapja sirtarët. Asgjë interesante. Pajisje të zakonshme zyre: lapse, goma, kapëse letrash, stilolapsa. Disa blloqe. U zvarrita tek një dollap i gjatë dhe e hapa. Skeda dhe dosje kartoni. Hapa një. Informacion mbi mua. Një tjetër. E njëjta gjë. Vegime paranojake ngacmonin trurin tim. Jo, kjo është e tepërt. Aty kishte gjithçka rreth meje. E para kishte fotografitë e mia, e dyta – një kopje të kartës së vlerësimit tim nga shkolla. Skedat më ranë nga duart. Nuk isha në gjendje t'i merrja. Nxora një dosje tjetër të rastësishme: kopjet e artikujve të mi të shkollës për zambakët dhe bozhuret. Nuk po kuptoja gjë. Hapa një tjetër: përshkrimet dhe vizatimet e detajeve më të holla të lojërave të mia, kur isha fëmijë. S'mund të nxirrja më. Ajri i kondicionuar ishte fikur dhe unë duhej të dilja jashtë urgjentisht, në ajër të pastër. Ngeca në korridor. Nuk më interesonte më, nëse mund të më shikonte dikush apo jo. Çfarë ishte kjo, gjithsesi? Kisha nevojë për ajër të pastër. Hapa derën e ndërtesës, dola jashtë dhe e kuptova se po dridhesha. U ula përdhe përballë derës dhe qëndrova aty.

Dera nga e cila dola, tek e cila tani isha mbështetur, u hap dhe zërat që i ndieja të më afroheshin, u ndërprejnë. Më rrethuan tre vetë me uniformë. Ndjeva se duhej të bëja diçka, prandaj me pak përpjekje, e ngrita kokën dhe i vështrova. Ndërkohë që sytë e mi takoheshin me të atyre, njëri prej tyre bëri një fishkëllimë të çuditshme. Tjetri tha:

“Ah, domethënë z.Hegel na ka ardhur për vizitë”. Pastaj u kthye nga ai që fishkëllei dhe i tha:

“Shko bëj njoftimin: direktiva katërmbëdhjetë, artikulli tetë”. Teksa ushtari vrapoi me urdhrin, eprori i tij u kthye nga unë:

“Epo, çfarë do të bëjmë me ju, z.Hegel, çfarë do të bëjmë? Ne po ju prisnim të na vinit për vizitë, po, por jo kaq shpejt” Unë e vështrova oficerin, duke u përpjekur të mendoja çfarë të thosha, por, para se unë të përgatisja përgjigjen, dera nga e cila hyri ushtari që mori urdhrin e njoftimit, u hap me vrull dhe dolën dy ushtarë. Ata u drejtuan me vrap për tek njëri nga helikopterët. Hapën kabinën, hynë brenda dhe mua më përpiu zhurma dhe rrotullimi gjëmues i helikës. Rëra dhe zhavorri m’i mbushën sytë. Pas një çasti, helika tërhoqi kabinën drejt qiellit së bashku me dy pilotët dhe i mori me vete që andej me gjëmim.

“Ju më detyroheni shumë shpjegime,” u thashë, kur gjëmimi u largua që andej. “Shumë. Vërtet, shumë”. Oficeri tundi kokën dhe më ndihmoi të ngrihesha, ndërsa ushtari tjetër, i cili qëndronte pas meje, më dha çantën e shpinës që më kishte rënë nga duart.

“Vetëm mos fillo me kushtetutën,” tha oficeri. “Ne e kemi një ekzemplar.”

“Një ekzemplar?” pyeta unë. “Po kush mendoni se jeni ju?”

“Sa arritët të shikoni, në të vërtetë, z.Hegel?” pyeti oficeri, teksa e mbante hapur derën e ndërtesës, nga e cila unë sapo kisha larguar. “Sa informacion keni ju tani?” Jo, mendova, nuk do të bie në këtë mashtrim idiot. “Në këtë moment, ne mund t’ju tregojmë gjithçka. Sipas direktivës katërmbëdhjetë, veprimi i juaj sot, do të thotë që eksperimenti ynë ka përfunduar.”

“Eksperimenti? pyeta unë. “Për çfarë po flisni? A e dini sa ligje keni shkelur?” Oficeri nuk u përgjigj dhe më tregoi me dorë ç’rrugë duhej të ndiqja”. Kur arritëm në fund të korridorit, ai hapi derën e zyrës së vet dhe tha: “Uluni, ju lutem. Çfarë doni për të pirë: kafë, birrë, verë, ujë mineral? Çfarë të dëshironi, i kemi këtu të gjitha”.

“Unë dua të më jepni shpjegim - çfarë është kjo?”

“E kuptoj” tha oficeri duke tundur kokën. “Unë e kuptoj dhe është pikërisht kjo arsyeja që ne filluam procedurat sipas direktivës

katërbëdhjetë”. “O zotëri, nuk e di për çfarë drejtin po flisni dhe as që më intereson kjo direktivë”. “Zoti Hegel” tha oficeri “unë do t’ju kërkoja të përmbaheni, të paktën, edhe” ai vështroi orën e dorës “njëzet e tre minuta. Direktiva Katërbëdhjetë parashikon që, brenda gjysmë ore, të mbledhet komisioni i krizës së projektit dhe do t’ju shpjegojnë gjithçka. Unë vetë nuk jam anëtar, megjithëse kam kryer një trajnim lidhur me këtë çështje, nuk jam i autorizuar t’ju them asgjë më shumë. Edhe një herë po ju kërkoj të prisni, derisa ekipi i specialistëve, të cilët kanë punuar për eksperimentin, t’jua shpjegojnë të gjitha në më pak se tridhjetë minuta. Ndërkohë, mund t’ju ofroj një *snack* dhe të thërres mjekun të ekzaminojë plagët që mendoj se i ke marrë duke kaluar gardhin”. Ngrita supet, oficeri vështroi ushtarin tjetër – ai u bind dhe doli jashtë. Unë dhe oficeri mbetëm ulur në zyrë. Ajri i kondicionuar funksiononte me ritëm të plotë. Ushtari tjetër u kthye me një tabaka me pije freskuese, pas tij hyri një burrë me një çantë. E vendosi mbi tavolinë dhe e hapi. Këqyri leukoplastin në krahun tim. E hoqi, dezinfektoi vendin e gërvishtur dhe ma lidhi me fashë. I perceptova gjestet e tij si armiqësore. Jam i nervozuar, mendova. “Më duhet të bëj një telefonatë” thashë. Oficeri pranoi dhe më pyeti: “Kujt do t’I telefonosh, zoti Hegel, kujt?” “Gruas sime.” Ai përsëri pohoi. “Do të jetë këtu brenda...” vështroi orën “shtatëmbëdhjetë minutash”. Tunda kokën për të thënë se nuk po kuptoja gjë. “Helikopteri që e patë tek ngrihej, ka shkuar për ta marrë” shpjegoi oficeri. “Ajo është anëtare e komisionit të krizës” shpjegoi oficeri. Çfarë budallallëku është ky tjetri, mendova dhe vendosa të pija diçka e t’i lija gjërat të ndiqnin rrugën e tyre.

Ndjeva arritjen e helikopterit. Pas derës me xham u shfaq një burrë nga gjashtëdhjetë vjeç, tullac. Me njërin dorë tërhoqi kravatën, me tjetrën trokiti në derë. Hyri dhe tha: “Mirëmbërë zoti Hegel, jam drejtori i projektit”. “Për cilin projekt flisni?” e pyeta. “Vërtet, çfarë bëni këtu?” “Më ndiqni në sallën e konferencave,

ju lutem” më tha, dhe pas një pauze të shkurtër, përsëriti edhe një herë me një ton më të zbutur: “Ju lutem, më ndiqni në sallën e konferencave”.

U ngrita nga karrigia dhe eca pas tij. Dolëm nga zyra dhe arritëm tek hyrja e ndërtesës. Drejtori më hapi rrugën, më mbajti portën dhe më buzëqeshi me nervozizëm, sikur më mëshironte. Dola në kopsht. Tani gjithçka kishte një pamje të ndryshme në krahasim me atë, kur ai kishte kapërcyer gardhin. Gjithçka ndriçohej me reflektorë, të cilët nuk i kishte vënë re më parë. Në një rrugicë ndërmjet dy ndërtesave, pashë të parkuar makinën time. Provova një ndjesi të bukur, hera e fundit që jam ndjerë kështu, ishte kur nëna më kapi duke pirë cigare. Isha katërmbëdhjetë vjeç, u ndjeva i rritur dhe ajo s’dinte ç’të thoshte. Përpiquej të tregohej e rreptë, por nga sytë kuptohej se i vinte për të qeshur. Më konsideronte të rritur, duke iu nënshtruar bindjes së saj, më respektoi dhe nuk tha asgjë.

Drejtori ma hapi derën përsëri dhe hymë në një ndërtesë tjetër. Përtokë ishte shtruar një qilim. Prapa derës ishin dy ushtarë. Vazhduam të ecnim dhe arritëm para një dere të madhe të veshur. Para saj edhe dy ushtarë të tjerë, njëri nga të nga të cilët na hapi derën. Kur i kalova afër, pata përshtypjen se po më ndiqte me sy. Kontrollova pantallonat dhe këmbishën, por të gjitha kopsat i kisha të mbërthyera. Ndoshta po djersij shumë, mendova. Nën sqetulla isha bërë qull. Drejtori ma mbajti përsëri derën që të kaloja dhe hymë në dhomë.

Nga e majta kishte tavolina konferencash të vendosura në formë gjysmërrethi, ku ishin ulur gjashtë a shtatë vetë. Midis tyre pashë Martën. I dola përpara. Kishte veshur një palë pantallona, një bluzë dhe robdëshambrin. Me siguri e kishin zgjuar nga gjumi, mendova. Para se të arrija tek ajo, dy duar nga secila anë më ngritën dhe më përplasën në tokë, para se të mund të thosha ndonjë gjë. Drejtori ishte afruar pranë meje, qëndroi mbi mua, mblodhi supet

dhe tha: “Harrova t’ju them, zoti Hegel, se tani s’mund të flisni me Martën”. “Pse?” e pyeta i inatosur, pasi u ngrita me ndihmën e dy ushtarëve, të cilët, para një çasti, më kishin hedhur përtokë. Ai tundi kokën. Nga ana tjetër ishin dy tavolina. Në atë më të largëtën ishte ulur mjeku – i vetmi që njihja unë. Ushtarët më shtynë në drejtim të tavolinës, pranë mjekut. “Në djall vafshi, si guxoni?” i mallkova unë. Nuk po përmbahesha më. “Si guxoni të na trajtoni kështu mua dhe gruan time? Bandë idiotësh të mallkuar! Si mund të na e bëni këtë?”

“E dini, zoti Hegel, Marta nuk është gruaja juaj” tha drejtori. “Edhe ajo është pjesë e eksperimentit”. U shemba mbi karrige. Mjeku që ishte ulur në tavolinë afër meje, u ngrit, m’u afrua, ndërsa nga ana tjetër drejtori fliste me gjysmë zëri me anëtarët e komisionit, pastaj më tha: “Zoti Hegel, ajo që do të dëgjosh, ka rrezik të minojë ekuilibrin tuaj, madje, ka mundësi, t’ju shkaktojë edhe *shock*” tha ai me një buzëqeshje të pakëndshme. “Do të ishte e çuditshme, nëse çka do të dëgjoni sot, të mos ju shkaktonte një *shock*. Mund t’ju propozoj një injeksion qetësues ose, të paktën, një qetësues të butë që nuk do t’i kufizojë aftësitë tuaja njohëse.” “Në djall, uluni dhe më lini rehat” i thashë. Mjeku u kthye tek tavolina dhe iu drejtua drejtorit, Martës dhe anëtarëve të tjerë të komisionit duke u thënë me zë të lartë: “Mund të filloni”, pastaj u ul. Ktheu karrigen nga ana ime që të më kishte nën vëzhgim. Më bezdiste.

Nga ana tjetër e dhomës u ngrit drejtori dhe mori fjalën:

“Të nderuar zonja dhe zotërinj, ju kërkoj ndjesë që ju mblodha kaq papritur sot, por zoti Albert Hegel na ka ardhur për vizitë. Ka ardhur me makinën e vet, të parkuar në afërsi të institucionit tonë. Ka kapërcyer gardhin dhe ka hyrë në sektorin F, ku ka gjetur dhe mund të ketë lexuar materiale të ndryshme. Në përputhje me direktivën katërmbëdhjetë, eksperimenti duhet të përfundojë dhe jemi të detyruar t’i shpjegojmë z.Hegel të gjithë eksperimentin,

sipas dispozitës së direktivës mbi të drejtat civile. Siç ju kujtohet, javën e kaluar, kemi pasur një përmbledhje të situatës, të paraqitur nga doktorëshë Vagnerova dhe Marta”.

Kur u shqiptua emri i saj pata një gulçim. “Në fakt, prisnim ndonjë veprim nga ana e zotit Hegel, por ndodhi më herët se e kishim parashikuar. As në shkencë s’mund të parashikohen të gjitha” tha drejtori, bëri një pauzë dhe buzëqeshi si për të kërkuar ndjesë. Pra, ky budalla, përveç të qenët shumë i sigurt në vetvete, është edhe një orator i zoti, mendova unë. “Do t’i lutesha doktorëshë Vagnerovës të fillojë” tha drejtori, u përkul dhe, shumë shpejt, nga e djathta e tij, afër Martës sime, u ngrit një grua rreth dyzet e pesë vjeçe.

“Zoti Hegel, kjo që do të dëgjosh, natyrisht, do t’ju habisë, gjithsesi, ju informoj që eksperimenti në fjalë dhe faktet që lidhen me të, nuk prekin në asnjë mënyrë ligjin, sepse duke u mbështetur në rëndësinë e studimit tonë, kemi pasur leje t’i shkelim të drejtat civile. Studimi ka të bëjë me përcaktimin dhe njohjen e së keqes. Siç e dini mirë, kemi qenë shumë kërkuar për t’ju udhëzuar rreth historisë, sidomos asaj të kohëve të fundit, lufta e Dytë botërore, që përfundoi para pak kohësh në Europë, për shembull. Nuk do të zgjatem të tregoj përsëri, mjafton të dini se nga përfundimi i saj, shumë shkencëtarë, historianë, politikanë dhe jo profesionistë, janë interesuar për këtë çështje: deri në çfarë pike origjina, evolucioni dhe përfundimi i asaj ngjarjeje të tmerrshme kanë qenë të kushtëzuara nga personaliteti më i rëndësishëm i Rajhut të Tretë të Gjermanisë, kancelari Adolf Hitler. Kampet e përqendrimit, eugenetika, vuajtja e pamatshme e kështu me radhë. Praktikisht, e gjithë kjo përbënte thelbin e problemit që s’mund ta zgjidhte askush, sepse Hitleri në fund të luftës së Dytë botërore u vetëvra.

Askush s’kishte mundur ta përballte me tmerret që kishte shkaktuar, siç ishte vepruar me anëtarët e tjerë të regjimit të tij anormal gjatë procesit të Nurembergut. Ne sot gëzojmë një

shkëputje më të madhe, falë kohës së kaluar dhe mund të vëmë re se as ai proces s'ka qenë i përkryer dhe nuk i është përgjigjur të gjitha pyetjeve e, megjithatë, mungesa e Adolf Hitlerit ka qenë jashtëzakonisht penalizuese në studimin mbi të keqen. Para më shumë se pesëdhjetë vjetësh, u gjendën eshtrat e tij dhe u sollën, në mënyrë sekrete, në institucionin tonë, i cili merret me studimin e së keqes në të gjitha format e saj. Babai shpirtëror i projektit ishte Robert Fisher, i cili vdiq para se të fillonte. Ideja e tij qëndronte në klonimin e individëve bartës të së keqes dhe vendosja e tyre në kushte familjare e historike të ndryshme nga ato, në të cilat ishin rritur origjinalët. Të studiohej me vëmendje zhvillimi i tyre, sjellja e qëndrimi i tyre dhe, vetëm në këtë pikë, të përcaktohet, nëse e keqja është e trashëgueshme apo e gjithë shoqëria mban përgjegjësi për të.

Debati shkencor është zhvilluar midis ekspertëve që mbronin pikëpamjen se lufta e Dytë botërore ka qenë e përcaktuar nga një i çmendur dhe nga ata që e shikonin si rezultat i një evolucioni të gjatë të gjurmueshëm, sipas mendimit të disave, deri në kohët e Spartës antike. Debati shoqëror kishte dy fraksione. Në qoftë se, për disa, gjëja më e rëndësishme ishte edukata, për të tjerët ishte ndikimi i trashëgimisë dhe testi i Fisherit ishte themelor për të dy rrymat. Për fat të keq, Robert Fisher nuk jetoi mjaftueshëm për të parë eksperimentin në veprim.

Vetëm para tridhjetë vjetësh ose pak më shumë, u arrit, më në fund, të zhvillohej një teknologji mjaft e besueshme që arriti të rikrijonte nga eshtrat e indeve të të vdekurve një të klonuar, të themi, qind për qind. Fjalët *original* dhe *kopje* nuk kanë kuptim, në të vërtetë. Siç, ndoshta, e keni kuptuar edhe vetë, ju jeni në gjithçka dhe për gjithçka identik me individin që quhej Adolf Hitler. Për nder të profesor Fisherit, ju është vënë një emër me initiale të njëjta me paraardhësin tuaj. Mbiemri Hegel u mbështet nga një grup studiuesish, të bindur që rrënjët e nazizmit ishin

të gjurmueshme, tashmë, që në filozofinë e klasike të filozofit gjerman Hegel.

Qasja e tyre nuk ishte plotësisht korrekte, por atëherë pati njëfarë vazhdimësie. Pra, emri i tij nuk vjen nga të parët e tij ose nga një gjysh europian, siç besohet deri atëherë. Me anën filozofike të çështjes janë marrë doktor Reti dhe doktor Dyshamp”.

Panik - tëmthat dhe gryka që oshtijnë. Vështrova Martën, nga e cila më mbanin larg, por vështrimi i saj ishte i fiksuar në një pikë, afërsisht tre metra larg saj – në tapet. Gjatë gjithë kohës as që m’i kishte hedhur sytë. Papritur u gjenda pranë mjekut me një shiringë në dorë. Tunda kokën. Ai qëndroi aty për një çast, pastaj u ul përsëri. Do të doja të zgjohesha, por s’kishte asnjë mënyrë. Nga çka kishin treguar dukej se e tërë jeta ime ishte qeverisur nga dikush tjetër. Kërkova konfirmim. Njëri prej tyre m’u përgjigj se ishte, tamam ashtu. “Epo mirë pra” thashë “si është e mundur që i kam flokët të verdhë dhe jam i gjatë një metër e tetëdhjetë e shtatë? Hitleri nuk ishte kështu, nëse i mbaj mend mirë leksionet e historisë dhe fotografinë bardh e zi në manual”. Drejtori bëri një buzëqeshje të shtirë: “Zoti Hegel... Albert... para tridhjetë vjetësh, nuk mund të arrinim deri në kushtëzimin e një varianti të geneve, kështu që i lamë ashtu siç ishin. Fakti që ju paraqiteni fizikisht, e theksoj - vetëm fizikisht, pak ndryshe nga Adolf Hitleri, nuk do të thotë që ju nuk jeni ai. Është një pyetje që bëhet shpesh nga njerëz jo ekspertë”. “Pra, jam ai edhe pse nuk i ngjaj?” e pyeta. “Po, pikërisht, kështu” u përgjigj doktoreshë Vagnerova? “Tani, a mund të flas me Martën?” pyeta. “Natyrisht” tha dikush që s’e njihja. “Po ju kush jeni?” pyeta unë. “Ehm, më falni, harrova të prezantohem, jam doktor Reti”. “Mirë” thashë. “Atëherë dua të flas me të”. “Urdhëroni, mund të flisni” m’u përgjigj Reti. “Jo këtu, dua t’i flas privatisht “Ah,atëherë s’qenkemi kuptuar” tha Reti. “Privatisht, nuk është e mundur?“Po pse?“ “Sepse tani eksperimenti ka mbaruar”. “Po unë dua të flas me të, dua të flas

tani, menjëherë” thashë. “Druaj se nuk është e mundur” tha Reti. Për një çast, ra heshtje. Pastaj u ngrit një burrë me një xhakëtë të rrudhur, pa kravatë.

“Quhem Somer, jam doktor Someri. Ky projekt ndërkombëtar bazohej mbi supozimin që të kontrollohej çdo faktor i klonimit tuaj, nëse ishte e mundur të kontrollohej. Kemi regjistruar gjithçka dhe të gjithë, më saktë, pjesa më e madhe e gjërave dhe e njerëzve që keni njohur ishin të lidhur, në ndonjë mënyrë, me projektin tonë. Siç mund ta imagjinosh punonjësit e komitetit tonë, dhe gjithë eksperimenti, kanë qenë në lidhje të ngushta me Ministrinë për mbrojtjen e kushtetutës, të lirisë e të demokracisë. Kjo do të thotë se kemi shfrytëzuar shpesh eksperiencën e tyre”. “Domethënë?” “Domethënë se, për qëllimet e eksperimentit, na është dashur, në një farë mënyre, t’ju mbanim disi të izoluar, për këtë, ju keni trashëguar, të themi, toka në kufijtë e shkretëtirës. Po të kishit jetuar në një qytet të madh, ndikimi i një metropoli, si dhe njohja e pakontrollueshme me njerëz të ndryshëm, do ta kishin bërë të pavlefshëm eksperimentin. Për ne ishte tepër e rëndësishme që ju të ndodheshit në një izolim, të paktë, të pjesshëm”. “Po Marta?” e pyeta. “Ehm” tha burri duke pastruar zërin. E zhvendosi peshën nga njëra këmbë tek tjetra, pastroi përsëri zërin, hoqi kapakun e shishes me ujë mineral që kishte përpara, e mbylli përsëri, pa hedhur ujë në gotë, dhe tha: “Të gjithëve na vjen keq për ju, nuk jemi njerëz pa ndjenja apo përbindësia, megjithëse kemi përdorur, të themi... të themi procedura pak të përdorura në Ministrinë e mbrojtjes së kushtetutës, të lirisë e të demokracisë”. “Atëherë, Marta?” pyeta përsëri. “Marta është një bashkëpunëtoresh shumë e vlefshme që, pasi fitoi një konkurs shumë të vështirë, ka ndjekur një kurs dhe një stërvitje, po aq të vështira.

Duke e dëgjuar të fliste, m’u tha pështyma në grykë. “Çfarë do të thotë që është një bashkëpunëtoresh e juaja?” “Epo, do të thotë se ishte ajo që merrej me vendosjen e telekamerave të fshehta në

korridor, që shkruante çdo javë një raport të imtë, që na informonte për gjëra të papritura... e kështu me radhë. “Çfarë të papriturash?” “Mhm... Për shembull përpjekjet tuaja për t’u regjistruar në fakultetin e botanikës. Na ka kushtuar shumë që të ndikonim tek rezultatet e provimeve, në mënyrë që ju të mos pranoheshit. Dhe shumë herë.

Një herë për pak sa nuk u pranuat, pavarësisht nga ndërhyrja jonë. Dëshira juaj për të studiuar na ka vënë në një provë, vërtet, të vështirë. Shumë vetë fillonin të bënin pyetje. Dhe ja, Marta përpiquej të të kushtëzonte, ndonjëherë pa sukses, mmh...ehm... në mënyrë që eksperimenti të mos dëmtohej”. Marta, akoma, i kishte sytë të fiksuar tre metra para vetes. “E përse s’mund t’i flas privatisht?” “Kjo do të ishte në kundërshtim me rregullin 6, zoti Hegel” ndërhyri drejtori. “Rregulli 6 e ndalon”. “Unë nuk dua t’ia di për rregullat tuaja” thashë. “Ne ju kuptojmë, vërtet, zoti Hegel, por, për fat të keq, nuk mund ta pranojmë kërkesën tuaj. Megjithatë kjo ju zhgënjën, ju lutemi të qetësoheni” tha drejtori. “Për të përfunduar” e rimori fjalën Reti “e gjithë bota juaj ka qenë e monitoruar, që nga lindja juaj. Ju jeni rritur në një ambient shumë normal, i bërë, qëllimisht, i zakonshëm.

Edhe nëna e babai juaj kanë qenë anëtarë të projektit. Por nënës suaj iu desh t’ju braktiste para kohe, sepse kishte arritur të vendoste një lidhje shumë të fortë sentimentale me ju”. “Domethënë nëna ime s’ka vdekur?” “Jo, sigurisht, jo. Ishte anëtare e eksperimentit”. Por s’mund ta takoj, kështu?” “Absolutisht jo, druaj se edhe kjo hyn në rregullin 6, kështu që jo. Për të vazhduar... të gjithë librat tuaj, videot, dëgjimi i audiove – gjithçka ka qenë e monitoruar. Personat që takonit, ditaret tuaj, ndjenjat tuaja, lidhjet intime me Martën – të monitoruara. Për shembull, gjërat pas të cilave ju keni qenë i dhënë që në fëmijëri lodrat, librat, kartolinat, suvenirët dhe vogëlsira të tjera, mbahej nën vëzhgim gjithçka dhe një skuadër ekspertësh vlerësonte gjithçka në mënyrë të vazhdueshme.” “Jeni

një bandë paranojakësh të ndyrë” bërtita. “Zoti Hegel, ne nuk presim që ju ta kuptoni projektin e zhvilluar për të individualizuar kushtet që lindin të keqen. Me gjithë respektin, ju nuk jeni ekspert”. Papritur, e mori fjalën drejtori dhe tha: “Deklaroj një pauzë prej gjysmë ore”.

Të gjithë, duke përfshirë edhe Martën, u ngritën e dolën jashtë. Mbeta vetëm në dhomë me mjekun dhe rojet. Nuk po duroja dot më. “Dua të shkoj në shtëpi” i thashë mjekut. Mjeku më dha një përgjigje, së cilës nuk i kushtova vëmendje. U ngrita, u ndjeva i lodhur, jashtëzakonisht i lodhur, i lodhur brenda, brenda trupit tim. Isha i lodhur dhe doja të kthehesha në shtëpi. Pas disa minutash, mjeku u kthye. Kishte ca dokumente që m’i lëshoi në dorë. I mora pa ua hedhur sytë. Më ofroi të largohesha me një helikopter. Nuk pranova dhe ai më tha se, po të doja, do të më shoqëronin me makinë. U mërzita. Udhëtimi drejt shtëpisë s’më ishte dukur kurrë aq i gjatë. E ngiste makinën një ushtarak, pas nesh vinte një automjet ushtarak. Në makinë, mjeku më tha se telekamerat që kisha pasur në shtëpi, tashmë, ishin hequr dhe eliminuar. I thashë, përse duhej t’i besoja. Më tha se gjithçka ishte shkruar në dokumentet që më dha dhe se duhej të firmosja. Nuk pranova dhe ai nuk nguli këmbë. Kur arritëm në shtëpi dhe e parkuan makinën time para garazhit, këqyra përsëri parafangon që Marta e kishte gërvishtur duke parkuar, pas udhëtimit që kishin bërë së bashku në bazën ushtarake. Pyeta mjekun, nëse pronari i fidanishtes, Shtefko, ishte njëri prej tyre. “Mendoj se jo” m’u përgjigj. “Jo, e sigurt, jo” përsëriti. “Gjithsesi, i ketë gjitha të shkruara në dokumentet që ju nuk pranuat t’i firmosni”. Mjeku dhe shoferi hipën në makinën ushtarake që na kishte ndjekur dhe u nisën. Hyra në shtëpi. Korridor. Kuzhina. Dhoma e ndenjes. Dhoma e gjumit. Nuk gjeta askund gjurmë të Martës. Kishin pastruar gjithçka. Nxora një birrë nga frigoriferi dhe e vura mbi tavolinë. Nxora dhe shishen e ujit mineral dhe e piva ngadalë. Birrën e vura prapë

në frigorifer. Nuk doja të dehesha. Bëra një xhiro rreth shtëpisë dhe leheve të luleve. Vadtja funksiononte. E rregullova pak dhe shkova në dhomën e gjumit. Këqyra nën jastëk. As atje s'kishte lënë asgjë. As këmishën e natës. As një shami. Kishin qenë shumë të kujdesshëm. Të përkryer. Më zuri gjumi. Kur u zgjova, ishte ora gjashtë e mëngjesit. Mendova se e gjithë kjo ishte një ëndërr, doja t'ia tregoja ankthin tim Martës. Mezi po prisja, por, pastaj, vura re se nuk ishte e shtrirë pranë meje, nuk ishte as jashtë, nuk ishte në dhomën e ndenjes – kishte ikur. Terror i pastër, absolut, i bardhë si bora.

Mbi tavolinë, në dhomën e ndenjes, gjeta një fashikull me dokumente. Ishin aty. Hyra në depo, nxora jashtë gjërat që kishin mbetur nga prindërit e mi, nga ata që, në fakt, nuk ishin prindërit e mi. Rrëmbova nëpër kuti të ndryshme, derisa gjeta atë që kërkoja. Librat e mi të vjetër, tekstet. Nxora atë të historisë. Shfletova pjesën që i përkiste luftës së Dytë botërore. Ndjeva që më therte gishti tregues i dorës së majtë. Nuk e di përse. U lava. Pastaj hyra në dhomën, ku ishin futur farërat e mia, plehrat dhe produktet kimike. Mora disa produkte. Në kuzhinë i përziejva duke shtuar pak uiski dhe vodka. Ta shpifte. Bëra me to, pak a shumë, gjysmë litri dhe e piva. U shtriva në krevat dhe humba ndjenjat. Veprova drejt, kur mendova se edhe Sokrati kishte vdekur, pak a shumë, kështu, të paktën kështu e kisha gjetur të shkruar në njërin nga ata libra.

Dhe kështu vdiqa, doktor vëllai. Më ra të fikët. Dhe, papritur, shikoj helikopterin të ulet në njërën nga lehet e mia, sikur fakti që aty ishin bozhuret dhe zambakët e mi, s'kishte rëndësi fare. Për ata, vërtet, s'kishte rëndësi. Mua më pezmaton shumë kjo gjë, por s'mund të bëja gjë, meqenëse isha i vdekur. Shikoj që e ngrenë trupin tim, jam vërtet i vdekur, e vënë trupin tim në helikopter. Pastaj e shoh atje në morg, të hapur si një derë rrotulluese, të hapur gjerësisht, dhe shikoj zemrën time, mushkëritë, stomakun

dhe ata merrnin prej tyre mostra të vogla. Sa keq që nuk isha prej qelqi, mendova në atë moment, nuk do të kishin pasur nevojë të më hapnin me ato bisturitë e tyre. Po dhe i fusnin të gjitha në ato makineritë e tyre që nuk e di përse shërbenin. Dhe pastaj lexoj raportin:

Materiali gjenetik i qelizave burimore të marra nga trupi i zotit Albert Hegel nuk është identik me materialin gjenetik të Adolf Hitlerit, përkundrazi, ka shenja qartësisht të dukshme që e bëjnë të klasifikueshëm si një sllav me origjinë ruse. E plot gjëra të tjera, doktor... dhe në fund gjej të shkruar: Nga analizat tona të specializuara arrijmë në përfundimin se zoti Albert Hegel, në të vërtetë, është klon i ushtarit rus Aleksandër Ivanoviç Babel. Ai ka qenë i rekrutuar në njësinë e parë që hyri në Berlin pas rënies së Raihut dhe atij iu ngarkua mbledhja e eshtrave të Hitlerit. Pa dyshim, ishte një rast ndotjeje gjenetike; ka shumë mundësi që të jetë marrë si mostër një fije floku ose një qime e zotit Aleksandër Ivanoviç Babelit.

E të tjera, e të tjera, doktor vëllai. Dhe bota vazhdon të rrotullohet paturpësisht. Dhe në fund të raportit një *post scriptum*: *Konsiderohet e nevojshme të përsëritet eksperimenti, e keqja duhet të mposhtet. Pa pikë turpi, vëlla, pa pikë turpi!”*

5. Deklarata spontane

Zoti Çerni ishte ulur në një stol druri, në korridorin e gjatë e të ngushtë. Stoli ishte lyster me në ngjyrë kafe të ndritshme. Ishte ora tre pasdite, por askush nuk e kishte thirrur emrin e tij akoma. Në fund të korridorit ishin ca njerëz që prisnin në këmbë. Thirrja për paraqitje ishte caktuar në dy e gjysmë. Ai rrinte aty dhe priste. Ishte një pasdite tetori dhe zhurmat e rrugës depërtonin në korridor e gjatë e të ngushtë përmes xhamit të pluhurosur të një dritareje.

Zoti Çerni u ngrit, shtriqu këmbët dhe rregulloi nyjën e kravatës. Nuk mendonte asgjë, i dukej sikur nuk mendonte për asgjë, e ndiente kokën plotësisht bosh, bosht dhe të heshtur. Kaluan edhe ca minuta të tjerë, shtriu, përsëri kravatën me gishtin tregues të tensionuar. Për një moment ndaloi dhe qëndroi ashtu, përkuli lehtë kokën nga njëra anë, pastaj e drejtoi. Trokiti në derë. Në derë ishte një pllakë alumini me numrin tetëmbëdhjetë. Pas një çasti, ndjeu hapat e dikujt. U hap dera dhe doli një vajzë.

“Përsëritje” i tha zoti Çerni.

“Përsëritje” iu përgjigj vajza. Në qetësinë e korridorit tani u ndje zhurma e një tramvaji.

“Si mund t’ju ndihmoj?” e pyeti vajza.

“Kam një thirrje” tha zoti Çerni. “Një thirrje për t’u paraqitur” përsëriti ai duke nxjerrë nga një zarf një letër të palosur më katërsh. Vajza e mori letrën, e ktheu nga ana e kundërt dhe e këqyri. E zhvendosi rëndesën nga njëra takë në tjetrën dhe, pa i ngritur sytë, tha: “Zyra e tyre nuk është më këtu. Janë transferuar tek një ndërtesë këtu afër”. E palosi letrën, ia dha dhe i shpjegoi se nuk

është një thirrje, është një ftesë”.

“Ah” tha ai “ah, epo mirë, po si shkohet atje” e pyeti. Vajza vështroi përtej supit të majtë të tij, drejt rrugës, jashtë dritares dhe pastaj drejt parkut nga ana e kundërt.

“Duhet të zbrisni dy kate më poshtë” i shpjegoi. “Vetëm dy kate, mos shkoni deri në fund, se nuk do të arrini dot. Vetëm dy kate! Pastaj do të dilni përballë shkallës ...asaj të madhes. Shkalla kryesore. Ajo me Masarukun përpara. Statuja e Masarukut. Prapa Masarukut do të gjendeni para shkallës kryesore dhe, atëherë ecni djathtas. Kaloni korridorin, duhet të ktheheni dy herë, një herë nga e djathta, pastaj nga e majta, deri tek shkallaret. Zbrisni poshtë dhe ajo është ndërtesa tjetër”. Qëndroi, për një çast, në heshtje. “Dhe ja ku arritët”.

“Faleminderit” tha zoti Çerni dhe bëri të kthehej?

“Prisni zotëri!” e thirri ajo. “Prisni. Duhet t’ju jap numrin e zyrës”. Ndjeu zhurmën e takave të saj, teksa shkonte tek tavolina e saj e punës, pas pak, doli përsëri. “131B” i tha.

“Faleminderit” i tha përsëri.

“Pra kjo është ndërtesa A dhe ajo B” shtoi ajo.

“Faleminderit”.

“Mirupafshim” i tha vajza.

“Mirupafshim” iu përgjigj ai.

Duke kaluar nga ndërtesa A në B iu desh të kthehej disa herë. Dy herë ndaloj para statujës së Masarukut dhe dy herë u rrotullua për t’i dalë nga mbrapa statujës. Herën e tretë arriti ta gjente ndërtesën B. Gjeti derën 131B, trokiti dhe tërhoqi dorezën. Në zyrë ishte një burrë rreth tridhjetë vjeç me syze, i hoqi dhe vështroi nga dera, ku ndodhej ai.

“Jam inxhinier Çerni” u prezantua ai.

“Mirëdita inxhinier, unë jam nëntoger Havranek” tha ai dhe i hodhi një vështrim të shpejtë orës.

“Jam me vonesë” tha zoti Çerni.

“S’ka rëndësi, zoti inxhinier, s’ka rëndësi. Qëkur na kanë transferuar, askush s’na gjen dot. Me siguri keni pritur atje, keni pritur dhe, kur keni parë që askush s’po ju thërriste, keni shkuar të pyesni, ku kemi përfunduar, kështu?”

“Mmh” u përgjigj inxhinier Çerni. “Po, pikërisht kështu”.

“Më falni që nuk ju kam dërguar njoftimin me numrin e ri të zyrës, por nuk arrita. Ju kërkoj ndjesë” tha nëntogeri.

“Mos doni të vij një herë tjetër?” e pyeti zoti Çerni.

“Jo, nëse keni kohë, mund të fillojmë tani, zoti inxhinier. Afrohuni dhe uluni”.

“Deri në ç’orë jeni hapur?” pyeti zoti Çerni.

“Mos u shqetësoni për këtë” tha nëntogeri. “Ju lutem uluni” përsëriti ai. U hodhi një sy dokumenteve që kishte mbi tavolinë dhe tha: “Doni një kafe? Kemi vetëm këtë për momentin. E dini, shpërngulja. Mund ta imagjinoni”.

“Jo, faleminderit” tha inxhinieri dhe, pas një çasti, shtoi: “Shpërngulja... nuk e imagjinoj dot”.

“Në fakt, nuk jua uroj...” iu përgjigj nëntogeri. “Ju na keni dërguar një kërkesë për hetim mbi zotin Janski, ose më saktë, një kërkesë hetimi”.

“Po” u përgjigj ai.

“Mirë, por para se të fillojmë, do të ishte më mirë të dërgonit diçka për veten”.

“Po çfarë, çfarë doni të dini?” e pyeti.

“Epo, për shembull, kur jeni njohur. Herën e parë që e keni takuar e kështu me radhë” shpjegoi nëntogeri, me një buzëqeshje kurajuese.

“Është njësoj si të më kërkonit të tërë jetën time” u përgjigj Çerni. “Të gjitha janë në ato dokumente apo jo?”

“Mungojnë disa gjëra” tha nëntogeri duke tundur kokën. “Disa” tha prapë dhe tundi kokën përsëri. “Ju, tashmë, jeni në pension, zoti inxhinier, kështu apo jo?” e pyeti.

“Kjo ka të bëjë me çështjen?” pyeti zoti Çerni.

“Jo, por ju jeni në pension?”

“Po” iu përgjigj Çerni

“Atëherë, kur të doni mund të fillojmë” tha nëntogeri dhe buzëqeshi përsëri.

“Çfarë mungon tek dokumentet?” e pyeti inxhinieri.

“Dimë shumë gjëra, por sipas ligjit aktual, nuk jam i autorizuar t’ju them cilat informacione janë apo cilat mungojë në këto dokumente”.

“Po pse? Nuk e kuptoj” tha inxhinieri.

“Janë të paktë ata që e kuptojnë, e dini, vërtetë të paktë, mbi të gjitha, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për ligjin e tretë dhe nuk di t’ju them për sa amendamente”.

“Ç”do të thotë kjo?” pyeti Çerni.

“Do të thotë që, po të kishit ardhur para gjashtë muajsh do të mund t’ju thosha të gjitha, ndërsa tani s’mund t’ju them asgjë.

“Po unë ju kam shkruar para më shumë se nëntë muajsh, vetëm se atëherë ju m’u përgjigjët që duheshin gjashtë muaj”.

“Po ashtu është, zoti inxhinier, tamam ashtu”.

“Po atëherë, përse nuk u morët me këtë punë, kur ishte akoma e mundur?”

“Kjo zyrë është vënë nën një udhëheqje tjetër, zoti inxhinier, një udhëheqje krejt e ndryshme, e dini”.

“Por mua nuk më intereson fare udhëheqja”.

“Shikoni, unë ju kuptoj, zoti inxhinier, ju kuptoj mirë dhe kuptoj edhe që e gjithë kjo mund të jetë e pakuptueshme, madje as unë nuk arrij ta shpjegoj si duhet. E kuptoj edhe se mund të pezmatoheni që gjërat zgjaten kaq shumë. Po cilin nëpunës të kësaj zyre duhet të procedoj sipas ligjit, më kuptoni? Në përputhje me të”.

“Po, por përse nuk jam thirrur menjëherë?”

“Zoti inxhinier, unë, para gjashtë muajsh, nuk punoja fare në

këtë zyrë? Dhe nuk punonte këtu as shefi im dhe as shefi i tij”.

“Atëherë çfarë duhet të bëj unë?” pyeti Çerni.

“Po ja, ju lutem të më tregoni si e keni njohur zotin Janski”.

“Po pse? Unë kam qenë në burg, kam qenë i dënuar”.

“Ju keni të drejtë, zoti Çerni, por nuk keni arritur të rehabilitoheni në fund të viteve gjashtëdhjetë”.

“Po unë e kam bërë kërkesën për rehabilitim”.

“Po, e di këtë, zoti Çerni, e di, por...”.

“Por s’ka pasur kohë, sepse erdhi pushtimi rus. Duhet ta dini...”.

“Zoti Çerni, unë e di dhe e kuptoj sa e pakëndshme duhet të jetë për ju, por...”

“Nëse e dini, përse më pyesni?”

“Eh, as ato pak gjëra që di, s’mund t’jua them”.

“Po gjashtë muaj më parë, do të m’i kishit thënë apo jo?”

“Po, para gjashtë muajsh po, por tani jo. Tani, siç ju informova, ka ndryshuar ligji”.

“E...e?”

“E dini, po t’jua thosha atë që di, do të shkelja ligjin, jo atë të kaluarin, por këtë që tani është në fuqi. Dhe, meqenëse akuzat që ngrini ju, janë të rënda dhe mund ta çojnë atë Janskin në gjykatë, unë duhet të vazhdoj në përputhje me ligjin, më kuptoni?”

“Jo, jo shumë”.

“Po të mos veproj sipas ligjit, në rast se do të shkonte në gjykatë, avokati mbrojtës i Janskit mund të vërtetonte se është shkelur procedura legale. Dhe vetëm për shkeljen e procedurës legale, gjithçka mund të hidhej në erë. Më kuptoni tani, zoti inxhinier, më kuptoni? Unë jam në anën tuaj, kjo zyrë është në anën tuaj, por duhet të veproj më sipas ligjit. Saktësisht siç e kërkon ligji”.

“Po nëse ky ligj ndryshon përsëri?” pyeti inxhinieri. Nëntogeri tundi kokën.

“Sidoqoftë, ne duhet të zbatojmë këtë ligj, zoti inxhinier, ligjin

që është në fuqi në këtë moment”. Zoti Çerni uli kokën, sikur po mendohej. Nuk tha asgjë. Nëntogeri mbeti ashtu duke e vëzhguar në heshtje. Pas pak, tha: “Harrova t’ju them, zoti inxhinier, se, po të doni, këtu mund të pini cigare. Po, mund të pini qetësisht...”

“Zoti Çerni ngriti kokën dhe tha: “Unë nuk e dija që ju jeni në anën time, siç më thatë, pak më parë”. Nëntogeri pohoi me kokë. “Nëse ju jeni me mua, atëherë përse nuk e keni marrë iniciativën për të bërë diçka?” pyeti inxhinieri.

“Pyetje e shpeshtë” tha nëntogeri “pyetje e shpeshtë... E dini, ne nuk mundemi, mund të hapim një praktikë me iniciativën tonë, por vetëm me kërkesën e paraqitur nga qytetarët. Dhe, meqenëse ju keni paraqitur një kërkesë hetimi për zotin Janski, ne mund të interesohemi”.

“Të interesoheni?”

“Po, të interesohemi” përsëriti nëntogeri. Në këtë moment, u hap dera dhe në zyrë hyri një grua rreth të dyzetave, me një trup të lidhur, me flokë biondë, të lyer.

“Mirëdita Lukash, si jeni? Ah, përshëndetje” tha ajo duke u kthyer nga zoti Çerni “si jeni?” Vuri kuletën dhe çantën në dysheme dhe hoqi pallton. E vari pallton në varëse, rregulloi xhaketën, pastaj mori kuletën e çantën, u afrua tek tavolina përballë nëntogerit dhe u ul. Vuri çantën në tavolinë, e hapi, nxori disa dosje dhe i vuri njëra mbi tjetrën mbi tavolinë. E mbylli çantën, e uli në dysheme dhe filloi të kërkonte diçka në sirtarët e tavolinës.

“Mirë, Helenka, gjithçka në rregull” u përgjigj nëntogeri.

“Nuk është e vërtetë, zotëri, nuk është aspak e vërtetë. Asgjë nuk shkon mirë, asgjë!” tha zoti Çerni.

“Por, por...” tha biondina duke vështruar nëntogerin. Nëntogeri nuk u përgjigj dhe ndreqi syzet.

“Zoti inxhinier Çerni na ka dërguar një treqindekatërmëdhjetëshe” tha nëntogeri.

“Një treqindekatërmëdhjetëshe, mmh, treqind e

katërmbëdhjetë” përsëriti biondina. Dhe është më shumë A apo B?” pyeti.

“Mua më duket më shumë B” u përgjigj nëntogeri.

“Mmh, atëherë B” tha biondina.

“Çfarë është kjo B dhe numri që përmendët?” pyeti zoti Çerni.

“Po ja, nëse bëhet fjalë për një B, duhet trajtuar me shumë kujdes. Nuk mund të lihet vetëm as në zyrë, zoti...”

“Sigurisht, e di, por, tani për tani, nuk është paraqitur akoma ky rast” u përgjigj nëntogeri.

“E çfarë rasti mund të ishte?” ndërhyri inxhinieri.

“Pooo, nëse, për shembull, nëntogeri do të duhej të shkonte për ndonjë arsye në zyrën tjetër, ose edhe në tualet, ju duhet të dilni nga zyra” tha biondja.

“Pse, mund të vidhja ndonjë gjë?” pyeti zoti Çerni. “Në kuptimin që, brenda secilit prej nesh është një hajdut, apo çfarë?”

“Zotëri, ju lutem, mos e merrni kaq personale...”

“Epo, si mund ta marr atëherë, më falni?”

“Është vetëm një direktivë, që ju të mos mund të rrëmoni në dosje”.

“Në dosje?”

“Po, në dosje,” tha ajo.

“Po, bëhet fjalë për dosjen time” tha zoti Çerni.

“Kështu mund të jetë” tha flokëverdha “Por rregulli është rregull dhe duhet ta respektojmë ligjin” shtoi ajo.

“Zotit inxhinier nuk i pëlqen që gjithçka duhet filluar nga e para” i tha nëntogeri flokëverdhës.

“Unë s’dua të filloj asgjë, sepse nuk e di për çfarë bëhet fjalë dhe s’kam dëshirë të rrëfej gjithë jetën time. Në moshën time, në moshën time, e kuptoni besoj...”

“Ne edhe mund t’ju kuptojmë, zoti inxhinier, por ligji dhe gjykatësit nuk do t’ju kuptojnë. Ata jo”.

“Po unë jam...”

“S’ka rëndësi sa vjeç je, zotëri. Ligji është një për të gjithë”.

“Ja kam shpjeguar, tashmë, zotërisë se ne jemi në anën e tij”.

“Sigurisht që jemi në anën tuaj” tha biondina “jo vetëm që jemi në anën e tuaj, por jemi këtu për ju!”.

“Kam harruar t’ju them që zonja Novakova është eprorja ime” tha nëntogeri. Flokëverdha u përkul dhe tha: “Major Novakova”.

“Pra...” tha nëntogeri dhe ngriti supet.

“Një mundësi do të ishte” tha biondina duke u afruar tek dritarja. Preku dheun e njëres prej vazove të shumta në parvazin e dritares, pastaj vuri dorën në gjoks dhe tha: “Je kujdesur mirë për lulet e mia. Me të vërtetë. Tani s’do të kem frikë të nisem për ndonjë udhëtim pune”.

“Çfarë mundësie?” pyeti nëntogeri.

“Zotëria mund të bëjë një deklaratë”.

“Çfarë deklarate” pyeti inxhinieri.

“Po ja, në vend që të viheni nën presion këtu në zyrë, mund të shkruanit gjithçka që ju quani të rëndësishme për qëllimet e kësaj çështjeje” tha biondina dhe u kthye të shikonte zotin Çerni.

“Mos u nervozoni, por unë vazhdoj të mos kuptoj shumë” i tha ai.

“Pra, ne do të kishim nevojë të merrnim vesh prej jush disa informacione, në bazë të të cilave, pastaj, do të mund të hapnim hetimin; atë që dimë deri tani, nuk mund t’juja lëmë ta shikoni qoftë edhe për një çast, sepse do të ishte shkelje ligji. Kështu që na duhet një lloj biografie”.

“Një biografi?” pyeti zoti Çerni.

“Po, një lloj biografie, por si titull do të shkruani deklaratë... por përmbajtja duhet të jetë një biografi. Kështu, apo jo?” pyeti nëntogeri duke vështruar nga flokëverdha.

“Po, saktësisht kështu ” iu përgjigj biondja.

“Epo mirë, po çfarë duhet të shkruaj?” pyeti zoti Çerni.

“Do të ishte mirë të shkruanit gjithçka që mund të na shërbente,

në ndonjë mënyrë ” i tha flokëverdha.

“Po, do të ishte më mirë” i mbajti iso nëntogeri.

“Pastaj, mund të hiqet ndonjë gjë ose të përmbliidhet, por është më mirë të shkruhen sa më shumë gjëra të mundshme”.

“Atëherë, në rregull...” tha zoti Çerni. “Po, pasi ta kem shkruar?”

“Pasi ta shkruani, na telefononi e na e sillni ose na e dërgoni me postë. Ne do t’i hedhim një sy dhe, pastaj, do t’ju themi çfarë mund të bëhet”.

“Do të më duhet ca kohë për ta shkruar”.

“E rëndësishme është që të jetë e shkruar në makinë” tha nëntogeri.

“Saktë, kjo është shumë e rëndësishme” theksoi biondina.

“Në makinë?”

“Po, në makinë. Kështu s’do të na duhet ta shtypim, por t’i bëjmë vetëm një fotokopje. Duhet të shkruhet në makinë, kjo do të na kursejë goxha punë”.

“E kam pasur diku një makinë shkrimi” tha zoti Çerni, pasi u mendua një çast. “Duhet ta kem diku”.

“Mirë...” tha biondja.

“Atëherë, u morëm vesh” tha nëntogeri. “Kur ta keni shkruar, më telefononi, unë do ta lexoj dhe, pastaj, të shikojmë si do të veprojmë”. Zoti Çerni u ngrit së bashku me nëntogerin, i cili ia shtrëngoi dorën e thatë dhe energjike. Flokëverdha qëndroi tek dritarja, e përshëndeti me kokë.

Burri i moshuar doli në korridorin e gjatë e të ngushtë dhe vuri re se midis rrezeve të dritës së vjeshtës vibronin pjesëza të vogla pluhuri, herë pas here ndonjëra zhvendosej në hije, atje bëhej e padukshme dhe pushonte së ekzistuari. Nuk dukeshin të nënshtruara ndaj ligjeve të gravitacionit.

Në zyrë flokëverdha vështronte e kënaqur vazot me lule. “Kësaj, ndoshta, do t’ia ndërroj vazon javën tjetër. Ato barbarozat

janë fantastike” tha.

“Nuk e imagjinoja që mund të bëhej edhe kështu” komentoi nëntogeri.

“Po, mund të bëhet, nëse atë biografi do ta fusim si deklaratë, do të mbetet në dispozicionin tonë, të zyrës sonë dhe ne, pastaj, mund të veprojmë në bazë të saj”.

“Jo, s’më kishte shkuar ndërmend”.

“Po, po, edhe Vasheku i Budejovicës e ka bërë nganjëherë”.

“Nuk e dija”.

“Vetëm se, gjithsesi, nuk do të shërbejë për asgjë”.

“Jo, po pse?”

“Sepse, kur ai gjyshi i shkretë do të ketë mbaruar së shkruari, gjithmonë, nëse nuk do të vdesë më parë dhe do të arrijë të kujtojë të gjitha ato tmerre që do të duhet të tregojë, do të kenë dalë, të paktën, tre variante të ligjit”.

“Edhe lidhur me këtë çështje specifike?”

“Po, mbase jo tamam për këtë, por, indirekt, do të jetë krejt e padobishme, në fund”.

“A nuk duhet t’ia themi atij?”.

“Epo, do t’ia themi, kur të aprovohet një variant i ligjit ose një amendament, tani për tani, nuk i dihet”.

“Po atëherë?”.

“Atëherë, t’i lëmë gjyshit edhe ca muaj shpresë. Lukash, po të vazhdosh të kujdesesh kështu për lulet e mia, do të propozoj për ngritje në detyrë”.

“Do të mjaftonte një bonus” i tha nëntogeri.

“Me një ujitje të tillë, bonusin, praktikisht, e ke siguruar bonusin”.

“Mirë, po plakushi?”

“Po të krijohet një situatë e pashpresë, mund ta propozojmë për një nderim”.

“Është e mundur kjo?”

“Jo në rrugë zyrtare, sigurisht” tha ajo “por në mënyrë gjysmë zyrtare, po”.

“Po si?” pyeti nëntogeri.

“Gjithçka varet nga situata, Lukash, nga situata. Ndoshta nuk është e mundur ta ndihmojmë, por një medalje nuk na kushton gjë dhe, nëse e lejojnë kushtet shoqërore, do të shikojmë. Tani që po shikoj me vëmendje” tha biondina duke u hedhur një sy vazove përsëri “mendoj se duhet të blej pak torfë”.

6. Dantja i zbatuar është një teori juhe

Atë ditë, doktor Antonin Lukavski arriti në punë gjysmë ore më herët. Ishte një fillim pranvere i vërtetë, origjinal. Hyri në portën kryesore të parkut të institucionit, përshëndeti njërin nga portierët e plogësht dhe, pasi pa orën, qëndroi pak afër liqenit artificial, i cili nuk ishte mbushur akoma. U ul në një stol, rrëmoi në çantën e madhe sportive, nxori një libër të trashë, me siguri – një tekst specialiteti, duke gjykuar nga kopertina. Në ato kohë, kishin kaluar disa vite pas gushtit të vitit 1968, ishte gjithnjë e më vështirë të gjeje tekste specialiteti.

Nxori nga xhepi i pantallonave cigaret, hapi librin, ndezi cigaren dhe filloi të lexonte. Pas shpinës së tij ngrihej një shkurre, e cila, brenda disa javësh, do të nxirrte lule me një aromë dehëse, por, për momentin, ishte vetëm një shkurre. Parku i institucionit dhe rrugicat anësore ishin projektuar në mënyrë që të ruanin një intimitet absolut. Ishin vetëm dy pika prej të cilave mund të vëzhgohej parku nga brenda. Projekti i parkut kryesor i kopshtit, me rrugicat, të cilat degëzoheshin, për t'u ribashkuar, pastaj, menjëherë, respektonte privatësinë në mënyrë shembullore. Shpesh herë, Antonini mendonte se duhej të kishin mbjellë, rreth çdo pavijoni, pemë, të cilat lidheshin disi me sëmundjet që kuroheshin në atë ndërtesë. Po ndizte cigaren e dytë, kur ndjeu dy zëra që diskutonin, prapa tij. Në fillim nuk u kushtoi vëmendje, por pastaj, fare pa dashur, e humbi përqendrimin dhe, jashtë vullnetit të tij, filloi të dëgjonte.

“Nuk e kanë fare të qartë, Marek, aspak të qartë” tha zëri i parë.

“Jo, Voklav. Sigurisht që jo” tha zëri i dytë, pak më i lartë dhe i ftohtë.

“Nuk e kanë të qartë domethënien e mitit, madje as të ndihmësit” tha Voklavi.

“As të ndihmësit” përsëriti Marek.

“Në fakt... miti është një ndihmës apo jo?” tha Voklavi.

“Natyrisht, vëlla, për këtë jemi të një mendjeje, plotësisht, nuk diskutohet”.

“Megjithatë ata nuk e kuptojnë”.

“Nga ana tjetër, vëlla, e formuluar kështu, çështja nuk është e treguar dhe as e sqaruar. Sepse, gjithsesi” u ndje një e qeshur e ftohtë “çfarë kuptojnë ata, eh?”

“Po pra, çfarë kuptojnë?” përsëriti zëri më i thellë i Voklavit.

“Në këtë mënyrë, çështja nuk është as e formuluar, as e treguar, as e sqaruar, kështu?”

“Realizohen vazhdimisht gjëra të reja” tha Voklavi. “Rreziku ose gëzimi nuk i falin asgjë askujt. Rreziku e gëzimi maskohen gjithmonë me çarçafë të rinj dhe nuk falin”.

“Pikërisht kështu, vëlla, nuk falin” tha Mareku. Në atë çast, doktor Lukavski kuptoi se zëri i dytë, ai më i larti, i përkiste pacientit të tij Marek, pastičerit, dhe filloi ta dëgjonte me vëmendje.

“Praktikisht, o mik, çfarë do të bëje për të shkruar një mit? Për çfarë do të flisje?”.

“Miti, vëlla, do të duhej të fliste... gjëja më e mirë do të ishte... po ja, gjëja më e mirë do të ishte për një Shtet ose për një person apo jo?”

“Jo, mik, jo ti nuk je i vëmendshëm. Përmblihu. Forca dhe mos përtyp më gjithë ato barishte franceze. Atë erë nuk e duron dot askush. Të lutem!”.

“Unë, më shumë, po ndiej erë cigareje”.

“Cigare? Të lutem, era e atyre barishteve franceze përmbyt të gjithë parkun”.

“Përgjigja si gjithmonë fshihet në atë, për të cilën ke folur ti. Gjërat më misterioze fshihen më mirë në dritën e diellit”.

“Që do të thotë?” pyeti Mareku.

“Në dritën e diellit” përsëriti Vaclavi dhe vazhdoi “do të thotë ditën, pra... në sytë e atij që na shikon drejt e në sy. Domethënë miti nuk duhet të ekzistojë me ose, apo, të këtij e të atij”.

“Të këtij, të atij?” tha Mareku.

“Po...të një Shteti e të një personi”.

“Ah, e ke për këtë”.

“Sigurisht kështu është”. Në atë moment u ndje një gromësimë e zëshme që u pasua menjëherë nga një gogësitje dhe ndërhyri një zë i tretë, i cili, me pak marrje fryme dhe disi me nervozizëm, tha: “Sapo u zgjova dhe, tashmë, isha në buzë të liqenit, kisha ecur në pjesën e poshtme. Dhe isha gati për t’u rishfaqur - rishfaqem është njësoj si rizgjohej. Njëra është e barabartë me tjetrën. Kështu – u zgjova dhe ju ndjeva menjëherë. Por, para së gjithash, duhet të them një gjë. Frantishek, mos ha më aq shumë hudhra. Është e padurueshme. Edhe pse jemi nën qiell të hapur”.

“Gjithmonë i them” ndërhyri Vaklavi. “Qelbet i tëri dhe kushedi, pastaj, cilat janë efektet anësore”.

“Efektet anësore, vëlla” tha pastičieri “çfarë efektesh anësore?”.

“Ku ta dish” i tha zëri i thellë i Vaklavit “ndoshta revolucioni bën pjesë në efektet anësore”.

“Revolucioni?” përsëriti pastičieri. “Revolucioni si efekt anësor i të ngrënit hudhra, siç po thua ti, barishte franceze? Dhe si erëza të kuzhinës?”.

“Sa ndikon tretja tek idetë politike e filozofike, akoma nuk është bërë ndonjë studim i mjaftueshëm” tha Vaklavi. “Për nesër, miq, do t’ju jap një detyrë. Mendohuni mirë për menunë që do të përfaqësonte më mirë tri fjalë”.

“Atëherë më duhet t’i shkruaj, Vaklav” tha zëri i tretë.

“Problemi i përditshëm për nesër: cila menu do të përfaqësonte më mirë: *liberté, égalité, fraternité*. Dhe cila menu do të përfaqësonte më mirë: God save our gracious Queen. Dhe cila menu do të përfaqësonte më mirë: Vittoria vince!”.

“E fundit është e lehtë, vëlla Vaklav, është derri i egër me salcë boronice” tha pastiçieri.

“Përse derri i egër dhe përse me salcë boronice?” pyeti Vaklavi.

“Kur po vija këtu, fjeta pak dhe në ëndërr notova. Pastaj arrita në breg, domethënë në zgjimin e vërtetë. Lidhur me çështjen tuaj të mitit duhet t’ju them se kam folur për këtë problem, tashmë, para shumë vjetësh, në një letër drejtuar mikut tim Skalixhero, famullitari i përgjithshëm i shtetit perandorak të Veronës dhe Viçencës”.

“Të lutem, Duarte, dalim në temë, përndryshe do të ftohemi të gjithë” tha Vaklavi.

“Mirë” tha Duarte “në ditët tona keni një dobësi për iluzionin e barazisë që ne, natyrisht, nuk e kishim. I shkrova gjëra, të cilat mund të ishin të dobishme edhe për ju”.

“Duarte” thirri Vaklavi me një ton kërcënues.

“Me siguri, princ, çdo vepër ka më shumë se një kuptim, më shumë se një qëllim. E them hapur dhe pa diskriminim, çdo vepër, pra edhe jeta, jeta është polisemantike”.

“Ç’do të thotë?” pyeti pastiçieri.

“Do të thotë” tha Duarte “që çdo vepër ka shumë kuptime. I pari është i drejtpërdrejtë. Nga fjala *litera*, shkronjë, pra fjalë për fjalë, i drejtpërdrejtë. I dyti është alegorik, pastaj vjen ai moral, pastaj ai anagogjik”.

“Në këtë labirint, do të mbetesh vetëm, o i pacipë! Siç është e vërtetë që mua më quajnë Frantishek!” bërtiti pastiçieri dhe dukej, sikur donte t’i hidhej në grykë Duartes. Doktor Lukavski u nervozua dhe mendoi se duhej ta ndërpriste diskutimin e pacientëve. Por, papritur, ndjeu: “Mos je i çmendur? Më fal, ti je

Mareku apo jo?”.

“Ah është e vërtetë” tha Mareku me zë më të qetë dhe shtoi: “Ju kërkoj ndjesë, miq, por fjalët e huaja të gjata më bëjnë të çmendem”.

“S’ka gjë” tha Duarte “për këtë jemi këtu apo jo? Kij besim tek kura e ndërgjegjshme e klinikës. Por ndoshta duhet shpjeguar me një shembull” tha ai, jo i bindur, duke kërcitur, pa dashje, gjuhën “marrim psalmin njëqind e katërmëdhjetë që thotë: *“Kur Izraeli doli nga Egjipti, shtëpia e Jakobit nga një popull barbar, Juda u bë shenjtori i Zotit, Izraeli fusha e Zotit. Kështu bëhet, kështu...”* Përplasi përsëri gjuhën dhe vazhdoi: “Nëse do të përpiqem të ekzaminoj vetëm fjalët, fjalëzat, të cilat qëndrojnë në radhë si dallëndyshet mbi një tel, do të na thonë se bijtë e Izraelit u nisën nga Egjipti të udhëhequr nga Mozé”.

“Atëherë s’kishte tela telegrafi, Duarte, çfarë po broçkullit?” tha Mareku.

“Ka të drejtë” e mbështeti Vaklavi “atëherë s’kishte tela telegrafi”.

“Megjithatë, dallëndyshet, nga pikëpamja alegorike, psalmi njëqind e katërmëdhjetë na flet për shpengimin, për çlirimin tonë dhe të askujt tjetër, miqtë e mi. Çlirimi nëpërmjet Krishtit, Zotit tonë, pra kuptimi moral, edhe në atdheun tonë imoral dhe në ambientin rrethues, kuptimi moral na flet për shpirtin që, nga varfëria, nga gjunjëzimi deprimues, ngrihet në gjendjen e faljes e të mëshirës. Kuptimi anagogjik - interpretimi mistik i Shkrimit të Shenjtë - ka të bëjë me largimin e shpirtit nga skllavëria e këtij mosbalancimi drejt lavdisë dhe lirisë së përjetshme. Ju lutem të mos e ngatërmoni të gjithë këtë me *liberte*. Të gjitha këto koncepte mund të quhen alegorike, sepse nuk janë të drejtpërdrejta e aq më pak historike. Prandaj, siç jua tregova, del e qartë se çështja duhet të jetë e dubluar, duale ose dyshe. Në mënyrë që të dy kuptimet të kryqëzohen”.

“Në qoftë se e kuptova atë që do të thuash, Duarte” tha Vklavi “është pak si dinamoja me rrymën e alternuar. Vetëm se ai ka tri faza, kështu që duhet të jetë e trefishtë”.

“Ndoshta këtu hyjmë në fushën e Trinisë Hyjnore, do të parapëlqejë ta shmangia për momentin këtë diskutim, megjithëse ke të drejtë”.

“Nëse e kam të qartë, kuptimi i mitit duhet të jetë toka” tha Vklavi.

“Pikërisht kështu, e saktë” e ndërpreu entuziasti Duarte. “Në rastin tonë bëhet fjalë për një tokë të dhunuar. Gjithsesi, po të shikojmë përreth, sigurisht që nuk do t’ju vijë keq. Dhe toka e dhunuar, qëkur është krijuar bota, është alegori për femrën”.

“Ky është pak si stereotip, Duarte, apo jo?” pyeti Vklavi.

“Natyrisht, natyrisht, por unë s’kam çfarë të bëj dhe, përveç këtyre, tani do të doja të flisja me ju për tri fazat e rrymës elektrike dhe të Trinisë Hyjnore”.

“Vëllezër, kam aq dëshirë për një cigare, saqë ia ndiej erën gjithë kohën” tha pastiçieri.

“Tani e ndiej edhe unë” tha Vklavi dhe u ngrit nga stoli. Në këtë moment doktor Lukavski kuptoi se po i referoheshin atij. Futi librin në çantë, u kollit, u ngrit dhe duke hedhur çantën në sup, kaloi rreth shkurre.

“Mirëmëngjesi, Marek” tha.

“Ky është vëllai im mjeku, miqtë e mi” tha pastiçieri. “Dhe këta janë miqtë e mi. Ai është Vklavi” tha duke treguar një afrikan zeshkan, me trup mesatar, i cili po e vëzhgonte me vëmendje mjekun dhe “dhe ky është Duarte” vazhdoi duke treguar një tip truplidhur, më i shkurtër se ai. Ky i fundit i bëri një gjest përshëndetjeje të përzemërt mjekut dhe tha: “Unë jam Duarte, doktor, Duarte Aligieri, për miqtë – Dante!”

Mjeku u dha nga një cigare dhe Duarte e ndezi. Afrikani e futi në xhep të vetën dhe vazhdoi të këqyrte me vëmendje mjekun.

“Epo, mua më duhet të iki” tha doktor Lukavski.

“Nuk të kam parë fare, vëlla doktor” tha pastiçieri. “Për faj të asaj bluzës së bardhë”.

“Të bluzës së bardhë? Po unë nuk e kam veshur” i tha mjeku.

“Eh, pikërisht për këtë arsye” tha pastiçieri.

“Tani e marr shërbimin” i tha mjeku.

“Atëherë punë të mbarë” i tha afrikani. Mjeku i vështroi të gjithë me radhë dhe u nis për në studion e tij. Atë ditë, në mensë, u ul pranë një kolegu të pavijonit dhe i tregoi për bisedën që kishte dëgjuar, pa dashje. “Ai tipi aty, negër ose mulat më mirë, Vaclavi, është këtu prej një muaji pothuajse dhe përbën një rast pak të ngatërruar. Ndërsa tjetri, tjetri është Dante”.

“Dante?” e pyeti Antonini.

“Po, Dante” iu përgjigj kolegu.

“Më fal, po si është e mundur që ai mulati, për më tepër, ka një emër çek, Vaclav?”

“Është një person që nuk flet shumë – gjithmonë lexon e shkruan. Nga ç’kam parë, lexon gjëra të ndryshme. Dhe në kartelën e shtrimit thuhet se, duke qenë një negër, e ka mësuar çekishten çuditërisht mirë”.

“Po ti a nuk më the që ai ka lindur këtu?”

“Po, por ka njerëz që mendojnë se një mulat, edhe duke qenë gjysmë çek, nuk mund ta mësojë mirë gjuhën tonë”.

“Edhe pse ka lindur këtu?”

“Po, edhe pse ka lindur këtu”.

“Po ti çfarë mendon?”

“Unë s’mendoj asgjë, sepse nuk dua të gjendem në situata të pakëndshme”.

“A nuk është pak e çuditshme?” pyeti Antonini.

“Disa mendojnë se, herët a vonë, do të tregohet që mulatët nuk arrijnë ta flasin çekishten mirë, edhe kur kanë lindur këtu”. Negrit akoma më pak”.

“Edhe kur lindin këtu?”

“Edhe kur lindin këtu. Gjithsesi, kjo është një teori e re revolucionare”.

“Unë mendoja që nuk ekzistojnë më... teori të tilla raciste”.

“As mos e përmend fjalën racë. Nuk është e mundur! Shpresoj që të mos na ketë dëgjuar njeri” tha kolegu i Antoninit duke vështruar përreth disi fshehurazi.

“Mirë” tha Antonini “nuk do ta zë në gojë më fjalë racë. Por mendoja se teori të këtij lloji ishin zhdukur me përfundimin e luftës së Dytë botërore”.

“Me luftën e Dytë botërore?” tha kolegu i Antoninit. “As mos pretendo, Tonda, por ti gjithmonë ke qenë pak naiv. Lufta e Dytë botërore?” përsëriti kolegu dhe ngriti sytë nga qielli për të shprehur moskuptimin e tij absolut mbi funksionimin e thjeshtë të universit çekoslovak lokal dhe të rajoneve fqinjë.

“Po ky Voklavi çfarë tipi është?” pyeti doktor Lukasi.

“E kam pyetur por më ka thënë pak gjëra, më ka treguar vetëm që bën sikur shkruan, thjesht, për kënaqësinë e vet. Atëherë e lëmë të shkruajë. Më ka thënë se i pëlqen të shkruajë, megjithëse nuk e flet mirë çekishten. Ndoshta ka dijeni për atë teorinë”.

“Ah” tha Antonini “gjithsesi, po të ketë të reja, më bëj të ditur, mendoj se është miqësuar me njërin nga pacientët e mi”.

“Natyrisht, kur të vendosë të më flasë” reagoi kolegu i Antoninit, pastaj rregulloi pjatat në tabakënë plastike, u ngrit, përshëndeti, i çoi pjatat e palara në një cep të mensës dhe i vuri në tavolinën e posaçme.

7. Deklarata personale ose biografia

I nderuar zoti nëntoger,

Kam lindur më 24 nëntor 1915 dhe jam mbi shtatëdhjetë vjeç. Para se të shkruaj për studimet e mia, për origjinën time dhe çështje të tjera, të cilat, përgjithësisht, nisur nga eksperiencia e jetës sime në Bohemi, paraqesin interes për institucionet publike, do të doja të theksoja disa pikënisje të rëndësishme. Siç e dini Ju, unë jam një inxhinier ndërtimi në pension. Shprehja verbale, pra, nuk është gjëja më e natyrshme për mua. Shkaku për të cilin po Ju shkruaj, është si më poshtë: do të doja të kërkoja nga institucioni Juaj të hetoni veprimtarinë e zotit Janski dhe të më informoni lidhur me hetimet. Një individ që është përgjegjës për një torturë në dëm të një tjetri, besoj, kryen një vepër të keqe, domethënë një krim, në çdo vend ose në çdo kohë verifikohet një gjë e tillë. Pra, mendoj se tortura që unë kam pësuar nga zoti Janski, konsiderohet si një vepër e dënueshme. Mbi të gjitha, dua të theksoj se nuk më intereson të dënohet fizikisht dhe as të arrestohet, nëse nuk harroj – ai e ka ditëlindjen më 23 mars, domethënë është disa muaj më i vjetër se unë.

Në moshën, në të cilën kam pasur fatin të arrij nuk synoj hakmarrje; megjithatë ky hetim ka për mua një rëndësi themelore. Dhe është shumë i rëndësishëm për bashkëshorten time Kveta. Nuk e kam të qartë për çfarë gjërash jeni në dijeni. Siç më këshilluat me mirësjellje Ju dhe kolegja Juaj, do të përpiqem t'i tregoj të gjitha në këto faqe letre, në mënyrë që të mund të filloni – siç thoni Ju – hetimin.

I jam drejtuar institucionit tuaj për një arsye tërësisht personale: është mundësia e fundit që më mbetet për të rifituar martesën time. Nuk e di çfarë është thënë në dokumentet Tuaja, problemi është se, në një mënyrë a në një tjetër, fati im dhe i gruas sime është ngatërruar dhe druaj se është akoma kështu, me fatin, nëse preferoni me jetën e Hynekut, pikërisht të zotit Janski.

Unë dhe zoti Janski jemi njohur në shkollën e mesme - ishte fillimi i miqësisë sonë të gjatë. Pastaj unë hyra në fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit të Institutit teknik, ndërsa ai në fakultetin juridik të Universitetit Karlov të Pragës. Bashkë me shokët tanë shkonim në ekskursione, ose në birrari, në koncerte të ndryshme, luanim futboll etj. Derisa një ditë, ndërsa po ecnim në një shteg të një kodre, u bashkuan me ne një grup i vogël vajzash. Midis tyre ishte Kveta. Duhet ta pranoj që, në fillim, nuk më pëlqente, nuk më pëlqente as emri i saj dhe as pamja e jashtme – vetëm zëri më la një mbresë të këndshme, menjëherë. Ajo dhe emri saj më dukeshin, në një farë mënyre... vulgarë. Dhe, në vjeshtë, kur mora vesh se lulet e saj të parapëlqyera ishin gjeorgjinat (lulepatatet) nuk u habita – ishin lule që mua s'më pëlqenin shumë.

Isha i ri, zoti nëntoger, isha i ri dhe i bindur që, nga lulet, vetëm trëndafilat dhe zymbylat ishin të denjë për t'u dashur dhe, nga emrat femërorë, vetëm Katerina, Maria, Barbara, por natyrisht, jo Kveta. Pastaj, dalëngadalë, fillova të ndieja se më mungonte diçka. Po, më mungonte ajo vajzë me atë emër aq të zakonshëm. Për të thënë të vërtetën, nuk dija asgjë, nuk isha fare i vetëdijshëm për dashurinë. Por e ndieja mungesën e saj më merrte malli, papritur, u ndjeva pak më i vetmuar se më parë. Sa herë që dikush më thoshte se e kishte parë, zemra akoma e fortë si shkëmb, përpëlitej pak, para se të rimernte pulsmin e zakonshëm. Pastaj, gjithmonë i habitur me veten time, fillova të ndiej xheloz. Isha xheloz për të gjithë ata që rrinin me të, kur unë, që duhej ta bëja këtë më shpesh, kisha për të studiuar. Nuk ndieja, siç thuhet,

shkëndijat. Nuk e kisha ndjesinë që s'mund të jetoja pa të. Nuk e perceptoja agoninë e një planeti bosh, në një univers bosh, asgjë nga këto, vërtet, por kur i propozova për martesë, isha i bindur se do të pranonte menjëherë. Kur ajo më kërkoi një javë për t'u menduar, mbeta i habitur.

Në vend që të shkoja në shtëpi dhe, të nesërmen në universitet, u enda dy ditë lart e poshtë nëpër qytet dhe, pasditen e ditës së tretë, më zuri gjumi mbi një stol, në parkun Letna. Do të kisha dashur të flisja me dikë, ndoshta me Hyneku, por kisha ndjesinë se po i vinte rrotull edhe ai, kështu që parapëlqeva të heshtja. Pas disa ditësh, u takuam dhe e pyeta, me padurim, çfarë kishte vendosur dhe ajo më tha –po! Në të vërtetë, nuk pati nevojë ta thoshte, sepse e kuptova, menjëherë, nga zëri i saj. Vetëm pas lindjes së vajzës sonë, Alisa, e pyeta për arsyen e asaj jave reflektimi dhe m'u përgjigj se sjellja ime ishte prej një mendjemadhi. Unë mendjemadh? e pyeta. Po, mendjemadh, tha Kveta. Po si, në ç'mënyrë? Për ty ishte... sikur të ishte e vetmja gjë e mundur. Për mua ishte ashtu, e vetmja gjë e mundur, iu përgjigja, për ty jo? Në të vërtetë po, tha ajo, por doja të të mendoja pak; isha aq e dashuruar me ty dhe ti as që e vije re. Po unë të propozova për martesë, protestova unë. Po, tha ajo, por vetëm më vonë, ku më kërkonin shumë vetë dhe unë i refuzova të gjithë – prisja vetëm ty. Atë ditë e kuptova, përse Hyneku më shmangte. Edhe ai, e pyeta, edhe Hyneku? Tri herë, m'u përgjigj Kveta. Për njëfarë periudhe, madje ishte zemëruar me mua. Nuk i kisha thënë se po të prisja ty, por ai, gjithmonë, ka qenë më dinak se ti, në këto gjëra. Ndoshta për këtë arsye të zgjedha ty, përveç faktit që isha e dashuruar marrëzisht. Ja çfarë më tha gruaja ime Kveta, zoti nëntoger. Kuptova se nuk isha vetëm unë që kisha zgjedhur e dashuruar, por kisha qenë i zgjedhur dhe i dashuruar prej saj. Më vonë, në burg, arrita të kuptoja, papritur. Ajo ndjesi, ndjesia e të qenit i dashuruar nga Kveta, dashuria e saj e dukshme për mua. Ajo ndjesi ka qenë si Krishtlindje e vogël në

mes të tundrës siberiane.

Unë jam një teknik, zoti nëntoger, vetëm një teknik, ndjenjat që provoj nuk di t'i analizoj dhe, në disa gjëra, në emocionet, nuk kam qenë kurrë i fortë. Në atë kohë, në kohën time, na mësonin se dashuria duhet të jetë romantike dhe kështu, kur arriti dashuria e vërtetë, edhe për pak mund të mos e vija re. Nuk dija t'i trajtoja ndjenjat, tani di, por tani s'ka më rëndësi, në moshën time njeriu ka turp, ose më mirë zihet ngushtë, vetëm për disa paaftësi fizike, në dukje të papërshtatshme.

Më ka bërë gjithmonë krenar aftësia ime për të mos u dorëzuar para ndjenjave, si disa miq e kolegë të mitë. Më ndodh, natyrisht, edhe mua të tronditem nga emocionet pozitive ose negative. Por ia kam dalë, pothuajse gjithmonë, t'i mbaj ato nën kontroll. Kur ndieja vështirësi për t'i zotëruar, përqendrohesha në punë dhe përpiqesha t'i përkushtohesha familjes. Këtë jam përpjekur ta bëj gjithmonë, gjithë jetën time. Rinia jonë ka qenë, vërtet, e pasur me ngjarje, thuhej se ishte një epokë revolucionare, sidomos në fushën time ishte vërtet revolucionare.

Kur fillova të studioj e të mësoj veprimet e statistikës, përdorja vizoren llogaritëse. Vizorja llogaritëse i korrespondon shkencës së proporcioneve, një sistem intervalesh, shkallësh dhe gabimesh të korrigjuara. U shpik dhe u perfeksionua falë një arsytimi të zgjuar mbi çështjen e numrave e të shkallëve. Pastaj erdhën makinat llogaritëse, më vonë kompjuterët. Si të gjithë të moshuarit, zoti nëntoger, i kam për zemër instrumentet që kam mësuar t'i njoh në rini.

Më kujtohet se, diku para tridhjetë vjetësh, në vitet gjashtëdhjetë, Kveta më lexoi një artikull njëfarë feje a filozofie orientale. Autori përpiquej të shpjegonte paqen absolute dhe përfundimtare të shpirtit – ndoshta, unë do të thosha – të trurit. Artikulli shpjegonte si ta mbrosh shpirtin nga ndjeshmëritë dhe gjendjet shpirtërore të imponuara, të bezdisshme. Pasi mbaroi

së lexuari, pas darke, i thashë: Është, saktësisht, ajo që bëj unë. Artikulli fliste për mandalat që janë forma qarkore, nëse e kujtoj mirë, për lutjet dhe për rruzaret me njëqind e tetë rruaza për t'i kaluar nëpër gishta duke marrë e nxjerrë frymë, fliste për rëndësinë e çlirimit të shpirtit. Paqja që përshkruante ishte e njëjta që provoja unë, kur punoja. Më pëlqente të punoja, më pëlqente të bëja përlllogaritje. Mbajtja e vizores llogaritëse në dorë më bënte të ndihesha mirë dhe nuk u mësova kurrë me makinën llogaritëse, kur, më vonë, m'u desh ta përdorja. Sistemet numerike ishin për mua si rruazat e një rruzareje. T'i bëja të rrëshqisnin shpejt kursorët e rigës llogaritëse mbi shkallët e graduara, më ndihmonte të çliroja mendimin. Të bëja llogaritë dhe t'i hidhja në të pastër ishte për mua sikur bëja lutjet. Edhe më vonë kur ndërmarrja më pajisi me makina llogaritëse, gjithnjë e më të përsosura, në sirtarin e tretë nga e djathta, vazhdoja të ruaja vizoret e mia llogaritëse. Natyrisht, sirtarët ishin të mbyllur me çelës. Askush s'duhet t'i shikonte vizoret e mia aq të dashura, do të mendonin se nuk ecja me kohën. Mua do të më pëlqente të ecja me kohën, por kohën, në të cilën jetoja, nuk e kuptoja mirë. Pa u menduar gjatë, ia thashë këto Kvetës, ajo vetëm hapi sytë e saj të mëdhenj, jeshilë dhe më tha: Atëherë është kjo arsyeja që ti shpesh punon deri natën vonë. Vërtet, të pëlqen kaq shumë Jozef? Nuk e mbaj mend se si iu përgjigja, por, me siguri, përgjigje ime s'do të ketë qenë shumë bindëse.

Një nga shenjat e pleqërisë, zoti nëntoger, të paktën në rastin tim, është se truri pushon së qeni racional. Tronditem nga emocionet dhe nga humori, gjendjet e ndryshme shpirtërore dhe gjëja më e keqe është se, kur këto procese mendore, deri atëherë të panjohura për mua, marrin rrugë e nuk e di ku dhe kur mbarojnë. Është si një udhëtim pa hartë në një vend të panjohur. Por, ndërsa në një vend të panjohur, mund të mblidhen pika referimi për t'i vënë në lidhje, duke u orientuar dalëngadalë, me koordinatat hapësinore,

në humorin tim, në gjendjet e mia shpirtërore, për fat të keq, kjo është e papraktikueshme. Është një ndjesi e krahasueshme me një shkretëtirë, në të cilën, çdo pikë referimi, çdo sistem trekëndësh, ndryshon vazhdimisht duke e bërë të pamundur orientimin.

Dhe midis të tjerash më vjen ndërmend se, pak vetë e dinë, që shkretëtira e Saharasë është pothuajse nëntëdhjetë për qind shkëmbore, megjithatë, edhe ky krahasimi im i dytë, duket i pabazë. Kam përshtypjen se, ashtu si nuk është e mundur të matet entiteti i një dhimbjeje ose i një dashurie, në të njëjtën mënyrë, unë s'kam kam një instrument të përshtatshëm dhe të kalibruar për të matur ndjesitë e mia.

Në universitet, unë ndiqja leksionet e asistentit Horski, i cili na tregonte shpesh për udhëtimet e tij në Siri dhe në Lindjen e Afërt. Qëkur ishte i ri, kishte shkuar me profesor Hroznin, me shkencëtarin që kishte deshifruar gjuhën hitike. Atë e kishin ngarkuar të bënte kontrollet teknike. Përcaktonte gjendjen aktuale, përshkruante hartografinë e bazës së rajonit, bënte projekte dhe, pastaj, mblidhte bubuzhela. Me të vërtetë! Ai, një teknik, mblidhte bubuzhela. Ishte gjëja që i kushtonte më shumë përpjekje e mundim, por ia kishte kërkuar drejtori i atëhershëm i repartit të insekteve të Muzeut të Natyrës, sepse Muzeu Kombëtar akoma nuk kishte bubuzhela të asaj zone.

Në të vërtetë, aventurat turke dhe siriane të asistentit Horski nuk më interesonin shumë. Megjithatë, një herë, në fund të një leksioni, në të cilin ai, përsëri, e kishte sjellë diskutimin në udhëtimet e tij të rinisë në Turqi, tha këto fjalë: 24 nëntori i vitit 1915 do të mbetet përgjithmonë, mbajeni mend, përgjithmonë, i shënuar në historinë e shkencës çekoslloake dhe botërore – atëherë unë u zgjova nga dremitja, në të cilën i kaloja pothuajse të gjitha leksionet e pasdites. Këtu unë duhet të dal pak nga tema: para se të futesha në burg, gjithmonë merrja një sy gjumë pasdite, nga ora dy deri në tre. Për fat të keq, siç e kam vënë në dukje më

lart, ky zakon i imi mori fund ditën e burgosjes sime – edhe tani nuk mundem më të fle pasdreke, madje as në kushte të rehatshme. Në fakt, kam frikë se shikoj ëndrra të këqija për ato dhjetë vite të kaluara në burg.

Tani të kthehemi tek asistenti Horski. Shpesh leksioni i tij qëllonte pikërisht ndërmjet orës dy dhe tre, kështu që hoqa dorë nga pushimi im i paradites, megjithatë leksionet i kaloja në gjendje dremitjeje. Papritur, ajo datë e përmendur prej tij, 24 nëntori i vitit 1915, më zgjoi. Në fakt ishte data e lindjes sime. Çfarë kishte ndodhur atë ditë? pyeta menjëherë, i zgjuar, papritur, nga gjumi. Asistenti më vështroi me dyshim dhe, me njëfarë ironie, komentoi: Duket qartë se ju keni munguar shumë herë, koleg, përndryshe do ta dije se, atë ditë, gjatë një konference të mbajtur pranë Shoqatës Orientale Gjermane, profesor Hrozni ka shpjeguar historinë, kulturën dhe shkrimin e Shtetit hitik dhe, e gjithë kjo, zotërinj të nderuar, sepse kishte arritur të deshifronte një gjuhë, akoma të panjohur, të gjetur në një regjistrim në alfabetin kuneiformë, i cili tashmë ishte i njohur. Vepër e denjë për një gjeni, të nderuar zotërinj, dhe çfarë privilegji për ne të ecim nëpër rrugët e Pragës, ku ka kaluar profesor Hrozni. Ishte e njëjta datë. Data e asaj konference përkonte me datën e lindjes sime.

Pas disa ditësh i tregova këtë Kvetës dhe ajo mbeti e habitur më shumë se unë. A nuk të duket interesante? më pyeti. Natyrisht, por bëhet fjalë vetëm për një koincidencë, asgjë më tepër, iu përgjigja. E di, por çfarë ka zbuluar ai, saktësisht? Nuk ka zbuluar asgjë, ka deshifruar, i thashë. Po çfarë ka deshifruar? pyeti ajo përsëri. Një gjuhë, një gjuhë të panjohur. Dhe kjo është diçka e mundur? Ndoshta po, meqenëse ai e ka bërë. Kvetë u habit aq shumë, sa që mori në bibliotekë një libër mbi kulturat dhe gjuhët antike – ato të deshifruarat dhe ato të padeshifruarat. Edhe atje shënohej e njëjta datë së cilës i referohej asistenti Horski: 24 nëntor 1915. Ishte data ime. Kisha lindur ditën, kur profesor Hrozni ia kishte

paraqitur botës atë gjuhë, të sapo deshifruar.

Të deshifrosh një gjuhë të para tremijë vjetëve, o dreq, nuk është gjë e vogël. Dhe jo në një alfabet latin, zoti nëntoger, por në shkrimin kuneiformë. Gjuha hitike është një nga gjuhët indoeuropiane më antike që është ruajtur në formë të shkruar. Është një fillim i mbarë. Historia e popullit të Perandorisë hitike, Perënditë, ligjet, jetët. Martesat dhe funeralet, shpërblimet dhe dënimet, betejat e luftërat të fituara ose të humbura...Sa gjëra mund të kuptohen nga një gjuhë, zoti nëntoger, sa gjëra, sidomos që kanë të bëjnë me një perandori të dalë njëmijë e dyqind vjet para lindjes së Krishtit?

Shkrimi kuneiformë? Kur i pashë për herë të parë ato shenja të çuditshme kuneiformë, m'u dukën si gjurmë zogjsh uJOR. Gjurmë zogjsh me putra palmipede (në formë pëllëmbë). Sigurisht më të vogla, si të harabelave të vegjël, por uji. Ato gjurmë, shenja, gdhendje të shkronjave kuneiformë ishin të gërvishtura me një majë shkruese të bërë me xunkth të mprehur me të cilën përpunohej argjila e lagësht. Maja shkruese prej xunkthi kishte formën e një kunji, prandaj, zoti nëntoger, quhej shkrimi kuneiformë. Një shkrim që ka lindur në Mesopotami si vepër e Sumerëve dhe që është përdorur për shumë gjuhë, ndoshta, si sot, alfabeti latin. Sa herë që nuk dinë si t'ia dalin, veçanërisht, kur bëhet fjalë për ngjarje të antikitetit ose të Lindjes së Largët, zoti nëntoger, dalin në dritë ose më mirë të themi shfrytëzohen Sumerët! Por ky është vetëm komenti i papërshtatshëm i një plaku të mjerë dhe ju lutem të mos ma vini re. Thonë se letërsia hitike në kuneiformë përfaqëson letërsinë indoeuropiane më antike. Dhe për dijeninë Tuaj, zoti nëntoger, Hitikët kanë jetuar atje, ku tani ndodhet Turqia dhe Siria, kur isha i ri, ajo zonë quhej Anatolia.

Tani mund të them që fillova të interesohem për gjithë këto, sepse Kveta ishte impresionuar shumë nga përputhja e datëlindjes sime me atë të konferencës së famshme, në të cilën u deshifrua

gjuha e Hitikëve. Kishte një imagjinatë më të flaktë se e imja, e ka pasur gjithmonë dhe me kalimin e kohës, kisha mësuar të mos e pengoja me argumentimet e mia logjike dhe pragmatiste ose me pyetje realiste. Ishte e lehtë, nuk më duhej të bëja shumë përpjekje. E dini, kur Kveta i lëshonte frenat e fantazisë ose, më mirë të themi, të fantazive, sepse i kishte me bollëk, bëhej shumë e bukur. Ëndërrimi ia ndryshonte shprehjen e fytyrës. Për shembull, filloi të përfytyronte si do të kishte qenë, nëse ata persona do të imagjinonin se dikush, pas tremijë vjetësh do të tregonte interes kaq të madh për ta. Si do ta kishin marrë, siç na ndodh edhe neve të mendojmë, edhe ata, herë pas here do të kenë menduar; ndoshta edhe do kenë folur për këtë, ndërsa rrisnin fëmijët e tyre, shkonin në betejë a në luftë. Ose, kur festonin martesat e tyre. Ndoshta Juve, zoti nëntoger, nuk do t'ju duket kaq origjinale. E pranoj se janë mendime mjaft të zakonshme në rrethana të caktuara, për shembull, gjatë një vizite në një muzeum ose në një vend arkeologjik. Por, kur për këtë fliste Kveta, e shikoje të hapte sytë, dhe pas një çasti t'i mbyllte, nganjëherë t'i mbante mbyllur për disa sekonda. Në përgjithësi, zakoni i mbylljes së syve, ndërsa flet me dikë, më duket, vërtet, i pacipë, pak gjëra më nervozojnë sa kjo. Por, zoti nëntoger, kur Kveta mbyllte sytë për dy sekonda, ishte diçka krejt tjetër, sepse në çastin që i rihapte, ata bëheshin akoma më jeshilë, akoma më të mëdhenj.

E pranoj se, jo gjithmonë, i kuptoja arsyetimet e saj, përfundimet e saj, por nuk doja ta ndërprisja, edhe kur mendimet e saj ishin në kundërshtim me rastësi të thjeshta logjike të debateve të përjetshme. Më pëlqente ta kundroja, ta vështroja. Në fillim nuk kuptoja, ishte si një sëmundje që përhapej, humbisja gradualisht mendimin tim praktik, doja vetëm ta dëgjoja, ta vëzhgoja, ta kundroja, vetëm të qëndroja me të. Po, kur fliste për këto gjëra, e doja akoma më shumë. Për ta thënë qartë e thjesht, e doja gruan time me një ndjenjë absolutisht jashtë origjinalitetit, banale.

Kështu një ditë, më erdhi ndërmend – gjërat e rëndësishme të një njeriu ndodhin gjithmonë kështu, një ditë, të paktën kështu shkruhet – që ekzistojnë akoma gjuhë të padeshifruara. Njërën prej tyre ishte përpjekur ta deshifronte vetë doktor Hrozni. Atëherë mendova se mund të provoja unë të deshifroja një prej këtyre gjuhëve. Reagimi i Kvetës më kujtohet akoma. Do të ishte fantastike, Jozef, thjesht fantastike, më tha. Kishim shkuar të laheshin në pishinën Zlutellazne. Ndoshta ishte valëvitja e flokëve të saj në erë që i bëri aq joshëse fjalët e saj. Ndoshta unë doja t'i bëja përshtypje Kvetës. Po doja t'i bëja përshtypje të veçantë asaj, doja të rrija me të, në mbretërinë e fantazive të saj dhe të flokëve të saj që valëviteshin në erë. Edhe pse mund të duket e pamundur – i njoh kufizimet e mia – nuk më kishte shkuar kurrë ndërmend më parë, se mund të ekzistojnë gjuhë që nuk ishin kodifikuar akoma. Megjithëse kishim gjithmonë para syve yllin e profesor Hrozni, megjithëse gazetatat sillnin lajme nga zbulimet e tij të fundit në Lindjen e Afërme, megjithëse gjithçka ishte e qartë, kurrë s'më kishte qëlluar të mendoja për faktin se disa gjuhë akoma nuk ishin deshifruar dhe se shumë shkencëtarë po provonin ta bënin. Shkuam ca herë me Kvetën për të ndjekur leksionet publike të profesorit tonë të lavdishëm. Unë isha ulur pranë saj dhe e vështroja; kur po ktheheshim në shtëpi, u kujtova se nuk e kisha kuptuar fare argumentin. Dija vetëm një gjë, kurrë më shumë se në ato çaste nuk kisha rrezikuar të bëhesha xheloz. Për dyzet minuta të mira, profesori gëzonte, i pa shqetësuar, vëmendjen e saj. Dhe, kur ktheheshim në shtëpi ajo ishte, gjithmonë, me humor të mirë, e gëzuar, e sjellshme buzëqeshte vazhdimisht, ndërsa unë isha i paaftë të përqendrohesha në çfarëdo gjëje. Ishte ky moment që mua më lindi ideja të provoja të deshifroja një gjuhë të panjohur! Do ta bëja së bashku me Kvetën. Natyrisht, e kuptova shumë shpejt se i kisha dhënë liri të rrezikshme imagjinatës, megjithatë kjo nuk e pakësonte entuziazmin. Ishte një ndjesi fëminore, si të ecje nëpër

katakombet antike ose të kërkoje një thesar në një ishull të shkretë. Atëherë nuk isha në gjendje ta kuptoja, por ndihesha pak si abati Faria dhe konti i Montekristos, ose si Henrik Shlieman, zbuluesi i Trojës. Ju lutem të mos më gjykoni me shumë rreptësi, zoti nëntoger. Unë doja vetëm t'i bëja përshtypje gruas sime, një ndjesi e panjohur për mua deri atëherë. Kurrë s'ka pasur shumë fantazi, prandaj kjo ide më joshi. Madje, pa ia thënë Kvetës, unë fillova të marr informacion mbi deshifrimin e gjuhëve të panjohura. Isha fare jashtë atyre problemeve, dija vetëm se, pas gjithë gjasave, operacionet statike, që unë i zotëroja në mënyrë të përsosur, nuk do të më hynin shumë në punë. Dalëngadalë, nëpërmjet ndonjë pyetjeje të matur, kuptova se Kveta ishte më e entuziazmuar, sesa besoja unë, nga synimi im për të deshifruar një gjuhë të panjohur.

Më kujtohej një fotografi që e kisha parë në biografinë e Henrik Shleimanit, zbuluesit të Trojës. Ai, i veshur me të zeza dhe pranë tij gruaja e tij, Sofia, e zbukuruar me stoli antike, që i përkisnin një periudhe njëmijë vjet më parë se ata të bashkoheshin. Doja t'i kushtoja diçka Kvetës, diçka të pazakontë, të madhe, diçka që t'i kalonte aftësitë e mia, mundësitë e mia dhe fuqinë time. Është një marrëzi, natyrisht, ç'mund të jetë tjetër – është çmenduri të përpiqesh të tregosh dhembshuri e dashuri.

Dhe ia hyra punës. Si hap të parë, mësova se, të gjithë ata që kishin arritur diçka në fushën e deshifrimit të një gjuhe të panjohur, ishin gjeni të linguistikës. Unë nuk isha gjeni dhe nuk isha as linguist. Përveç se njihnin gjuhën amtare, atë e njihja edhe unë, të gjithë ata zotëronin mirë gjuhët europiane, gjuhën fatkeqe gjermane, frëngjishten elegante, gjuhën e papërcaktuar angleze dhe, për më tepër dinin edhe gjuhë të vdekura, latinishte dhe greqishten, por disa, dinin edhe gjuhë të Dhiatës së Vjetër. Po bëhesha gjithnjë e më i vetëdijshëm për marrëzinë time, por nuk u dorëzoja, gjithsesi, unë e kisha ditur gjithmonë se nuk do të ishte e lehtë. Problemi kryesor është metoda, thosha me vete,

metoda është një mendim i mirë logjik. Në njëfarë mënyre mohoja atë që ishte thënë gjithmonë midis rreshtave në lidhje me intuitën gjeniale. Kisha një gjë të re për të kaluar kohën. Kisha një hobby, ishte një eksperiencë e re dhe intriguese. Për fat të keq, ashtu si dhe në jetën e Hitikëve, edhe në tonën u fut historia. Në fakt jetonim në një epokë interesante, një vrapim i shkurtër, i shfrenuar i demokracisë pas luftës dhe, dy vjet më vonë – grushti i Shtetit komunist. Punova edhe për ca kohë, pastaj përfundova në burg. Cilido të ketë qenë shkaku, sot ka pak rëndësi. Ç'rëndësi ka e gjithë kjo, nëse martesë ime me gruan e vetme që kam dashur në jetë, është shkatërruar? Në situatën time dhe në moshën time, nuk ushqej shumë shpresa që të mund të rregulloj ndonjë gjë - do të doja vetëm që të arrinim ta falnim njëri-tjetrin. Ose më mirë, do të doja unë të falja, sepse, në fund të fundit, nuk mund të flas në vend të saj, do të doja të çlirohesha nga pezmatimi që më copëton zemrën. Do të doja të falja. Dhe Ju ta falni këtë plak që me llafet e tij ju vjedh Juve kohën e çmuar dhe vetvetes arsyen. Kam dashur vetëm Kvetën, gjë që, sot, ndoshta mund të duket defekt thelbësor, por unë u përkas kohëve të tjera, kohëve që po kalojnë ose, ndoshta tashmë, kanë kaluar dhe nuk ekzistojnë më. Unë, akoma mundesha t'ia lejoja vetes luksin të mos zgjidhja midis mundësive të ndryshme.

Më kapën dhe më arrestuan, në dhomën e marrjes në pyetje gjeta Hynekun. Ai, një nga miqtë e mi më të dashur, shoku im i tenisit, ishte nga ana tjetër. Ai, juristi me mendje të mprehtë. Fillimisht u përpoq të më bindte të firmosja një deklaratë, pastaj, m'u lut, m'u përgjërua dhe, në fund, gati filloi të qante, deri sa më tha, i dashur Jozef, Jozefi im, miku im, po të mos e bësh këtë që të them unë, pas meje do të vijnë të tjerët. Dhe ata do të jenë shtazë pa frena. Kështu janë, më beso, i njoh unë, do të të shkatërrojnë. Nuk do të mbijetosh as në fazën e parë të pyetjeve, i dashur Jozef, e di unë, e di dhe ti se atyre nuk u reziston edhe heroi më i madh;

ne të dy nuk jemi heronj, jemi njerëz të zakonshëm, jemi vetëm dy lojtarë tenisi. Dhe kishte të drejtë miku im Hynek. Sigurisht që kishte të drejtë, unë isha shumë larg nga të qenët hero, megjithatë nuk vendosa menjëherë të firmosja atë që më kërkonte. Të paktën në fillim, sepse nuk e kisha kuptuar që nuk isha vetëm unë në rrezik. Arrestimi im kishte ndodhur në mënyrë aq të rrufeshme, sa që nuk kisha arritur ta kuptoja domethënien e tij. Ndodhi gjithçka aq shpejt, sa që e kisha të vështirë të orientoheja. Dhe ai kishte të drejtë edhe në lidhje me ata që do të vinin pas tij - ishin, vërtet, si egërsira pa frena. Vetëm një gjë kishte harruar të ma thoshte: që ata njerëz ishin nën urdhrat e tij. Dalëngadalë nga Hyneku që ishte u transformua para syve të mi, në Ulikum. Ulikumi ishte një gjigand prej guri, ishte shurdh e i verbër, sepse kështu nuk do të mund të bënte lëshime para bukurisë ose keqardhjes. Kishte lindur në mitologjinë hitike, më saktësisht, në mitin e Kumarbit, nëse ju intereson. Pra, thjesht për ta thënë, Kumarbi ishte babai i të gjitha perëndive hitike. Dhe, kur Kumarbi mori komandën mbi perënditë e tjera - si ndodhi – tani është vërtet e parëndësishme; për të siguruar fronin e tij hyjnor u dha jetë disa përbindëshave. Ulikumi ishte njëri prej tyre, babai i të gjitha perëndive e plazmoi, e formoi prej një shkëmbi dhe, pasi Ulikumi, djali i tmerrshëm, lindi, babai i tij e vuri mbi supet e Upelurit, që përkon pak me Atlanten tonë. Upeluri-Atlante ishte një gjigand me pamje njerëzore që jetonte në ferr, mbi trupin e tij vunë qiellin dhe tokën. Por Atlante-Upeluri ishte i padepërtueshëm nga asgjë. Asgjë nuk e prekte. Edhe kur vuri re që toka ishte ndarë dhe shkëputur nga qielli me shpatë, një ngjarje që bëri të dridhet gjithë universin përreth. Si pasojë e kësaj ngjarjeje, botët kishin vendosur të copëtohen në grimca atomi. Perënditë kishin pushuar së marri frymë, zemra e tyre kishte ndaluar për një çast. Meqenëse Upeluri alias Atlante nuk vuri re asgjë nga këto, babai i perëndive i vuri mbi supe djalin e tij, përbindëshin prej guri Ulikumin. Vetëm, kur përbindëshi prej

guri filloi të rritej, Upeluri-Atlante nisi ta ndiente dhimbjen. Pas pesëmbëdhjetë ditësh, kur Ulikumi, i biri i babait të perëndive, u ngrit nga oqeani duke u lartësuar deri tek qiejt, perëndia diell e pa dhe ua rekomandoi perëndive të tjera, të cilat u tronditën nga paniku dhe frika.

Thirrën perëndinë stuhi, por as ajo nuk guxoi të bënte gjë. Vetëm motra e tij Ishtar që duhet të ketë qenë shumë tërheqëse, mendoi se do të mund ta josthte Ulikumin. Por babai i Ulikumit e kishte parashikuar, prandaj e kishte plazmuar prej shkëmbi, prandaj e kishte krijuar shurdh, të verbër dhe të pandjeshëm. Perëndia stuhi u vu në krye të një dërgate të përgjithshme dhe rekrutoi në ushtrinë e saj rrufe, shtrëngata, breshër dhe të gjithë demat e saj, por fatkeqësisht, zoti nëntoger, perëndia stuhi, pavarësisht nga shtatëdhjetë aleatët e saj hyjnorë, e humbi betejën, për më tepër Ulikumi vazhdoi të rritej duke kërcënuar edhe pallatin e saj, pallatin, në të cili askush nuk guxonte të vinte këmbë, për të cilin ishte e ndaluar edhe të flitej. Edhe për të zotin flitej vetëm me enigma dhe kurrë nuk shqiptohej emri i plotë, nga frika se ai mund të ndihej i thirrur. Ulikumi e kërcënoi pallatin e perëndisë stuhi. Ndërkohë që rritej, hija e tij përhapej dhe errësonte një pjesë gjithnjë e më të gjerë të tokës. Perëndia diell, nga frika e Ulikumit, ndryshoi trajektoren. Disa rajone vdisnin nga mungesa e dritës së diellit. Mungesa e diellit shkaktoi uri, mjerim e vdekje, por, mbi të gjithë, prej saj kishin frikë perënditë dhe jo njerëzit, sepse perënditë kishin më shumë gjëra për të humbur dhe, ndërkaq, Ulikumi vazhdonte të rritej. Perënditë s'dinin çfarë të bënin dhe, më në fund, i kërkuan këshillë Eovit, perëndisë së mençurisë. Me siguri, në ditët e sotme, do t'i kishin dhënë një studio ose ndonjë shoqatë konsumi, por çdo popull ka zakonet e tij, zoti nëntoger.

Për t'i rënë shkurt, perëndia e mençurisë zbuloi se Ulikumi rritej mbi supet e Upeluri-Atlantes dhe kërkoi një kronikë, një informacion në kronikat antike. Zbuloi se ishte e domosdoshme

të ndahej Ulikumi nga Upeluri-Atlante duke e shkëputur po me atë shpatë që, kohë më parë, kishte ndarë tokën nga qielli. E gjithë kjo ndodhte në Mesopotami, në mitologjinë hitike, para njëmijë vjetësh dhe mua, emri i Ulikumit, të përbindëshit prej guri - shurdh, i verbër dhe i pandjeshëm, më dukej aq i padëmshëm, aq i pafajshëm, onomatopeik, tamam si emri i mikut tim të vjetër; shoku im i ndeshjeve Hynek – tenist i shkëlqyer që, më vonë, siç mora vesh, kishte filluar të luante vetëm fshehurazi, sepse tenisi konsiderohej një sport borgjez – miku im, miku i familjes sime, Ulikumi. Papritur, miku im Ulikumi më shpjegoi se isha vetëm një i çmendur, një idiot i madh, sepse nuk e kisha kuptuar që unë, në të vërtetë, s'kisha të bëja fare me këtë, isha vetëm pjesë e një strategjie, tiranie e hakmarrjeje - njëri kundër të tjetrit - dhe roli im ishte i parëndësishëm. Më la të kuptoj se, po të mos firmosja, po të mos mësoja përmendësh atë që donin ata, do të mjaftonte një telefonatë për të kapur edhe gruan time – kush do të kujdesej pastaj për vajzën time? Kur ma tha ishte kthyer me shpinë nga unë, ishte pranverë dhe nga dritarja dukej qershiza e lulëzuar në kopsht. Por unë e dija, e ndieja që po shijonte efektin e fjalëve të tij dhe tmerrin që kishin shkaktuar. E dinte se do të mjaftonte të përmendte dy emra, të pyeste rastësisht: Si është Kveta dhe bija jote Alisa? dhe unë do të bëja çdo gjë që të më kërkonte. Çfarëdo gjëje. Por nuk po arrija akoma t'u besoja ndjesive të mia, të cilat, për më tepër, në atë moment, ishin të ngatërruara. Dhe, mbi të gjitha, ndieja vetëm nga një vesh, sepse, kur të qëllojnë me pistoletë afër veshit, nuk është vetëm dhimbje dhe gjak që pulson, por është një tërmet që të trondit trupin që nga palca e kurrizit, përmes muskujve dhe kapilarëve që shkrihen... unë në atë çast, nuk arrija të besoja fare se ai që po dëgjoja ishte zëri, plani, shantazhi i mikut tim Hynek, nuk e dija e nuk e kuptoja, sepse nuk isha vënë në dijeni që ai ishte transformuar në Ulikumi. Në një gjigand prej guri që kishte ardhur të më dërrmonte e të më shkatërronte, një

gjigand prej guri i verbër, shurdh e i pandjeshëm, që s'donte t'ia dinte për dashurinë, për bukurinë, aq më pak, për dhembshurinë dhe miqësinë.

Pastaj më arrestuan. Qëndrova në burg dhjetë vjet. Kur më rrasën brenda, Alisa ishte vetëm disa muajshe dhe, për shkak të atyre dhjetë vjetëve, nuk pushoj së vuajturi e së brengosuri. Vuaj që nuk e pashë të rritej. Kur u ktheva ishte pothuaj njëmbëdhjetë vjeçe dhe po shkonte me hapa gjigande drejt moshës së rritur. Pavarësisht nga përpjekjet e mia, s'kam arritur kurrë ta kompensoj për ato dhjetë vite. Kur dola nga burgu, unë isha një i huaj për të.

Por para se të pajtohesha përfundimisht me gjithçka, kur akoma më kishte mbetur ndonjë rreze e papërcaktuar shprese, u përpoqa të mbaja brenda vetes ëndrrën time dhe, të paktën, të zbuloja diçka, aq sa isha në gjendje të kuptoja mbi kulturat e antikitetit. Kur dola nga burgu, profesor Hrozny kishte vdekur. E dija se në momentin e vdekjes së tij, studionte për të deshifruar një sistem tjetër shkrimi, shkrimin linear B. Nuk ia arriti qëllimit, nuk pati kohë, por, para lirimit tim nga burgu kishte arritur ta bënte një anglez, njëfarë Ventriss, me profesion arkitekt, në vitin 1956. Ai arkitekt, unë inxhinier ndërtimi, ishim pothuajse kolegë. E mora vesh, kur u lirova. Përtej Shtetit tonë, koha kishte kaluar më shpejt, tek ne kishte ndaluar. Tashmë, vetëm për të kaluar kohën në luks, merrja, herë pas herë, libra për antikitetin në bibliotekë. Për shumë kohë vazhdoja të endesha lart e poshtë, derisa mendova se do të më bënte mirë të mësoja ndonjë gjuhë të huaj, një gjuhë shumë të përhapur. Bëra një tentativë, provova me frëngjishten. Fillova ngadalë dhe, më duhet të them, se nuk e pata të lehtë. Gramatikën e kuptoja, përjashtimet, shqiptimin, por, sapo filloja të studioja fjalët, rrëshqisja në errësirën më të zezë. Gjendesha nën shtypjen e kujtimeve që nuk do të kisha dashur t'i sillja kurrë ndërmend. Para se të mbyllja sytë për t'u përqendruar dhe të fiksoja një fjalë në kujtesë, menjëherë e shikoja veten në procesin

e marrjes në pyetje, në errësirë, të ulur në atë karrigen metalike, shaminë që më mbulonte sytë, e lagur me gjakun tim që thahej mbi fytyrë dhe mezi merrja frymë.

Pas pak kohe, e lashë, nuk mund të vazhdoja të rijetoja momentet më të këqija të jetës sime. Kur studioja në universitet, për të mësuar gjërat më të vështira, mbyllja sytë dhe i përfytyroja me formën e imazheve këndgjëra me ngjyra. Tani nuk isha në gjendje ta bëja më këtë. S'më mbetej gjë tjetër, veçse të braktisja frymëzimin tim rinor. Gjithçka që më mbetet tani, është synimi mjeran për të rifituar dashurinë e gruas sime Kveta.

I nderuar Zoti nëntoger, nuk jam shumë i sigurt se kjo deklarata ose biografia ime, mund t'ju hyjë në punë. Gjithsesi, vazhdoj të shpresoj dhe mbetem në dispozicionin Tuaj.

Nderimet e mia,

Ing. Jozef Černý (inxhinier ndërtimi në pension)

8. Vegimi i parë mbi pavdekësinë

Shpjegimi i pastiçerit Marek Svoboda në lidhje me emrin Hitler, njëri nga disa të tjerë që kishte adoptuar, nuk e kënaqi plotësisht doktor Antonin Lukavskin. Dilnin në pah, qartësisht, prirje paranojake në marrëdhëniet me femrat dhe, në përgjithësi, me shoqërinë njerëzore. Progresi monstruoz i shkencës që tregonte, midis tjerash, ishte vetëm fryt i fantazisë së tij, teknikisht nuk ishte i mundur dhe, pas gjithë gjasave, nuk do të kishte qenë as në të ardhmen; e vetmja gjë që dilte e qartë nga tregimi i tij ishte prirja e pacientit për histori jashtë realitetit. Doktor Lukavski, madje, mendonte se pacienti mund të simulonte një siklet psikik. Gjithsesi, mungonte një arsye bindëse. Megjithatë në pavijon, pati një ndryshim. Shtrimi i tij përmirësoi menjëherë cilësinë e ushqimit. Pastiçeri u njoh menjëherë me kuzhinierin e spitalit dhe ushqimi, tani u bë me erë të këndshme, jashtëzakonisht i mirë dhe doktor Antonini nuk mund të mos e pranonte se të gjithë pacientët, personeli, madje edhe ai vetë filluan t'i prisnin me padurim vaktet e ngrënies në spital. Brenda pak javësh, u bë e qartë se qëndrimi i Marek Svobodës në pavijonin e psikiatrisë nuk ishte aspak i nevojshëm dhe e nxorën me kusht që të vinte një herë në muaj në studion e Antoninit. Bisedonin për gjithfarë gjërash dhe Antonini vuri re se ishte kënaqësi të fliste me të. Çiltërsia e tij ishte rrezatuese. Disa herë ndodhte që ai të diskutonte me të për thelbin e mjekësisë.

“Ç’kuptim ka?” pyeti zoti Svoboda. “Shëndeti!” u përgjigj doktor Lukavski. “Po kur do të zbulohen të gjithë sëmundjet dhe

do të gjendet mjekimi për to?” “Është një problem abstrakt që nuk më përket mua, sepse nuk do të jetoj mjaftueshëm për ta parë atë” iu përgjigj doktor Antonini. “Çfarë do të ndodhë pastaj?” pyeti Mareku. “Do të fillojë të merret me qëllimin e saj të vërtetë – me pavdekësinë. Jam pothuajse i sigurt, vëlla” tha ai me vendosmëri. Pastaj shtoi: “Kam pasur dy vegime lidhur me këtë, dy vegime mbi pavdekësinë. Sot do të tregoj atë që ishte vendosur në të kaluarën, në një vend larg prej këtu. Kur të kthehem, të enjten tjetër, do të të tregoj atë që është vendosur këtu, por në të ardhmen”.

Dhe kështu filloi: “Ecim nëpër male. Unë, gruaja ime, vëllai im më i vogël, ca kushërinj dhe disa hamallë, ndihmësa dhe shërbëtorë. Tashmë nuk pyesja më, nëse ishim refugjatë apo tregtarë, nuk më dukej ndonjë dallim thelbësor. Ishim të rrethuar nga male të larta. Thashë që ecim nëpër male, por në fakt, përpiqeshim t’iu vinim rreth e rreth. Të ecësh nëpër male s’do të thotë të ecësh mbi male. Lëviznim me kujdes, si gjarpërinj të urtë, përmes grykësh e luginash, kërkonim të korruptonim rojet, të paguanim lundërtarët, të shmangnim doganat, të merrnim arratinë nga fati ynë natyral. Përpiqeshim të ishim të guximshëm, të mbijetonim. Shisnim lloje të ndryshme mallrash, shisnim e blinim gjithçka që mund të shitej e blihej, megjithatë, kishim vetëm aq sa na mjaftonte të mbulonim lakuriqësinë e jetëve tona.

Udhëtonim në drejtim të Persisë dhe na ishte dashur të shmangnim ushtri të ndryshme, njërën pas tjetrës. Në fillim të pranverës duhej të arrija në Tabriz, në Persi ku, para një viti, kisha bërë marrëveshje për disa mallra. Atë vit ishim nisur pak më herët; pranvera, nga një vogëlushe e lulëzuar ishte transformuar në një plakë fytyrëprishur. Nuk po ikte të ftohtit, përkundrazi shtoej. Ditën e dymbëdhjetë të udhëtimit tonë, vura re se gruaja ime ishte më keq se zakonisht dhe se përpiquej me të gjitha forcat për t’u mbajtur mbi kalë. Fillimisht e lidha me problemet e zakonshme të femrave, ato që Zoti i gjithëfuqishëm ua ka imponuar femrave si

dënim për vuajtjet që u shkaktojnë burrave, pastaj ndjeva kollën e saj që kërciste si kashta nga zjarri. Sytë iu bënë të akullt, flokët e zinj në blu e humbën shkëlqimin dhe unë fillova të trembesha se nuk do ta shpëtoja dot nga Azraali, engjëlli i vdekjes. Për disa ditë nuk mbylla sy dhe, pas një jave, kur e zinte gjumi në prehrin tim, ndieja frymëmarrjen e saj gjithnjë e më të dobët - vendosa të ktheheshim.

Por, tashmë, ishte tepër vonë. Një ushtri e mallkuar, e re dhe e panjohur, e një fuqie të mallkuar që, këtë herë, vinte nga Europa e mallkuar, nxiste, si një mizëri insektesh, një valë refugjatësh në buzë të vdekjes. Të ktheheshe në veri, drejt shtëpisë, ishte e pamundur në atë moment, sepse Zoti ynë që, me shikimin e tij, u jep jetë e vdekje yjeve, kishte shkaktuar një goditje tjetër: barbarët përpiqeshin përsëri të përvetësonin luginat e malet tona, mineralet tona, pasurinë e tokës sonë, madje edhe atë që ndodhet nën të; unë dëshiroja që Zoti ynë, emri i të cilit është i përjetshëm t'u shkaktonte atyre të njëjtat vuajtje që na shkaktonte ata neve. Vëllai im më i vogël filloi të kërkonte një mjek, një të urtë që na e kishte rekomanduar një miku im, tregtar qilimash, por kur arritëm në vendin e caktuar, i gjithë fshati ishte i zbrazët, shënuar me shenja zjarri. Kalova para një, dy, tri shtëpive të djegura dhe urdhërova njerëzit e mi t'u hipnin kuajve, megjithëse, ngaqë kishin pasur një ditë marshimi, m'u desh t'i ujdísja protestat e tyre me kamxhik. Urdhërova të mos humbitnim kohë për të varrosur kufomat e atyre fatkeqëve, sepse s'doja të ndiqja fatin e tyre. Dhashë urdhër të ngarkoheshin armët, nuk duhej t'i dhuronim jetët tona të varfra. Preferoja më mirë të mos e vështroja gruan time, ecja në krye të njerëzve të mi, i thashë vëllait ta kishte kujdes gjithë kohën dhe të më lajmëronte, kur ta shikonte të sflitur fare, kur engjëlli i vdekjes të kishte zbritur tek ajo. Në mesditë i arritëm tregtarët e tjerë që u bashkuan me ne. U gëzova, sepse atë rrugë e njihja pak. Pikërisht në momentin e lutjes, im vëlla erdhi me vrap tek

unë për të më thënë se jeta e gruas sime, tashmë, varej në një fije peri dhe shtoi, i trishtuar, se fibrat e saj po shkërmoqeshin me shpejtësi. Rastësisht, njëri nga tregtarët që u bashkuan me ne, na ndjeu dhe më tha se babai i tij ishte mjek, ai vetë kishte mësuar shumë prej të atit dhe u tregua i gatshëm të vizitonte gruan time. Shkuam të dy tek ajo, nuk e kisha parë prej dy ditësh. Ishte më e bukur se kurrë dhe po vdiste. E lashë aty tregtarin së bashku me vëllanë tim dhe shkova t'i lutem Zotit, mëshira e të cilit nuk njeh kufi, u luta dhe i kërkova një këshillë. Çfarë të bëja? Nuk e njihnim zonën përreth, në veri ishin barbarët-vrasës të tërbuar, në verilindje ishin mijëra refugjatë; Tabrizi ishte akoma larg dhe po të largoheshim nga rruga do të na sulmonin barbarët fanatikë europianë ose dikush tjetër. Po mbaroja pjesën e dytë të lutjeve, kur vjen tek unë personi që kishte vizituar gruan time, i cili më tha se duhet të zbrisim patjetër në luginë, në mënyrë që të fillonte një mjekim, përndryshe ajo do të vdiste brenda javës. Më tha se, po të doja ta shpëtoja, duhej ta nisja menjëherë drejt luginës. Meqenëse Zoti që qan mbi veprimet tona, më kishte dënuar me një dashuri të paepur e të pafund për gruan time, nuk hezitova. Pasi u konsultova me tregtarë të tjerë praktikë të asaj zone, urdhërova të niseshim, menjëherë drejt luginës më të afërt. Lugina ishte larg vetëm pak orë rrugë të vështirë – mund të arrinim para perëndimit të diellit. Brenda meje falënderova Zotin, që njihte edhe qëllimet e fshehta të zemrave tona dhe urdhërova të ktheheshim. Ishim në një vend ndërmjet Persisë dhe Armenisë.

Dërgova përpara për zbulim kalorësin tim më të mirë, me kalin më të mirë, pra me timin. Vëllait i lashë porosi të kujdesej për gruan time me dy palë sy dhe filluam zbritjen. Shtegu ishte i vështirë, shkëmbor dhe i papërdorur prej vitesh. Ishte vetëm një përrua malor që e përshkonte, rregullisht, çdo pranverë. Shtegu dukej një grumbull i ngatërruar gjarpërinjsh dhe kisha frikë se në zbritje, kafshët tona do të thyenin ligamentet. Nuk ndodhi.

Kafshët qenë më me fat se një nga shërbëtorët e mi që u rrëzua dhe u rrokullis poshtë. Pak orë më vonë, kaluam pranë trupit të tij në rrëzë të malit.

Një shërbëtor tjetër kërkoi të përfitonte nga shpejtësia e grupit tim, për t'u kthyer mbrapsht fshehurazi, së bashku me kalin e tij dhe me kafshë të tjera. Zbriti nga kali dhe bëri sikur do t'i nxirrte, me një thikë, një gur të mprehtë që i ishte ngulur kalit në thundër. Por ishte një marifet shumë i vjetër për të ma hedhur mua, për më tepër vështrimi i tij nuk ishte i kthjellët dhe, herën e fundit që kisha folur me të, i kishte fiksuar sytë tek kopsat e palltos sime. Kur humbas besimin tek dikush, ky i fundit duhet të presë vetëm faljen e Zotit, i cili është pafundësisht i mëshirshëm. Pra e prita pas kthesës dhe, duke e parë që s'po vinte, i dola përpara. Kur e pashë, në vend që t'u përgjigjej thirrjeve të mia, vazhdoi t'i shtynte kafshët mbrapa drejt maleve; me një fishek të pushkës sime ia dërgova Zotit, babait vigjilent të të gjithë universit, shpirtin e tij të padenjë.

Para perëndimit të diellit arritëm në luginë dhe pamë fshatin e parë. Duke gjykuar nga shtëpitë, mund të ishte një fshat me nja dyqind banorë. Në qendër ndahej nga një lumë, mbi të cilin kalonte një urë; mbi shtyllat e saj kishte zbukurime të mrekullueshme – kisha parë të tillë vetëm në Bagdad, kur isha fëmijë, herën e parë që shkova me babain, në një udhëtim për punët e tij.

Shqetësimi im i parë ishte të kërkoja një mjek dhe, madje, gjeta dy. Fillimisht asnjëri prej tyre nuk deshi ta vizitonte, me justifikimin se ishim të huaj dhe ata nuk ishin mësuar të vizitonin të huaj pas perëndimit të diellit, por mendova t'u ofroja para. I pari i pranoi menjëherë dhe erdhi tek gruaja ime. I dyti mblodhi supet dhe u nis të ikte, kështu që unë, për të qenë i sigurt se gruaja ime do të jetonte, qeshë i detyruar t'i thyeja ndonjë brinjë që të kuptonte se unë nuk do ta lija lulen time më të shtrenjtë, vetëm në duart e një kockëndreqësi. I ndërruan kompresat, i përgatitën një

përzierje me barishte kuruese dhe ia hapën kremrat mbi lëkurë; pastaj ne i informuam se të gjithë të afërmit e tyre të dashur ishin të mbyllur në dy dhoma të lokalit që njerëzit e mi kishin zënë dhe, nëse gruaja ime do të vdiste, nuk do të ishte e vetmja që e priste vdekja. Nuk m'u desh të shtoja më, vetëm dyfishova rojet gjatë natës.

Kur u zgjova të nesërmen në mëngjes, pas një nate me ëndrra, në të cilat provoja, në fillim, ta bindja dhe pastaj ta korruptoja engjëllin e vdekjes Azrael, duke i ofruar disa vjet nga jeta në këmbim të jetës së gruas sime, pashë, gjatë një patrullimi, njërin nga mjekët që lagte shallin e gruas sime në lumë, nën urë. Atëherë u tërbova dhe vetëm vëllai im ia arriti të më mbante që të mos e godisja për vdekje atë burrin. Çfarë do të jetë kjo kurë? Zieja nga inati. Familjet e dy mjekëve përpiqeshin të më bindnin me të qara e britma se, uji që kalonte nën urën monumentale, ishte kurues. Nuk besova deri të nesërmen, kur pashë lëkurën e fytyrës së mjekut të bëhej e freskët si e një fëmije të sapolindur, pa një gjurmë të grushtave e të këpucëve të mia.

Në mbrëmje, para se të bija për të fjetur, hyra me kujdes në dhomën, ku pushonte gruaja ime. U luta për të dhe, tashmë, nuk dija çfarë t'i premtoja Zotit në këmbim të jetës së saj, timen ia kisha ofruar kohë më parë, por, siç dukej edhe ajo nuk mjaftonte; qëndrova pak aty i zhytur në mendime, pastaj u nisa drejt rrëzës së malit për të kontrolluar rojet e mia. Mëngjesin tjetër, teksa prisja, prapa derës së dhomës së saj, që ajo të zgjohej, e ndjeva, në një moment, që po këndonte ngadalë këngën e saj të preferuar, atëherë hyra dhe pashë që ajo ishte shëruar. Flokët i shkëlqenin, ngjyra rozë e lëkurës, siç e kishte pasur gjithmonë. Kur e befasova, qetësisht, me një puthje e një përqaftim, vura re në sytë e saj një shkëndijë shumë të guximshme, me një hije spitullimi, falë Zotit, forca e saj ishte e pamposhtur. I pagova mjekët dhe i lashë të lirë familjarët e tyre. Më nderuan me një përkulje deri në tokë, me siguri, s'kishin

parë kurrë aq para së bashku - në atë kohë, ata ishin akoma më të varfër se ne. Pas disa orësh ata u erdhën prapë për të më kthyer një pjesë të parave. Atëherë u thashë t'ua falnin paratë të varfërve të vendit – mbetën të kënaqur dhe u larguan me hap më të lehtë.

Qëndrova në fshat me njerëzit e mi e me mallrat e mia edhe ca ditë akoma në fshat, për t'u siguruar plotësisht se gruaja ime ishte shëruar, pastaj u nisëm nga fshati me qëllimin për të marrë një nga rrugët, të cilat, përmes luginës më të afërt, drejtoheshin nga jugu. Por, kur ishim mbi urë, kuajt filluan të tërbohen. Kishim dalë në agim dhe s'kishte asnjëri përreth, përveç djalit të pronarit të hanit, të cilin e kishim marrë si udhërrëfyes që të na shoqëronte deri në luginë. Kuajt hidheshin si të çmendur dhe ai i gruas sime u rrëmbye aq shumë sa që mund ta vinte atë në rrezik, atëherë zbrita nga kali im dhe, përmes turmës së njerëzve, të kafshëve e mallrave, arrita ta frenoja. Ajo më vështroi me mirënjohje, por, papritur, njëri nga kuajt me një goditje me prapanicë më hodhi në ujë. Pata fat, po të më kishte goditur me shqelm, s'do të kisha dalë i gjallë. Uji i lumit nën urë ishte i cekët, arrita të kacavirrem pas bregut, i hipa kalit dhe u nisëm. Pas ca orësh u thava.

Megjithatë, nuk mund të mos vija re qëndrimin e ndryshuar të udhërrëfyesit tonë. Qëkur më pa të bija në ujë, vura re në fytyrën e tij shenja të një frike të madhe. “Jam përsëri në shalë, o mik” i thashë “nuk më ka ndodhur asgjë, bëra vetëm një banjë në ujin kurues të lumit tuaj”. Sa më shumë rrudhej fytyra e tij, aq më shumë më vinte për të qeshur. Edhe gruaja ime kishte vënë buzën në gaz. Ai më pyeti, nëse kisha rënë në ujë i tëri. Iu përgjigja – po. Pastaj më pyeti, nëse isha zhytur në ujë me të gjithë trupin dhe kokën. Përsëri i thashë po. “Atëherë, Zoti qoftë me ty” tha. “Pse?” e pyeta. “Në lumë derdhen ujërat e pesë përrenjve. Të urtët thonë se ky lumë është mbetja e ndalesës së fundit e parajsës që, sipas shkrimeve të shenjta, ndodhet në krahinën tonë, në kufi me Armeninë. Dhe se uji i këtij burimi” shtoi djali i pronarit të hanit,

tashmë me zë të dëshpëruar “të bën të pavdekshëm. Për shkak të korrupsionit të botës, forca e tij, tashmë, është dobësuar shumë, por duke u zhytur me trup e kokë, nuk do të mund t’i shpëtosh pavdekësisë”. Duke dëgjuar rrëfimin e tij, gjykova se mund të kesh frikë nga shpata e armikut, nga një sëmundje e keqe ose nga një plumb, por, sigurisht jo nga pavdekësia. “Zot, kij mëshirë për të, sepse nuk është i vetëdijshëm për fuqinë e veprimeve të tua” murmuriti udhërrëfyesi ynë dhe sytë e tij u ngulën mbi pluhurin e shtegut dhe lulet e tij të para pranverore që çanin përmes mbetjeve të borës, pothuajse të shkrirë. “Paragjykime” tha vëllai im “vetëm paragjykime të shpellarëve të paditur që nuk e kanë idenë as të luftërave që ndodhin përreth tyre, as të qeverive që ndryshojnë, që kanë një mentalitet të vjetër e naiv”. Im vëlla ia plasi të qeshurit, gati sa nuk ra nga kali. Çfarë paragjykimesh... qesha edhe unë së bashku me të. Pasi arritëm në luginë dhe paguam rojet, kaluam kufirin, tashmë, ishim në Persi, rruga drejt Tabrizit ishte e hapur.

Në Tabriz bleva një shtëpi, gruaja ime lindi fëmijë, unë hapa një aktivitet tregtie bashkë me vëllain dhe punonim në të gjithë Persinë, Turqinë, Armeninë. Fati i familjes sime filloi të ecte mbarë. Një ditë, në rrethina të Bagdadit, nuk arritëm të merremi vesh me një tregtar për çmimin e shafranit të Indisë dhe ai filloi të lëshonte mbi mua dhe vëllain tim gjithfarë fyerjesh. Në fund më tha: “Duhet të vendosë vëllai yt i madh për bizneset, jo ti”. Unë qesha me të madhe, por të nesërmen, në treg, u pashë në një pasqyrë që shitej. U shtanga në vend. Flokët e tim vëllai, tashmë, kishin marrë ngjyrë argjendi, ndërsa të mitë jo. Vëllait tim kishin filluar t’i bien flokët, mua jo. Lëkura e vëllait tim, çdo ditë merrte rrudha të reja – e imja mbetej gjithmonë njësoj.

Atëherë i hipa kalit dhe e rraskapita, siç kisha bërë me të tjerët, që të arrija në shtëpi sa më shpejt. Sapo hapa derën, e rrëzova përtokë shërbëtorin dhe, me zemrën që më dridhej, hyra me vrap në dhomën e gruas sime, e shtrëngova në gjoks, e çova në ballkon

dhe, në dritën e plotë të mesditës, fillova të numëroja rrudhat e saj. Pas udhëtimit të fundit, pas sëmundjes që kaloi dhe lindjes së fëmijëve, rrudhat e saj ishin shtuar. Tani kishte rrudha, të cilat nuk ekzistonin para një viti, rrudha nga të qeshurit e rrudha pleqërie, rrudha habije e rrudha të papriturash. Disa rrudha asaj i vinin nga rutina e lutjeve, të tjera nga buzët e shtrënguara, kur bënim dashuri dhe disa të tjera nga llafet qëllimkëqia të grave. Pastaj mora pasqyrën më të madhe që kishim në shtëpi dhe u pashë në të me vëmendje. Përsëri mbeta i shtangur, vazhdova të shikoja veten në pasqyrë për disa çaste, i shastisur, pastaj, e bëra copë-copë. Fytyra ime s'kishte ndryshuar fare në vjeshtat e fundit. Shenjat që kisha pasur më ishin shëruar plotësisht, madje nuk isha në gjendje të përcaktoja as vendet, ku i kisha pasur. Në fytyrën time nuk shfaqeshin rrudha. Atëherë e kuptova çfarë kishte ndodhur, isha bërë i pavdekshëm, isha mallkuar. Do të shikoja të vdiste gruan time shumë të dashur, do ta shikoja të plakej dhe unë s'do të mund të jetoja pleqërinë pranë saj. Vëllai im, bijtë e mi, miqtë dhe armiqtë e mi do të transformoheshin në shumica hijesh që Azrael do t'i merrte me vete, vetëm unë do të mbetesha njësoj, pa ndryshime, i mallkuar. Zoti i përjetshëm bëftë që unë të arrij në fund të ditëve të mia.

I kapluar nga dhimbja, me shpirtin e shkrehur në vajtim, në një natë pagjumësie ia rrëfeva gruas sime tmerrin e sekretit tim. Atë ditë, Zoti më dha një gjumë të rëndë, pa ëndrra. Kur hapa sytë të nesërmen, pashë se gruaja ime kishte kaluar një natë pa mbyllur sytë dhe e kuptova se ajo kishte ruajtur gjumin tim, duke përzënë shpirtrat e errësirës dhe duke mbledhur një legjion engjëjsh në ndihmë të fatit tim të hidhur. Një ditë më vonë, para se të gdhihej, më mori për dore dhe më çoi tek xhaxhai, vëllai i babait të vet që jetonte në rrethina. I rrëfyem historinë tonë.

Na dëgjoi me vëmendje, teksa pinim çaj; sytë e tij të vegjël kishin humbur në rrjetin e plasarit të lëkurës së rrudhur. Kishte

gjeste mitike, rrudha të thella, dhe një lëkurë që të kujtonte epiderminë e elefantëve afrikanë. Kur e përfunduam rrëfimin tonë, ai më vështroi me trishtim dhe tha: “Biri im, shumë shpesh e ke ofenduar Azraelin, duket se arroganca jote nuk ka fund”. Duke u ndjerë i fyer, u ngrita në këmbë dhe vetëm respekti për moshën e tij, më ndaloi ta mallkoja dhe ta krahasoja shpirtin e tij me atë të qenve të rrugës, të sëmurë e të neveritshëm; duhej të kishte qenë diçka tepër e butë.

Plaku më vështroi me bisht të syrit dhe qeshi në heshtje. Pastaj më kërkoi t’i merrja ca libra dhe letra të mbështjella, të vendosura mbi dollapët, që prej kohësh, siç tha ai vetë, nuk arrinte t’i merrte dhe që nuk i shërbenin, tashmë, prej vitesh. Hapi librat, shfletoi faqet me shkrim të dendur dhe pergamenët e mbushur plot me grafema të huaja dhe filloi të lexonte pa na kushtuar neve kurrfarë vëmendjeje.

Po fillonte të lindte dielli dhe gruaja ime, për herë të parë atë ditë, buzëqeshi, tha që ai gjithmonë kishte qenë kështu, i humbur në libra dhe, që të mos e shqetësonin fëmijët, kishte mësuar të bënte ëmbëlsira prej sheqeri, më të shijshmet në të gjithë lagjen. Kur ishin të vegjël, po të rrinin urtë e të mos e shqetësonin atë, mund të qëndronin në dhomën e tij dhe, pastaj, u jepte ëmbëlsira – po të mos rrinin urtë, gjithsesi, i merrnin ëmbëlsirat, sepse xhaxhai nuk kishte zemër t’ua mohonte. Nuk ishte martuar kurrë – cila grua do të pranonte të merrte për burrë një varfanjak si ai që jetonte vetëm për librat e veta dhe vetëm falë bamirësisë dhe respektit të të tjerëve? Megjithatë, të gjithë fëmijët e lagjes e adhuronin.

Pas shumë orësh, të kaluara në atë banesë të varfër, orë të kaluara duke mbajtur ujë, duke ndenjmur kot e duke përzënë mendimet bezdisëse si mushkonjat, në mbrëmje, sapo vendosa të ndizja llambat, xhaxhai, papritur, u ngrit dhe hapi me vendosmëri njërin nga librat. Më vështroi dhe më tha: “Lidhur me problemin tënd, mund të bëhen vetëm hamendje, nuk është studiuar e përshkruar

nga të urtët, megjithatë do të të shpjegoj çfarë ka ndodhur. Sipas shkrimeve të shenjta, në origjinë, parajsa ndodhej me të vërtetë në Armeni. Çka të kanë treguar fshatarët, ka mundësi të jetë e vërtetë.

Ndoshta do të mësosh se feja jonë, si feja e barbarëve dhe si ajo e qenve të krishterë, ëndërron parajsën, ku shpirti ynë do të çlirohet nga errësira dhe padija dhe ku shpresojmë të takojmë Zotin, lavdia e të cilit do të dojë shekuj për të ardhur. Edhe ajo feja antike e çuditshme që nuk e njeh Zotin, themeluesi i së cilës u ndriçua ose, për më tepër, u godit nga shkëndija hyjnore në Parkun e Drerëve, diku në Indi, ka një vend të shenjtë në zonën, për të cilën më tregove. Nuk kisha menduar kurrë që në këto legjenda mund të ketë një të vërtetë”.

Pastaj, xhaxhai i gruas sime filloi të më tregonte për lloje të ndryshme engjëjsh, për portat që të çonin nga njëri qiell në tjetrin. Për parajsën, në të cilën mund të pranohet vetëm ai që është i përgatitur siç duhet. Më tregoi shkrimet tona të shenjta, edhe ato të barbarëve e të pafeve. Gjente një lidhje ndërmjet asaj që më kishte ndodhur mua dhe vargjeve të disa profetëve, jo vetëm tanët, por edhe të popujve barbarë, gjente lidhje dhe kontraste që transformoheshin, përsëri, në harmoni hyjnore, në gjëra që, sipas mendimit tim të varfër, modest, të paditur, ishin të paqëndrueshme, si një lule e thatë, e harruar në treg, ose si takimi i parë i dy të dashurve, ose si ndriçimet e shenjtoreve. I dëgjova të gjitha me vëmendje, isha i çuditur dhe i tronditur nga vizionet e tij dhe nga erudicioni i tij, por nuk arrija të kuptoja çfarë lidhje kishte e gjithë kjo me fatin tim të mjerë, ku lidhej *kësmeti* im. Shpirti m'u dobësua dhe dëshpërimi zuri vend mbi shpinën time të përkulur. Në atë moment hyri në studio gruaja ime me darkën. Xhaxhai ishte kthyer anash dhe shikonte ngultas në kopsht, më shpjegonte diçka mbi Racielin, engjëllin që ishte shërbëtori më i dashur i Zotit, i ndarë nga Zoti i tij vetëm nga një perde.

Pa lëvizur fare kokën dhe para se gruaja ime të fliste, ai u

përgjigj: “Ke të drejtë vogëlushe, e di, fale xhaxhain tënd plak, të dehur rëndshëm nga llafologjia e vet. Pra” tha ai duke u kthyer nga unë “më thuaj argumentin, tek i cili je fiksuar më shumë, çfarë të tërheq më shumë dhe unë do të përpiqem të të këshilloj ty dhe vogëlushen time”. Nuk dija çfarë të thosha. Fillova t’i thosha se tregtia ishte gjëja që kuptoja më mirë dhe ai tundi kokën, para se unë të hapja gojën, desha t’i thosha se vitet e fundit në treg kishin dalë lloje të reja armësh, por ai tundi kokën i pakënaqur, para se të flisja. Atëherë i thashë: “S’ka tregtar më të zotin se unë. Blej e pastaj shes anis të thjeshtë dhe të yjësuar, estragon, galangë, dafinë, kardamon, shafran Indie, koriandër, arrëmysk dhe lulen e saj, valanidh, xhenxhefil dhe hisop. E adhuroj aromën e këtyre specieve si tingëllimën e monedhave që ato më sjellin”. “Kur përzihen speci i kuq, speci i bardhë, pak trigonelë, shafran, koriandër dhe kardamon” më pyeti “çfarë përftohet?” Ia plasa të qeshurit: “Të gjithë e dinë, është baza e kerrit, mishit me beharna” i thashë. “E drejtë!” pohoi ai me kokë dhe pastaj shtoi: “Ti ke në natyrën tënde shumë spec, shumë spec djegës, ke një natyrë, është pak të thuash, gjaknxehët dhe në jetën tënde je kryqëzuar disa herë në ecje me Azraelin, engjëllin e vdekjes. Ndoshta kjo ka ndodhur edhe afër tokës tënde, ose të krahinës – ajo çka mbetet nga parajsa. Atë ditë që ke vrarë shërbëtorin tënd që donte të të mashtronte, nuk pate vrasje ndërgjegjeje?” më pyeti. Pyetja e tij ishte e qartë, kështu që dhe përgjigja ime: “Sigurisht jo” bërtita. “Si do të mund ta drejtoja ndryshe një aktivitet tregtar, si do të mbikëqyrja gjithçka ose të mbaja familjen time? Si?”. Burri i moshuar vështroi gruan time, ngriti supet dhe tha: “Shumë zjarr, vogëlushe, shumë zjarr. Kur keni zbritur në luginë nëpër atë shtegun që dukej si një grumbull gjarpërinjsh, ai shteg, ti do të habitesh, është përshkruar në njërin nga librat që kam blerë në Medinë” vazhdoi xhaxhai “keni kaluar atë që quhet kufiri i Edenit, zona ku dikur shtrihej parajsa dhe, pikërisht aty, ke vrarë shërbëtorin tënd – kjo të ka

hedhur ty kundër mallkimit. Engjëlli i vdekjes është hakmarrë ndaj teje duke bërë që ti të zhyteshe në ujërat e pavdekësisë. Në gjithë këtë, Azraeli ka treguar njëfarë zgjuarsie, mund të thuash edhe ironi” tha dhe heshti.

Nuk kuptoja për çfarë po fliste, por vendosa të mos e ndërprisja. “E vetmja mundësi” vazhdoi “e vetmja mundësi që të mbetet tani është pendesa absolute”. “Ç’do të thotë kjo?” e pyeta. “Do të thotë që, kurrë më, nuk do të marrësh jetë njerëzish, që do ta vësh gjaknxehtësinë tënde në shërbim të të pambrojturve, atyre që Zoti u ka dhënë vuajtjen”. “Ndoshta po më kërkon të bëhem i varfër e lypës?” e pyeta duke ngritur zërin. “Nuk do të të ndihmojë fakti që i shikon gjërat në antitezë” u përgjigj. “Ndhimoje vogëlushe, nëse nuk është tepër vonë” i tha gruas sime dhe nga shprehja e fytyrës së saj kuptohej se ishte koha të largoheshim.

Pas disa ditësh, dërgova në shtëpinë e plakut vëllain tim, që t’i shpjegonte cili ishte kuptimi i fjalëve dhe çfarë duhej të bëja, që të më shpjegonte gjithçka në mënyrë të thjeshtë e të qartë, isha vetëm një tregtar normal unë, nuk i kisha dhuntitë e tij. Kjo ishte përgjigja e tij: “Të heqësh dorë nga gjëja që vlerëson më shumë”. Pas ca ditë lodhjeje, zemërimi dhe inati të dukshëm, ia dhashë hamshorin tim më të mirë, më të zjarrtë drejtorit të jetimores së komunës që ta shiste e t’i shpenzonte paratë për ushqime e veshje për fëmijët. Ai e shiti kalin tim më të mirë në treg me një humbje të konsiderueshme: sapo e mora vesh, më hipën xhindet dhe vrapova tek ai.

Hyra në dhomën e tij, ku e gjeta të përkulur mbi fletoren e llogarive të tij mjerane dhe fillova ta akuzoj se kishte humbur, të paktën, një të tretën e vlerës reale të kalit, kur, papritur, na ndërprejnë dy fëmijë, një djalë që vraponte me një shami koke në dorë dhe e motra që e ndiqte për t’ia marrë shaminë, e cila i përkiste asaj. Nuk e di përse, por pata ndjesinë se i kisha parë ata dy fëmijë. Vajza në fillim iu lut të vëllait, pastaj u përpoq t’ia marrë

me forcë. Por djali ishte më i gjatë se ajo dhe, për më tepër ishte ngritur në majë të këmbëve, me shaminë në dorë dhe krahun e ngritur mbi kokë. Motra nuk mundej ta arrinte. Drejtori i jetimores i qortoi, ia mori shaminë djalit dhe ia ktheu motrës së tij, i nxori jashtë derës, në kopsht dhe më pyeti: “I njeh këta fëmijë? Nuk e di cilët janë? Para shumë vjetësh, vëllai i tyre i madh vdiq në male, në një udhëtim tregtie që bëje ti, siç thuhet, dhe ata mbetën jetimë. S’kishin askënd tjetër, prindërit kishin vdekur para kohe dhe u kishte mbetur vetëm ai vëlla, i cili përpiquej, në një mënyrë a në një tjetër, t’i mbante ata me bukë; kur vdiq edhe ai, ndërkohë që ishte në një udhëtim pikërisht me ty në male, mbetën jetimë”.

Ndjeva marrje mendsh dhe u shemba mbi stol, ndërsa drejtori më mbante për krahun. Ata fëmijë ishin vëllai dhe motra e shërbëtorit tim, të atij që donte të më vidhte dhe që e kisha vrarë pa mëdyshje. Drejtori vazhdoi të më fliste, por unë nuk i dëgjoja fjalët e tij, shikoja gojën e tij që hapej e mbyllej, sytë e tij të hutuar. Erdha në vete vetëm, kur më afroi në buzë një filxhan çaj. Pastaj u largova dhe, një ditë më vonë, i dhashë para për ta zmadhuar ndërtesën. Pas disa ditësh u ktheva tek drejtori me kërkesën për t’i birësuar ata fëmijë, motrën dhe vëllanë e njeriut që kisha vrarë. Atij i shkëlqeu fytyra dhe tha se kishte dëgjuar zëra të gabuar në lidhje me mua - nuk ishte e vërtetë që e kisha zemrën të ashpër si guri. Kur pashë fytyrën e tij transparente si një pasqyrë që reflektonte çdo dridhje të zemrës së tij, u habita që nuk e kishte shitur kalin prej race të pastër, me një çmim akoma më të lirë.

I birësova zyrtarisht ata fëmijë dhe, meqenëse ishin më të mëdhenj se ata që kishte lindur gruaja ime, sipas ligjit, në rastin që Azraeli kishte ndërruar mendje dhe, një ditë, do të më linte të vdisja, atyre do t’ju mbetej pjesa më e madhe e trashëgimisë sime. Më vonë, gruaja më tha se kisha kaluar disa net duke bërëtitur në gjumë aq fort, sa ajo s’më kishte dëgjuar ndonjëherë, thosha fjalë si turp e faj, kërkoja ndjesë. Disa nga ato ëndrra i mbaj mend akoma,

ishin të rënda si drejtësia e Zotit, e cila na shtyp, siç shtypim ne ulla në shtrydhëse druri për të nxjerrë vajin.

Pas ca muajsh, në dyqanin e qilimave, ndjeva një shitësin tim t'i thoshte një tjetri: "Pronari, këto javët e fundit është dobësuar vërtet dhe, papritur, është plakur". Nuk e morën vesh kurrë, përse u dhashë një javë pushim dhe i pagova njërit prej tyre pajën e vajzës.

Atë ditë shkova përsëri tek xhaxhai i gruas, por shtëpia ishte braktisur dhe plakuri nuk ishte aty. Më thanë fqinjët se kishte shkuar diku në kufi me Armeninë për të blerë dorëshkrime të shenjta. Kur ia tregova gruas sime, ajo më tha se, herë pas here, shkonte në shtëpinë e tij për të pastruar e për t'i gatuar ndonjë gjë dhe se ai kishte lënë një letër për ne tek fqinjët. Letra ishte shkruar me një kaligrafi shumë të bukur, kurrë s'kisha parë diçka të tillë.

Xhaxhai na uronte mua dhe gruas sime që vazhdonte ta quante – vogëlushja ime – një jetë të bukur dhe thoshte që kishte dëgjuar se fati im kishte marrë kthesën normale. Pastaj kujtonte gjatë, siç bëjnë të moshuarit, momentet e fëmijërisë së gruas sime, kur ajo vinte rrotull e luante në studion e tij. Kohët, kur ai ishte krenar dhe pretendonte të largonte perden që fshihte qëllimet e Zotit. Por, tani, e kishte kuptuar se fati ynë ishte, për të, një ftesë për të ecur drejt së panjohurës.

Para pak kohësh, kam vënë re se, edhe unë kujtoj shpesh çastet e rinisë, siç dëshmon rrëfimi im, tamam si pleqtë dhe të sëmurët. Në fakt ky jam unë tani, një plak dhe një i sëmurë në pritje të Azraelit që do të vijë të më marrë. E ndiej se vizita e tij do të përkojë me pjekjen e ulla dhe shpresoj të më mbetet kohë, të paktën, për të mbledhur prodhimin e këtij viti".

Ndërsa dëgjoja rrëfimin, doktor Lukavski mbante shënime dhe, të nesërmen, shkoi në bibliotekë dhe rreshtoi disa volume të përmbledhjes *Një mijë e një netët*. Fillimisht lexoi përmbajtjen. Pastaj konsultoi tryezën e lëndës. Në fund u hodhi një sy titujve

të tregimeve dhe lexoi disa prej tyre. Por atë histori nuk e gjeti. Pas një ore, e deklaroi të përfunduar kohën kushtuar kërkimit të tij shkencor, sepse pasdite kishte turnin në institucionin e tij. Me siguri kam shfletuar pa e vënë re, mendoi. Me siguri. Nuk mund të mos e kishte marrë prej andej historinë e tij, mendoi Antonini, pastaj puna e përfshiu dhe iu desh të pushonte së interesuari, cili ishte burimi i botës imagjinare të pastiçerit.

9. Lojëra dashurie

Kur e arrestuan Jozefin me akuzën për veprimtari subversive kundër Republikës, Alisa ishte tre muaj e katër ditëshe. Kveta nuk dinte çfarë të bënte dhe ku të shkonte, ndiente vetëm se duhej të vepronte menjëherë dhe sa më shpejt që të ishte e mundur. Sikur të mos kishte asgjë më të rëndësishme se shpejtësia, sikur vetëm po të vepronte shpejt, mund të kishte ndonjë shpresë. Mori vajzën dhe shkoi tek e ëma. Por, kur ajo i doli përpara aq e vjetër, aq e hutuar, e kuptoi se duhej të shqetësohej edhe për të, përveç se të lironte Jozefin. Teksa i ndërronte mbesës pampersin, gjyshja dukej më e qetë, më e paqtuar. Kveta atëherë i tregoi se në shtëpinë e saj kishin ardhur tre vetë për të marrë Jozefin, e kishin urdhëruar të merrte dokumentet dhe nuk e kishin lejuar atë as ta prekte dhe, kur ajo duke shpërfillur ndalimin e tyre, kishte provuar... ta përqafonte, njëri kishte hyrë ndërmjet tyre me duart në mes.

Për herë të parë, Kveta e kishte prekur me dorë frikën, të cilën nuk e kishte njohur deri atëherë. Asnjëri prej tyre nuk i ishte përgjigjur argumenteve të saj, justifikimeve, shpjegimeve përgjëruese. Dhe ishte akoma më e vështirë, sepse nuk dinte çfarë gjëje duhej të argumentonte, çfarë të shpjegonte dhe përse, për çfarë duhej të kërkonte ndjesë. Lutjet ishin krejtësisht të kota. Pastaj, thjesht, e morën nga shtëpia. Dhe ai, burri i saj dukej, çuditërisht, i qetë dhe i bindur. Sikur të priste me padurim të shkonte pas tyre. Sikur të kishte midis tyre një lidhje sekrete. Sikur...

Dhe e morën. Dhe ajo nuk e pa më. I kishte vrapuar pas nëpër shkallë, megjithëse ai i kishte bërë shenjë të shpejtë e të papritur

kundërshtimi, nuk donte që ajo ta ndiqte, sikur dinte diçka, për të cilën ajo nuk e kishte idenë. Kur zbriti poshtë, para portës, ndjeu vajzën që qante dhe tingëllimi i zërit të saj e shënjoji zemrën e tij, shpirtin e tij, ose trurin e tij me një mençuri kryelartë. Britma e së bijës e mbyti dhimbjen dhe mallin, që tashmë e shtrëngonin Jozefin. Malli si një mysafir i pakalueshëm, i paturp e kokëfortë kërkonte strehim, kur nxori dokumentet dhe i përplasi me forcë në stolin e recepsionit, malli tregonte kredencialet e tij, aset fituese në një ndeshje të humbur që në fillim, pa marrë parasysh se mysafiri paraardhës nuk i kishte bërë gati valixhet, nuk ishte larguar, nuk i kishte dorëzuar akoma çelësat, nuk ishin ndërruar akoma çarçafët.

Dhe, me njëfarë qetësie indiferente, e vëzhgoi Jozefin që largohej me ata tre burra; për një kohë të gjatë do ta zëvendësonte ajo. Zëri i vajzës e detyroi Kvetën të ngjitej me shpejtësi shkallëve dhe ta merrte në krah, teksa largonte perdet e dritares për të parë makinën, ku kishte hipur Jozefi. Por nuk dukeshin më.

Nëna, më vonë, i tha se, tashmë, kishin kaluar pesë vjet që nga fundi i luftës që mendonte se, tani, do të kishin jetuar në qetësi se, për më tepër, ishin të gjithë çekoslovakë, pra s'mund të ndodhte asgjë. Në qoftë se një njeri është i ndershëm, fisnik, i mirë, nuk do t'i bënin keq.

Kur e zuri gjumi vajzën, Kveta doli në rrugë, pa përshëndetur fare. Vetëm, kur u gjend në trotuar, e kuptoi se nuk e kishte idenë fare, ku ishte Jozefi. Brodhi nëpër qytet deri në perëndim. Pa një njeri, pa një ku, pa një përse. Kur u ndezën dritat e rrugës, ngriti kokën dhe pa, para vetes, statujën e Shën Vençeslaos, të rrethuar nga katër shenjtorë. Nga mbrapa ngrihej pallati i muzeumit kombëtar, plot me fosile, zogj të balsamosur e gurë, ku ishte ruajtur skeleti i balenës. Dhe aty, në sheshin Shën Vençeslao, Kveta vështroi mbrojtësin e Republikës Çeke, prapa kutisë gjigande prej guri të praruar. Pastaj ndjeu zërin e një shitësi që i zgjati një gazetë. E mori, pagoi dhe e vuri kuletën në çantë. Por vazhdonte ta ndiente

zërin e tij bezdisës dhe vendosi t'i shmangej. U kthye në rrugën Krakovia dhe hyri në galeri. Papritur dikush e zuri për krahu. Ktheu kokën. “Zonjushë... zonjushë, gazeta juaj. Gazeta”.

“Zonjë” u përgjigj Kveta “jam zonjë dhe jo zonjushë. Zonjë”.

“Juka rënë gazeta” i tha gruaja ia dha atë Kvetës. Kjo e falënderoi duke tundur kokën. Zëri i shitësit nuk ndihej më. Hapi gazetën. Në faqen e parë ishin rezultatet e regjistrimit. Në titull thuhej se më 1 mars 1950 në Çekoslovakia numëroheshin 12.338.450 vetë, 8.896.133 vetë ishin banorë të Republikës së Çekisë. Kveta e kaloi galerinë në heshtje, pa u menduar. Pasi doli jashtë vështroi, edhe një herë, numrat në gazetë. Si mund t'i numëronin, mendoi ajo. Një numër aq i lartë. Gjithë ata persona. Është e pamundur të regjistrohen të gjithë, kundërshtoi. Sigurisht, mendoi pastaj, duhet të ketë një zyrë të posaçme. Cili nga ata numra jam unë? Cilët nga ata jam unë, Jozefi, Alisa? Kveta e ndiente se shifrat e fundit të atij numri 8.896.133 duhet të ishin ajo, Jozefi dhe Alisa. Sigurisht, tre të fundit jemi ne dhe, sigurisht, ka nja zyrë të posaçme.

Pas disa ditësh erdhi e ëma. Që në prag të derës, pa hyrë akoma Brenda, i futi në dorë një letër. Me një kaligrafi të madhe, të parregullt, prej gjysheje, ishte shkruar: *Doktor i së drejtës Hynek Janski*. Pastaj vinte rruga, numri dhe, poshtë, emri i një zyre të panjohur. “Ai, me siguri, do të na ndihmojë” tha nëna pa varur akoma pallton në varësen e rrobave. “Do të na ndihmojë” përsëriti duke hyrë në kuzhinë. “Ka pasur gjithmonë dobësi për ty” shtoi dhe filloi të merret me mbesën.

Kveta e dinte se Jozefi ishte nën hetim për diçka që nuk e kishte bërë kurrë. Si mund ta kishte bërë, nëse çdo moment që nuk ishte në shtëpi, e kalonte në zyrë duke bërë llogaritje? Pa inxhinierë ndërtimi, thoshte gjithmonë ai, as komunistët nuk do të bëjnë dot, Kveta ime e dashur, inxhinieria e ndërtimit është shkenca e të ndërtuarit dhe s'ka fare të bëjë me politikën, shërben për të bërë të mundur që pallatet të qëndrojnë pa u shembur, që urat, digat,

kullat dhe fabrikat të qëndrojnë e të mos shemben.

Kështu thoshte ai, por, papritur, Kvetës asgjë nuk i dukej më e sigurt dhe, shpesh, e shqetësonte një mendim, një mendim i përsëritur që nuk i shqitej, megjithëse përpiquej me këmbëngulje ta mbyste: në fakt, edhe e pamundura mund të bëhej e mundur dhe, ndoshta, Jozefi mund të kishte gabuar se, me rigën e tij llogaritëse plastike të bukur, të bardhë e të re, mund t'i ketë ngatërruar llogaritjet e tij. Kështu Kveta, tani, gjendej para Hynek Janskit, doktor në dy të drejta, shok i vjetër, lojtar i aftë në tenis, dikur anëtar i klubit që frekuentonin edhe ajo me Jozefin.

Ai, Hyneku, me një kostum me viza të holla, me një prerje të përkryer, buzëqeshte si gjithmonë. Mbi tavolinë, në mes të studios ishte një vazo e vogël me agulice; me një shenjë të Hynekut, një djalosh i ulur në një tavolinë në qoshe, ndoshta – daktilografist, u ngrit dhe doli nga dhoma, me një dosje dokumentesh nën sqetull. Kveta, pasi kishte kërkuar kot më kot, për ditë të tëra, burrin e saj tani gjendej aty para Hynekut; në atë periudhë të frikshme, plot turbullira, ishte gjëja më e mirë që mund të shpresonte. Ai tha vetëm: “Kveta e dashur, afrohu, mos qëndro tek dera” i shtrëngoi dorën fort. Nuk i kishte pëllëmbët e djersitura, madje i kishte të thata dhe mbante erë kolonje. Ia shtrëngoi dorën me vendosmëri, i rreptë, por edhe i përzemërt.

Kur daktilografisti, sekretari apo kushdo që ai, doli dhe mbylli derën, pas kërcitjes së bravës, ai ia kapi dorën përsëri dhe e afroi tek goja, tamam sikur donte t'ia puthte, si në kohët e dikurshme, para luftës, por nuk ia puthti, sepse tani që ishin komunistët në pushtet prej dy vjetësh, ky quhej një gjest borgjez dhe do të ishte diçka mendjelehtë, komprometuese, e rrezikshme. Në atë kohë do të kishte qenë më e pranueshme ta puthte në buzë, sesa ta puthte si një përfaqësues i borgjezisë, bartës i sjelljeve të infektuara rrezikshëm.

Ajo ishte njësoj si më parë, po, pothuajse e njëjta, mendoi

Hyneku, Dukej pak më e shëndoshë, natyrshëm, pas lindjes së vajzës. Pastaj ia shtrëngoi dorën, siç kishte mësuar të përshëndeste ose të përcillte, nga bashkëpunëtorët e tij të dashur politikë nëpër mbledhje. Ia shtrëngoi dorën thatë e me vendosmëri dhe sekretari daktilografist e kuptoi menjëherë çfarë duhej të bënte dhe u ngrit, përshëndeti me kokë atë – komisarin, përshëndeti edhe gruan me sy jeshilë të errët, e panjohur për të, por sigurisht, jo për komisarin. Aq jeshilë i kishte sytë saqë sekretarit, iu mor fryma. Fatmirësisht, nuk duhej të fliste, hutimi i tij do t'u kishte rënë në sy të gjithëve - arriti ta mposhte dhe askush nuk e vuri re.

Përshëndeti, mbylli derën dhe shkoi të shënonte në regjistrin e tij gjysmëzyrtar që, në atë datë, doktori komisar, shoku Hynek Janski, kishte pritur një grua rreth njëzet e tetë vjeçe. Emrin e kërkoi me nxitim e inat në librin e vizitave, në recepsion, ku zeshkania me sy jeshilë, me një veshje tepër elegante, kishte firmosur si Kveta Çerna. Në kolonën pranë, ajo kishte vënë edhe kodin e saj fiskal dhe sekretari u ndje i mikluar që mësoi datëlindjen e saj të saktë, pasi kishte hamendësuar për moshën e saj.

Pasi mbylli derën sekretari, Hyneku nuk mundi të përmbahej, e çoi dorën e gruas pothuajse në buzë, gati për ta puthur, por autokontrolli i pamëshirshëm që e frenonte, që e kishte bërë gjithmonë në tenis një kundërshtar të rrezikshëm, iu kundërvu dëshirës së tij dhe ai gjest nuk u çua deri në fund. Buzët e tij aluduan të puthin ajrin duke u ndalur fiks tre centimetra dhe shtatë milimetra larg gishtave të saj. Buzëqeshi dhe konstatoi me vete se Kveta vetëm ishte shëndoshur pak pas lindjes. Duke ngritur sytë nga dora e gruas, nuk mundi të mos vinte re linjat e trupit të saj, të dominuara nga gjoksi, të fshehura nga veshjet si një peizazh nën borë.

E lëvizi karrigen nga tavolina, ajo u ul; ai mori karrigen tjetër, nga ana e kundërt dhe e tërhoqi në mënyrë që të ulej pranë saj. Pastaj e la të tregonte. Burri i saj ishte arrestuar, vërtet, ishte një

arrest sigurie, por fjala sigurie nuk kishte kurrfarë kuptimi me xhaxha Josif Visarionoviçin në fronin e Kremlinit, shprehja arrest sigurie do të ishte njësoj sikur të thoshe – Jozefi është arrestuar. As më shumë, as më pak. Fjala nuk tregonte asgjë, nëse po bëheshin verifikime. Fjalët e përmbajtura dhe të strukura, kufizohen duke shprehur gjeometrinë e pushtetit. As më shumë, as më pak. E siguroi se ishte përpjekur të kuptonte, sa ishte e mundur rreth situatës së Jozefit. Nuk i tregoi që, tashmë, ishte vënë nën presion nga njerëzit e tij. Tha që ishte përpjekur dhe shtoi se nuk mund t'i jepte asnjë shpresë. E gjithë kjo me një shprehje solemne dhe të sinqertë, fytyra pothuajse të linte të dalloje gëzimin që u takua me të.

Në fund, madje ishte i kënaqur që Kveta, para fillimit të luftës, nuk e kishte pranuar propozimin e tij për martesë. Gjithsesi, ai kalonte nga një mbledhje në tjetrën dhe s'do të kishte pasur kohë për një familje. Gjëja që e kishte nervozuar ishte se ajo e kishte refuzuar atë për Jozefin, sepse priste propozimin e tij, ndërsa Hynek ia kishte bërë këtë një vit më parë. Kjo kishte qenë e pakëndshme. Po, e pakëndshme. Hyneku ishte i sinqertë me të, nuk e gënjeu.

Vetëm një dy gjëra... ia mbajti të fshehta. Për shembull që Jozefi kishte marrë një mësim të mirë prej njerëzve të tij. Jo prej tij! Prej njerëzve të tij. Nuk kishte bërë as gabimin ta kontaktonte ai i pari. Kishte pritur që ajo ta gjente. Ai dinte gjithçka për Kvetën. Ai po. Po ajo...? Për të kishte mbaruar gjithçka para luftës. Për Kvetën!

Po të mos bëhej fjalë pikërisht për Jozefin, i cili ishte miku i tij më i afërt, ai që gratë kurrë nuk i kishte kuptuar. Jozefi miku i tij i ngushtë. Miku i tij i ndrojtur. Po të mos bëhej fjalë për Jozefin, mikun e tij, atë mospranim edhe mund ta kishte duruar.

Kur doli nga studioja, Kveta ishte e kënaqur që Hyneku nuk e kishte shfrytëzuar situatën, që nuk e kishte ftuar për një gotë verë, një drekë ose një kafe, që nuk kishte dashur t'i kujtonte kohët e

vjetra, plotësisht i pajtuar - ishte e qartë – me faktin që ajo ishte martuar prej disa vjetësh me një tjetër. Gjithsesi, dikur kishin qenë shokë që të tre.

Kur u largua Kveta, pasi ia hapi derën, e nxori në korridor dhe mbylli derën, Hyneku hapi krahët dhe u përplas me të gjithë forcën tek parvazi i derës prej druri të zverdhur. Deshi ta tërhiqte, ta shkulte dhe e gjithë kjo në qetësi, që të mos ndihej nga ana tjetër - ra në gjunjë. Pastaj, pothuajse pa qenë i vetëdijshëm, filloi të përkëdhelte karrigen, në të cilën, para një çasti, ishte ulur Kveta dhe të lëmonte me dorë vazon e vendosur mbi tavolinë që ajo e kishte prekur. Vazhdoi ta prekte, ta prekte, e preku aq shumë herë, sa ishte për t'u habitur jashtëzakonisht. E prekte dhe qeshte në një lumturi të pakufishme. E shikon Kveta ime, gjithçka shkon sipas parashikimit. Siç ishte parashikuar dhe, këtë herë, do të shkojë siç dua unë, e dashur, siç dua unë.

Në atë kohë njerëzit arrestoheshin si në një linjë montimi. Prodhimi në seri që e kishte zanafillën diku në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si vepër e Henri Fordit, e përruar për makinat T, ishte perfeksionuar shumë. Fordi, modeli i kapitalizmit, e çoi prodhimin në seri të makinave të tij në nivel të shkëlqyer. Arriti pothuajse deri në përsosmëri dhe, meqenëse ngjyrat e ndritshme pasteli kërkonin kohë për t'u tharë, duke zgjatur kohën dhe duke rritur koston e prodhimit, Henri sajoi një shprehje, e cila, më vonë, u nderua nga ithtarët e kapitalizmit aq sa aforizmat e pakuptimta të Koanit, nga ithtarët e budizmit zen.

Henri u thoshte klientëve të vet: “Mund ta keni modelin e makinës suaj me çfarëdo ngjyre, mjafton të jetë e zezë”. Ishte e qartë që Henri kishte arritur një shkallë ndriçimi shumë më të madhe, sesa ata që në qetësinë e pyjeve me bambu përpiqeshin të duartrokisnin vetëm me një dorë. Ithtarët e kapitalizmit përulen dhe habiten se si Henry, me mjeshtëri dhe inovacion, ka arritur ta kuptojë realizmin e llogaritjes, limitet tregtare, tregun, publicitetin

dhe kurbat e paimagjinueshme të fitimeve dhe të humbjeve, habiten dhe përkulen si të krishterët para legjendës së San Franciskos që u predikon zogjve dhe, pastaj, endi rrjetin e teologjisë në mënyrë që ai Zoti i tij i krishterë të mbetet brenda, pikërisht si dikur që me rrjet kapeshin laureshat për t'u dhënë shije pastave franceze ose italiane. Me natyrshmëri, shkathtësi e egërsi. Në mënyrë të butë, virtuoze, të egër, evolucioni i fuqishëm i shpirtit eurolindor lundron drejt prodhimit në seri të gjykimeve masive. Hetimi s'do të thotë asgjë, ka vlerë vetëm akuza.

Tradita kishtarë e torturës që ka zgjatur deri në agimet e Rusisë cariste, e bashkuar me filozofinë klasike të Shteteve gjermane dhe me gjenialitetin e analizave marksiste, solli në fillimin e ekzekutimeve. Nënvlërësimi i përhershëm i popujve të vegjël dhe traditave të tyre. Nënvlërësimi i përhershëm i elementit sllav dhe të rëndësisë së tij për ndërtimin e një bote më të mirë. Sa energji, sa përvojë njerëzore e shpërdoruar në kampet e përqendrimit dhe në gjykimet masive. Sa mendje gjeniale që nuk kanë mundur të kontribuojnë në pasurimin e botës.

Gjatë një muaji Hyneku nuk u bë i gjallë. Kvetë priti me durim, teksa realiteti i pushtetit totalitar rrënojesej në mendjen e saj. Priti një muaj, pastaj i telefonoi vetë Hynekut që nuk kishte kohë. Pas katërmëdhjetë ditësh, më në fund e gjeti kohën. I tha që do të bëhej një proces, i tha se Jozefi do të dënohej për mbrojtjen e dikujt, në punë, të cilit i kishte dalë krah në një padrejtësi. Bëhej fjalë për pronarin e vjetër të ndërmarrjes së shtetëzuar. Kishte qenë një marrëzi e madhe duke pasur parasysh kohën. Kishte thënë se pronari ishte njeri i mirë. Po si mund të ishte njeri i mirë, Kvetë e dashur, kur ai ishte një kapitalist!

Pastaj e informoi se nuk mund të bënte asgjë për të. Kur ka një akuzë – vjen dënimi, kështu funksionon. Vetëm akuza është e rëndësishme. I kishte thënë të vërtetën dhe s'kishte ndërmend ta zbukuronte situatën. Kishte plane të mëdha për të, por jo tani,

akoma jo. Tani ajo do të dërmohej shpirtërisht, do ta fajësonte atë, do të zemërohej me të. Dhe ai do ta linte të qetë. Ta linte që temperament i saj fisnik, mendja e saj e turbulluar të qetësoheshin. Trup e shpirt. Sepse ai, Hyneku, kishte plane të mëdha për të.

Karriera e suksesshme e Hynek Janskit nuk i detyrohej ndonjë dhuntie të veçantë dhe as ndonjë angazhimi të dalluar, por një butësie të thjeshtë, të zakonshme, e bazuar mbi bindjen se nuk ka gjë më të rëndësishme se një durim i mërztshëm, letargjik, rraskapitës, madje edhe anemik. Ky ndërgjegjësim i vetëm i tij ishte aq banal, sa shkonte deri në nivel të frikshëm, ngjallte ankth.

Hynek Janski ishte i bindur se, pothuaj të gjithë, ishin mendjemëdhenj, ndiheshin të jashtëzakonshëm, të papërsëritshëm, të paparë, edhe ajo, Kveta. Ndërkohë që Hynek Janski, doktor në të dyja të drejtat, e dinte – krenohej me këtë, sikur kishte zbuluar një ligj me vlerë universale – që ishte absolutisht njësoj si çdo burrë tjetër. Ndihej krenar që nuk ishte as i papërsëritshëm, as i jashtëzakonshëm, krenohej që ishte një njeri i durueshëm dhe absolutisht konformist.

Falë atij durimi, Hyneku fitonte ndeshjet e tenisit, ai nuk rrezikonte, luante në linjën bazë, pa *lëvizje të rrëmbyeshme*, marramendëse, as hedhje topi shumë të zgjuar, jo, ai jo. Ai priste rastin, shfrytëzonte gabimet e kundërshtarëve të vet dhe, në heshtje, i djersitur, i ndiqte të gjithë topat, derisa kishte forcë, nuk përgjigjej duke fshikur rrjetat, nuk i prekte rrezikshëm vijat e fushës, jo, linte gjithmonë kufirin në një metër dhe fitonte.

Kveta do të ketë një reagim absolutisht të zakonshëm, shumë normal, tipik, si gratë e të dënuarve të tjerë. Nuk pritej një zgjidhje e jashtëzakonshme, as origjinale, për arsyen e thjeshtë, sepse nuk pritej e pamundura.

Fillimisht, për disa javë, Kveta do të ndihet e dëshpëruar, do të digjet në ferrin e ankthit së bashku me fytyrën e vet të bukur, me lëkurën e saj të butë, do të zgjohet çdo natë, rregullisht ndërmjet

orës dy dhe katër, do të psherëtitijë, do të qajë pa fund, derisa të bindet se tmerri i saj më i madh është bërë realiteti. Do të gëlltisë aq shumë lot deri në shterim, rrathët e syve do t'i thellohen, sytë do t'i thahen e skuqen, do të bëhen si një mirazh që nuk jep shenja se do të zhduket, do të ngjajnë me sinjalet e neonit që shkëlqejnë natën në çdo cep, pastaj ajo do ta shikojë kudo, kudo që do ta ndalojë vështrimin.

Gjatë asaj periudhe, Hyneku nuk do ta takonte. Ndoshta vetëm ndonjë takim në ndonjë vend publik që, gjithsesi, nuk do të zgjaste më shumë se njëzet a tridhjetë minuta. Do t'i injektonte shpresë pa u dhënë shumë, pa u komprometuar dhe, mbi të gjitha, do të shmangte dënesat e saj në krahët e tij. Përndryshe situata do të merrte një karakter të pakëndshëm, të pakuptimtë e mendjelehtë. Do të lindte një ndjesi solidariteti, keqardhjeje, ndjenja vëllazërore që do ta kishin larguar nga qëllimi i tij. Ai do priste momentin, në të cilin, pas dëshpërimit të hidhur, pasi të kishte djersitur nga ankthi, do të vinin lodhja dhe dhimbja e pafund. Dhe së bashku me zemërimin, kuptohet, ndaj atij që ishte arrestuar, burgosur e torturuar, kundër të dënuarit. Pra Kveta do të zemërohej me burrin e saj të adhuruar, me Jozefin.

Gjithmonë ndodh kështu, njerëzit fajësojnë të vdekurit e tyre, ose ata që kanë përfunduar në burg, ose janë vrarë dhe nuk kanë dhënë mbrojtje. Ndodh kështu gjithmonë, ka ndodhur kështu gjithmonë. Kur do të vijë momenti është e vështirë ta thuash. Por Kveta do të pushojë së qari, nuk do të mund të flejë, do të ndihet fajtores, kështu do të shkojë. Dhe në atë moment, Hyneku do t'i gjendet pranë. Atëherë do të arrijë ta shikojë mirë, sepse Kveta nuk do t'i ketë më sytë kuq nga lotët e mesnatës, gropat e syrit do t'i thellohen. Dhe ai do t'i gjendet pranë.

Pastaj, pas disa muajsh, ajo do të pajtohet me faktin që i shoqi do të qëndronte në burg për shumë vjet. Dalëngadalë do të pranojë gjithçka, do të pushojë së pezmatuari dhe do të kuptojë se duhet

të vazhdojë të jetojë për vajzën e saj derisa ... më në fund... do ta kapërcejë ndërgjegjësimin e turbullt për të bërë, herë pas herë, edhe diçka për vete. Do të kuptojë ose do të zbulojë se nuk mund të mendojë gjithë kohën për kampin e përqendrimit, në të cilin do të jetë duke u kalbur burri i saj për trembëdhjetë vjet me radhë. Dhe, papritur, do të kuptojë ose do të zbulojë se ajo është akoma një femër, një grua.

Do të duhen muaj të tërë të gjatë për të arritur deri aty, megjithëse çdo etapë e këtij evolucioni mund të ndihmohet, mund të shpejtohet. Ishte e pakëndshme dhe pezmatuese të presësh kaq gjatë, por Hyneku e dinte se do të mund të mbështetej tek durimi i tij.

Pas disa muajsh, Jozefi u dënua me trembëdhjetë vjet burg. Domethënë deri në 1963. Në atë hark kohor, Kveta ishte dobësuar, në kurorën e flokëve ishin shfaqur fije gri, gropat e syrit binin në sy edhe nga larg. Hyneku i kishte thënë se, gjatë procesit nuk mund të bënte asgjë, por do ta ndihmonte Jozefin pas dhënies së dënimit, do të përpiqej ta rregullonte që ta çonin në një kamp përqendrimi më të durueshëm. Tashmë, Kveta ishte pajtuar me fatin e tyre dhe me logjikën kristalore të despotizmit. I ishte mirënjohëse Hynekut, sepse kishte shfaqur dëshirën ta ndihmonte Jozefin.

Herë pas here, ai shkonte ta takonte. Filloi t'i çonte shpesh ushqime, të cilat mungonin në treg. Pak a shumë, pas një jave nga ditëlindja e parë e Alisë, erdhi me një qese letre të paketuar me kujdes. Kur ajo e hapi dhe nxori portokallet, aroma e tyre e përmyti shtëpinë si një lumë, herë dukej si aromë liqeni, herë si e një lumi të vogël, herë si aromë ujëvare. Hyneku nuk qëndronte kurrë më shumë se gjysmë ore dhe, nganjëherë, Kvetës i vinte keq. Por, për të vënë re humnerën e dëshpërimit në sytë e saj, mjaftonte shumë më pak, vetëm disa minuta. Falë përvojës së tij të punës, kishte përcaktuar disa sinjale të pagabueshme për të dalluar shkallën e ferrit personal, në të cilën gjendej fatkeqi apo fatkeqja.

Kur Kveta shkoi në zyrë, pas shpalljes së vendimit, Hyneku, i

shkroi në një copë letër adresën e tij duke i pëshpëritur që të mos e kërkonte më në zyrë, por në shtëpi, nëse do të kishte nevojë për ndonjë gjë. Pak a shumë, Kveta, kalonte nga Hyneku, një herë në muaj. Atëherë edhe nëna e saj ishte mësuar me idenë që e bija, për trembëdhjetë vite të gjata, do të ishte vetëm, pa dhëndrin e saj. I kishte ndodhur edhe burrit të një shoqes së saj, në moshën shtatëdhjetë vjeç, të përfundonte në burg. Ishte dobësuar aq shumë, saqë, gjatë procesit gjyqësor, njihej vetëm nga mustaqet. Edhe flokët, ngjyrë kafe deri atëherë, tashmë i kishte fare të bardhë. Ishte e vështirë të besoje që një njeri me një dënim dy vjet më shumë se Jozefi, që do të festonte tetëdhjetëvjetorin në një minierë uranumi, do të mund të mbijetonte.

Fakti që askush prej tyre nuk ishte kriminel nuk ishte i rëndësishëm në fushën e luftës së klasave, gjeometria e pamëshirshme e pushtetit i likuidonte të gjithë ata që konsideronte armiq.

Nëna e Kvetës e ndiente që po e linin forcat dhe nuk do të arrinte të jetonte deri në kthimin e Jozefit. Nuk i kishte thënë gjë akoma Kvetës, por me urtësinë e të moshuarve, një urtësi që bazohet në ndërgjegjësimin për brishtësinë e vet, përpiquej të kalonte sa më shumë kohë me mbesën. Në atë periudhë Kveta kishte arritur stadin më të mprehtë të dhimbjes dhe, tashmë, ishte pajtuar me fatin e saj. Një javë para se të shkonte të takonte Hynekun, bleu një fund të ri. As pas shumë vitesh më vonë, kur hetonte ndërgjegjen e saj, nuk arriti ta përcaktonte, nëse kishte qenë një koincidençë apo zëri i lig i nënvetëdijes që kishte kapur mundësinë.

Kur shkoi ta takonte, sapo kishte filluar pranvera. Hyneku i bëri një filxhan kafe braziliane, që nuk gjendej në dyqane normale, ndërsa Kveta vështronte pemët në lulëzim përgjatë bregut të lumit. Ajo e mori filxhanin me të dyja duart, ishte akoma shumë e nxehtë, por u kënaq me aromën shumë të këndshme, grishëse, aromën e ngrohtë dhe vazhdoi të vështronte nga dritarja pemët e lulëzuara, pa lëvizur, megjithëse porcelani përvëlues ia digjte duart.

Hyneku shkoi të merrte sheqerin në kuzhinë; duke u kthyer, u ndal në heshtje në prag të derës dhe po e vëzhgonte: në buzët e saj vuri re një buzëqeshje flirtuese që u kushtohej sythave të pemëve dhe, kështu, mori vesh se ditët e autodisiplinës së rreptë po përfundonin. Pastaj e pa duke pirë një gllënjë kafeje të nxehtë, akoma të hidhur, e pa të ngrihej nga divani për t'u mbështetur tek parvazi i dritares. Shtrimi i fundit të butë që i binte mbi ije, duke ia ravijëzuar mollaqet, ngjyra që me ndihmën e ndrojtur të një pudre të lirë ia gjallëronte faqet – gjithçka kishte një kuptim. Bluza e lehtë, ngrohtësia në rritje e asaj dite pranverore e bënë të formulonte pyetjen: “Çfarë je gati të bësh, në mënyrë që Jozefi ta ndiejë veten pak më mirë, Kveta?”.

“Çfarëdo gjëje” tha ajo, pa u dhënë fjalëve të tij ndonjë domethënie të veçantë. “Gjithçka, pa diskutim”.

“Është një pyetje serioze” vazhdoi ai. “Serioze” përsëriti ai. Ajo e vështroi duke kthyer, në fillim, kokën, pastaj gjithë trupin, gjaku i vërshoi në fytyrë dhe tha, me një farë pasigurie: “Hynek, unë para nuk kam. Mezi arrijmë të mbijetojmë”.

“Sa po më fyen” iu përgjigj. “Më fyen, nuk ishte aspak kjo ideja ime”.

“O Krisht, nuk e kisha fjalën se i doje për vete” i tha Kveta.

Pastaj shtoi: “Mendova se i doje për të shpërblyer dikë...”

“Cila gjë të pëlqen më shumë tek vetja?” pyeti Hynek.

“Nuk e di” u përgjigj Kveta.

“Cila është?”

“Me të vërtetë, nuk e di, Hynek” tha.

“Dhe je gati ta ndihmosh?” e pyeti përsëri.

“Sigurisht ” iu përgjigj.

“Kveta, do ta ndihmoj, do të përpiqem, por dua një gjë prej teje, dua që ti të mendosh për këtë”.

“Po unë vazhdimisht mendoj” reagoi Kveta. “Gjithë kohën, s'bëj gjë tjetër, vetëm mendoj për këtë”.

“Jo kështu, Kveta e dashur, jo në këtë mënyrë” i tha Hyneku. “Unë dua ta kuptosh ti vetë për çfarë bëhet fjalë”.

“Çfarë ke ndërmend?” tha Kveta, e nervozuar.

“Dua që ti të vish tek unë javën tjetër dhe të më vërtetosh që ke menduar për këtë”. Kveta nuk u përgjigj, dukshëm e turbulluar, u ul në divan para filxhanit të kafes, tashmë bosh.

“Ti e di, çfarë i bëjnë atij?”

“Mendoj që nuk i japin për të ngrënë sa duhet, nuk e lënë të flejë, që e rrahin”.

“Po, Kveta, po, por e gjithë kjo, për çfarë arsyeje?”

“Sepse duan që, që...”

“Sepse duan t’i shkatërrojnë, prandaj gjëja e parë është – t’i poshtërojnë” e ndërpreu Hyneku, pastaj heshti. “Dua që ti të vish tek unë, javën tjetër, të më thuash çfarë do të ishte, për ty, po e përsëris, gjëja më e tmerrshme, çka do të poshtëronte më shumë. Duhet të ma thuash këtë, të paktën ta di që nuk po përpiqem kot”.

Kveta e përshëndeti Hynekun me ftohtësi dhe ai vuri re se, kur ndihej e fyer, qafa i zgjatej dhe i tërë trupi dukej sikur i lartësohej. Po, është më e bukur, kur është e fyer, mendoj. Ta bësh të nervozohet. Duhet ta bëj këtë më shpesh. Të nesërmen, në zyrë, fshehurazi nga sekretari i tij, bëri që Kveta të thirrej në një zyrë sociale, e dyshuar se nuk kujdesej mjaftueshëm për vajzën e saj.

Sipas parashikimit, të nesërmen, ajo trokiti në derën e tij. Ai e siguroi që do të bënte ç’ishte e mundur që Alisa të mos kalonte nën kujdesin e shërbimeve shoqërore.

Gjallëria dhe gatishmëria e pazakontë e Hynekut e siguronin dhe e qetësonin Kvetën. Filloi të kishte besim tek ai. Kur shkoi në shtëpinë e tij, u ul dhe i foli për frikën e saj më të tmerrshme. Një vendim fatkeq është njësoj si t’i hapësh djallit portën e qytetit. Hyneku ishte gati për bisedime të gjata. E dëgjoi me vëmendje përzierjen e shqetësimeve të saj, frikën e saj imagjinare, vuajtjet e zakonshme, duke pritur që në listën e saj të fillonte të shfaqej edhe

trupi i saj.

Pas rreth dyzet minutash, gjatë të cilave ai pothuajse nuk e ndërpreu, ajo, më në fund, filloi të fliste për trupin e saj. Hyneku e dëgjoi, fantazia dhe intimiteti përziheshin, si sallata jeshile me trëndafilat. Interesante, por akoma e papërshtatshme. Kur më në fund, e skuqur në fytyrë, filloi të fliste për dhimbje të ndaluara dhe për dëshira seksuale sekrete, Hyneku e ndërpreu, sikur të mos ishte fare i interesuar dhe u kthye në fjalët e para të ligjërit të saj të gjatë.

“Kveta, the se nuk do të duroje të rrije e lidhur, të kishe pranga. Ja shikoje. Do të të tregoj si funksionojnë” i tha. “Ja ku i ke dy. Merri dhe provoji. Imagjino sikur i ke të vëna? Merri me vete në shtëpi dhe, javën tjetër, kur të vish do t’i vendosësh para syve të mi, në fillim në këmbë, pastaj në duar. Është sa për të pasur një përvojë. Që ta dish si ndihet njeriu”.

Dhe kështu, dalëngadalë, çdo javë, në çdo vizitë shtyheshin pak më përpara. Filluan me prangat. Kveta, fillimisht, u habit nga gjithë kjo, por ishte një ekstravagancë që e eksitonte.

Nuk e kuptonte, nëse ndodhte për shkak të Hynekut, të kërkesave të tij të pazakonta apo të vetë asaj. Ndonjëherë i vinte prangat edhe, kur ishte vetëm në shtëpi dhe frika e vetme që ishte - se mos humbiste çelësin. Kur shko i tek ai, qe ajo vetë që i vuri prangat më të mëdha në këmbë dhe të voglat rreth kyçeve. Hynek e lidhi këmbë e duar me një litar dhe e la ashtu, pak a shumë gjysmë ore, ndërsa thithte gllënjkat e verës dhe pinte një cigare amerikane të ruajtur për këtë rast. Pas gjysmë ore Kveta iu lut ta zgjidhte, sepse donte të urinonte. Hynek ia plotësoi kërkesën, e dinte që kishte akoma shumë rrugë përpara. Kur doli nga banja, e përqafoi dhe i tha: “E pe, bibë e trembur. Në të vërtetë nuk është ndonjë gjë. Është vetëm frika jonë që na paralizon”.

Dhe kështu, gradualisht, brenda disa muajsh, ngadalë, por me vendosmëri arritën aty, ku synonte Hynek prej kohësh. Dhe një

ditë ai e urdhëroi: “Tani përkulu”. Kveta u përkul dhe hoqi fundin e saj veror duke zbuluar mollaqet, ijet dhe mitrën. Dhe kështu ajo zbuloi, njëri pas tjetrit, sekretet e kënaqësisë që shpërthen nga dhimbja dhe ngacmimi i pangopur i dëshirave të fshehta. Nëse Kveta vonohej qoftë dhe për pak minuta, sapo të hynte duhej të përkulej, të qëndronte si me katër këmbë në gjunjë e në duar dhe Hyneku e godiste në prapnicë e në shpinë aq herë sa minuta ishte vonuar. E tërhequr jo vetëm nga interesi që tregonte për të, por edhe nga dhimbja që i shkaktonte në trupin dhe shpirtin e saj, vonohej në mënyrë patetike para hyrjes së pallatit, vetëm që ta godiste më shumë, një goditje më shumë për çdo minutë vonese.

Dalëngadalë u dashurua me Hynekun, me dhimbjen që ai i shkaktonte. Pas disa muajsh, asnjëri prej të dyve nuk e përmendte më ndihmën që Hyneku duhej t’i kishte dhënë Jozefit, tashmë ishin marrëdhëniet e tyre prangat që i mbanin të lidhur. Kveta e mbylli derën dhe pushoi së qeni Kveta, kthehej në një mushkë, një pelë, një hamshore, siç e quante ai. Sapo ai e quante kështu, trupi i saj tendosej, qafa i drejtohej dhe ajo humbiste vetëdijen për atë që do të ndodhte. I thoshte: “Pela ime e stërvitur që, më parë, ishte aq rebele, tani vlerëson atë që përbuzte... Është e vërtetë, mëzi im?”

Ajo i pranonte fyerjet dhe poshtërimet e tij me një kënaqësi të çuditshme, vetëm pas disa muajsh, asaj i shkoi ndër mend ta pyeste si ia kishte arritur të transformonte një person aq krenar e të pavarur, siç ishte ajo. “Pavllovi” iu përgjigj Hyneku. “Pavllovi dhe eksperimentet e tij të famshëm me qentë. Është një teori e thjeshtë, e testuar dhe funksionon me të gjithë. Refleksi i kushtëzuar... mos e harro kurrë, kafsha ime e dashur, që e zotëroj në mënyrë perfekte rusishten. Nuk jetohet vetëm me Leninin”.

Herë pas here, Kveta betohej se nuk do të shkonte më tek Hyneku. Madje e provoi. Herën e parë rezistoi tri javë, pas së cilës, ai i tha se, po të donte të kthehej, e priste një leksion aq vështirë që s’do të mund ta harronte. Ajo pohoi me kokë, u zhvesh lakuriq dhe

i kërkoi që të mund të shtrëngonte një shami me dhëmbë. Të vetmet pjesë që nuk ia preku ishin qafa, kokë dhe fytyra. Edhe pse ishte një verë e nxehtë, Kveta filloi të mbante mëngë të gjata, çorape të errëta dhe funde të gjata që nuk lejonin të kalonte drita e diellit. Filloi të mbyllet me çelës në banjo, në mënyrë që e ëma të mos i shikonte shenjat që i mbulonin gjithë trupin.

Kur, duke qarë, duke shtrënguar dhëmbët dhe duke ngashëryer, u përpoq përsëri të ndërpriste lidhje e tyre, mori atë që Hyneku e quajti leksionin e tij të dytë shembullor. Ajo s'donte ta takonte më, por vazhdonte të dëshironte orgazmat që i jepte ai duke e goditur. Kur u kthye tek ai, trupi i saj digjej flakë si asnjëherë tjetër. Hyneku përdori instrumente dhe lloje të tjera shërbimi. Trupi i saj dukej i rrahur me mijëra hithra. Por e vërteta ishte se orgazmat e kryqëzuara, që ndiqnin gjithmonë keqtrajtimit, ishin akoma më të fuqishme. Kveta e donte trupin e saj, ndërsa urrente thellësisht shpirtin e saj. Por ndjesia e servilizmit total dhe që kishte dikë, i cili interesohej për të, ishte aq e jashtëzakonshme, saqë nuk arrinte të shkëputej. Nganjëherë asaj i ndodhte të shpërthente në të qara, në momentet më të papërshtatshme, gjithmonë, kur kujtohej për Jozefin dhe për transformimin që kishte pësuar vetë ajo. Ajo, sepse askënd tjetër s'mund të fajësonte.

Ra zilja, u hap dera, Hyneku u largua për t'i hapur rrugën. I mbante sytë poshtë. Në anën e djathtë të korridorit ishte akoma biblioteka që kishin lënë gjermanët, të cilët kishin banuar aty, para luftës. Hyneku vështroi orën e pagabueshme ruse, me dedikimin që i kishte gdhendur Ministri i Brendshëm, si mirënjohje për të gjithë armiqtë e socializmit e të paqes që kishte likuiduar dhe i tha:

“Ke ardhur me shtatëmbëdhjetë minuta vonesë, putanë. Është një numër tek, prandaj do ta shumëzojmë me një numër çift, për shembull katër. Sa bën?”

“Gjashtëdhjetë e tetë” u përgjigj Kveta.

“Mirë” tha Hynek “tani përkulu”.

10. Torturuesi

1.

Para se tanket ruse të arrinin në Pragë, filluan të përhapen lajmet për torturat e pamëshirshme, mizore, çnjerëzore që ushtroheshin mbi të burgosurit politikë në vitet Pesëdhjetë. Gazeta e revista përmendnin njëfarë komisari, me emrin Janski, si një nga shpikësit më të egër të atyre mizorive. Jo vetëm i poshtëronte të burgosurit duke i rrahur e duke i shtrënguar t'u nënshtroheshin torturave që, ndoshta, as nuk i përkasin kësaj bote, por përdorte pa mëshirë edhe të afërmit e tyre, të njohurit, njerëzit më të dashur për ta. Përdorte njërin kundër tjetrit. I gjymtonte burrat, i bënte të paaftë të ndienin kënaqësi me gratë e tyre dhe, ndërkaq, ngjallte tek të dënuarit dyshime, iluzione duke i shantazhuar dhe duke ua coptuar shpirtin.

Ata që shkonin në dhomën e tij, shumë shpejt, arrinin të dëshironin të shpërbëheshin, të vdisnin, t'i jepnin fund vetes. Nëpër gazeta filloi të flitej për procese hetimore, për komisione speciale, për çështje gjyqësore në ngarkim të torturuesve, pastaj tanket ruse u vendosën në sheshin Shën Venceslao dhe askush s'pati më dëshirë e vullnet të merrej me hetime.

Në vitin 1964, Hynek Janski u shkarkua nga detyra e tij si hetues dhe titulli i tij - komisar referent, u shfuqizua. Dukej se shkenca e tij, s'kishte më arsye të ekzistonte. Madje flitej për dënimin e tij, për t'ia shpërblyer me të njëjtën monedhë. Në gjë, eprorët e tij bënë më të mirën – nuk u pezullua, por u shkarkua. Pezullimi do të kishte ndikuar mbi pensionin e tij, gjë që do të sillte

një sërë pengesash. Doktor Janski u shkarkua dhe u bë ndihmës i menaxherit të një magazine fruta-perimesh, në rrethina të Pragës. Për shumë vite u mor me shtatë punonjës, me ndonjë vinç ngritës ngarkesash dhe me temperaturën e ngrirjes së frutave e perimeve. Ekspertiza e tij, e përdorur gjatë, përvoja e tij e pazëvendësueshme - nuk hynë në punë më. Kishte ca vartës të dobët dhe një shef të vetëm, të alkolizuar që ushqehet, që nga mëngjesi, me çaj të përzier me rum.

Pastaj erdhi Gjashtëdhjetë e teta, viti i tankeve ruse dhe, që atëherë e në vazhdim, filloi të priste vizita para kabinës së rojës së objektit. E thërrisnin dhe ai dilte. Ishin kolegë të vjetër që donin të dinin si ishte. Ai s'kishte as një vend, ku t'i priste. Turp. Nganjëherë shkonin në birrari, ku porosisnin ndonjë kafë ose gulash. Megjithëse askush nuk i thoshte asgjë të saktë, Janski e kuptonte se eprorët e tij të vjetër vinin aty për një qëllim të vetëm: të kuptonin, nëse ai ishte akoma gati.

Kaloi edhe njëfarë kohe, derisa, në Krishtlindjen e vitit 1971, shkoi në punë, si çdo mëngjes dhe gjeti, para kabinës së rojës, një makinë me shoferin, i cili i dha një zarf të madh e të trashë, të mbyllur me dyllë të kuq. Sapo e pa, Janski e kuptoi, menjëherë, që ditëve të tij të vështira, u kishte ardhur fundi. Kishin arritur në konkluzionin që specialistët, për të qenë të dobishëm, duhej të ktheheshin në vendet e tyre të punës. Me gishtat që i dridheshin, Hynek grisi cepin e zarfit dhe nxori prej tij ca letra. Dokumenti më i rëndësishëm njoftonte se ishte caktuar profesor në një akademi të sapo krijuar. Shoferi, ndërkohë, e ndiqte Janskin me bisht të syrit, pastaj u zgërdhi dhe pyeti: “Bëhet fjalë për një emërim, shok? Është emërim?

“Po” u përgjigj Janski. “Po ju...nga e dini?”

“Ju nuk jeni as i pari, as i fundit... shok” sqaroi me vendosmëri shoferi duke u përpjekur të shfaqte buzëqeshjen e tij më dashamirëse. “Pra, ku... ku duhet t'ju çoj, shok? tha shoferi,

pastaj u bllokua. “A doni të shkoj brenda të marr gjërat tuaja?” pyeti ai duke bërë me dorë nga magazina.

“Jo, s’ka nevojë. I marr vetë gjërat e mia” tha Janski.

“Mbaje mend mirë” i tha shoferit, me një buzëqeshje të ngrohtë “mbaj gjithmonë lidhje të mira me kolegët, kur e lë vendin e punës, nuk është e thënë që të mos ju qëllojë t’i takoni përsëri, edhe nëse karriera juaj është në ngjitje. E dini si thuhet, shoku shofer: sillu me ndershmëri me atë që takon në ngjitje, sepse mund ta takosh përsëri, kur të zbresësh”.

Kështu doktor Hynek u bë profesor. Në mënyrë të rrufeshme dhe të papritur. Zyra e punës së tij ndodhej pikërisht në zonën përballë magazinës së karotave, trangujve dhe zarzavateve të ngrira, në të cilën kishte punuar. Hynek Janski kishte ndjesinë e papërcaktuar se, eprorët e vjetër të riintegruar, ndiheshin turpëruar nga institucioni i ri. Rruga për në akademi ishte e bukur, sidomos në pranverë. Çdo ditë Hynek zbriste nga tramvaji dhe kalonte pranë ndërtesës poshtë shkollës fillore, pastaj i binte përqark parkut të lojërave. Pasi kalonte shkollën kthehej majtas për nëntë minuta, me hap të vendosur, ecte përmes një terreni që në të kaluarën, duhej të kishte qenë kopsht, para se dikush u përpoq ta kthente në park. Në kryqëzimin tjetër, Janski, çdo ditë, kthehej majtas. Edhe dy minuta të tjerë dhe arrinte para ndërtesës së gjerë e mikpritëse të Akademisë.

Pra, doktor Janski u bë profesor. Lëndët që do të jepte ai ishin të ashtuquajturat teknika speciale të marrjes në pyetje suplementare. Ky institucion i ri nuk kishte fare të bënte me policinë. Për sa mund të dukej e çuditshme, askujt s’i kishte shkuar ndërmend të pyeste dhe askush nuk ishte informuar kurrë, nga kush apo nga cili organ varej academia. Jansky, pa mëdyshje, iu fut punës së tij të re me entuziazëm. Në leksionet e tij analizonte me detaje dhimbjet e shumëllojshme. Tregonte, përshkruante dhe karakterizonte të gjitha pjesët e trupit të njeriut, të gjitha skajet nervore, për të cilat

ishite ekspert, i njihte si një udhëtar i zakonshëm që i njehe stacionet, sallat e aeroportit dhe portet. Njihte përmendësh çdo pikë të trupit njerëzor që shërben si portë për të kaluar në shtegun e dhimbjes. Studentët, të caktuar për të ndjekur leksionet e tij, kryesisht ishin burra. Vinin nga institucionet shtetërore, vështirësisht të përcaktueshme, të cilat i kishin selitë në rrethina të qytetit, brenda vilave që nuk kishin as numër rruge duke tërhequr kështu, pa dashje, vëmendjen e postierëve dhe të kontrollorëve të gazit dhe të energjisë elektrike, tepër të ndërgjegjshëm.

Në fakt, nuk ekzistonin, siç nuk ekzistonin punëdhënësit e tyre dhe institucionet që drejtonin. Leksionet e doktor Janskit, me pasionin e tyre, trembnin ekspertët dhe frekuentuesit muskulozë, të cilët pyesnin thellë në zemrën e tyre – si ishte e mundur të masakrohet kështu shpirti njerëzor, për të mos folur për trupin duke imagjinuar çfarë do të ndodhte, po të gjendeshin në anën tjetër, në atë të gabuarën dhe të përfundonin në duart e Janskit. Nuk bëhej fjalë vetëm për shpulla e grushte, nuk bëhej fjalë për ndonjë brinjë të thyer, por për një shkencë të vërtetë. Vetëm për një gjë i vinte keq Janskit – të gjitha nocionet që kishte mësuar nga kolegët rusë dhe që i kishte zhvilluar me aq zell e talent, gjatë gjithë atyre viteve të kaluara mësimdhëniejeje në akademi, kurrë nuk ishin përmbledhur në një manual ose tekst universitar, pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura dhe këmbëngulëse. Nuk ia arriti qëllimit, megjithëse vazhdoi ta kërkonte edhe kur doli në pension, në vitin 1981. Kështu njohuritë dhe mençuria e tij mundën të përhapeshin vetëm në rrugë gojore, gjatë leksioneve të mbajtura në vende krejtësisht private. Si çdo mësues i mirë përpiquej t'u shpjegonte studentëve të vet, në çdo mënyrë të mundshme shkencën dhe artin e vet. Përpiquej që ata të kuptonin e të zhvillonin vetë njohuritë dhe aftësitë e fituara në akademi. Që studentët t'ia kalonin mësuesit të tyre; Çdo vit leksioni i parë fillonte në të njëjtën mënyrë: “Për çdo mënyrë që ka në dispozicion trupi ynë për të shkaktuar dhimbje – ka edhe

një që ngjall gëzim e kënaqësi. Kjo është baza e shkencës sonë, pikënisja jonë. Dhe mos harroni kurrë, miqtë e mi të dashur, se kemi, të paktën, tri herë për shumë për ta bërë të pyeturin të thotë ato që di dhe ato që ne duam të dëgjojmë”. Këtu ndalonte dhe, pas një pauze të matur mirë, shtonte: “Ushtrimi i parë: përshkruani ë gjitha mundësitë që trupi juaj ju jep për të provuar kënaqësi dhe dhimbje. Mbeten njëzet minuta deri në fund të leksionit. Shkruani, ju lutem. Në fund të orës do të mbledh fletët dhe do t’i vlerësoj”.

2.

Në pranverën e vitit 1981, inxhinier Jozef Çerni pati një vizitë nga një gazetar. Tashmë, ishte i treti për atë vit. Një djalosh nja njëzet e pesë vjeç që, me padurimin e një koneje, doli menjëherë në temë. Por Jozefi s’kishte kurrfarë dëshire për të folur dhe mbeti i pakënaqur nga mosinteresi i djaloshit për muzikën klasike, tek e cila Jozefi përpiquej ta devijonte bisedën, gjithë kohën. Djaloshi s’kishte interes për muzikën dhe as që u përpoq të simulonte një interes të tillë gjë që Jozefit do t’i ishte dukur e drejtë ta bënte dhe, për më tepër, atij ia kishte dhënë adresën e tij një organizatë, për të cilën ai s’kishte dëgjuar kurrë të flitej. Pastaj ai nuk pranoi të pinte as çaj, as kafe. A është e mundur të bëhet një bisedë dinjitoze me një person të panjohur në këtë mënyrë, mendoi Jozefi me vete, pa ditur të jepte përgjigje.

Gazetari donte të dinte vetëm për sjelljen e Janskit dhe, nga shprehja e tij dukej qartë se ai nuk e kuptonte, pse Jozefi nuk donte të fliste. Nuk dorëzohej, fliste për drejtësinë për kompensimin e abuzimeve me pushtetin. Çfarë mund të dinte nga drejtësia një djalë në moshën e tij, mendonte Jozefi duke rregulluar fletët mbi tavolinë. Dhe, papritur, bëri një pyetje që e habiti edhe atë vetë: “Ju jeni i dashuruar?” Gazetari pohoi me kokë duke u skuqur. Që pikërisht ajo skuqje që e bëri Jozefin të mos e nxirrte jashtë, siç kishte bërë me të tjerët para tij. Midis tyre nuk ishte asnjë që t’i

pëlqente muzika klasike e ngatërronin inxhinierinë statike me statistikën. Motive të mjaftueshme, mendonte Jozefi, për të mos u besuar atyre dhe të humbiste kohë kot me ta. Por, faqet e përflakura të gazetarit e shtynë t'u përgjigjej, megjithëse me kujdes, pyetjeve të kones.

Kështu, Jozefi filloi të fliste, teksa djaloshi bënte ca shkarravina të palexueshme në bllokun e mbështetur mbi kofshë, duke pulitur sytë. Kur Jozefi kishte mbaruar, djaloshi kërkoi një gotë ujë, të cilën e piu me një frymë dhe, pasi e falënderoi, u largua. Jozefi nuk mori vesh më asgjë për të. Pas disa javësh erdhi për vizitë Antonini me një insert gazete, në të cilin, së bashku me të tjerët kishte dalë edhe emri i Jozefit. Artikulli sillte edhe ato çka Jozefi i kishte treguar gazetarit. Jozefi e ruajti gazetën për në darkë, në momentin kur përgatiti kafën e tij të zgjatur dhe lexoi artikullin. Shkruanin që ishte krijuar një komision për të hetuar mbi gjithë çështjen dhe se ishte koha për...etj.

Në çdo frazë përfshihej fjala drejtësi, ose dënim, ose kompensim. Në fund të artikullit ishte përmendur adresa e organizatës, së cilës viktimat mund t'i drejtoheshin për të hedhur dritë mbi gjithçka. Jozefi mbeti në mëdyshje, nuk e kishte menduar kurrë veten si viktimë. Ai – një viktimë? Nuk i përshtatej as atij vetë, as profesionit të tij. Ishte ndjerë gjithmonë si dikush që i kishte ndodhur, të themi, një aksident, një aksident i pakëndshëm politik me pasoja të pakthyeshme, por kurrë s'kishte menduar se ishte viktimë.

U ul në tavolinën e vet, nxori nga sirtari një vizore rrethore llogaritjesh që ishte mburrja e tij – forma e saj e qetësonte gjithmonë – dhe bëri përsëri llogaritjet, të cilat, një ditë më parë, i dilnin mrekullisht. Edhe pasi i ribëri nga e para të gjitha llogaritjet, nuk arriti të ndihej viktimë. Po, një komision është duke hetuar, mendoi, dhe konsideroi se vijat e forcës së objektivit të tyre, mund të jenë ndërprerë, në një kënd të dhënë, me vektorin e aksidentit

politik që ai kishte pësuar. Edhe aksidentet rrugore me pasoja të pakthyeshme kanë nevojë për kohën e tyre, mendoi, por, gjithsesi, nuk arriti të ndihet viktimë dhe i erdhi keq për këtë.

Priti sa të kthehej gruaja e tij, Kveta, nga fshati, ia dha ta lexojë artikullin dhe e pyeti çfarë mendonte ajo. Nuk kishte asnjë mënyrë për ta bërë atë të shprehej në lidhje me artikullin – ishte e qartë se, gjithçka lidhej me burgosjen e tij, i shkaktonte dhimbje të skajshme. Jozefi e vuri artikullin në sirtarin e tavolinës dhe aty mbeti.

Atë vit Kveta vendosi se kishte ardhur koha të lyente apartamentin. Këtë radhë Jozefit nuk i erdhi keq, sepse kishte për ndihmë Maksimilianin, dhëndrin e tij të ardhshëm dhe, së bashku me të, Kveta dhe Alisa përgatitën shtëpinë për këtë ritual pa lidhje, këtë festë të lëvizshme të estetikës shtëpiake që i kishte rrënjët në kohët kur higjiena publike dhe private e qytetarëve ishte burim shqetësimi. Jozefi ia la Kvetës zgjedhjen e ngjyrave. I rezervoi vetes të drejtën të thoshte fjalën e vet vetëm për studion duke luftuar fuqishëm për ta lënë atë pa kurrfarë zbukurimesh. Pastaj gratë i nisën për në fshat dhe Jozefi mbeti në shtëpi me Maksimilianin.

U habit nga shpejtësia e punës së lyerjes, të cilën, deri tani, e kishte bërë gjithmonë vetëm me ndihmën e Kvetës dhe, në vend që të mbaronin të premtën në darkë, siç ishte parashikuar – mbaruan të enjten në mëngjes. U mbetej akoma dhe një ditë e lirë dhe do të pastronin gjithçka. Befas dhe papritur Jozefi mbeti vetëm në apartamentin me tavan të lartë; era e pigmenteve kimikë që vinte nga muret përzihej me atë të qytetit që hynte nga dritaret e hapura. Jozefi filloi, pothuajse pa e kuptuar, të shfletonte, ngadalë, dokumentet e vendosura në tavolinë – në dorë kishte artikullin që fliste mbi nevojën për të bërë drejtësi dhe për të kompensuar abuzimin me pushtetin.

Vendosi shpejt, pa mëdyshje. Urgjenca e vendimit tim, mendoi,

është proporcionale me mungesën e femrave. I vendosur, e futi artikullin në çantë doli, bleu tre sandviçë të furrës dhe u nis në adresën e komisionit. Atje i shpjeguan gjatë e gjerë parimet, sipas të cilave ishte ndërtuar komisioni dhe Jozefi zbuloi se, prej disa vitesh ishte hapur një praktikë mbi doktor Janskin. Punonjësi i shpjegoi, se tani, doktor Janski punonte në një magazinë në periferi të Pragës. Jozefi u habit shumë dhe vendosmëria e humbi forcën. Por tani s'mund të kthehej mbrapa, prandaj ai kërkoi të gjitha informacionet që mund t'i jepnin. Nuk ishin shumë, por punonjësi që e quajti, pikërisht, zoti inxhinier, e informoi se, ndoshta, brenda disa muajsh, dosja do të arrinte në gjykatë dhe e pyeti Jozefin, nëse donte të dëshmonte. Jozefi iu përgjigj se do të mendohej, atëherë nëpunësi i dha një fletë letre që kishte formën e një dokumentin zyrtar. Jozefi e futi në çantë dhe u largua.

Pas disa ditësh vendosi të dëshmonte, megjithëse kjo nuk i jepte ndonjë kënaqësi të veçantë dhe i dërgoi komisionit me rekomandë dokumentin me miratimin e tij. Kaluan disa muaj pa ndodhur asgjë. Më njëzet e një gusht të vitit 1968, tanket ruse pushtuan Çekosllovakinë, punonjësi emigroi dhe, duke kaluar përmes Gjermanisë Perëndimore, Kanada, SHBA, më në fund u stabilizua në Argjentinë. Në rrëmujë e sipër dokumentet humbën, komisioni u shkri dhe Hynek Janski, më në fund, mund të mos shqetësohej më për fatin e tij.

3.

Hyneku, herë pas here, priste vizita në magazinë nga ndonjë ish-epror. Shkonin e merrnin ndonjë gulash ose pinin kafe dhe flisnin për kohën. Biseda të këndshme që ngrohnin miqësitë e vjetra. Në kohën e njëres prej këtyre vizitave një koleg – që pasi kishte dalë në pension të parakohshëm, ishte kthyer në shërbim aktiv - i solli disa dosje të vjetra. Binte shi dhe ato ishin lagur. I vuri mbi karrigen pranë Hynekut dhe filloi të ankohej për motin, mbaroi

gulashin, i uroi lexim të mbarë dhe, para se të ndahej me të, i tha: “Po të isha në vendin tënd, nuk do t’i hidhja në plehra”. Gjithmonë ka qenë hokatar, mendoi Hyneku duke buzëqeshur lehtë dhe qëndroi në heshtje, mirënjohës e i lumtur që kishte akoma miq, tek të cilët mund të mbështetej. Në shtëpi Hyneku i preu spangot me një brisak dhe paketa prej letre të përdorur u hap para tij si një lule e pafajshme. Aty brenda ishte gjithë jeta e tij. Çertifikatat e liceut, një kopje e diplomës universitare. Gjykimet që kishin shkruar për të kolegët e tij të dashur. Ajo paketë përmbante të gjithë karrierën e tij dhe një sasi të madhe dosjesh dhe dëshmish, të cilat do të përbënin akuzën kundër tij. Ishin dokumente të mbledhura prej atij komisionit që donte ta çonte atë në gjykatë.

Hyneku i lexoi të gjitha me vëmendje, i seleksionoi, i nënvizoi. Disa të burgosur të cilët i kishte marrë në pyetje, as që i kujtonte, disa i sillte ndërmend vetëm pjesërisht dhe, papritur, i doli para syve një modul i formuluar me kujdes, me një kaligrafi të njohur, numra të stilizuar. Shkronjat e njohura mirë *e* dhe *a* dhe në fund firma: *Jozef Çerni, inxhinier ndërtimi*.

Hynek u ndje, thjesht, i fyer. Si ia ka lejuar vetes Jozefi ta bëjë këtë? Si ia ka lejuar vetes të më denoncojë? Si ishte e mundur? Nuk mund të kishte besim as tek miqtë e vjetër? Ai komision i çuditshëm, gazetarët, të gjithë duke llogotitur gjëra mbi të vërtetën dhe drejtësinë, ndërsa donin vetëm të hakmerreshin. Sikur nuk e dinin se nuk varej prej tij, qenë Çurçilli dhe Stalini që vendosën kush, ku do të jetonte dhe cilat do të ishin zonat e ndryshme të kontrollit, ku do të fillonin e do të mbaronin kufijtë e perandorisë.

Ai s’bënte gjë tjetër vetëm administronte gjeometrinë e pushtetit; këtë, Jozefi i dashur, inxhinieri i ndërtimit, duhet ta kishte kuptuar. Nuk e kuptonte Jozefi? Ai, që, megjithëse ishte pothuajse i tredhur, vazhdonte të jetonte me të, me Kvetën? Pikërisht ai ka përpiluar dhe firmosur modulën? Dëshiron të dijë të vërtetën? Epo, atëherë ja ku e ka! Ta gëzojë, ta gëlltisë, të mbytet me të vërtetën

e tij të shkërdhyer. Sikur nuk e dinte se në luftë dhe në dashuri gjithçka është e lejuar! Që jo vetëm në Perandorinë e njëmijte, por edhe në perandorinë e zemrës, ia del ai që është i aftë për një mobilizim absolut. Mobilizim absolut dhe forcë të pastër, pa terma gjysmake. Të pastër e të kulluar si ajri i maleve. Forcë absolute dhe dashuri absolute. Ja sepse e kam pasur timen për dhjetë vjet. Për dhjetë vjet e kam zotëruar mendjen dhe trupin e saj. Mendimet dhe shpirtin. Sytë jeshilë të errët dhe mitrën e saj. Sepse kam fituar betejën absolute për të arritur dashurinë e saj.

Dhe një fitimtar nuk pyet kurrë nëse e duan të humburit. Një fitimtar fiton dhe kaq – pa *nëse* e pa *por*. Sepse, i dashur Jozef, fitimtari është ai që fiton. Sa gjë e thjeshtë! Elementare! E kulluar! Fitimtari fiton llogoret dhe dashuritë. Fitimtari fiton. Ja, përse, për shumë vite të mrekullueshme Kveta ka qenë e imja. Prandaj erdhi tek unë, sepse është dashuria që dominon dhe fitimtar është ai që fiton.

Pastaj Hyneku vuri re se e kishte tepruar me mendimet e veta, edhe pse ishte e kuptueshme dhe vendosi të bënte diçka më praktike. Prandaj u ul para makinës së shkrimit dhe filloi. Letra përbëhej nga disa faqe, ishte voluminoze dhe disa shprehje teknike, linin të kuptohej se autori kishte punuar në administratë shtetërore dhe zotëronte, gjithashtu, edhe njëfarë kulture mjekësore. Frazat ishin të sakta dhe njëkuptimshme. Autori analizonte hollësisht marrëdhënien ndërmjet Kveta Çernit, bashkëshortes së inxhinier Jozef Çernit dhe hetuesit, me titull profesional komisar referent, doktor në drejtësi – Hynek Janski.

Letra tregonte kur kishte filluar lidhja ndërmjet Janskit dhe Çernës, sa kishte vazhduar dhe mbi çfarë bazohej. Më tej, nën titullin *Efikasiteti i dhimbjes*, ai sillte një listë klinike, precize të përkëdheljeve dhe të rrahjeve, ndaj të cilave trupi i Kveta Çernit kishte qenë i ndjeshëm. Lloje të ndryshme dhimbjesh dhe lloje të ndryshme kënaqësish. Motivet që e shtynin atë të vazhdonte

të vinte, edhe pasi burri i saj, Jozef Çerni, ishte liruar nga burgu. Ishte një përshkrim i përmbajtur, pa emocione. Doktor Janski ishte i kënaqur, nuk kishte shok të matej me të në përgatitjen e raporteve. Pastaj e rilexoi letrën dhe i erdhi keq që duhej të shkonte në postë vetëm për këtë.

Faturat ishin paguar dhe kartolinat ishin nisur. Në vendin e adresës së dërguesit shkroi emrin: *Kveta Černa*, një shaka vërtet argëtuese, mendoi. Dhe, kështu, kjo çështje përfundoi. Po, ndihej akoma pak zot, krijues hyjnor, një *spiritus agens*. Ai, akoma, duhej marrë në konsideratë. Një ndjesi kjo që i jepte ngrohtësi.

4.

Kur ra zilja, Jozefi ishte në shtëpi. Gruaja dhe vajza kishin shkuar në pazar. “Akoma” përsëriti me vete dhe nuk kuptonte, përse ai, me një naivitet të pafund mashkullor, mendonte se, tashmë, prej disa ditësh gjithçka e nevojshme ishte gati për martesën. Sikur blerjet për një martesë kishin fund, sikur çështja mund të arkivohej për të kaluar tek tjetra. Këtë herë duket se kishin shkuar për të kërkuar ca fjongo në magazinën e madhe – Dum Mody. “Fjongot” murmuriti prapë Jozefi. Ata kishin fjongo, përse të merrnin të tjera, ndoshta nuk e dinin se ngjyrat nuk janë tjetër veçse valë elektromanjetike? “Sasiore. Sa-si-o-re!” përsëriti me zë të lartë. Por as që e kishte provuar t’ua shpjegonte atyre. I njihte ai, vetëm do të kishin qeshur me të. Një e qeshur babaxhane. Mos na lodh me argumente teknikë, babi, por na thuaj cilën ngjyrë parapëlqen do t’i kishte thënë e bija, pastaj së bashku me Kvetën, do të kishin diskutuar për shijen e tij të dyshimtë për ngjyrat. Sikur nuk e dinte. Po si jo!

Alisa i ngjan Kvetës çdo ditë e më shumë, tha me vete. Natyrisht martesë është një moment... por gjithë këto gjërat e tjera ekstra? Megjithatë kanë lulëzuar. Të dyja kanë lulëzuar. Pa dyshim, mendoi. Nuk mund të mohohej. Gruaja dhe vajza e tij janë çelur.

I kishin blerë edhe atij, për çudi, një kuti me puro kubaneze të shtrenjta, shumë të shtrenjta, dhe shumë të mira. Dhe i kishin thënë të dyja që duhej të ruante një, vetëm një për ta ndezur në banket, pas fjalës që do të mbante si babai i nuses. Ishin puro, vërtet, të shtrenjta, dymbëdhjetë copë në një kuti druri. Tani i kishin mbetur dhjetë, por kishin mbetur vetëm dy javë nga dasma... kështu që nuk rrezikonte të mos i mjaftonin. Gjithsesi, Jozefi kurrë s'kishte pirë shumë duhan. Vetëm nganjëherë dhe vetëm, në mënyrë që ta shijonte me të vërtetë. Nuk kishte gjë më të bukur se të pinte cigare në shoqërinë e një muzike të bukur. Diçka për ta shijuar. Parapëlqente me Tondën që dinte të dëgjonte edhe duke qëndruar në këmbë. Dhe dinte të vlerësonte.

Jozefi vështroi kutinë me dhjetë puro dhe vendosi të ftonë Tondën. Ai do të sillte konjak dhe do të kishin pirë nga dy puro duke dëgjuar, natyrisht, kuartetin për harqe në fa maxhior të Dvorzhakut. Atë që e kishte kompozuar përtej oqeanit. Sidomos kohën e tretë që ishte aq e bukur.

Jozefit iu desh të firmoste akoma, për herë të dytë, para se të merrte letrën nga postieri, një vijë më lart, sepse, gabimisht, kishte firmosur në vend të një tjetri. Ishte akoma i rrëmbyer nga koha e tretë e kuartetit të Dvorzhakut dhe, mbi të gjitha nuk pushonte së kërkuari me mend ritmin e tij, për të cilin nuk ishte i sigurt.

Një melodi, sidomos atë melodi, ishte e lehtë ta mbaje mend, por ritmi është tjetër gjë. Ritmi, ritmi është vepër e Zotit, ka thënë një dirigjent orkestre, u kujtua, pastaj ngriti letrën para syve dhe pushoi së kënduari me vete. Dërguesi ishte Kveta. Mbeti i habitur, madje, për një çast, edhe i shqetësuar. Në pjesën e pasme të zarfit ishte vënë emri i saj si dërguese, por shkrimi nuk ishte i saj, dukej qartë që në shikimin e parë. Mori një prerëse letrash të gjatë, të mprehtë e të hollë nga tavolina e tij dhe e preu zarfin. Filloi të lexonte duke u spostuar, herë pas here, gjysmë hapi sa nga njëra anë në tjetrën. U kollit disa herë, bëri të lëvizte, përsëri, një këmbë

përpara, por nuk e hodhi dot hapin. Kur mbaroi së lexuari vuri re që grykën e kishte të thatë, si me rërë.

Dy gjëra u bënë, shumë shpejt, të qarta. E para: diçka brenda tij ishte këputur, si susta e një sahati kulle. Diçka kishte marrë fund. E dyta: për gjithë jetën nuk kishte kuptuar asgjë nga gruaja e tij, as një thërrime.

Pasi e lexoi, e vuri përsëri letrën në zarf dhe e futi në xhep. Ishte e vërtetë...? Po, nëse ishte e vërtetë, çfarë të bënte? Si mund të sillesh në një situatë të tillë? Kishte në kokë një stacion pa shkëmbim. Provoi ndjesi mjegullnaje dhe tronditjeje, derisa u shfaq një mendim i vetëm: i tronditur vërtet, por nuk duhet të bie në panik! S'kishte shumë kuptim, por Jozefi vazhdoi ta përsëriste.

Brenda tij ndodhën, me shpejtësi, tipe të ndryshëm dëshpërimi, ndjenja xhelozie dhe shkatërrim absolut, derisa, papritur, ndjeu në gojë një shije djathi të kripur. Pa panik, qortonte veten disa herë, por as kjo nuk e ndihmoi, siç që e pavlerë përpjekja për ta mbajtur kokën të qartë. Çfarë të bësh në këtë situatë, tha me vete, nëse zbulon se je i tradhtuar dhe se gruaja jote është një putanë! Dhe nuk ishte vetëm kjo. Me kë? Me kë është bërë putanë? Gëlltiti shijen e djathit të kripur dhe kafshoi buzët. Filloi të ndihet... i tronditur po, por jo i pushtuar nga paniku! Ndoshta ishte një denoncim i gënjeshtërt, një nga të shumtit, kjo është një traditë që e kemi në gjak. Sigurisht, së pari, duhet testuar terreni, duhet përcaktuar lloji i nëntokës dhe në çfarë thellësie akulli e ka hedhur themelin, po të jetë e mundur, të sigurohet që kjo akuzë shpifëse bazohet në prova, kjo e bllokonte mendjen e Jozefit bashkë me një seri tjetër mendimesh, të cilat përpiquej t'i mbyste me tërë forcën, mendime dhe çdo gjë tjetër që mund t'i ngjante, qoftë edhe larg, një ndjenje.

Që ndjenjat ishin vdekje dhe mendimet – jeta e martesës së tij, për fat të keq, tashmë, ishte e qartë si dielli. Çdo ndjenjë ishte si një peshk i vdekur, i helmuar, i zënë në rrjetën e shqyer të mendimeve që, në mënyrë të dhimbshme e të ngathët, përpiqeshin akoma të

shpëtonin të shpëtueshmen. Edhe dhoma e tij e preferuar, papritur, u ngjye në gjak. Edhe tavolina e punës e fortë që nuk i mungonte qëndrueshmëria, që poshtë qerpikëve gjysmë të mbyllur, u përthye në hapësirë, papritur, si një altar, mbi të cilin, herët a vonë, do të masakrohej një dhi anonime. Sigurisht vazhdonte, nëse kjo ishte ... e vërteta e pamëshirshme, ajo dhi ose kafsha e flijuar, do të isha unë dhe gjaku do të mbulonte muret.

Mendja e Jozefit nuk dukej gati për ta përballuar pritjen. Me një shpejtësi acaruese, ana e tij teknike filloi të mbizotërojë dhe mendja, pra jo ai, u përpoq të llogariste sa larg do të kishte spërkatur gjaku i dhisë, ose i tij, nëse, pikërisht në atë çast, do të pritej vena e qafës. Duke mos pasur kurrfarë njohurish nga fiziologjia dhe mjekësia, mendjes së tij iu desh të kryente veprime aritmetike relativisht komplekse dhe të vendoste cilat formula të përdorte për llogaritje. Njëfarë mungese përqendrimi e bënte llogaritjen akoma më të vështirë. Zemra është një pompë. Numri i litrave të gjakut – nga katër deri në gjashtë. Viskoziteti, fërkimi në vena, në arterie, në kapilarë. Densiteti i lëngut. Forca e pompës. Diametri i vrimës. Po, nuk ishte dhe kaq e vështirë, teksa jo ai, por mendja e tij, arrinte në një konkluzion përfundimtar; filloi, dalëngadalë, të largohej disa hapa nga tavolina e tij e përhershme, sepse, siç dukej, po të pritej në fyt në atë çast – gjaku, me siguri, do të njolloste muret e sapolyera. Edhe mund t'i vriste, njërin ose tjetrën, ky mendim shpëtimtar sikur e qetësoi pak.

Para se të zhदारaritej ky mendim, e kuptoi qartësisht se kurrë nuk do kishte qenë i aftë të vriste, përvoja që kishte nga vetja – nuk linte dyshime, për fat të keq. Po më plas truri, tha me vete, dhe mendimet nuk më dëgjojnë. Në çast kuptoi se nuk mund ta priste Kvetën në shtëpi, duhej të largohej nga shtëpia! Nxori nga xhepi zarfin. E lexoi edhe një herë letrën, e vuri mbi tavolinë, kërkoi në një sirtar çelësat-rezervë të shtëpisë në fshat, në Lhotka, i mori dhe iku.

5.

Alisa nuk e mori vesh kurrë, përse atë ditë, ndërsa përgatiste detajet e fundit të fustanit të nusërisë, pasi kishin blerë fjongot e verdha në ngjyrë mjalti, nëna e saj ishte mbyllur në studion e babait dhe kishte filluar të qante; nga natyra e rrudhave të saj ishte e qartë se nuk ishte martesë shkaku i atyre lotëve. Jozefi e kishte lënë letrën mbi tavolinën e tij të punës dhe Kveta, në fillim, s’kishte ndërmend ta lexonte. E kishte ngritur për të rregulluar e për të marrë pluhurat. Bënte kështu gjithmonë, kur ishte nervoze dhe, tani, para dasmës së Alisë, vazhdimisht ndihej e shqetësuar.

Fakti që ishte letër-rekomandë, e bënte të binte në sy, me ngjyrën e saj, në ngjyrën kafe të këndshme të tavolinës, mbi të cilën ishte vendosur. Të marrësh e të lexosh një fletë letër, në fund të fundit, nuk është ndonjë gjë e çuditshme, gjykoi Kveta në ata fragmente sekonde që e ndanin jetë e saj të lumtur nga ndjesia e shkretimit dhe shkatërrimit që, tashmë, priteshin. Kur mori vesh përmbajtjen e letrës që e kishte lexuar Jozefi, filloi të qante me dënësë. Kveta nuk e lexoi deri në fund, nuk ishte e nevojshme, gjithçka aty ishte e vërtetë.

E mori letrën e futi përsëri në zarf, shkoi në banjë, e grisi në copëza shumë të vogla, e hodhi dhe lëshoi ujin përsipër. U kthye në dhomë, u ul në karrigen pranë tavolinës së punës së burrit të saj, kontrolloi të gjithë sirtarët, por nuk gjeti asgjë, përveç ndonjë vizoreje dhe disa libra profesionalë. Kompetenca e tij gjithmonë e kishte bërë krenare. Atë krenari e ndiente akoma. Tani nuk ngashërente më, e dinte që s’i mbetej gjë tjetër, veçse të priste të shoqin. Duhej vetëm të rrinte ulur e të priste. Asgjë tjetër s’kishte kuptim.

Alisa e kuptoi se nënës së saj i kishte ndodhur diçka. Që babai nuk ishte në shtëpi – kjo nuk e shqetësonte, por që nëna të rrinte ulur në studio me sytë të fryrë nga dënesat – nuk paralajmëronte asgjë të mirë. Nga sa mbante mend Alisa, pak herë kishte ndodhur

që nëna të ulej në karrigen e babait në studio, e bënte vetëm kur ishte e inatosur me të. Kurse tani, të krijohej ndjesia që ajo kishte frikë. Kur iu afrua për të parë si ishte, ajo i tha: “Më lër rehat, jam mirë, vetëm se më duhet të pres që të kthehet yt atë, bija ime”.

Bie erë telashesh, mendoj Alisa, por nuk mund t’i kushtonte kohë më së ëmës, sepse pas një ore, Maksim do të kishte arritur në stacion, prandaj nuk ishte e sigurt që të arrinte në kohë. E puthi nënën në faqe. I kishte sytë të fryrë dhe përpiquej të shtirej sikur gjithçka shkonte mirë. Alisa i hodhi një sy dhomës, për siguri, por nuk pa asgjë të veçantë. Veshi dekoltenë e re dhe iku me vrap të merrte Maksimilianin në stacion; duke dalë i tha mamasë, me zë të lartë, se ndoshta do të rrinte tek ai atë natë dhe shtoi se ai s’e kishte parë akoma dekoltenë e re dhe kushedi a do ta vinte re, megjithëse në Gjermani, me siguri, do të kishte parë akoma më të bukura. Dhe iku.

Në mbrëmje Jozefi u kthye. E vetmja llambë e ndezur ishte ajo e tavolinës së tij të punës. Hyri dhe e gjeti Kvetën të ulur aty duke lëvizur lart e poshtë kursorin e njëres nga vizoret e tij llogaritëse. E pa të kruspullosur në karrige, gjithë frikë. E pa frikën e saj dhe iu kujtua që e kishte lënë letrën mbi tavolinë. S’kishte nevojë ta pyesje. I tha: “Kveta? Kveta?” dhe e vështroi në sy.

“Nuk duhej ta merrje vesh kurrë, megjithëse ... megjithëse e kam bërë për ty” tha Kveta dhe vuri re, menjëherë, edhe pse, gjatë orëve të kaluara, kishte formuluar e riformuluar, frazë pas fraze, ato që duhej t’i thoshte, kishte sajuar diçka që të ngjallte mëshirë.

“Do të shkoj në fshat, Kveta, do të rri atje, thuaja ti Alisë, të lutem” i tha Jozefi, pastaj mori çantën që e merrte çdo ditë në punë dhe doli. Atë natë, Kveta nuk mbylli sy. Fragmentet e pagjumësisë së saj kokëfortë i jepnin pauza të rrufeshme nga ankthet që fluturonin mbi të duke i lënë, në zgjim, imazhe të maktheve të gjata e të qarta, të shpyllëzuara që ndanin dhimbjen nga vrasja e ndërgjegjes.

Kur ndjeu çelësin në bravë dhe ritmin e këmbëve të vajzës së saj, mori frymë disi lirisht dhe u kujtua, turbull, se kishte parë një ëndërr të çuditshme e të pakëndshme, prej së cilës u zgjua me mirënjohje. Kishte parë në ëndërr sikur i shoqi e kishte lënë, që kishte ikur përgjithmonë e dhimbja që kishte ndier në ëndërr e kishte çarë më dysh. Boshllëku që kishte ndier e kishte zgjuar. Sapo u zgjua, ndjeu nevojën për ta ndarë me burrin e saj atë ëndërr të pazakontë, por kjo nuk zgjati shumë. Para se balli i saj të mbushej me sumbulla djerse, e kuptoi që nuk bëhej fjalë për një ankth. Kur Alisa, bashkë me paninet për mëngjes, me qumështin dhe gazetë, solli çelësat e babait që i kishte gjetur në kutinë postare dhe e pyeti përse i kishte lënë aty, muri i ankthit u shemb dhe Kveta filloi të bërtiste, të rënkonte e të qante. Ajo që përpiquej akoma ta quante një ëndërr – ishte realitet.

Alisa e përqafoi duke e mbajtur të mos binte nga karrigia. Por ankthi kishte një forcë shkatërruese dhe që nga ai moment e në vazhdim, pa e lënë fare të qetësohej, filloi t’ia shkatërronte shpirtin dhe mendjen. Pasi u qetësua ngashërimi i nënës, Alisa e çoi në dhomën e gjumit dhe i telefonoi Maksimilianit që t’i tregonte çfarë kishte ndodhur dhe t’i lutej të vinte. Por edhe Maksi, kur, më në fund arriti, nuk mundi të bënte asgjë, përveç se të përqafonte Alisën, herë pas here, me nervozizëm. Nëna u përmend për disa minuta, u afrua e shastisur tek dera e dhomës së gjumit dhe tha: “Babai yt më ka braktisur. Më ka braktisur, por nuk duhet të zemëroresh me të. Më ka lënë mua, jo ty, bija ime”. Pastaj u kthye përsëri në dhomë dhe vazhdoi të qante.

Që nga ajo ditë burri i saj filloi të jetonte në shtëpinë që kishin në fshatin Lhotka. Kur e pyesnin, thoshte se kishte vendosur të bënte një riparim të përgjithshëm të shtëpisë, që ta kishte për të jetuar aty gjatë pensionit; filloi, me të vërtetë, ca punë ndërtimi. Po ta pyesnin çfarë mendimi kishte Kveta lidhur me këtë, ai, thjesht, e shmange përgjigjen. I mori të gjitha gjërat e tij nga shtëpia, në

kohën kur ishte i sigurt se nuk do ta takonte Kvetën. Pas ca kohësh miqtë e të afërmit nuk e pyesnin më dhe u mësuan me faktin që secili bënte jetën e vet. Fakti që duhej të udhëtonte çdo ditë dy orë me tren, vajtje-ardhje, për të shkuar në zyrë, ishte puna e tij – kështu i përgjigjej Alisë që përpiqej të rregullonte situatën. Por, gjithsesi, edhe ajo, me kalimin e kohës, u mësua.

11. Vegimi i dytë mbi pavdekësinë

Pa e thënë askush asnjëherë, pa e shpallur ose shprehur në ndonjë mënyrë, fillimisht në qendër, pastaj në gjithë qytetin, u përhap lajmi që instalimi në kullë kishte nevojë për një riparim. Dhe ndodhi që, kur kjo bindje, e cila deri në atë moment kishte mbetur e mbështjellë në kashtën e harresës dhe të pasigurisë, arriti deri tek ne – të gjithë, pak a shumë, e kuptuam, me kundërshti e pakënaqësi, se askush nuk e kishte marrë vesh kurrë, për çfarë shërbente ai instalim. As unë vetë nuk e dija, megjithëse i detyrohej një stërgjyshit tim riparimi i tij gjatë restaurimit të fundit të bashkisë dhe të kullës së kryesore.

Situata arriti në atë pikë, saqë këshilltarët duke u ndier të detyruar – asnjëri nuk e dinte tamam prej kujt, ndoshta nga një ndjesi e papërcaktuar përgjegjësie - vendosën të lëvrojnë fonde për riparimin e instalimit. Lajmi më erdhi nga burime të ndryshme, pastaj mora një ftesë të tërthortë për të marrë pjesë në riparimin e atij instalimi të kullës. Gjithsesi, mbetej problemi: pavarësisht nga vizatimet dhe projektet e vjetra, duke përfshirë edhe fletoren me llogaritjet matematikore, diskutime të ndryshme për materialet që duheshin përdorur dhe kostot, pasi ishin studiuar të gjitha certifikatat, dokumentet dhe skicat që ekzistonin – vazhdonim të mos kuptonim për çfarë shërbente ai instalim në kullë.

Më në fund, këshilltarët dhe punonjësit e bashkisë menduan të organizonin një konkurs publik. E emërtuan *Hedhja e rrjetit* dhe midis synimeve të tij ishte edhe të verifikonin, nëse gjendej ndonjë person që e mbante mend funksionimin e instalimit. Gjithsesi,

ndiheshin disi të turpëruar nga padija e tyre, sepse të gjithë e dinin se instalimi i kullës ishte krenaria e të parëve tanë dhe, në të kaluarën, vinin për ta parë nga gjithë kontinenti. Para bashkisë qëndronin grupe turistësh, të cilët, me instrumente optikë të kohës, akoma jo të përsosur, kapnin imazhin e jashtëm të tij.

Në ato kohëra, akoma nuk ishte e mundur të regjistroheshin tingulli dhe imazhet njëkohësisht; edhe nëse arrinin ndonjëherë, imazhet dilnin të sheshta, nuk ekzistonte, atëherë, riprodhimi tredimensional. Pastaj uleshin dhe e shikonin nga larg ato imazhe të sheshta, pa mundur të hynin, ose të merrnin pjesë, në ndonjë mënyrë, në veprimtarinë që zhvillohej. Për çudi, kjo nuk u dukej as e mërzitshme.

Historiani Vilem, me të cilin u njoha gjatë restaurimit të instalimit, më shpjegoi se në atë kohë njerëzit njerëzit takoheshin dhe i mbanin ato imazhe të sheshta brenda librave specialë, të cilët i shkëmbenin midis tyre. Kur takoheshin miqtë me njëri tjetrin, i shfletonin ato libra duke e shoqëruar vizionin me një shpjegim. Imazhet paraqisnin, zakonisht, familjen ose miqtë dhe vendet që vizitonin. Mendohet që rreth këtij zakoni ishte zhvilluar një etiketë e ndërlikuar dhe komplekse që vetëm pak specialistë arrijnë ta kuptojnë atë sot.

Pas shumë mbledhjesh të gjata, më në fund, u vendos që instalimi të riparohet, megjithëse nuk ia njihnin funksionin. Së bashku me mjeshttrin Matias më vunë në krye të Komitetit për restaurimin e instalimit. Duhej të vazhdonim punën për rikonstruksionin e tij dhe për një restaurim të përgjithshëm. Na kishte emëruar këshilli bashkiak dhe mendoj që mund të them me sinqeritet se emërimi i të dyve u prit pozitivisht nga qytetarët. Vendosiëm së pari, të mblidhnim të gjithë dokumentet që kishin të bënin me instalimin në një dhomë të bashkisë, që anëtarët e këshillit na e kishin caktuar. Sot që instalimi është në funksion prej shumë vjetësh, është e thjeshtë të qeshësh për fillimet tona dhe janë të trasha e denigruese

banalitetet – si humbim në kohë kot duke mbledhur dokumentet, teksa askujt prej nesh, anëtarëve të komisionit dhe guxoj, të them, asnjë qytetari, nuk i kishte shkuar ndërmend të ngjitej ndonjë kat më lart, përmes urës lidhëse dhe të shkonte të këqyrte në kullë, për të parë me sy si ishte bërë ai instalim. Mjeshtri Matias mendoj ta rishikonte historinë, të cilën në qytet e njohin edhe fëmijët, e zhvilluar dyqind vjet më parë.

Në atë kohë ishte ftuar në qytet një kompozitor i famshëm, që krijoi një opera magjepsëse, interpretimi i së cilës u prit me një entuziazëm të habitshëm. Si mirënjohje speciale, atij iu lejua një vizitë në kullë me turin shtesë të mekanizmit. Ky artist i famshëm thoshte, më vonë, në kujtimet e tij, se kurrë në jetën e tij, s'kishte parë diçka aq të përsosur, të bukur dhe, njëkohësisht, mizore. Siç e dinë të gjithë tani, vepra e tij *Sonatë kushtuar Instalimit të drejtësisë dhe progresit* u bë pastaj, joformalisht, himni i qytetit tonë. Kompozitori, për të cilin po flas dhe që e njihni të gjithë, është Lepoldi XVI. Por fakti që as në dokumentet lidhur me vizitën e tij në instalim, nuk është shpjeguar për çfarë shërbente ai. Ndoshta në atë kohë e dinin të gjithë ose përpikëshin, në njëfarë mënyre, të fshihnin padijen e tyre.

Pas një analize të kujdesshme të, ajo që na ndihmoi më shumë, papritur, ishin informacionet e tipit financiar. Njëri prej historianëve, pasi kishte shqyrtuar të gjitha faturat që ne kishim në dispozicion, për habinë tonë të madhe, arriti në përfundimin se, një restaurim vetëm i pjesshëm i instalimit, ai që u bë nga paraardhësi im njëqind e pesëdhjetë vjet më parë, kishte kushtuar më shumë se rikonstruksioni i kanalizimeve pas tërmetit të shtatëmbëdhjetë, të paharrueshëm dhe shtrirjes së rrjetit interplanetar 28-9 të marra së bashku. Kjo dëshmon, pa dyshim, se për paraardhësit tanë instalimi i kullës ishte një gjë e pazëvendësueshme, por ne vazhdonim të mos kuptonim domethënien dhe qëllimin. Rrëmonim në errësirë.

Gjithsesi, sado e çuditshme mund të duket, ne nuk i jepnim shumë rëndësi. Ishte e qartë që, sapo hyje në njërën nga birraritë mikpritëse të qytetit tonë, gjendej dikush që hetonte mbi zhvillimet e riparimit të instalimit. Informacionet që kishim arritur të mblidhnim ishin kontradiktore. Çdo lajm ishte krejt i papajtueshëm me të tjerët. Dukej se disa e hidhnin fjalën sikur instalimi shërbente për të paraqitur shpirtin njerëzor. Të tjera informacione supozonin se riprodhonte natyrën autentike të individëve, të familjeve dhe të gjithë qytetit ose shoqërisë. Këtij varianti i kundërviheshin teori që mund të përcaktoheshin fizike; sipas tyre instalimi ishte ndërtuar në mënyrë origjinale, nga astronomët për të vëzhguar thellësitë më të lashta të universit dhe të kohës. Sipas ca dokumenteve të tjera, instalimi kishte të bënte me formulimin e parimeve të drejtësisë, të filozofisë, të së drejtës e të vdekjes. Të gjitha referimet të bënin të mendoje që, për njëfarë periudhe, ai kishte qenë i krahasueshëm me një qenie të gjallë që ndërhynte në prirjen e qytetit. Lajmet dhe informacionet e mbledhura kishin mospërputhje.

Vendosëm që do ta bënim eksplorimin e instalimit në fshehtësi dhe se kjo do të ndodhte gjatë javës të veprimtarive sportive, të cilat, si gjithmonë, do të tërhiqnin vëmendjen e shumicës së banorëve të qytetit. Në mes të javës ishte parashikuar një ndeshje vendimtare midis skuadrës sonë dhe të asaj të qytetit fqinj. E fiksuam zbulimin, pikërisht, për atë pasdite.

Morëm me vete një aparat regjistrimi dhe shpirtin plot guxim e shpresë. U ngjitëm në katin e dytë të bashkisë. Përshkuam një korridor të gjatë e të ngushtë, ku shfaqeshin portrete të pikturuara me dorë, të Etërve të qytetit. Ishin aty para rikonstruksionit të fundit të instalimit. Duke ecur, mendova instinktivisht se, para më shumë se njëqind vjetësh, edhe paraardhësi im duhet të kishte kaluar andej. Me siguri, edhe ai e kishte parë vargun e portreteve, ata njerëz me vështrim të ngrysur, me veshje të errëta. Pikturat ishin, me të vërtetë, të vjetra, sepse s'kishte asnjë portret gruaje,

por instalimi, siç e dinin të gjithë, ishte shumë më i vjetër.

Pastaj, arritëm në fund të korridorit. Hapëm derën, ngjitëm disa shkallë dhe u gjendëm para një dere tjetër, përmes së cilës arrihej tek instalimi. Është e kotë të thuash, sa nervozë ishim. Mjeshtri Matias dhe asistenti i tij nxorën nga valixhja disa objekte të rëndë metalikë, të cilët do të shërbenin për hapjen e derës. Ne të tjerët nuk kuptonim shumë nga ai sistem i ndërlikuar i hapjes; vetëm vështronim, sikur të bëhej fjalë për një spektakël kërcimi ose për një veprimtari sportive. Ishte interesante si rrotulloheshin ato objekte metalike duke prodhuar një tingull shumë të lartë. Dhe, befas, kur po fillonim të dyshonim që mjeshtri Matias dhe asistenti i tij i kishin mbivlerësuar forcat e tyre, dera u hap.

Hymë dhe u gjendëm në një sallë me tavan të harkuar. Mjeshtri Matias më preku dorën dhe, duke treguar lart, tha: “Është një tavan-qemer”. Nuk dija çfarë t’i thosha dhe, për një çast, hezitova. Nën shkallaret që të çonin në kullë, mbi një pedestal guri, ndodhej një statujë që paraqiste një njeri me kokë shqiponje dhe pendë. I kishte krahët të hapur sikur donte të na përqafonte. Sytë e mbuluar me një fashë. Futurizëm, mendova, kishin një vështrim largpamës dhe të pastër, meqenëse akoma nuk kishin kurrfarë njohurie mbi artet plastike gjenetike bashkëkohore.

Një studim i mëtejshëm i statujës nga historiania Eleonora, zbuloi, pjesërisht, domethënien e saj; vetëm se Eleonora vuri re se, kur dolëm nga kulla, krahët me pupla të statujës ishin në një pozicion tjetër krahasuar me momentin kur hymë; kështu na bëri ta vëmë re edhe ne të tjerët – vëzhgues më të dobët. Kjo u përsërit edhe ditët e tjera. Nganjëherë statuja i kishte buzët të zgjatura si në buzëqeshje, nganjëherë shprehja e saj ishte e zhgënjyer, ose kafshonte buzët.

Meqenëse, pas një ekzaminimi të hollësishëm, nuk u gjet në statujë ndonjë mekanizëm i fshehur – ishte një derdhje kompakte bronzi – i konsideruam ndryshimet në formë e në shprehje të

statujës si një prej shumë mistereve të instalimit dhe të gjithçkaje që lidhej me të. Eleonora gjeti në arkiva një shënim, ku thuhej se dikur kulla e bashkisë ishte quajtur Kulla e Shqiponjës. Një nga emrat më antikë të instalimit ishte pikërisht, instalimi i shqiponjës. Studiuesit debatuan mbi origjinën e këtij emërtimi. Shpjegimi më bindës është ai që supozon se në terrin e antikitetit, në këtë vend, ishte vendosur një pjesë e një fortifikimi, ndoshta një kështjellë, e quajtur Çerdhja e Shqiponjës, prej kësaj erdhi emri Kulla e Shqiponjës. Etimologjia, e cila është një shkencë ose art që ka të bëjë me origjinën e emrave, në këtë rast, ecën kuturu.

Në një transkriptim, instalimi është përcaktuar *orli stroiii*. Tani e kuptonim, përse statuja njeriu-shqiponjë ishte i rëndësishëm – ishte simbol i origjinale Kulla e Shqiponjës dhe i instalimit të shqiponjës. Të parët tanë e kishin farkëtuar si mbrojtës simbolik. Gjatë një studimi të mëtejshëm, historiania Eleonora na tha se i kishte qëlluar të gjente një emër që, ndoshta, ishte akoma më antik sesa *orlostroj*, pra *orlojiv*. Për askënd prej nesh kjo nuk kishte ndonjë domethënie. Kronikat historike nuk na hynë në punë. Ndoshta bëhet fjalë për një interpretim të gabuar të fjalëve, kushedi. Gjithsesi, vendosëm të mos e përdorim fjalën *orloj*, meqenëse nuk ishte e qartë për çfarë bëhej fjalë, ose cilin objekt përcaktonte. Ashtu siç nuk dimë cili është funksioni i asaj gjëje që quhej – *orloj*. Hipoteza më e mundshme ishte se bëhej fjalë për një gabim të bërë gjatë transkriptimit nga një dokument në tjetrin, duhet të ishte kjo arsyeja e atij emri të çuditshëm, ndoshta të gabuar – *orloj*.

Ndezëm dritat dhe pamë disa afreske me ngjyra të mbytura dhe ndonjë stol përgjatë mureve. Nga mbrapa ishin shkallët që të çonin në kullë. Mjeshtri Matias u ngjiti i pari, i ndjekur nga asistenti i tij – unë isha i tretë. Filluam të ngjitemi. Pas disa minutash, duke na u marrë pak fryma, arritëm tek një derë tjetër. Mjeshtri Matias futi përsëri instrumentet e veta në vrimën e derës dhe ajo u hap. Hymë.

U gjendëm në një sallë të madhe në formë katrore, e cila zinte të gjithë planimetrinë e kullës. Kishim arritur në destinacion. Në mes të sallës ishin disa tavolina të bashkuara. Sipër ishin vendosur arka të ndryshme druri me përmasa të ndryshme. Mbi disa prej tyre ishin pikturuar skena, tashmë – të venitura. Të tjerat ishin veshur me metal e dru të tipave të ndryshëm.

Ishin, pak a shumë gjashtëdhjetë arka, nga njëzet të mëdha, pesë mesatare dhe të tjerat – të vogla. Çdo arkë ishte e pajisur me një vrimë për dry dhe, pas një çasti mëdyshjeje, mjeshtri Matias dhe ndihmësi i tij filluan të hapnin me mjetet e tyre arkat njëra pas tjetrës. Sapo arritën të hapnin të parën, të gjithë u mblodhëm përreth dhe ngritëm kapakun. Brenda, i mbështjellë me diçka si lëkurë, ishte një pajisje metalike, ndërsa në të dytën, gjetëm një pasqyrë, në një tjetër vizatime dhe libra, në një tjetër- një përshpejtues dhe një ngadalësues pjesëzash elementare.

Kështu, kuptuam se instalimi ishte çmontuar dhe vendosur në arka. Pasi i hapëm të gjitha, filluam t'i shqyrtojmë materialet dhe i kataloguam të gjitha. Dy arka të mëdha ishin me dokumente. Menduam se ishin instruksione për të montuar makinën, por nuk ishim të sigurt, sepse, pothuaj të gjitha librat, ishin shkruar në njërën prej gjuhëve që eruditët flisnin në të kaluarën, ndoshta në ndonjë dialekt. Në një kuti të vogël gjetëm shënime të shkruara nga paraardhësi im. Kur m'i treguan kolegët e mi, nuk arrita ta përmbaja njëfarë emocioni. Disa libra dhe disa vizatime ishin infektuar nga myku dhe u copëzuan; kështu nuk do të mjaftonte ta mblidhnim instalimin – do të na duhej, pjesërisht, ta rikrijonim atë. Shpresonim që, dalëngadalë, duke e rindërtuar, do të zbulonim edhe kuptimin e tij. Eelonora restauroi një nga tekstet që na u duk se kishte rëndësi qendrore:

“Teoria e vitalizmit ose teoria e forcës vitale, afro tre shekuj më parë, u frenua dhe u çmontua plotësisht, por studimet e reja mbi vetëdijen njerëzore u kombinuan, papritur, me nocionet e asaj

shkence që e quajmë mekanikë kuantike, e cila, nga ana e saj, u lidh, në mënyrë të papritur e të befasishme, me hulumtimet bindëse të teologjisë. Kështu, gradualisht, shkenca e Zotit u kombinua me shkencën e lindjes së universit dhe studimet mbi mendjen njerëzore e shpirtin njerëzor. Është e gjithë kjo që, sot, na lejon ta ndërtojmë këtë instalim. Një instalim i një fuqie të pamatshme, i cili mbështet dhe përbën ekzistencën tonë, atë të individit si atë të Shtetit dhe të Perandorisë në të gjitha parimet e tyre.

Parimi antropik, pra ideja që ne e shohim universin, tamam, ashtu siç është, sepse, po të ishte ndryshe, ne s'do të ishim dhe s'do të kishte mundësi ta vëzhgonim, u lidh kështu me predispozitën që shpjegon integritetin e universit, me faktin që universi nuk ka kufi”.

U deshën ca muaj, para se të arrinim ta montonim makinën. Ndërkohë, jo vetëm në qytet, por edhe në rrethinat e tij të gjera, u përhap lajmi se ishim shumë afër vënies së tij në punë. Filluan të lulëzojnë hamendje të ndryshme. Thuhej se kushdo që t'i afrohej instalimit do të provonte një kënaqësi të madhe dhe se, kushdo që të vendosej në një distancë të caktuar prej tij, do të ndiente një tmerr surreal, aq sa për të kuptuar, papritur, një fjalë, e cila, në enciklopeditë e vjetra, identifikohet, jo me shumë qartësi, me emrin e *ferrit*. Thuhej se në pozicionin, tamam, para instalimit, do të shikoje jo vetëm të ardhmen tënde, pore dhe atë të disa galaktikave të afërta; po të zije pozicion mbrapa tij, do të shikoje të kaluarën tënde, gjithashtu edhe atë të Rrugës së Qumështit. Thuhej se, po ta prekje instalimin, mendimi yt do të përzihej me mendimet e miqve dhe armiqve të tu. Thuheshin shume gjëra dhe, secila prej tyre ishte, për fat të mirë ose të keq – e vërtetë!

Përpiqeshim me të gjitha forcat tona të fshihnim kuptimin e vërtetë të instalimit. Kuptimi i tij, misteri i tij u zbulua para nesh, dalëngadalë, gradualisht, dhe, fillimisht, nuk arrinim t'i besonim lumturisë sonë. Intuita e parë e dobët ishte e historianes Eleonora,

e cila ia komunikoi supozimin e saj mjeshtrit Matias dhe ky, pastaj, ma bëri të ditur mua. Eleonora, kolegia jonë me origjinë nga Akuitania, një Shtet federal franko-anglez, u ndje në siklet, kur mjeshtri Matias i tha se ajo duhej të më kishte vënë në dijeni edhe mua për idetë e saj. Pasi e provuam të gjithë instalimin, pasi gjithçka, absolutisht gjithçka që thuhej për të doli e vërtetë, Eleonora, mjeshtri Matias dhe ndihmësi i tij u rreshtuan para nesh dhe, me ndihmën e disa llogaritjeve të gjata e të detajuara, na bindën se instalimi fshihte brenda vetes shumë më tepër nga ç'kishim guxuar të imagjinonim.

Shpjegimi që na dhanë i referohej teorisë së bashkimit të madh që integronte bashkëveprimin elektromanjetik të dobët e të fortë dhe e bënte të pavlefshme këtë teori duke e konfirmuar atë, njëkohësisht, pastaj folën për veçorinë unike të mendimit e të fenomenit në një hapësirë kohore, në të cilën lakimi i hapësirës kohore ishte drejtpërdrejt proporcional me vlerën e pafund të emocioneve njerëzore.

Shpjegimi i tyre u pasua nga një heshtje e gjatë e lutëse. Ashtu si unë, besoj se shumë të tjerë nuk kishin kuptuar detajet e llogaritjeve dhe shndërrimin e pjesëzave shumë të rënda dhe shumë të lehta në lidhje me tkurrjen e sferave hapësinore-kohore. Po, pak i kuptonim detajet, por thelbi ishte i qartë. Që, me të vërtetë, ai instalim mund të zgjidhte një çështje aq themelore, askush s'kishte guxuar të mendonte. Që, instalimi mund të ishte, vërtet, një instrument i aq përfitimeve...? U zhytëm në heshtje, ndihej vetëm frymëmarrja e të pranishmëve.

Eleonora mendonte se makina kishte potenciale shumë më larta se ato që, deri atëherë, kishim pasur mundësi të provonim. Besonte se, në thelb, ishte një instalim ekzekutimi.

Kur, pas një kohe të papërcaktuar, u rishfaqëm, njëri pas tjetrit, nga mendimet tona, filloi të valëvitet në ajër një pyetje e pashprehur. Kush do të ishte i pari për ta vënë në provë atë teori aq

joshëse? Pas një votimi të shkurtër, mjeshtri Matias dhe Eeonora morën të njëjtin numër votash. Dy a tre anëtarë të Komitetit tonë për restaurimin e instalimit nuk arritën të votonin. Përjetonin një kënaqësie aq të thellë, saqë vendosëm të mos ua prishim. Numri i barabartë i marrë nga të dy kandidatët na vuri në një situatë të pazgjidhshme, kur, papritur, profesor Aleksandër Pazdera, njëri nga ata, që buzëqeshte me një përhumbe lumturie dhe nuk po vinte në vete, e tha të vetën - propozoi në mënyrë fare të qartë: “I pari le të jetë më i vjetri, ai e meriton më shumë”. Kjo nuk i kishte shkuar ndërmend askujt. Nuk llogaritej më mosha që prej... prej shekujsh. Aleksandri, gjithsesi, tregoi aftësi kuptueshmërie të pazakontë e të thellë. Propozimi i tij u pranua nga komiteti, nga mjeshtri Matias dhe nga kolegja Eleonora.

Mjeshtri Matias zuri vend mbi njërin nga dy qendrat e elipsit që përbënte instalimin. Pastaj makina u vu në veprim dhe mjeshtri Matias u zhduk nga fushëpamja jonë. Më pas u dëgjuan tinguj të papërcaktuar. Më kujtonin një melodi nostalgjike; pastaj dikush u shpreh se ngjante si tingulli i shpirtit që braktiste trupin. Nuk e di – besoj që secili prej nesh perceptoi dhe ndjeu gjëra të ndryshme. Pastaj ndodhi... I shtrirë para nesh gjendej trupi i tij. Mjeshtri Matias vdiq. Të gjithë filluam të qajmë nga emocioni dhe gëzimi. Po, mund të them që ajo qe dita më e lumtur e jetës sime.

Ishte dita kur u çlirua nga pavdekësia e mallkuar, e cila na shoqëronte si një plagë, tashmë, prej shekujsh, e trashëguar nga të parët tanë. U çlirua nga pavdekësia e mallkuar që na mundonte, ashtu siç kishte munduar kolera të parët tanë, në epokën e errët, tashmë të dallueshme me vështirësi, të katedraleve. Gjatë mijëra vjetësh, të parët tanë të mallkuar kishin marrë nga jeta si parazitët, duke e përsosur ekzistencën e tyre, pra, edhe tonën deri në atë pikë, saqë, në fund, kishin arritur atë që quhet vlerësim absolut, fjala pavdekësi në atë kohë nuk përdorej më, askush s’do ta kuptonte. Njerëzimi ishte bërë aq i pavdekshëm, nuk ishte më e

mundur të vdisje nga sëmundja, plagët, ose me vullnetin e vet, me vetëvrasje. Njerëzimi kishte arritur vlerësimin absolut që në errësirën e antikitetit të frikshëm, mund të parashikohej. Kështu u bëmë pasardhësit e deformuar të përbindëshave. Dhe tani, më në fund, nuk jemi më krijesa të pavdekshme dhe jemi bërë përsëri të vdekshëm, domethënë jemi njerëz.

12. Maksimiliani

Djali mori emrin Kristof, i vetmi emër mashkullor që Alisa qe gati ta pranonte, më i arsyeshmi. Maksimilini do të kishte dashur të festonte, përveç dashurisë së tyre, edhe bashkimin e dy familjeve dhe propozoi emrat e të parëve të tij, të cilët, në një mënyrë a në një tjetër, ishin dalluar në histori. Vetëm se, shumica ishin emra me origjinë polake ose gjermane dhe Alisa e quante të padobishme t'ia ndërlikonte jetën të birit me një emër, të cilin, edhe vetë prindërit do ta kishin të vështirë ta shqiptonin. Pra, u zgjodh emri Kristof. Për Maksimilianin, bëhej fjalë për një emër me një rëndësi mesatare, në esencën e tij baroke, i dukej edhe mjaft shprehës. Kështu, më në fund, pas një seri diskutimesh të qytetëruara dhe lutëse, u pajtuan me emrin që vinte nga Krishti dhe nga njëri prej katërmëdhjetë shenjtorëve mbrojtës.

Alisa, natyrisht, ishte e mërzhitur që prindërit e saj ishin ndarë, pa një arsye të dukshme, por fëmija thithte pothuajse gjithë vëmendjen e saj. Dhe askujt nuk i shpëtoi pa vënë re që Maksimiliani, pavarësisht nga karakteri i tij mendjemadh, filloi të sillej me Alisën në një mënyrë disi të ndryshme. U bë baba dhe kjo e mbushi me gëzim, por ndjeu të rridhnin brenda tij kujtime e përjetime të papërcaktuara që grupoheshin, mblidheshin në tufa, kërkonin një udhërrëfyes dhe, me fluturimin e dallëndyshes, skicoheshin mbi qilimat e ndërthurur me mundim, të kujtesës. Tufat e kujtimeve, hamendjeve e ndjesive u kthyen në shtëpi. Duke kujtuar prindërit e tij, Maksimiliani ndjeu mollët e tharta të vetëdijes të piqeshin brenda tij.

Puna që bënte nuk i pëlqente më, e mërziiste dhe, herë pas here, zgjohej me ballin e zbehtë nga ëndrrat e frikshme, të cilave nuk ua kujtonte përmbajtjen. Maksimiliani nuk ishte i lumtur. Nuk ishte i kënaqur me veten, ndihej i huaj me kohën e vet si kurrë më parë. Ishte martuar me Alisën me dashuri të madhe dhe duke i dhënë jetë një fëmije, ajo kishte përmbushur pjesën e pashkruar të marrëveshjes së tyre martesore, po ai? Çfarë pritej prej tij? Ndihej i pasigurt dhe nuk i pëlqente kjo pasiguri. Nuk flinte mjaftueshëm, si ajo që i duhej të ngrihej për fëmijën dhe e vetmja gjë që i kthente pak dinjitet ishte të mbyllej çdo pasdite në zyrën e vet, të shkëpuste telefonin, të ulej në të vetmin divan që ndodhej aty e të flinte.

Punonte në një ndërmarrje që prodhonte suvenire dhe ai kishte një detyrë, jo shumë të përcaktuar – të miratonte propozimet për prodhime të reja. Korrigjonte ndonjë gabim të trashë gramatikor dhe sigurohej që emrat e qyteteve dhe të komunave që kishin porositur suvenire të shkruheshin e të gdhendeshin saktë. Ajo që i jepte më shumë kënaqësi ishte kontrolli i emblemave të qyteteve. Çmimet e tyre ishin kaq të ulëta, sa që ai habitej si mund ta paguanin për punën e tij.

Njohuritë e tij në lidhje me emblemat e qyteteve, me institucionet dhe ose me principatat kishtare, të ngulitura nga babai, mbetën të padobishme dhe njohuritë fragmentare të historisë, edhe ato të trashëguara prej tij, gjithashtu, nuk i hynin në punë. Për çfarë i duheshin Maksimilianit, për shembull, njohuritë e sakta e të hollësishme mbi historinë dhe kuptimin e letrës papnore *Inter gravissima*, e cila ishte letra e preferuar e babait të tij, një historian lokal, jo shumë i njohur? Letra papnore *Inter gravissima*, doli me 24 janar të vitit 1582 dhe përcaktoi një ndryshim datash, për të qenë të saktë, nga 4 tetor u kalua direkt në 15 tetor të të njëjtit vit. Por kjo, natyrisht, nuk e ndihmoi t’ia dilte në krye pështjellimit të brendshëm, në të cilin e kishte zhytur të qenët baba.

Kalendari i ri i shpallur nga letra papnore, u paraqit në

Çekosllovakia vetëm në vitin 1584, vit, në të cilin, 6 janari u pasua direkt në 17 janari. Dhe e gjithë kjo për të kthyer vitin e kalendarit Julian, të llogaritur në 46 a.c. në mënyrë jo shumë të saktë nga Sosigjeni, astronomi i Çezarit. Diferenca që në origjinë përbënte vetëm disa minuta, pas gjithë atyre shekujve, ishte zmadhuar tepër dhe kalendari nuk ishte i saktë. Maksimiliani i dinte të gjitha, por nuk i shërbente për asgjë, kur shikonte, i lebetitur, gruan e vet, se si trupi i saj, pas lindjes, i ngjallte një përzierje tërheqjeje dhe pështirosjeje? Çfarë vendi zë tek burrat ana njerëzore dhe sa ajo kafshërore? Kjo pyetje e turbullonte. Si nxitimi për të folur me të birin për gjërat që i interesonin atij dhe askujt tjetër, madje as në largësi.

Kur mendonte për lindjen e lumtur të të birit dhe për rolin fare të parëndësishëm që kishte pasur ai, atë çka u takonte të gjithë burrave, zhytej në një ndjesi pasigurie, e cila, dalëngadalë, u transformua në nervozizëm. Herë pas herë shkonte të takonte atë Frantishekun, i cili i kishte martuar dhe ai, duke e nxjerrë nga thellësia e tokës ose nga shpirti i tij, formonte një variant të fesë katolike, krejt të vetin, duke u përpjekur ta ngushëllonte Maksimilianin, pa e kuptuar se vetëm po e largonte atë përgjithmonë nga kisha romake.

Në atë epokë komuniste, të pabesë, atë Frantishek ishte i bindur se forca e fesë dhe ashpërsia e shpirtit ishin themelore për të ruajtur traditën. Këtu dhe tani dukej e qartë se Papa i asaj kohe gabohej, kur synonte t'u jepte jobesimtarëve imazhin e Krishtit të hijshëm, në një formë konsumatore dhe si bartës të një lirie të keqpërcaktuar. Jeta në Çekosllovakia, ky popull maksimalisht ateist, të cilin Toka pranonte ta mbante akoma në sipërfaqen e saj, nuk bënte gjë tjetër, veçse konfirmonte, me siguri të plotë, gjithë këtë. Diskutimet e gjata e jo shumë të mëshirshme e të dashurit atë Frantishek, e bënë Maksimilianin të ndihej absolutisht i vetmuar.

Babai i Alisë ishte transferuar në shtëpinë që ndodhej në fshatin Lhotka dhe nëna në shtëpinë e Anës, një hallë e largët, e

moshuar dhe e braktisur, e cila tregonte një interes të pazakontë për familjen e re, nganjëherë i ngatërronte emrat e Alisë dhe Maksimilianit me emra njerëzish të tjerë të gjallë ose të vdekur, por ky defekt i vogël nuk i hiqte asgjë dashurisë së saj. Kur lindi Kristofi, u propozoi të shkonin të jetonin me të në fshat. “Për ajrin e pastër” tha dhe numëroi emrat e të gjithë elementëve kimikë dhe të vlerave të tyre në njësi të ndryshme mase. “Në Pragë i kanë matur të gjitha” u tha ai, duke shtuar, në mënyrë të theksuar: “por është një informacion i rezervuar, rreptësisht i rezervuar, kështu që mos ia thoni askujt. Nëse s’do të bëjnë diçka për këtë” vazhdoi me elokuencë “do të ngordhim si kafshët ose do të pësojmë transformim dhe do të bëhemi një specie kafshësh krejtësisht të ndryshme”. Si i kishte marrë gjithë ato informacione për pastërtinë e ujit, të ajrit e të ushqimeve, nuk e tregoi kurrë.

Herë pas here shkonin të takonin gjyshin Jozef në fshat. Ishte një familje e çuditshme, mendonte Maksimiliani. I ati i Alisë, gjyshi i djalit të tij, pak kohë para martesës së tyre, ishte transferuar, krejt papritur, në shtëpinë e fshatit dhe shkonte me pushime në Pragë, vetëm, kur ishte i sigurt se nuk do të gjente aty të shoqen, Kvetën, gjyshen e Kristofit. Gjatë kohës që kalonin në fshat, Alisa pastronte lehet nga barërat e këqija dhe lante ndërresat e të atit. Maksimiliani filloi të vriste mendjen për të kuptuar motivin e vërtetë të vizitave të tyre aty.

Ai vinte djalin në karrocë dhe e shëtiste nëpër Lhotka dhe në buzë të pyjeve të gjera. Kur bënte vapë, ulej në një stol jashtë birrarisë, nën një pemë të madhe dhe, duke pirë ndonjë gllënjë birrë, përkundte djalin në karrocë. Një pasdite, nga ana tjetër e gështenjës së madhe, nën të cilën ishte ulur, ndjeu zëra më të lartë se zakonisht. Një grua e moshuar, me flokë të thinjura të mbështjella me një shami diskutonte me një plak tjetër:

“I kam parë, zoti Horejsi, i kam parë me sytë e mi”.

“E çfarë ke parë, Ruzhenka, më thuaj”.

“Ata gjarpërinjtë, pra. Ishin përbindështa të mëdhenj, të trashë sa kofsha ime”.

“Mhm. Sa kofsha juaj, Ruzhenka. Mmh. Sa kofsha juaj, para sa... sa vjetësh?”

“Ka qenë para tridhjetë vjetësh, apo jo?” tha një zë tjetër.

“Epo, po ju them, zoti Horejsi ishin dy përbindështa, dy gjarpërinj të mëdhenj të varur në pemë dhe, më i madhi ishte i trashë sa kofsha ime”.

“Po këmbët tuaja janë akoma të bukura. Më lër t’i shikoj... mundem? Vërtet, a mundem?” i tha plaku, teksa ngrinte me shkop fundin e gruas.

“Çfarë bëni, zoti Horejsi, mjaft? Kushedi ku e ke future atë shkop dhe tani ma fut poshtë fundit, po si mund ta bëni këtë”. Maksimiliani filloi t’i dëgjonte zërat me vëmendje.

“Ata përbindështa, me siguri, kishin dalë nga ai kopshti zoologjik privat që mbanin në qytet, atje në kështjellë dhe, ndërsa gjermanët përparonin, gjermanët filluan të qëllonin nga kodra përmbi lumë, po, ishin mbrapa kodrës, serave dhe kopshtit zoologjik, ku ndodhet sot Kovoshroti. Amerikanët hodhën një granatë kundër gjermanëve, por goditën kopshtin dhe kafshët ikën dhe filluan të bredhin nëpër pyje. Burri im i ndjerë, pas një viti, pa një lloj brejtësi të madh me gjemba si iriq dhe prifti i fshatit fqinj, para se të përfundonte në burg, pa një majmun. Janë të vërteta të gjitha këto!”

“Eh, Ruzhenka, njerëzit tregojnë gjithfarë historish. E dini si thuhet? Fjalët janë vetëm ujë që rrjedh!”

“Epo, atëherë mos më kërkoni më zoti Horejsi, nëse ju nuk më besoni, çfarë të bëj unë. Mos më pyesni dhe pikë. Përse vazhdoni të më pyesni?” Befas gruaja u kthye nga Maksimiliani dhe u drejtua tek ai me hap të sigurt.

“Ju” tha “po ju them pikërisht juve, e përsëriti. “ju rrini tek Çerni, apo jo?”

“Po, e vërtetë” u përgjigj Maksimiliani “është vjehrrri im”.

“Atëherë pyeteni inxhinierin, zotin Çerni, nëse është e vërtetë? Edhe ai i ka parë. Po, i ka parë edhe ai”.

“Çfarë ka parë?” pyeti Maksimiliani.

“Epo ju lutem” tha gruaja dhe u kthye, përsëri nga plaku me shkop dhe pleqtë e tjerë që kishin ngritur veshët. “Problemi është se ju s’jeni prej këtij vendi. Keni ardhur pas 45-ës”.

“Ruzhenka, po kjo ç’hyn këtu, tani?” thirri burri me shkop.

“Pyeteni zotin Çerni, ai i ka parë edhe majmunët që vraponin në mes të pyllit, pasi kishin ikur të gjitha kafshët nga kopshti zoologjik” tha gruaja.

“Eee, si quheni ju?” pyeti burri me shkop Maksimilianin.

“Maksimilian”.

“Dhe i vogli është Kristofi, apo jo?” pyeti ai.

“Po, është djali im. Po ju nga e dini si quhet?”

“Këtu të gjithë dinë gjithçka për të gjithë. Por, pyeteni me të vërtetë inxhinierin, vjehrrin tuaj, nëse i ka parë. Nëse i ka parë ata majmunë”.

“Mirë” u përgjigj Maksimiliani “do ta pyes”. Gruaja u përshëndet me ne, i bëri një shenjë burrit me shkop dhe u largua me një broke me birrë.

“E megjithatë” tha burri duke theksuar çdo rrokje me një goditje të shkopit “do të kenë ngordhur nga të ftohtit ato kafshë ekzotike. Nuk janë mësuar me të ftohtin, nëse vijnë nga Afrika ose nga Australia. Kam apo s’kam të drejtë? E si do të jenë ushqyer pastaj?”

“Gjethë, zoti Horejsi, gjethë!” thirri gruaja me broke në dorë që kishte ndier nga larg vërejtjen e burrit me shkop dhe ishte ndalur para portës së restorantit.

Atë ditë Maksimiliani nuk pati mundësi të fliste me vjehrrin, por të nesërmen në mëngjes, pasi kishte parë ëndërr se kishte humbur në një kopsht zoologjik, u kujtua dhe e pyeti për gjithë

atë histori.

“I kam parë. Po, kam parë disa kafshë” i tha vjehri Maksimilianit. “Gjermanët tërhiqeshin, amerikanët përparonin, njëra palë ose tjetra e qëlluan atë vend dhe kafshët ikën. Eh, lufta. Derisa, pas luftës, nuk e di çfarë viti ka qenë, bëri një dimër shumë i ashpër, tmerrësisht i ashpër. Dhe, me siguri, ato kafshë kanë ngordhur të gjitha. Prifti i asaj kohe quhej Ruzhiçka ose diçka e tillë, por në origjinë kishte një emër gjerman, bëri një predikim shumë të bukur mbi faktin që dukej sikur jetohej në një kopsht parajse. Si në parajsë e kështu me radhë. Që jemi në parajsë dhe as nuk e dimë, nuk jemi të vetëdijshëm. Edhe ai i kishte parë ato kafshë të egra. Ishte fill para revolucionit apo më vonë? Nuk e mbaj mend mirë. Një ditë tjetër, Maksimilian, do t’ju tregoj më shumë”

Martesa e Maksimilianit me Alisën nuk lulëzoi. Fëmija nuk e saldoi dot bashkimin e tyre dhe nuk shënoi kulmin e gëzimit e të dashurisë. Pritshmëritë autentike, nëse do ta themi në mënyrë koherente, të qartë e të sqartë, nuk u përmbushën. Alisa, pas lindjes, humbi çdo rreze qetësie dhe, sapo hormonet e fundit të mjaltëzuara nga shtatzënia u zhdukën nga enët e gjakut, u ndje e rrethuar vetëm nga ngjyra gri e rrugëve të shkreta. Kur shkonte së bashku me fëmijën të takonte të atin në fshat, ndihej pak më mirë, por fakti që shikonte babain të vuante pa përkujdesjet e nënës së saj, e vinte në siklet. Shpesh harronte të priste thonjtë e duarve. Nganjëherë nuk rruhej për ditë të tëra, madje, nganjëherë, harronte edhe të hante. Ajo ia kujtonte dhe ai zemërohej duke fajësuar vetveten dhe kështu, Alisa, pas pak, nuk ia vinte më në dukje, sepse, kur ndihej keq, vetëqortimet e tij, e ndiqnin nga pas si plumba të bezdisshëm në folenë e lindjes.

Ndarja e çuditshme e prindërve të saj, të cilët bënë garë kush të kujdesej më shumë për Kristofin, nuk i jepte qetësi e Alisë. Secili prej tyre numëronte një listë fajesh e gabimesh të veta. Ndërkohë

Maksimiliani kishte ndërruar punë për të fituar më shumë para, por sa më shumë para fitonte, aq më pak rrinte në shtëpi. Kur kthehej, nganjëherë ishte aq i lodhur, saqë e zinte gjumi në karrige, pa mbaruar darka. Kur Kristofi mbushi një vit, u mblodh e gjithë familja – nëna dhe babai, të larguar prej më shumë se një viti, u takuan.

Nëna ishte përgatitur për këtë takim prej javësh, sikur ishte ndonjë aksion ushtarak. Rrobat të reja, krehje e re, manikyr e pedikyr, fustane dekolte të reja, të përdorura aq, sa të mos e shtrëngonin; nuk donte që Jozefi ta shikonte jotërheqëse, aq më pak - të pakëndshme. Iu desh një javë e tërë për të zgjedhur parfumin që i shkonte moshës dhe qëllimit të saj. Jo joshës, por i këndshëm. I këndshëm, pra jo si parfumi i rinisë, por si një parfum qetësues i një pasditeje të vonshme. Nëna u përgatit për takimin për disa muaj, me zellin dhe vendosmërinë e vajtjes në Polin e Veriut. Por, kur burri i saj erdhi në Pragë nga fshati, befas, ajo mbeti e çarmatosur. Me bluzën e vjetër, me mjekrën e pakujdesur, figura e tij e gjatë ishte më e kërrusur se herën e fundit që e kishte parë.

Gati gjithë kohën Jozefi luante me Kristofin dhe, kur u largua, harroi të merrte dhuratën që i kishte bërë e shoqja – biletat për koncertin, në të cilin do të duhej të shkonin bashkë. Asaj i ishin dashur ditë të tëra dhe ryshfete që t'i siguronte ato dy bileta për koncertin e një pianisti të ri kanadez, i cili ishte bërë legjendë për ekzekutimin e shkathët të Variacioneve Goldberg të Bahut. Kveta kishte hedhur në lojë letrën më të mirë, asin e saj – të tjerë s'kishte as në dorë, as në zemër.

Alisa ishte një nënë krenare dhe Maksimiliani një baba krenar dhe në qendër të universit të tyre ishte Kristofi, por dallimi midis gjyshit dhe gjyshes ishte tepër e madhe për të mos u vënë re. Kur Jozefi doli në ballkon për të pirë cigare, i ranë nga xhepi bishta cigaresh. Alisa u inatos, në heshtje, me të, sepse ai kishte veshur

bluzën e vjetër ngjyrë kafe, megjithëse, para një jave, ajo i kishte larë një kostum, dy këmbisha dhe i kishte pastruar këpucët e lehta. Vështrimi i ftohtë, i largët dhe, fshehurazi, i tronditur i nënës së saj që, pas një viti, shikonte të shoqin, nuk mund të ishte më elokuent dhe atmosfera gjatë ditëlindjes së Kristofit u dominua nga sikleti që provonin të gjithë, përveç gjyshit dhe Kristofit. Gjyshi zvarritej këmbadoras pas nipit në çdo cep të shtëpisë dhe të dy nuk i kushtonin fare vëmendje pjesës tjetër të shoqërisë.

Kur gjyshi dhe nipi u lodhën dhe Kristofi i vogël filloi të hapte gojën për gjumë, gjyshi doli për të kapur trenin. Iku disi papritur dhe të gjithë patën përshtypjen se nuk u përshëndet me asnjeri, por gaboheshin. Ai ishte përshëndetur vetëm me Kristofin, i cili nuk ishte në gjendje t'ia thoshte askujt. Pas pak minutash, iku dhe nëna dhe i tha Alisë: “Duhej të më kishe thënë si i kishte punët babai, duhej të më kishe thënë. Nuk është mirë nga ana jote që s’më kishe treguar për gjendjen e tij”. Dhe iku.

Nga ai moment, Alisa nuk u përpoq më, kishte mjaft për të bërë për martesën e saj dhe nuk ishte e aftë të ndreqte martesën e prindërve të saj. Vazhdoi të kujdeset për të atin që po plakej shumë shpejt dhe, momentet e rralla që i shoqi kalonte në shtëpi, përpiquej t’i gëzonte. Hired e shtatzënisë së saj të parë e të fundit po bëheshin gjithnjë e më shumë një kujtim i largët. Tani Alisa ishte e mbytur nga një përditshmëri e qullët që rridhte turbull, e vetmja gjë transparente ishte dritarja e akuariumit, përmes së cilës vëzhgonte martesën e vet.

Maksimiliani nuk kalonte shumë kohë në shtëpi. I shmangte pyetjet e saj duke treguar histori të pabesueshme ose me heshtje. Kur Kristofi mbushi tre vjet, Alisa filloi t’i fliste të shoqit për mundësinë e një fëmije të dytë, por, sa herë që e hapte këtë bisedë, ai zhdukej nga shtëpia për ditë të tëra. Zakonisht kthehej në të gdhirë, i dehur, bashkë me shokë të dehur dhe atëherë shkuarja në banjë për Alisën, bëhej një vrapim me pengesa, qëllimi i të

cilit ishte të mos pengohej në krahë, këmbë ose barqe trupash me frymëmarrje të rëndë, të cilët me frymën e tyre, me erë alkoli, mbysnin gjithë shtëpinë. Kur vinte në vete Maksimiliani dhe Alisa provonte t'i fliste, përfundonin gjithmonë në grindje, edhe për paratë e pakta që kishin.

Bisedat e tyre, tashmë, ishin vetëm debate dhe grindjet transformoheshin në keqkuptime fatale. Dëshpërimi i trashur në të cilin kishin ngecur, kishte një erë përzierjesh kimike. Plagosjet reciproke zgjeroheshin gjithnjë e më shumë dhe çfarëdo mjeti për të qetësuar dhimbjet ishte i mirë, megjithëse e mpinte shpirtin. Por nuk ishte pandjeshmëria, përkundrazi, Maksimiliani e kuptonte çdo ditë e më shumë mjerimin e falimentimit të vet. Një falimentim i kalitur me djersë, dhimbje dhe me pak gjak. Të vëzhgoje atë rrënim ishte shkatërruese.

Shikonte ëndrra nga më të ndryshmet. Në njërën prej tyre, më e pakuptimta, ai ishte astronaut. Pothuajse gjatë gjithë ëndrrës vinte me kujdes skafandrin, pastaj rregullonte mbulesën e jashtme të anijes kozmike dhe dilte ose, më mirë të thuash, hidhej në hapësirën ndëryjore. Në atë pikë, litari me të cilin ishte lidhur këputej dhe ai fluturonte gjithnjë e më larg, shumë më lart nga stacioni hapësinor i nënës Tokë. Në një variant të ëndrrës, stacioni hapësinor kishte një dritare të rrumbullakët, në të tjerat jo, por në të gjitha, ai ishte i vetëdijshëm që aty brenda ishte gruaja, e cila i bënte kafën ose i përgatiste strudel me mollë që Maksimiliani e adhuronte. Alisa kurrë nuk e shikonte në kohë përmes dritares së anijes kozmike.

Ishte e qartë që, në mungesë të gravitetit, do të ishte e pamundur të bëje kafe, por kjo s'kishte rëndësi në ëndërr. Maksimiliani zgjohej nga gjumi gjithmonë i pushtuar nga një ankth që ia merrte frymën. Midis gjërave të tjera që e mundonin ishte fakti se në brendësi të anijes nuk mungonte kurrë graviteti, atje ishte njësoj si në tokë. Mungesa e gravitetit ishte vetëm jashtë, gjë që

binte në kundërshtim me ligjet e natyrës. Maksimiliani e dinte se domethënia e ëndrrave të tij, në thelbin e saj, ishte e thjeshtë dhe e qartë – përfaqësonte falimentimin e tij absolut.

Maksimiliani e kuptoi shpejt se në atë udhëtim, që ishte martesë e tij, diçka po i rrëshqiste nga duart. Nuk e dinte saktësisht çfarë, por valët e emocioneve, të lodhjes dhe mungesa e përhershme e parave e shtynë të synonte diçka tjetër, të paktën për vete. Përpiquej të ishte më i vërtetë, të mos ishte si babai i tij. Në fund të fundit, epoka ia lejonte. Me vitet Shtatëdhjetë kishte ardhur koha të mblidheshin gjithë ato ide të endura në mendjet e zellshme të viteve Gjashtëdhjetë, ëndrrat e vëllazërisë, barazisë, dashurisë dhe harmonisë së sferave, të gjitha konceptet që kishin arritur edhe në Çekosllovakë, pavarësisht nga perdja e hekurt, e vendosur përsëri. Liria që kërkonte Maksimiliani nuk ishte politike, por njerëzore. Në fund të fundit, tanket dhe ushtarët rusë ishin brenda kazermave ushtarake çekosllovaqe.

Kërkonte ta çlironte veten, megjithëse, nganjëherë, nuk e kishte të qartë nga çfarë gjëje. Por mjaftonte të shfletonte çfarëdo reviste për të gjetur shpjegime të hollësishme të një teorie tjetër psikologjike dhe ishte e qartë që duhej të çlirohej nga vetvetja dhe nga paragjykimet e veta. Maksimiliani nuk e dinte cilat ishin paragjykimet e tij, por kuptoi teorinë e përgjithshme të zhvillimit njerëzor, kuptoi, gjithashtu, se demoni i padijes mund të minojë çdo ide dhe çdo ndjenjë. Kuptoi që, nëse jeta e tij kishte një vlerë – duhej të kuptonte vetveten dhe shpresonte që përpjekjet e tij do të ndikonin pozitivisht edhe në martesën e tij. Kështu që, në kufirin ndërmjet fushave pjellore të teorive të ndryshme psikologjike, unike e të shquara, lindi ideja e vërtetësisë.

Të ishe i vërtetë do të thoshte t'i jepje liri shpërthimit të ndjenjave, të gjitha ndjenjave, sepse vetëm ato ishin autentike. Këtë kishte kuptuar Maksimiliani. Në praktikë do të thoshte të pije në mbrëmje, në festa dhe natën, kur kthehej, ndihej shumë

më i tërbuar, sesa kur nuk e kishte përqafuar idenë e vërtetësisë. Tani, atij i qëllonte shpesh të përplaste grushtin mbi tavolinë, kur grindej me Alisën. Pas pak muajsh filloi t'ia shtrëngonte kyçet e duarve aq, sa i shkaktonte dhimbje, më tej - ishte gati ta godiste.

Herën e parë mendoi se ishte më i dehur se zakonisht. Herën e dytë, në të vërtetë, ishte esëll dhe i shpjegoi që duhet t'i hapë rrugë shpërthimit të tërbimit të vet. Herën e tretë, kur e goditi ajo u përplas me krah pas murit, por vazhdoi të mos e pranonte se kishte frikë prej tij. Më vonë, u shfaqën blanat nga goditjet dhe frika.

Kur Kristofi ishte katër vjeç e gjysmë, doktori e këshilloi Alisën të ndërpriste, për pak kohë, kontraktivët. Në atë periudhë, Maksimiliani flinte më shumë jashtë se në shtëpi dhe Alisa nuk donte të dinte asgjë për dashnoret që kishte ai. Megjithëse ai vinte shumë rrallë dhe marrëdhëniet e tyre seksuale ishin sporadike, pas ca muajsh, Alisa kuptoi që ishte shtatzënë. E mori vesh para se të sigurohej. Ajo ndjesi që nuk e provonte, tashmë, prej pesë vitesh të gjata, ishte përsëri brenda saj. Edhe Kristofi i vogël vuri re diçka, megjithëse kalonte shumë kohë me gjyshin, i cili e merrte shpesh me vete në fshat, për të kaluar fundjavën. Alisa ishte përsëri në atë gjendjen e ëmbël e ushqyese të një lumturie të madhe, e cila i garantonte mbrojtje dhe ngrohtësi.

Tani nuk kishte më rëndësi ndarja me Maksimilianin – më në fund do të kishte dy fëmijë – kjo ishte më e rëndësishmja. Vazhdoi të shkonte në fshat me Kristofin, ku gjyshi filloi t'i zbulonte sekretet e llogaritjeve, të gjeometrisë dhe lojës së damës dhe, nganjëherë, zakonisht të shtunave vinte edhe Maksimiliani për një mbrëmje ose për një mbrëmje e gjysmë. Grindjet që shpërthenin ndërmjet tyre, si një luftë kryeneçe në llogore, ishin të pashmangshme, tamam sikur dashuria e tyre të ishte transformuar, ndoshta në kuarc e sqfur, ose në urrejtje për shkak të sflitjes dhe shqetësimeve të pa fund.

Ishte gjithmonë diçka e rrufeshme – mjaftonte një vështrim,

një intonacion sarkastik ose një gjest i zgjedhur mirë dhe fillonte beteja. Fillimisht akuzat, pastaj kundërakuzat. Dhe një ditë Alisa i tha: “Atëherë zhduku dhe mos u kthe më! Atë që desha prej teje, tashmë e kam marrë. Kristofin dhe fëmijën tjetër që kam në bark! Dhe parapëlqej të kujdesem vetë për ta, ty nuk do t’i besoja as për pesë minuta – do të bëheshin si ti!” Vetëm pasi e qëllloi dhe, ajo e shtrirë përtokë, fshinte gjakun nga fytyra, Maksimiliani kuptoi domethënien e fjalëve e saj.

“Pret një fëmijë?” e pyeti.

“Po” u përgjigj ajo “pres një fëmijë, prej teje, i dashur, prej teje” shtoi ajo.

“E kush mendon se do ta ushqejë” bërtiti Maksimiliani, para se ta zinte për flokësh e ta godiste prapë.

Jozefi, për shumë kohë, nuk i kishte vënë re grindjet e tyre. Mbi të gjitha, flinte në katin e sipërm bashkë me Kristofin dhe në mbrëmje, gjithmonë, e hiqte aparatin e dëgjimit. Kur Kristofi shikonte ndonjë ëndërr të keqe, shkonte në krevatin e gjyshit dhe e ia kapte dorën. Nëse ëndrra ishte, vërtet, e frikshme - ia tundte dorën aq shumë, saqë gjyshi zgjohej. Jozefi ndizte abazhurin mbi komodinë, vështronte nipin dhe vinte aparatin e dëgjimit. Vetëm në atë moment, mund të flisje me gjyshin. Kështu bëri edhe atë radhë, por, në vend që t’i tregonte ëndrrën e tij të çuditshme, vuri gishtin para gojës dhe i tha: “Dëgjoji, po zihen prapë”. Nga poshtë vinin ulërimat e Maksimilianit dhe të Alisë.

Gjyshi u ngrit ndenjurr, hodhi robdëshambrin krahëve dhe i tha Kristofit: “Po zbres poshtë t’i rregulloj gjërat, fluturak, gjithçka do të shkojë mirë, nuk do të jetë si javën e kaluar” dhe zbriti shkallët. Kur hapi derën, pa dhëndrin e vet që tërhiqte për flokësh të bijën, e qëllonte dhe përpiquej ta bënte të dilte që poshtë stolit, ku ishte strukur duke bërtitur. Iu hodh përsipër Maksimilianit, por vrulli i tij ishte i një të moshuari, jo ai i babait që duhej të mbronte të bijën. U përplas tek një karrige e përmbysur dhe ra përtokë, pa

ndonjë ndërhyrje nga jashtë. Kur arriti të ngrihet, Maksimiliani, i dehur, ishte futur ndërmjet tyre dhe i bërtiste se nuk duhej të përzihej.

Kristofi pëshpëriste gjithmonë, kur i fliste natën, prandaj Jozefi ishte i detyruar ta ngrinte në maksimum volumin e aparatit të dëgjimit dhe tani zëri i Maksimilianit i kumbonte fort e me dhimbje në vesh. Ishte e padurueshme dhe për t'u mbrojtur nga ato ulërime, Jozefi, menjëherë, i futi një shuplakë me të gjithë peshën e trupit të tij, aq sa e bëri të lëkundej. Maksimiliani pushoi së bërtituri dhe e qëllloi. Më vonë, Jozefi e klasifikoi grushtin e Maksimilianit si një goditje e djathë e pasuksesshme. U përpoq t'i shmangej, por shumë i moshuar dhe i ngadalshëm për t'i shpëtuar plotësisht; gjithsesi, arriti që grushti të mos e godiste në mjekër, ku ishte drejtuar, por në nofullën e majtë.

Pas goditjes ra me shpinë dhe u pengua në një karrige të rrëzuar përtokë. E kishte parë karrigen, por nuk mundi ta shmange, për shkak të shpejtësisë. Pasi ra në tokë, ndjeu dhimbje në parakrahun e djathtë dhe në brinjë. Në dhomë ishte qetësi. Maksimiliani, i tërbuar, goditi me shqelm diçka dhe doli. Nga dërrasat e dyshemesë, ku kishte rënë, Jozefi ndjeu vibracionin e shkaktuar nga përplasja e derës, pastaj – qetësi. Pas pak, Jozefi provoi të ngrihet dhe u zvarrit këmbadoras, derisa gjeti aparatën e dëgjimit që i kishte rënë, e vuri në vesh, por nuk dëgjonte asgjë, e vuri prapë, hapi kapakun, këqyri brenda, rregulloi më mirë baterinë që nuk bënte kontakt. E vuri përsëri në vesh, vështroi të bijën dhe, më në fund, arriti të dëgjonte fjalët e saj: “Është çarë membrana, baba! Po humb gjak, baba!”

Fqinji që i shoqëroi në spital kishte veshur, mbi pizhame, një palë pantallona kadifeje dhe një xhakavento. Jozefi ishte me robdëshambrin, pizhamet dhe një palë këpucë të mëdha. Kristofi ishte veshur si për shkollë dhe Alisa ishte kruspullosur sa një grusht – i rridhte gjak nga rrëza e kofshëve. Fqinji kishte sedilje që

mund të zgjateshin, kështu që mbështeti sediljen nga mbrapa, mori Alisën në krahë dhe e shtriu mbi të. Gjatë gjithë rrugës vazhdonte të fliste me indinjatë: “Maskarai, çfarë maskarai, inxhinier, mund t’u kishte vrarë të dy. Në burg duhet të vejë, ai faqezi”. Para se të niseshin, u dha të treve nga një kapuç skish. “Nuk funksionon ngrohja” shpjegoi ai “bën ftohtë, merrini këta!”

Atë mbrëmje Alisa humbi fëmijën e saj të dytë, të cilin as në spitalin rajonal, nuk arritën ta shpëtonin. Mjeku ia kapi dorën Jozefit dhe i tha për ndërprerjen e shtatzënisë së vajzës së tij. Jozefi shau e mallkoi. Mjeku e vështroi Jozefin më nga afër dhe i tha: “Ju ka katandisur keq edhe ju”. E zuri për krah u përshtri Jozefin që vazhdonte të shante dhe i tha: “Ejani me mua të bëni një radiografi”. “Nuk largohem dot, nuk jam vetëm” u përgjigj Jozefi duke treguar të nipin. “Atëherë do të vijë edhe ai, duhet ta bëni radiografinë, pa diskutim”. Kristofi e ndoqi Jozefin përgjatë korridorit të spitalit, gjyshit i diagnostikuan nofullën e çarë, dy brinjë dhe parakrahun e majtë të thyer. Pas radiografisë, filluan ta fashonin gjyshin dhe t’i vinin krahun në allçi – Kristofi ia plasi të qarit. Jozefi vuri re se djali s’kishte dëshirë as të luante damë xhepi që fqinji ia kishte gjetur në makinë dhe vajza e tij kishte humbur fëmijën, për të cilin ai nuk ishte në dijeni se ekzistonte. Kërkoj leje të bënte një telefonatë – i telefonoi gruas së vet, Kvetës, në Pragë. Sapo ia dëgjoi zërin i tha: “Mendoj se duhet të vish këtu. Alisa ka dështuar. Unë kam ca brinjë të thyera dhe djali qan e lebetitet. E kam shumë të vështirë ta pranoj, por mendoj se kemi nevojë për ty”.

13. Kveta

1.

Në atë krevat, në shtëpinë e teto Anës, nuk u mësova dot kurrë. Edhe pasi kisha fjetur në të për shumë vite, pyesja veten, nëse duhej ta shisja ose ta hidhja poshtë. Kur u transferova tek teto Ana, bëra përpjekje për ta ndrequr, por tapicier i që kisha gjetur nga njoftimet, më mbushi me komplimente dhe s'bëri gjë fare. Ishte pak më i ri se unë, kështu që u ndjeva e mikluar; qëkur kishte ikur Jozefi, isha dobësuar dhe kisha arritur, më në fund, peshën time normale. Mund dhe të kisha bërë ndonjë lëshim, por në atë kohë, besoja akoma se Jozefi do të kthehej.

Gjithsesi ai krevat ishte gjysmë krevati. Në origjinë ishte një divan. Kishte një shpinore të lartë, të veshur e të butë, e cila, nga ana e djathtë, zgjatej deri në pjesën e pasme dhe, nëse paraqitej nevoja, mund të mbante kokën dhe një pjesë të shpinës. Ndihesha rehat dhe e sigurt. Kur nuk doja të flija, mund të mblidhja jastëkët dhe të strukesha aty. Pas divanit kisha vendosur një abazhur që teto Ana e mbante në depo, e kisha ndrequr pak damaskun e prishur e të dalë boje dhe abazhuri ndriçonte sipër divanit si një tendë e vogël. Provova shumë llamba me tension të ndryshëm për të zgjedhur një, e cila pa m'i verbuar sytë, të më lejonte të lexoja.

Në atë shtëpi gjithçka ishte e vjetër. Mobiliet, qilimat, madje edhe soba, por më e vjetër nga të gjitha ishte teto Ana. Para se të transferohesha në shtëpinë e saj, një funksionare e lartë me një krehje të çuditshme, kishte vendosur që ajo duhej të shkonte në azilin e pleqve. Teto Ana nuk kishte fëmijë, pra ishte vetëm

dhe m'u duk e çuditshme që ai vendim, i marrë nga institucionet, kishte arritur vetëm kur, përreth, kishte filluar të shfaqej interes për atë shtëpi.

Një ose dy herë në muaj i telefonoja për ta pyetur, nëse i duhej ndonjë gjë dhe i çoja çfarë kishte nevojë, por, pasi iku Jozefi, unë vetëm qaja nga dëshpërimi dhe, për ca kohë, e harrova fare atë. Kur, më në fund, shkova ta takoja, kuptova se asaj së shkretës i ishte dobësuar shumë kujtesa. Fqinja e saj, zonja Martinkova që, bashkë me mua, kujdesej për të, kishte pësuar një frakturë në qafë të këmbës dhe ishte shtruar në spital, kështu që teto Ana kishte mbetur fare vetëm.

Pas pothuaj gjashtë muajsh që nuk e kisha parë, m'u duk shumë e dobësuar. Në fillim nuk vura re gjë, sillej mirë më me mua, por, kur filloi të më thërriste Libushe, Hanička e Karolina, pa e përmendur kurrë emrin Kveta, e kuptova që tetoja e shkretë ngatërronte gjithçka më shumë seç bënte më parë. Prandaj, në vend të Jozefit, fillova të kujdesem për teto Anën. Dy javët e para vetëm laja rroba, pastroja e hidhja poshtë gjëra të vjetra, të padobishme. Pastaj u mora me larjen e dritareve dhe të dyerve. Tezja më shikonte dhe, në vartësi të asaj që bëja, më thërriste me emra të ndryshëm. Një ditë po tërhiqja një qilim në oborr për ta shkundur, ishte gjithë pluhur e pisllek dhe ajo më vështronte nga tavolina e saj në kuzhinë, teksa qëndroja në derë, veshur me rroba të vjetra dhe me qilimin në krah, e djersitur, me shkundëset nën sqetull dhe, atëherë, hoqi syzet, tundi kokën dhe tha: “Ti duhet të jesh Zorka jonë”. Pastaj tundi kokën përsëri dhe shtoi me një ton qortues: “Si je katandisur, duhet të kesh më shumë kujdes për veten, o vajzë”. Pikërisht atëherë fillova të vë re se më thërriste me emra të ndryshëm në vartësi të veshjes, me një logjikë krejt personale.

Duke rregulluar shtëpinë disa gjeta albume fotografish dhe atë mëngjes, në agim, kur ra telefoni, isha shtrirë tamam mbi njërin

nga albumet e mëdhenj prej lëkure, në gjumë më ishin dërmuar brinjët; ishte akoma errësirë dhe, kur hapa telefonin dëgjova zërin e Jozefit. Kishte një zë vjeshtak – më foli për Alisën për Kristofin dhe për vete. U vesha shpejt e shpejt dhe nga një kabinë telefonike, sepse u kujtova vetëm kur isha në rrugë, kërkova një taksi që të më çonte në stacion. Atje fillova të kthjellohem për gjendjen dhe më zunë të dridhurat.

Sapo e mbloodha veten, i telefonova Antoninit, meqenëse ai ishte mjek. Për fat të mirë sapo e kishte mbaruar turnin, kështu që erdhi me makinë e më mori dhe u nisëm bashkë për në spital. Gjatë rrugës i tregova me hollësi ato që Jozefi më kishte thënë në telefon. Antonini më dha një termus me kafe, ndoshta s’kishte pasur kohë ta pinte në punë, gjatë rrugës u ndal në një kinkaleri për të blerë cigare.

Kur Antonini parkoi para spitalit dhe zbritëm nga makina, pashë në shkallë fqinjin Vashek, i cili kishte shoqëruar Jozefin, Alisën dhe Kristofin. Qëndronte atje në këmbë dhe pinte cigare – dukej shumë i trishtuar. Dhe kjo më shqetësoi më shumë, e kujtoja qëkur ishte fëmijë, duhej të ishte tre a katër vjet më i madh se Alisa, ishte njeri me shumë humor, prandaj pamja e tij e trishtuar dhe e brengosur më la pa frymë. Kur hymë në dhomë, Alisa po shikonte nga dritarja dhe dy paciente të tjera po hanin mëngjes shtrirë. Afër krevatit të saj ishin vendosur dy karrige, një në secilën anë, mbi një rën flinte Kristofi. Tjetra ishte bosh. U ula. Antonini i përkëdheli flokët Alisë dhe doli për të kërkuar doktorin që ishte në shërbim atë natë dhe që ishte kujdesur për ta.

Kishim ardhur vonë, kisha ardhur tmerrësisht vonë, kështu që u kufizova me një përqafim të vajzës sime, ia mora dorën djalit dhe u përpoqa në të gjithë mënyrat, në të gjitha mënyrat, që të mos qaja. Nuk qe e lehtë. Sapo arritëm, megjithëse ishim përpjekur të hynim me qetësi të madhe, Kristofi u zgjua dhe më tha: “Gjyshe, mirëmëngjesi” pastaj, ngaqë s’po e shikonte askund

Jozefin, shtoi: “Gjyshi, me siguri, ka vajtur në banjë”. Dhe u struk përsëri nën krahun e Alisë. Pastaj erdhën Jozefi dhe Antonini. Jozefi më përshëndeti dhe, për një moment, pata përshtypjen se që i gëzuar që më pa. Qëndruam aty ulur derisa infermierja na nxori të gjithëve në korridor, sepse dy pacientet e tjera nuk lëviznin dot dhe duhej të urinonin e të kryenin të gjithë higjienën e mëngjesit.

Aty në korridor, Antonini na tregoi se mjeku kishte bërë një raport që mund të përdorej për hetimin e çështjes. Pastaj hyri dhe Vashek, u afrua tek ne, dëgjoi për çfarë po flitej dhe tha: “Në burg duhet të shkojë maskarai, në burg!” Dhe unë u lumturova që, më në fund, dikush e tha. Por në, të njëjtën kohë, nuk arrija të kuptoja si kishin arritur deri në atë pikë. Dhe, ndërsa gjendeshim aty, Vashek më tha, më duhet të shkoj në punë, nëse doni t’ju çoj në shtëpi, do ta bëj me kënaqësi. I thashë që do të doja të shkoja për të përgatitur një valixhe me rroba për Kristofin, Alisën dhe Jozefin, sepse, natyrisht, s’mund të rrinin aty – do të duhet të vijmë në Pragë me ne.

Edhe Antonini pohoi me kokë, e dija që kjo ishte e drejtë dhe se Jozefi do të vinte pa krijuar probleme. Antonini tha që do të më shoqëronte ai vetë dhe e falënderoi Vashekun. Pra, u nisëm për në shtëpinë e fshatit, i lamë Jozefin dhe Kristofin në spital me Alisën. Mora gjërat më të domosdoshme që ishin aty në fshat, ca bojra të Kristofit, ca *puzzles* dhe dy kuti me pjesë mekanike, bashkë me dy makina të vogla dhe një traktor të vogël plastik ngjyrë portokalli.

Për Jozefin mora një pallto, këpucët e lehta, pantallonat, një çadër dhe çantën e tij. Këtë të fundit ia dhashë Antoninit, sepse rrugës m’u kujtua se Jozefi murmuriste gjithmonë, kur më shikonte që e prekja. Ajo ishte, nëse e mbaj mend mirë, e katërta çantë në tridhjetë vjet dhe i ruante të gjitha aty në shtëpi, në fshat. Prandaj e mori Antonini, sepse Jozefi tallej gjithmonë, kur më shikonte me çantën e tij në dorë dhe thoshte se një çantë pune në dorën e një femre është si një armë pa siguresë. Nuk mërzitesha, por gjërat me

të cilat bënte shaka Jozefi ishin po ato që, herë të tjera, e irritonin dhe, në atë moment, nuk kishte nevojë për probleme të tjera.

Duhej t'i çoja të gjithë në Pragë dhe atje do të mund të kujdesesha për ta, sepse e dija që teto Ana nuk mund të rrinte mbi tri ditë pa kontroll ose do të shkërmoqej përsëri para syve të mi. Përpiquesha me të gjitha forcat të mos qaja, por nuk përmbahesha dot. Fola për këtë me Antoninin dhe më tha se në termusin e kafes kishte futur një qetësues që të mos dërrmohesha fare dhe, kur e pyeta përse e kishte pirë edhe ai, më tha se Maksimiliani kishte bërë diçka vërtet të tmerrshme dhe ishte fat që nuk ishte dëmtuar edhe djali i vogël. Në atë çast, me kafe apo pa kafe, me qetësues apo pa qetësues, shpërtheva në lotë, si çdo grua e pafuqishme - siç isha unë në atë moment.

Vajza ime kishte humbur fëmijën, për të cilin as nuk isha në dijeni dhe Kristofi kishte humbur një vëlla të vogël ose një motër, pa e ditur fare. Pra, i çova të gjithë në Pragë. Jozefi ndërroi bravën e derës për të ndaluar hyrjen e Maksimilianit dhe pastaj lajmëroi të gjithë banorët e pallatit për ndërrimin e bravës, ndërsa unë shkova në polici për të denoncuar dhëndrin tim. Ndërkaq Jozefi qëndroi me Alisën në apartamentin tonë të vjetër dhe pata përshtypjen se Kristofi ndihej mirë aty, megjithëse, pas disa ditësh, filloi të pyeste përse babai i tij e kishte lënduar aq shumë mamanë, unë i shkrova një letër atij priftit që i kishte martuar për t'i treguar çfarë kishte bërë Maksimiliani dhe për t'i kërkuar ta paralajmëronte atë që të mos i afrohej më vajzës sime ose do ta vrisja me duart e mia.

Por ai m'u përgjigj me ca fjalë për Zotin e për faljen dhe se nuk i përkiste atij t'i gjykonte mëkatet e bijve të Zotit, se jetonin të gjithë nën një diell. Pastaj e kuptova që nuk duhej të prisja tjetër gjë prej tij, një prift që s'kishte pasur kurrë fëmijë. Gjithsesi, duhej t'i shkruaja, sepse Maksimiliani ishte zhdukur pa lënë gjurmë, nuk gjendej në punën e tij, as në shtëpitë e të njohurve të tij, as në ndonjë vend tjetër; nga sa kisha marrë vesh prej Alisës, kisha

përshtypjen që ai shkonte me një grua tjetër. Çdo pasdite shkoja në spital tek Alisa dhe në shtëpi për të parë Kristofin dhe Jozefin – u çoja për të ngrënë të gjithëve, në heshtje, pa rënë në sy fare, vëzhgoja Jozefin tim, por në një mënyrë që ai të mos e vinte re dhe kuptova se ai i shkreti, pa aparatin e dëgjimit, pothuajse nuk ndiente asgjë.

Edhe Antonini shkonte t'i takonte, atmosfera atje brenda ishte aq e tmerrshme, sa që do të isha shembur, po të mos ishin tabletat që më kishte dhënë Antonini. Në një moment, teto Ana, filloi të vinte re se unë dilja në orare të rregullta dhe kërkoi të më shoqëronte dhe shtoi se kisha nevojë për një gjumë të mirë. Nuk u përgjigja dhe e mora me vete, me që kishte dëshirë. Qe e lodhshme ta tërhiqje atë nëpër autobuza e tramvaje nga njëra anë e Pragës në tjetrën, por ia arrita. Dhe, kur arritëm, ajo që nuk i kujtonte kurrë emrat e njerëzve, me të cilët fliste, filloi të bisedonte me Jozefin që i kishte bateritë e shkarkuara, Kristofi i dëgjoi dhe ia plasi të qeshurit se si ngatërroheshin të gjithë dhe dukej sikur asnjëri nuk e dinte me kë fliste dhe përse - qeshi pa pikën e respektit.

Dhe, kur Jozefi vuri re se tetoja e thërriste çdo moment me emra të ndryshëm, kur, më në fund arriti të dëgjonte, edhe atij iu duk qesharake, në një moment filloi të qeshte me të madhe edhe vetë teto Ana; kur u kthyem në shtëpi ndjeu orën me lavjerrës që binte dhe, befas, tha: “Sa e kam kërkuar këtë orë, duhej të më kishit thënë që ishte këtu”. Pastaj shtoi: “Javën tjetër do të shkojmë në kopshtin zoologjik, sepse do të vijë një elefant i ri, u pëlqen fëmijëve” dhe unë iu përgjigja se Alisa, tashmë, është e madhe për gjëra të tilla, por ajo më kundërshtoi duke thënë që ajo, me të vërtetë, mendonte për Kristofin dhe unë, pa e zgjatur, pohova me kokë.

Meqenëse prej kohësh nuk kisha asnjë lajm për atë faqezium, dhëndrin tim, shkova për të marrë ndonjë informacion në polici dhe më thanë se procesi penal ishte pezulluar. Kur kërkova

arsyen, polici duke kontrolluar dokumentet, m'u përgjigj: "Ka ardhur këtu vajza juaj dhe ka bllokuar gjithçka". U inatosa dhe i thashë që ishte e pamundur, kishte dy proces-verbale ose raporte mjekësore, si quheshin, dhe se unë s'e kisha pranuar anulimin, por polici më sqaroi se unë nuk kisha qenë e pranishme në ngjarjen, madje nuk isha as dëshmitare, ndërsa vajza ime, e cila ishte pala e drejtpërdrejtë në këtë proces, vajza ime nuk donte të dëshmonte që ishte rrahur. Atëherë unë u nervozova: "Po çfarë duhej të bënte tjetër ai maskara, ta gjymtonte? Ta vriste? Nuk mjafton që i shkaktoi dështimin e barrës?". Polici më vështroi me trishtim dhe u përgjigj: "Rastet e dhunës familjare, zonjë, gjithmonë janë të ndërlikuara" pastaj lëvizi, nxori një gotë, e mbushi me ujë nga çezma dhe ma dha duke më thënë se më kuptonte, megjithëse, në të vërtetë, nuk më kuptonte fare, prandaj u largova.

Kur fola, në mbrëmje, me Alisën, më tha se denoncimi nuk do të kishte ndihmuar për t'i ndrequr gjërat dhe shtoi: "Mama, vërtet, do që ta fus në burg babain e djalit tim?". Nuk kisha përgjigje për këtë dhe, kur u ktheva tek teto Ana atë mbrëmje, ajo më vështroi dhe më tha: "Kveta, nëse nuk do të kujdesesh pak për veten, shumë shpejt, do të të mbulojnë thinjat". Unë mbeta e habitur, sepse, për herë të parë, pas kaq kohësh, nuk ma ngatërroi emrin dhe kjo gjë më hutoi aq shumë, saqë atë natë filloi të qaja përsëri, ndërsa shfleteja një album fotografish bardhë e zi duke u përpjekur të kuptoja, cilët persona nga familja jonë fatkeqe, ishin në fotografi.

Mendoja se, ato gjashtë muaj që Jozefi ishte në Pragë, do ta shikoja më shpesh, sidomos, kur Alisa doli nga spitali. Më shumë se e mendoja realisht – shpresoja. Por, në pranverë ai u kthye shtëpi, në Lhotka. Kur ishte këtu në Pragë me Alisën dhe Kristofin, në apartamentin tonë të vjetër, papritur, kuptova që e doja akoma, si më parë. Sigurisht ishte gjithçka ndryshe, krahasuar me tridhjetë vjet më parë. Nuk shkonim më nëpër koncerte bashkë dhe ai përpiquej të më shmangej. Herë pas here shkoja në Lhotka për të

takuar Alisën dhe Kristofin, kjo më lejohej - nga dita e fatkeqësisë së shkaktuar nga Maksimiliani Jozefi nuk më ndaloj më. Më bënte lëshim.

Në Pragë i gjeja bateritë për aparatën e dëgjimit dhe ia lija mbi raft, sipër koleksionit të disqeve të tij. Nuk më thoshte asgjë, por, kur kishte nevojë, i merrte. E di, sepse i numëroja. Dhe një ditë, një ditë e kapa në një veprim të dukshëm dashurie. Kisha shkuar të mblidhja kërpudha bashkë me Kristofin, filloi të binte shi, prandaj e mbështolla djalin me mushamanë time dhe u laga vetë deri në palcë. Kur arritëm në shtëpi, u ula në kuzhinë, para sobës dhe Jozefi më përgatiti një grog e më solli peshqir për t'u fshirë. Dhe atë grogun, nuk do të kisha dashur ta pija, për ta ruajtur. Pastaj më dha dy aspirina dhe unë piva njërin – tjetrën e mbaj akoma në një kuti të vogël të gdhendur, të cilën Jozefi ma kishte dhuruar gjatë pushimeve, shumë vjet më parë dhe, ajo aspirinë, për mua, është kthyer në një aspirinë romantike e fshehtë.

2.

Kveta nuk arriti ta bindte të bijën për të filluar procesin gjyqësor kundër Maksimilianit, që ta rrasnin brenda, siç thoshte Kveta e të mos kishte mundësi t'u dilte përpara njerëzve të ndershëm. Për të falënderuar Alisën që kishte tërhequr denoncimin, Maksimiliani pranoi divorcin e menjëhershëm. Jozefi vazhdonte të jetonte në fshat dhe Kveta shkonte atje, herë pas here, për fundjavë bashkë me Alisën dhe Kristofin.

Një ditë, plot shpresë, u nis për në fshat vetëm, pa lajmëruar, por që në prag të derës, Jozefi i tha se duhej të shkonte urgjentisht në Pragë. Kështu kaloi dy ditë vetëm në fshat, në një izolim të thellë, saqë nuk e mori më kurrë një nismë të tillë. Madje as nuk kërkoi të kuptonte, nëse puna e Jozefit ishte vetëm një pretekst. S'kishte rëndësi. Të rrëmonte midis rrobave të vjetra në dollapë. Të rregullonte gazetën e revistat e vjetra. Të gjente lulet e vjetra,

të thata që Jozefi i harronte çdo vit i harronte t'i ndërronte me një tufë të rejash – e gjithë kjo e mbylli në një vend të vetmuar, në qetësi, në shurdhëri e vetmi të përqendruar.

Të vetmet shëtitje për të ishin në restorant jashtë dhe në varreza, dhe vetëm pasi mbërritjes së trenit të fundit nga Praga, kur e kuptoi se Jozefi nuk do të kthehej para së nesërme. Nuk u kthye. Bëri disa shëtitje lart e poshtë nëpër fshatin Lhotka, përshëndeti fqinjët dhe u kthye mbrapsht. Por nuk qe e lehtë të hynte në atë shtëpi të zbrazët, prej ku, njeriu për të cilin kishte ardhur, kishte parapëlqyer të largohej, sapo e kishte parë të vinte.

Ndërsa Kristofi rritej, Jozefi i lejonte vetes gjithnjë e më shumë, e çonte të bënte shëtitje, në garat e kuajve, nëpër kështjella dhe kala të ndryshme, në garat e zagarëve të gjuetisë, nëpër guroret aluvionale, dy herë kishin shkuar me tren në detin Balltik në Poloni, një herë në Jugosllavi në detin Adriatik, në stadiumin Marketa të Brevnovit për garat e motoçiklizmit, ndeshjet e hokejit dhe të futbollit. Përveç kësaj kujdesej që Kristofi, të paktën, një herë në javë të shkonte në kinema të shikonte filma uestern, të cilin, pastaj e tregonte. Asgjë nuk i jepte më shumë kënaqësi, sesa shëtitjet që bënin së bashku.

Me kujdesin që e karakterizonte, Jozefi u bë ekspert i madh i orareve të trenave. Krijoi një alfabet të tërë simbolesh dhe shkurtimesh, me të cilat shënonte birraritë dhe restorantet e stacioneve. Edhe self-serviseve të vogla, ku hanin, u bëhej një shkurtim dhe një përshkrim i detajuar me vlerësimin e ushqimeve, salsiçeve të mëdha e të vogla, tipe të ndryshme sallatash me patate që shërbeheshin. Jozefi kishte të qartë një gjë: fëmijët në dallim nga të rriturit, kanë nevojë të hanë rregullisht, por Kristofi mund të hante çka i pëlqente dhe jo ato që mamaja dhe gjyshja mendonin se i bënin mirë.

Nëse përshkonin një itinerar, tashmë, të bërë, ata e dinin me saktësi, ku duhej të shkonin të hanin, ku sallata me patate nuk

ishite dhe aq e mirë, ku të jepte dhimbje barku, prandaj ishte më mirë të porosisnin salsiçe ose qofte dhe, e gjithë kjo, pa humbur kohën e çmuar duke blerë ushqime ose budallallëqe të tjera. Në verë flinin në ndonjë motel të vogël turistik, në dimër udhëtonin më rrallë bashkë, sepse programet e tyre pengoheshin nga tekat e motit.

Në shkollë Kristofi s'kishte problem. Jozefi ia paraqiste aritmetikën, kiminë dhe fizikën në një mënyrë të tillë, që ai nuk e kuptonte se po studionte. Nganjëherë Alisa mërzhitej, sepse i biri kalonte më shumë kohë në fshat me gjyshin, sesa në shtëpinë e tij dhe nuk e kuptonte përse e kishte me aq qejf të rrinte në atë shtëpi të ngrohur keq, në Lhotka.

Kur mbushi nëntë vjeç, Jozefi vendosi që Kristofi duhej të kishte një dhomë më vete. Kur mbushi njëmbëdhjetë, vendosi se ajo që kishte, tashmë, ishte shumë e vogël dhe do t'i rregullonte një të re në papafingo. Në më pak se katër muaj e rregulluan së bashku. Në moshën trembëdhjetë vjeç, i vetmi kontakt i rregullt me Pragën ishte fagoti me rroba të palara që nipi e çonte nga Lhotka në Pragë dhe rrobat e pastra, të hekurosura e të arnuara që sillte në fshat nga Praga. Kjo i krijonte Alisë ndjesinë se dinte diçka nga jeta e të birit e të babait të saj. Nuk ishte plotësisht e vërtetë, nganjëherë shkonin në shëtitje të gjata dhe ajo as nuk merrte vesh gjë.

Një herë ata kaluan një javë të tërë në Sllovaki dhe ajo nuk ishte fare në dijeni. Në Sllovaki ata ishin mysafirë tek një mik i Jozefit, i cili i kishte shkruar se prapa vendit ku jetonte ai, sillej, shpesh, një ari dhe se, po të shkonin atje, do të mund ta shikonin. Ariu nuk u duk gjatë gjithë javës, por, patën rastin të shikonin një rrëqebull dhe u ndjenë të kënaqur. Kristofi bënte goxha mungesa në shkollë, por, meqenëse ishte i zoti dhe në mbledhjet e klasës shkonte gjithmonë gjyshi, i cili rregullonte gjithçka, s'kishte ndonjë gjë për t'u shqetësuar.

Viti 1989 e zuri Jozefin në spital. Fillimisht ishte ndier pak i lodhur, pastaj pak i turbulluar, derisa ana e majtë e gojës nuk i bindej më. Kur, pas disa ditësh, u zgjua kuptoi që kishte një iktus. Ky ishte shkaku që atij iu desh një vit për të kuptuar se ishte ndërruar qeveria. Ndërkohë Kristofi ishte lidhur me një vajzë, e cila, herë pas here, shkonte me të në Lhotka. Kur u kthye Jozefi në shtëpi kuptoi se nuk kishte më nevojë t'i çonte rrobat në Pragë, sepse Kristofi dhe Libushe kishin blerë një lavatriçe. Alisa habitet që ishte ndërprerë, papritur, bartja e rrobave nga Lhotka në Pragë dhe kthim dhe kështu mori vesh që i ati kishte pasur një iktus. I bëri të birit, tashmë disa centimetra më i gjatë se ajo, një predikim të gjatë të arsyeshëm, por ai iu përgjigj, pa kurrfarë emocioni, se gjyshi, thjesht, nuk donte ta merrte vesh askush.

Revolucioni i kadifenjtë që ndodhi atë vit, e impresionoi teto Anën aq shumë, sa që i ndërpreu përgatitjet për vdekje dhe, pas shumë vitesh, shkoi tek okulisti që ai të porosiste syze më të forta. Pastaj filloi të lexonte rregullisht gazetatat, të dëgjonte programet radiofonike dhe televizive dhe të kënaqej me ndonjë revistë – atëherë dilnin shumë. Kur Kveta po bënte plotësimin e dokumenteve për rritjen e pensionit të tetos që i takonte atë vit, me habi të madhe, zbuloi se ajo edhe teto Ana nuk kishin lidhje gjaku. Për disa ditë pyeste veten si t'ia thoshte asaj dhe, kur, më në fund, ia bëri të ditur, teto Ana tundi dorën me shpërfillje dhe tha se, sipas studimeve të fundit të gjithë njerëzit mbi Tokë ishin të afërt, të gjithë me të gjithë, dhe se i gjithë njerëzimi vjen, pothuaj me siguri, nga Afrika. Nuk i kujtohej – nga Etiopia apo nga Mozambiku. Kur e pyeti Kveta nga e dinte ajo këtë, teto Ana iu përgjigj se duhej të ishte kujdesur më shumë për veten e më pak për njerëzit që e rrethojnë dhe se kishte ardhur koha të gjente një burrë të mirë.

Kur i tha Kveta se kishte qenë e martuar gati gjatë gjithë jetës së saj si e rritur, tetoja vetëm ngriti vetullat dhe tha se po priste akoma që ajo ta njihte me burrin e saj. Nga nëntori i vitit 1989, teto Ana filloi

të përmirësohet gjithnjë e më shumë, megjithëse nuk ecte më si më parë. Kveta habitej sa mirë orientohej tetoja në ngjarjet që ndodhnin në botë dhe kur nuk arrinte të kujtonte emrin e ndonjë gjëje apo të dikujt, e zëvendësonte, menjëherë, me një nofkë. Për shembull, Presidentin filloi ta quante Mbreti i skuterit. Mbret, sepse jetonte në kështjellë, dhe skuter, ngaqë, në një intervistë, kishte treguar se, për të kaluar më shpejt nga një zyrë në tjetrën, përdorte gjatë korridorit të gjatë një skuter. Një shpjegim vështirësisht i kundërshtueshëm, sepse e kishte njëfarë logjike dhe përshkruante me saktësi disa momente të pakundërshtueshme të subjektit në fjalë, megjithëse i shfaqeshin vetëm teto Anës, jo gjithë botës.

Kristofi ishte i vetmi që e takonte Maksimilianin një a dy herë në vit. Babai i tij bëhej i gjallë, papritur, pa lajmëruar, i shërbente më shumë për të qetësuar ndërgjegjen e tij, sesa për të mësuar mbi të tashmen, të kaluarën apo të ardhmen e të birit.

Një ditë, në mars të vitit 1991, teto Ana mori një letër, e cila erdhi në një zarf të verdhë më i gjatë, krahasuar me metrikën e zakonshme të postës shtetërore. Në pullë ishte një mbretëreshë me një kurorë në kokë dhe vula mbante shkrimin *Londër*. Pasi u mendua pak, tetoja u kujtua për disa të afërm, të cilët që para pushtimit të gjashtëdhjetë e tetës kishin vajtur për të punuar përtej detit, ku kishin krijuar familje dhe nuk ishin kthyer më në Çekosllovakia. Nga letra mori vesh se, shpejt, do të vinte në Pragë njëri nga djemtë e asaj familjeje, emrin e të cilit e harroi në çast dhe, për këtë arsye, do ta quante gjithmonë kushëri.

Në letër thuhej se do të vinte pas disa ditësh dhe se, nga teto Ana, nuk donte asgjë, prandaj ajo s'e kuptonte përse e kishin shkruar atë letër. "Të gjithë kanë nevojë për diçka" i tha Kvetës me zë të vendosur "të gjithë!" Edhe ti ke nevojë që burri yt të kthehet tek ti, megjithëse nuk thua asgjë, e fsheh dhe, veç të tjerave, o Zot, të vjen edhe turp!".

14. Ardhja e kushëririt – Letra – Biseda me Jozefin.

1.

Kushëriri mbërriti në aeroportin e Ruzynes, i pajisur me një çekishte të përsosur dhe me një njohje të saktë të historisë çeke dhe të Europës Lindore. Ishte vizita e tij e dytë në Pragë, të parën nuk e mbante mend, kishte qenë pesëmbëdhjetë vjet më parë, në moshën dhjetëvjeçare, kur e ëma që kishte vazhduar të kërkonte në shtete të ndryshme të botës, peizazhin tipik çek, mbi të gjitha atë që kujtonte më shumë Polabin e origjinës së saj, kishte vendosur të bënte një ndalesë prej një dite në Pragë, gjatë një udhëtimi nga Helsinki në Vienë. Për fat të keq, e informuan, menjëherë, se kishte një vizë të pasaktë dhe se ajo që i duhej asaj, një vizë emigrantësh, nuk mund t'i jepej.

Prandaj, me një zhgënjim të madh nga institucionet, kaluan një natë të vetme në hotel, sepse avioni që duhej t'i çonte në vendin, ku jetonin, në Perëndimin kapitalist, atë ditë nuk fluturonte më. Kushëriri nuk mbante mend asgjë – gjithçka që dinte ia kishte treguar nëna e tij. Aeroporti i Pragës mund të ngatërrohej lehtësisht me çdo aeroport tjetër. Nuk të risillte ndonjë atmosferë të veçantë, edhe pse duhej të ishte unik, falë zbukurimit me lule dekorative, të cilat, gjithsesi, gjendeshin në çdo aeroport, të vendosura në të njëjtat pika të të njëjtëve terminalë, brenda saksive të njëjta të lëvizshme, pranë portave prej qelqi të njëjta, të mbërritjeve dhe nisjeve.

E ëma e kishte paralajmëruar se, në aeroportin e Ruzynes,

do ta priste një kushërirë e largët e teto Anës, një zonjë që quhej Kveta. Një fotografi e Jirit ishte futur në zarfin e letrës së parë drejtuar tetos. Jiri ishte një emër i çuditshëm dhe në Angli askush s'dinte ta shqiptonte. Sa herë që Jiri provonte t'ia mësonte ndokujt, shqiptimin e tij të drejtë, i duhej shumë kohë dhe me rezultate zhgënjyese – maksimumi që mund të arrinte ishte *Jirshi*.

Kishte pasur probleme që në vogëli, për këtë arsye parapëlqente ta thërrisnin Xhorxh. Tani do të qëndronte në një vend, ku të gjithë do ta shqiptonin saktë emrin e tij dhe ku të gjithë e kuptonin çekishten, atë gjuhë sekrete, të cilën në Londër e dinin vetëm e ëma, i ati, motra e tij dhe ca të njohur të paktë që mblidheshin në rrethet çeke. Jeta, përveç ish perdes së hekurt, paralajmëronte një aventurë të madhe.

Avioni, me të cilin erdhi, ishte prodhim rus. I vjetër, plot kërcitje dhe Jiri pati përshtypjen se bulonat që mbanin të bashkuara pjesët e ndryshme të trupit të avionit, vuanin nga njëfarë lodhjeje materialesh. Kur fluturuan mbi kufirin e Shtetit, kapiteni tha që po kalonin kufirin dhe, kur iu afruan Pragës, asistenti i fluturimit na informoi se, nga e djathta e avionit dukej kështjella e Karlshteinit. Jiri vështroi fqinjin e tij me një buzëqeshje ndjese dhe u zgjat për nga dritarja e vogël. Kështjella nga lart, dukej akoma më fotozhenike nga ç'e kishte njohur nëpër kartolina. U kujtua, menjëherë, çfarë shkruhej në guidat turistike: *e ndërtuar për të ruajtur bizhuteritë e Kurorës më 1348, në kohën e Karlit IV, mbreti më i rëndësishëm, perandor, çek*. Çekët e quanin Babai i Atdheut, që është diçka ndërmjet shprehjes së nderimit e të një titulli. Tërheqëse.

Pastaj avioni hyri në një korrent ajri dhe filloi të dridhej aq, sa Jiri u pendua që kishte porositur drekë dhe jo ndonjë birrë të thjeshtë, siç preferonin, në përgjithësi, pasagjerët çekë ose ndonjë lloj tjetër pije alkolike. Avioni u ul. Binte një vesë shi. Një autobus i transportoi pasagjerët drejt terminalit të mbërritjes. Pritën pak, pastaj një punonjës i kompanisë ajrore e hapi derën e kalimit duke

i paralajmëruar të përgatisnin pasaportat. I thoshte të gjitha në çekisht dhe në anglisht. Në anglisht bëri dy gabime, por kishte shqiptim më të mirë se punonjësi i Parisit, ku kishte qenë Jiri herën e fundit dhe, ndryshe nga ai, përpiquej të ishte i kuptueshëm. Shenjë e mirë, mendoi Jiri.

Në dhomën ngjitur ishin dy kabina prej qelqi, ku ishin ulur dy policë. Udhëtarët u rreshtuan në dy radhë dhe, një nga një, i paraqisnin pasaportat policit në sportel. Polici kishte uniformë jeshile të errët me shenja të kuqe. Nuk buzëqeshte. Kishte një pamje të papërkulur, të rreptë, funerale. Kur i erdhi radha, Jiri i zgjati atij pasaportën e tij çeke, ku ishte shkruar se kishte lindur në Londër. Duke lexuar këtë, polici e shfletoi pasaportën me kujdes, e mbajti në dorë për një çast, pastaj vështroi Jirin. Jiri buzëqeshi në mënyrë kurajuese. Në aeroportin e Parisit buzëqeshnin të gjithë, edhe në Romë e Dyseldorf, edhe në Izrael njerëzit të buzëqeshnin, por në Pragë jo. Këtu polici nuk buzëqeshte fare.

Nga shprehja e fytyrës së tij, Jiri dyshoi se diçka nuk shkonte, kështu që, për të mos e irrituar, pushoi së buzëqeshuri. Polici u kthye tek faqja e të dhënave personale. “Lindur në Londër” tha ai. Jiri rrudhi zellshëm ballin, sepse nuk ishte i sigurt, nëse ishte një pyetje apo një konstatim. “Mmh” ia bëri polici. Mori vulën dhe, me një shprehje të pandryshuar, e vuri mbi pasaportën e Jirit. Jiri e mori me mend që ai polic nuk i buzëqeshte askujt. Uniforma ushtarake, natyrisht, nuk i jepte mundësi për këtë. Ngjyra jeshile e errët e mbërthente edhe aty, në atë aeroport, në periferi të qytetit. Dukej sikur do të dilte nga llogoret një mjet i blinduar, i kamufluar me degë dhe polici do të kërcente mbi të me shkathtësi dhe do të dilnin mbi pistë që të vraponin për të mbrojtur diçka shumë të rëndësishme.

Më në fund, ia hodhi Jirit pasaportën me një shprehje mospërfillëse dhe thirri: “Tjeeetriiii!!! Nuk është një fillim inkurajues, mendoi Jiri, kanë kaluar mbi dy vjet pas revolucionit

të kadifenjtë, por, me sa dukej, këtu në aeroport, s'ka arritur lajmi akoma. Por ç'rëndësi ka, është herë e parë që vij në Europën Lindore dhe s'mund të ankohej. Në heshtje e korrigjoi veten. Jo Europa Lindore, prindërit, gjithmonë, ishin shumë të prekshëm lidhur me këtë: Europa Qendrore! Kjo është! Europa Qendrore! Europa Qendrore!

Pasi mori çantën dhe valixhen doli në holl. Ishin rreth tridhjetë vetë që prisnin pasagjerët e ardhur nga Londra, katër a pesë prej tyre mbanin në dorë karta të përmasave të ndryshme. Emri i tij nuk ishte. Zonja Kveta, ndoshta, s'ka arritur akoma, mendoi Jiri, vështroi përreth dhe shkoi të këmbente paratë. Pastaj bleu një kanoçe *coca-cola*, u ul në një stol, e hapi dhe po e pinte. Pas nja dhjetë minutash, grumbulli i personave që prisnin, u shpërnda. Një grua rreth të gjashtëdhjetave, me flokë të thinjura, u afrua dhe pyeti: “Mos jeni ju, zoti Jiri?” Jiri e vështroi, kishte një pallto treçerekëshe me jakë gëzofi që, në Angli, do ta kishin dënuar me një margjinalizim të pamëshirshëm, në emër të luftës kundër vrasjes së kafshëve, kështu që Jiri shpresoi të ishte imitim.

“Jam Jiri, Jiri Novaçek” u prezantua.

“Unë jam Kveta Çerna dhe mendoj të jem tetoja juaj” tha Kveta duke shqiptuar çdo fjalë me kujdes të tepruar, në mënyrë që i huaji të mund ta kuptonte.

“Mirëdita” i tha Jiri.

“Mirëdita” u përgjigj Kveta duke u përkulur t'i shtrëngonte dorën. Teksa regjistronte me shikim jakën prej gëzofi dhe këqyrte bordurat prej gëzofi të mëngëve, duke i shtrënguar dorën vështroi shkarazi sytë e saj dhe vuri re, menjëherë, se kurrë s'kishte parë sy të tillë. Smeraldët, sikur janë jeshilë, tha me vete, por nuk ishte i sigurt, sepse s'kishte parë kurrë smeraldë në jetën e tij. Ndërkaq zonja Kveta u nis dhe ai e ndoqi me çantën e valixhen. Arritën në stacionin e autobusit dhe ajo filloi t'i shpjegonte si do të arrinin atje, ku duhej të shkonin. Jiri e dëgjonte me vëmendje dhe, kur

ajo përmendi Vinohradin dhe rrugën Jan Masaruk, ngrehu veshët. “Ishte ai ministri që e vranë?” pyeti.

“Po, ai. E njihni, Jiri” vlerësoi Kveta e kënaqur. Jiri u bë flakë i kuq dhe kjo ishte e dukshme. Për ta zbutur disi këtë, tha: “Por, që në Pragë bëhej verë, nuk e dija”.

“Verë? “u habit Kveta. “Ah, jo, është vetëm një mënyrë të thëni. Domethënë, Vinohradi, është emri i një lagjeje!”

“E kuptoj” u përgjigj ai dhe buzëqeshi. “Por në Bohemia kultivohen pjergullat apo jo? Më ka thënë nëna ime, në zonën e lumit Elba, kështu?”

“Po” u përgjigj Kveta që filloi të mërzhitet me atë bisedë për verën. “Po, në shumë vende. Edhe në Moravia kultivohet rrushi dhe në Melnik. Por, e dini, nuk jua kam thënë akoma se do të rrini, pikërisht, në Vinohrad, në shtëpinë e vajzës sime”.

“Ah” tha Jiri.

“Po, tek vajza ime”.

“Tek vajza juaj në Vinohrad, ku, gjithsesi, nuk bëhet verë” vazhdoi Jiri. Kveta nuk u përgjigj edhe, sepse po afrohej ora katër e pasdites dhe në atë orë, s’bënte dot pa një filxhan kafe, qoftë edhe të vogël – tani po fillonte t’ia ndiente mungesën. Alisa e sistemoi Jirin në dhomën e Kristofit, i cili nuk flinte aty, tashmë, prej dy vjetësh. Jiri u njoh me Alisën, nxori rrobat nga valixhja, pastaj të gjithë bashkë u nisën për në shtëpinë e teto Anës.

Kur hynë në apartamentin e teto Anës, Jiri ndjeu një përzierje aromash. Mbi të gjitha aromën e bimëve në kopsht që hynte nga një dritare gjysmë e hapur, pastaj erën e grimcave të pluhurit që fluturonin pa ndërprerje dhe, në fund, një erë urine, fare pak e ndjeshme. Kur hynë në dhomën e ndenjes ai pa të ulur në një divan të lartë, një grua të imët, me fytyrë të rrudhur prej breshke, e mbështjellë në batanije të ndryshme. Duhej të ishte, të paktën, nja nëntëdhjetë vjeçe. Flokët e saj të thinjur bënë kontrast me damaskun ngjyrë kafe të mbështetëses së divanit. Gruaja lëvizte me

një ngadalësi të madhe dhe, pasi rregulloi disa cepa të batanijeve, tundi dorën e rrudhur në drejtim të Jirit duke e ftuar të afrohej. Ishte pranuar për dëgjese.

“Pra, ti je Jiri” tha teto Ana, duke marrë me dorën e djathtë letrën e hapur nga komodina, ndërsa me dorën tjetër mbante syzet. “Atëherë, më thuaj si janë ata të tutë?” e pyeti. “Mirë, shpresoj. Për më tepër, me një djalë si ti, si duhet të jenë!” Jiri mori frymë thellë. “Natyrisht, mund të jenë të kënaqur që kanë një djalë” vazhdoi teto Ana.

“Unë kam edhe një motër” e ndërpreu Jiri, duke i vështuar të gjithë me buzëqeshje.

“Një fëmijë femër është i padobishëm” tha teto Ana. “Shikomë mua, unë s’kam pasur fëmijë, por, sigurisht, nuk do të kisha dashur vajzë, shikona ne, tri gra” i tha. “Tri gra!” përsëriti ajo duke i theksuar fjalët. “meshkujt nuk e kanë jetën të lehtë dhe nuk gëzojnë asgjë nga jeta. Pastaj me një ngadalësi të pabesueshme, ngriti gishtin tregues dhe vazhdoi: “Dhe jetojnë më pak, janë mjeranë të vërtetë burrat”.

“Po ku e ke dëgjuar këtë teto” e pyeti Alisa, e cila, ndërsa përgatiste darkën bashkë me Kvetën, e kishte dëgjuar bisedën.

“Po këtë e dinë të gjithë! Apo ti nuk e dije?” u përgjigj teto Ana. “Vdesin gjashtë a shtatë vjet përpara”. Ra zilja e derës. Kveta vrapoi ta hapte dhe u kthye, pas pak, së bashku me një burrë që luante me një palë syze të zeza të mëdha.

“Zoti...”

“Verner” tha burri.

“Zoti Verner thotë se e ke ftuar për darkë, teto?” pyeti Kveta në mëdyshje.

“Tungjatjeta, Karel, jam e gëzuar që të shikoj” e përshëndeti teto Ana.

“Zotëria do të darkojë me ne?” pyeti Alisa teto Anën, ndërsa e ëma, prapa atij, ngrinte supet dhe hapte sytë. “Ke harruar të na e

thuash, teto” i tha Alisa.

Por teto Ana nuk ia vuri veshin pyetjes dhe, kur u afrua mysafiri, e kapi nga mënga e xhaketës dhe i tha: “Ulu Karel, çfarë bën, nuk do të ulesh? Ulu. Mendo, ky djalë është djali i Eviçkës dhe ...o, zot, si e ka emrin burri i saj?”

“Babai im quhet Jiri, si unë” u përgjigj Jiri.

“Ne nuk njihemi” ndërhyri Kveta. “Unë jam Kveta Çerna dhe Kjo është vajza ime Alisa”.

“Verner” tha burri. “Verner, gëzohem”.

“Lëreni mirësjelljen, Kveta, mendoni për darkën. Jiri duhet të jetë i uritur, pas një udhëtimi aq të gjatë. Apo jo?”.

“Po, në fakt, do të haja çfarëdo gjëje” tha Jiri.

“E dëgjon, Karel, sa mirë flet çekisht, e dëgjon?”.

“Po, flet mirë vërtet, shumë mirë” komento i zoti Verner.

“E di çfarë më ka shkuar ndërmend, Karel, ti punon akoma në atë kompaninë e sigurimeve?”.

“Jo, ka kohë që nuk punoj më aty, Anina, që para revolucionit”.

“Ah, po tani çfarë bën?”.

“Tani punoj në bankë. Ta thashë herën e fundit, kur folëm bashkë”.

“Ah po, në bankë, epo edhe aty nuk është keq. Dëgjo, gjej ndonjë gjë për këtë djaloshin, për Jirin. Një punë”.

“Jo, jo, s’ka nevojë” tha Jiri.

“Ti hesht, sepse nuk e di si shkojnë gjërat këtu” tha teto Ana. Dhe vështroi zotin Verner. “Kopje e së ëmës, identik me Eviçkën, sidomos goja, a nuk është kështu Karel?”

“Mos na e vini re, nëse flasim për ju, sikur... të mos ishit këtu” kërkoi falje Veneri.

“S’ka gjë” tha Jiri.

“Në moshën time” tha teto Ana “po shkoj për nëntëdhjetë e pesë, Karel, Në moshën time, s’kam kohë më për këto mirësjellje, e di”. I hodhi Jirit një vështrim të mprehtë dhe ngriti krahun, ai

e kuptoi se kërkonte ndihmën e tij për t’u ngritur nga divani. E ndihmoi dhe teto Ana i buzëqeshi rrufeshëm, pastaj ia përkëdheli krahun, në të cilin mbështetej dhe tha: “Dhe ti, Karel, të lutem ma jep atë shkopin atje...atë, po atë”. Zoti Verner ia dha tetos shkopin, ajo u mbështet në të, nga njëra anë e mbajtur nga shkopi, nga ana tjetër nga Jiri, u nis për në dhomën më të madhe, ku do të hanin darkë.

Jiri përpiquej t’i kalibronte hapat e tij me hapat e vegjël të teto Anës dhe Karel Verner ecte pas tyre, duke u kujdesur që trupi i plakës të mos dridhej për ndonjë nevojë. Kështu, hap pas hapi, të tre ecën deri tek tavolina, ku pas pak do të shtrohej darka. Gjatë darkës, Jirit iu duk se mundimi i tij për të deshifruar ngatërrimin e ndërlikuar të marrëdhënieve, madje më i nyjësuar se filigranet e mjeshtrove të vjetër venecianë, nisi t’i jepte efektet e tij dhe ai filloi të kuptonte me kë kishte, vërtet, lidhje gjaku. Mirëpo, sapo i dukej se kishte gjetur, ku e niste një fill dhe ku mbaronte tjetri, vinte ndonjë fjalë e teto Anës ose e Kvetës, ose e zotit Verner, që e nxirrte fare jashtë nga ajo hapësirë e mbërthyer me vidat e logjikës së marrëdhënieve familjare. S’kishte rëndësi kush, çfarë thoshte – gjithçka tingëllonte në të njëjtën mënyrë. Për shembull, kur teto Ana theksoi, turbull, një nga linjat e origjinës së saj: “Pastaj, pas grushtit të Shtetit të dyzet e tetës, ai u martua përsëri në Gjermani dhe motra e saj që ishte në Kanada, u transferua në Vjenë; atje ajo lindi një djalë tjetër me burrin e dytë dhe motra e saj, e cila jeton në Visoçina, për këtë arsye, nuk munda t’i përfundonte studimet. Pastaj vajza e saj që besoj se nuk është më e madhe se Kristofi yt, Alisa, u martua me atë kushëririn e largët nga Opava – ja kjo është e gjitha”. Jiri filloi të mendonte se, për ta kuptuar plotësisht botën e çekëve, nuk do t’i mjaftonin datat e thjeshta historike. Pa u sflitur, në njëfarë mënyre, ai zbuloi se për të kapur kuptimin e këtyre gjërave, i duhej më shumë energji e mendjemprehtësi nga sa e kishte imagjinuar.

2.

Data: ajo që do ti, dita e dyta në Pragë.

Përrshëndetje, motër;

siç të premtova, po të shkruaj duke shpresuar që të jetë adresa e saktë dhe që të të vijë letra e të mos më duhet të udhëtoj përsëri nëpër gjysmën e botës, para se të kthehem në shtëpi, në Londër dhe të pres tre muaj të tjerë, si herën e fundit, kur isha në Romë. Për të qenë të qartë, kam folur me babin e mamin. Kishte një ngatërresë të vogël, sepse më kishin telefonuar në hotel, ku e kisha anuluar prenotimin dhe atje nuk ua kishin dhënë numrin që u kisha lënë unë. Pastaj babai mendoi t'i telefononte teto Anës, por, ajo, ose s'ka dëgjuar asgjë, ose e ka harruar, është pak a shumë njëqind vjeçe dhe ka pamjen e një breshke të vogël.

Më në fund, arritën të më gjenin, ndoshta tetoja ua kishte dhënë numrin e Alisë, domethënë të së bijës së teto Kvetës. Nuk është e lehtë të kuptosh kush është kush dhe s'kam arritur akoma të sqaroj, minimalisht, kushërinjtë e kujt jemi ne, në të vërtetë. Aeroporti – asgjë të veçantë, lulet të gjitha të thata dhe rrugët e pista. Plehra që bien nga kovat dhe bishta cigaresh kudo. Këtu janë ca makina qesharake që quhen tramvaj. Ndoshta nuk e dinë që bëhet fjalë për amerikanizëm, praktikisht, ata janë trena elektrikë të vegjël. Gjithmonë të përpiktë. Një kontrast i çuditshëm krahasuar me rrugët e pista. Ka edhe metro. E mrekullueshme, vërtet e mrekullueshme, duhet ta shikosh, do të të pëlqente shumë dhe do të kënaqte gjithë ëndrrat e tua fantastike të çmendura.

Që të kesh një ide – ajo funksionon mrekullisht dhe, në krahasim me rrugët plot plehra, është vërtet e pastër, si në Gjermani, pastaj, çfarë dizajni! Mendo që një stacion normal duket si brendësia e një anijeje kozmike nga serialet e vjetra të fantashkencës në TV, ata që të pëlqejnë vetëm ty, mamasë dhe Geofreit, tipi i Buch Rogers, Star Trek e kështu me radhë. Imagjino një fletë alumini

me ngjyra të ndryshme, mbi të cilën janë stampuar vizatime gjeometrike, hemisfera, vrima dhe gjëra të tilla. Nuk e di si u ka shkuar ndërmend. Thjesht e shkëlqyer, siç thotë babai në çekisht: të lësh mendtë.

Por, sikur të mos mjaftonte, pjesa tjetër e murit që nuk është mbuluar me fletë alumini, e tëra është veshur me mermer. Nuk bëj shaka: gur artificial ose mermer, ngjan pak si në një mauzole hapësinor. I just love it, sis! Atyre parapëlqej të mos u them, çfarë mendoj, kam përshtypjen se janë goxha të ndjeshëm në këtë drejtim, besoj se do të dashuroheshe edhe ti. Pra, këto janë shënimet e mia të para të udhëtimit. Të fala Geofreit dhe lidhu me mamanë, përndryshe do të të mallkojë përsëri. Dhe mos të të shkujnë në mendje të flasësh për çka ka ndodhur në Paris.

Xhorxhi

P.s. Shpresoj ta kesh vënë re Çekishten time të mirë! Eh!

3.

Zoti Verner kishte gjithmonë me vete një palë syze të zeza, të cilat i vinte rrallë. Vazhdonte t'i kalonte nga njëra dorë në tjetrën, duke hapur herë njërin bisht, herë tjetrin, sikur të ishte i përqendruar në çastin kur do t'i vinte në sy. Nganjëherë mbështeste një bisht në buzën e sipërme, gjithsesi, Jiri që të gjithë e quanin vetëm *kushëri*, nuk ia kishte parë asnjëherë ato syze të vëna. Zoti Verner ishte trupmadh, me një gjatësi mesatare. Kushëriri ia kalonte vetëm me pak centimetra dhe, falë moshës njëzet e gjashtë vjeçare, trupi i tij i dobët dukej shumë më elegant dhe i këndshëm, duke e bërë objekt të tipit të simpative, krejt sipërfaqësore, që e lehtësojnë shumë jetën, pa e vënë re fare i preferuari.

Zoti Verner, rreth tëmthave dhe në veshë, kishte flokë të bardhë të prerë shkurt, në pjesën tjetër të kokës dukej lëkurë tullace e

nxirë nga dielli. Merrte e nxirre frymë thellë, sikur bënte ndonjë ushtrim fizik veçanërisht rraskapitës; mbante kravatë të lirshme dhe nxitonte gjithmonë, ku dhe përse, nuk kuptohej. Një herë, kur e pyeti kushëriri, shtrëngoi fort dhëmbët mbi bishtin e hapur të syzeve të zeza dhe ra në mendime. Duke kuptuar se, pas pyetjes së kushëririt qëndronte interesi real, pa asnjë gjurmë ironie, vendosi t'i përgjigjej. "Punonjësit, kushëri, janë si trena ekspres" i tha. "Për të qenë më i saktë janë diçka midis trenit të zakonshëm dhe atij ekspres. Treni i zakonshëm tërheq shumë vëmendjen e njerëzve, ndërsa ekspresi, megjithëse është treni më i rëndësishëm, nuk bën aq përshtypje. Nxitimi është shpejtësia bazë e punonjësit.

Të tjerët duhet të mendojnë se ke gjithmonë punë, jo aq sa mund t'ia dalësh, sepse kjo mund të përdoret kundër teje, por aq sa organizimi i çështjeve administrative, juridike, dhe i kërkesave të klientëve ta justifikojë". Kushëriri e vrau mendjen pak rreth asaj fraze, fjalët i dinte të gjitha, por nuk arrinte t'ia nxirrte kuptimin, kështu që tundi kokën nga njëra anë në tjetrën. "Po të lësh përshtypjen se nuk arrin t'ia dalësh punës, mund të të konsiderojnë të paaftë, e kupton? Kushëriri pohoi me kokë. "Ndërsa po të sillesh në mënyrë që të duket se eprorët e tu të japin urdhra, të themi, jo të pakuptimtë, por, jo shumë të arsyeshëm, që ta ndërlikojnë jetën kot, atëherë ia ke dalë". Kushëriri pohoi prapë me kokë dhe u përpoq të nxirrte diçka të dobishme. Punonte në bankë prej një jave, por s'kishte zbuluar dot, cili ishte kuptimi i punës së tij. Eprori i tij, njëfarë Dostal, e kishte ngarkuar të organizonte mobilimin e tri zyrave. Kushëriri e kishte pyetur disa herë për çfarë do të shërbenin ato zyra, por nga përgjigjet e tij, kishte kuptuar se nuk e dinte as ai vetë. Zoti Dostal, vetëm i kishte thënë se, pas gjithë gjasave, do të ishin zyrat e tij, prandaj duhej të mobiloheshin me kualitet të padiskutueshëm.

Ishte një punë që duhej bërë për disa ditë, pastaj, kushëriri mbetej pa punë përsëri. Shkonin gjithmonë për drekë në një

restorant, vetëm dhjetë minuta larg, në këmbë, ku ai dhe zoti Dostal takoheshin gjithmonë me zotin Verner. Ndërsa hante supën, zoti Verner, barkmadh, djersitej gjithnjë. E gëlltiste me nxitim të madh, madje edhe me njëfarë zelli, pastaj nxirrte nga xhepi shaminë e bardhë ose të kaltër dhe fshinte fytyrën gjithë djersë. Pas kësaj, bëhej dukshëm më i qetë dhe fillonte të të bënte shoqëri. Kushëriri jetonte në shtëpinë e Alisë dhe ajo, nganjëherë, e çonte në shtëpinë e tyre në fshatin Lhotka, ku takoheshin me babain e saj dhe Kristofin.

Fillimisht, Alisa kishte shpresuar se ai dhe djali i saj do të miqësoheshin, nëse jo për gjë tjetër, të paktën, sepse kishin pothuajse të njëjtën moshë, mirëpo Kristofi i kushtohej tërësisht biondes së vet, Libushes, me një devotshmëri që s'e kishte parë kurrë, gjithashtu, gjatë kohës që rrinte aty, luante damë me gjyshin. Jozefi, tashmë, ishte burrë i moshuar. Në fillim kushëriri as që kishte menduar se ai mund të ishte në ndonjë marrëdhënie me zonjën Kveta, sepse ajo tregonte, të paktën, dhjetë vjet më e re se ç'ishte në të vërtetë. Dukeshin sikur i ndanin dy dekada, ndërsa diferenca ishte vetëm shtatë vjet. Kur kushëriri e vështronte Jozefin shikonte një plak të gjatë e të dobët, që çalonte shpesh me këmbën e majtë. Kur Jozefi e pyeste kushëririn për të rejat nga Anglia, kushëriri mezi i përgjigjej, s' dinte kurrë çfarë t'i thoshte, edhe pse e pyeste shpesh.

Atij i dukej se, pavarësisht nga përgjigja që do t'i jepte, bashkëbiseduesi i tij do të mbetej i kënaqur. Pastaj Jozefi e pyeti, nëse i pëlqente Çekosllovakia dhe kushëriri iu përgjigj se kishte qenë vetëm në Pragë deri tani dhe se Praga i dukej akoma më e bukur se Venecia dhe Jeruzalemi, dy qytete që i njihte nga afër dhe që, deri në atë moment, i kishte gjykuar si më të bukurat në botë. Përgjigja e tij e gjallëroi Jozefin, i cili u përpoq me të gjithë forcën e vet ta bindte se gabohej, megjithëse nuk e kishte parë kurrë as Venecien, as Jeruzalemin me sy. Ndërsa fliste i fërkonte pëllëmbët

e duarve duke prodhuar një si kërcitje gjethesh në vjeshtë. Mbështeti këmbën e djathtë mbi një stol druri të lëvizshëm, në origjinë – mbajtëse e një pianoforteje dhe tha: “E duam shumë Pragën, tepër, dhe nuk është mirë. Për gjithë jetën, përveç atyre dhjetë vjetëve që kam kaluar në burg, kam punuar në Pragë si inxhinier ndërtimi. E njoh gjithë nëntokën e Bohemisë qendrore. Njoh sistemet e ndryshme të përforcimit të ndërtesave, i njoh themelet e pothuaj të gjithë pallateve të Pragës. Hartat e zbulimeve gjeologjike i dija përmendësh, megjithëse tani që jam në pension vë re se kam harruar gjëra që kurrë s’mendoja se do t’i harroja”. Nuk ishte e kuptueshme, madje as e sigurt që Jozefi dhe kushëriri ishin reciprokisht të interesuar për mendimet e njëri tjetrit dhe nuk ishte e sigurt, nëse donin të komuniknin për ndonjë gjë. Por Jozefi ishte fiksuar në atë mendim dhe ashtu vazhdoi.

“Shiko, çdo herë që shkoj në Pragë më duket sikur jam në një muze. Vitin e kaluar isha në spital dhe flija disa metra larg nga shtëpia e Faustit. Çdo vend mban diçka nga historia”.

Kristofi ishte jashtë në kopshtin që rrethonte shtëpinë për të çmontuar e pastruar makinën korrëse dhe, përmes dritares kapi ca fjalë. Hyri në shtëpi, përgatiti një pije me thanat që kishte mbledhur Libushe, e hodhi në dy gota dhe ua çoi një Jozefit dhe një kushëririt. Kushëriri ishte gati për të ikur, por Kristofi i dha gotën dhe ai e mori në dorë, e piu dhe u ul përsëri. “Gjyshi nuk flet shumë” tha Kristofi “por nganjëherë i pëlqen të flasë, është një gjë e rrallë apo jo, gjysh?” tha Kristofi duke vështuar Jozefin. Jozefi i uli sytë tek gota, falënderoi me një lëvizje të kokës dhe u përhumbe në vorbullën e mendimeve.

Mendonte që kryeqyteti ishte i madh, neveritshëm i madh dhe neveritshëm i ngjashëm me një muze të urryer. I neveritshëm siç ishin dikur trupat e kafshëve të balsamosura. Por, tani, nuk iu duk e nevojshme t’ia thoshte këto një kushëririt të ri, të huaj. Ku e njeh ai Pragën, mendoi, dhe me zë të lartë tha vetëm: “Kur ta njohësh

Pragën pak më mirë, do të flasim prapë”. Pastaj filloi të thithte me gllënjka pijen e tij të ftohtë dhe e kaloi gotën në fillim mbi faqen e djathtë, pastaj mbi të majtën. Akoma faqja e majtë nuk e kishte ndjeshmërinë e së djathtës. Ishte si një anestezi tek dentisti. Vrau mendjen përse vallë qyteti i tij nuk e joshte më...

Ndoshta bukuria u përket vetëm modeleve të përhershëm. Ndoshta çdo gjë është gjeometri e aplikuar. Pak forma që përsëriten kudo. Çfarë është arkitektura, nëse jo gjeometri e aplikuar? Trekëndësja. Rrathë. Spirale. Çfarë është tjetër ky barok viral? Por nuk është vetëm kjo. Përse, mendoj. Ndoshta varet nga fakti që, tashmë, prej më shumë se një shekulli, nuk evoluon asgjë. “Ndoshta ky është shkaku” tha duke iu drejtuar kushëririt. “Është në ruajtje, në gjithçka e për gjithçka, në ruajtje deri në vdekje!”.

“Po flisni për Pragën? Mendoni që Praga është ruajtur në mënyrë të tepruar?” pyeti kushëri.

“Mendo që në Pragë, në Muzeun Kombëtar të sheshit Shën Vençeslao, është skeleti i një balene. Nuk e di se çfarë ka të përbashkët një skelet balene me vlerat morale dhe intelektuale të popullit çek, por imagjinoje të jetosh brenda atij skeleti. Çdo mëngjes ti zgjohesh, ecën nëpër ato salla pompoze, të mbushura me marmota, nuse lale, brejtës të ndryshëm gjembaçë, të cilët duhet të bëjnë dush me naftalinë që të mos pushtohen nga mola. Kështu është atje brenda. Gjithçka e vdekur dhe pa jetë. Një kufomë dekorative që shkëlqen, të cilën turistët e kafshojnë si hienat mishin e kafshëve. Është një kufomë kolosale turistike. Ja çfarë është.

Zotërinjtë e rinj nuk mendojnë më për njerëzit që banojnë aty. Madje as nuk shtiren. Është çështje kohe, do ta mbulojnë tregun e Sheshit të Vjetër dhe Sheshin Shën Vençeslao me çati qelqi. Teknikisht nuk është problem, mund të fiksohet kudo për tri ditë, i kam bërë llogaritë. Pastaj do ta mbyllin dhe do të bëhet - gjysmë kuriozitet turistik, gjysmë - një muze i mpirë. Megjithatë, çfarë

pretendojmë? Jo, është ajo që meritojmë”.

Konsideratat e gjyshit e shqetësonin Kristofin. Këto dhe diskutime të tjera të ngjashme që vinin nga hiçi dhe nuk të çonin asgjëkund, së bashku me faktin që aftësia e tij në lojën e damës, ishte pakësuar dukshëm pas iktusit, e turbullonin. Para se të shtrohej në spital, alernoheshin në humbje dhe fitore, pak a shumë një me një, tani gjyshi humbte gjithmonë. Për më tepër, kohët e fundit shprehej në mënyrë të çuditshme, me fraza që i kishte konsideruar, gjithmonë, të pasakta, të vlefshme vetëm për librete operash. Ai shprehej, gjithmonë, në mënyrë të thjeshtë e pragmatike. Fliste qartë e saktë. Ndërsa tani, mendimet e tij nuk ishin të sakta. E vetmja gjë që e qetësonte ishte se javët e fundit, dukej më i kënaqur dhe kishte filluar të vinte pak rregull në shtëpinë e fshatit. Ndoshta kishte filluar të ndihej më mirë.

15. Letër mbi krapin

E dashur Sara,

Kam vendosur të të tregoj për këto ditët e fundit. Dje, duke u kthyer nga një kurs disaditësh afër Pragës, ku isha dërguar nga banka, çova në shtëpi valixhet me ca dhurata dhe dola përsëri që të blija diçka për të ngrënë. Ishte një ngricë që të çante, siç thonë këtu, megjithëse nuk e kam kuptuar mirë akoma domethënien. Duket se s'ka të bëjë fare me të goditur, pra me – të çash diçka ose dikë – kjo vetëm si shënim... që edhe ti të mund të mësosh diçka të re; çekishtja që flasim ne është pak më ndryshe nga ajo që flitet këtu, ti je motra ime e madhe, prandaj meriton pak mësim.

Pra kisha ndërmend të blija diçka për të ngrënë, kur pashë rrugës burra me përparëse të gjata lëkure. Vetëm burra – s'kishte gra ose vajza. Mbanin përparëse të gjata prej lëkure, nga të cilat pikonte ujë i pistë. Deri dje mendoja se çekët ishin njerëz miqësorë dhe mjaft të qytetëruar. Në vështrim të parë është kështu. Vetëm se, kur i pashë të angazhuar në këtë ritual, u ndodha para një gjëje të papritur. Ndoshta, ato fuçi të mëdha, plot me ujë e peshq, i kishin nxjerrë në rrugë, kur ishte akoma natë. Voza – i quajnë. I quajnë tamam si ato enët ku ruhet birra – voza. Por nuk besoj se peshqit i vënë në birrë, megjithëse pas së djeshmes, nuk jam më i sigurt.

Por nuk ishte pamja e atyre vozave të mbushura me peshq që më habiti më shumë dhe as fakti që, në më pak se një ditë, i kishin vendosur kudo. Mbeta i shastisur, kur pashë t'i vrisnin, domethënë, i vrasin akoma, aty, në qoshet e rrugës, aty në vend. Marrin një thikë - kanë lloje të ndryshme thikash - pastaj kanë

një rrjetë të vogël, me të cilën nxjerrin peshqit nga voza. Burri me përparëse e nxjerr krapin nga uji, e vë mbi një tavolinë, e mbulon me një leckë, duke e mbajtur në një mënyrë që të mos rrëshqasë. Pastaj, e vret me një goditje në qafë. Shpesh krap i lëviz me nervozizëm, pavarësisht nga truri i tij i pakonsiderueshëm, ndoshta, e kupton çfarë e pret. E gjithë kjo kryhet në një qetësi absolute, Sara. Ndihet vetëm pllauritja e ujit.

Po të kishin zë peshqit, ndoshta, s'do të ishte e mundur të veprohej kështu, në publik, sepse ata do të rënkonin gjithë kohën. I gjithë qyteti do të rënkonte, i lagësht dhe i shqetësuar, midis ulërimash të mbytura. Por ja që ndihet vetëm uji që shushurin. Pasi e kanë goditur në qafë, burrat me përparëse lëkure e kapin krapin, në një mënyrë aq të rrufeshme, saqë mezi arrin ta shikosh, e presin në bark dhe nxjerrin të brendshmet e tij, aq të ngrohta, saqë nxjerrin avull. Mua m'u duk se, në atë çast, krap i jetonte akoma. Lëvizte. Pyeta disa herë, por më thanë se, në atë stad të operacionit, peshqit, tashmë, janë të vdekur.

Pas prerjes së barkut, gjithçka ngjyhet në gjak. Megjithatë askush nuk e vë re. Tëmthi, zorra, zemra, së bashku me organet e tjera, hidhen poshtë, në ndonjë cep. Këtë fazë nuk e kam vëzhguar mirë, të kërkoj falje, Sara, sepse isha gati për të vjellë. Gjithsesi, unë kisha dalë të blija diçka për të ngrënë. Dhe ndoshta nuk do të habitesh që unë nuk bleva asgjë. Asgjë.

Nuk kam mundur të ha dy ditë, kryesisht, sepse, sado që përpiqesha t'i shmangia ato vende për ekzekutimin e peshqve, sa herë që dilja, gjendesha përpara një voze të atillë. Pastaj erdhi moti i acartë dhe në trotuare u formuan pellgje të ngrira me ujë e gjak peshqish. Pas disa ditësh, arrita ta frenoj ndjesinë e neverisë dhe fillova të haja ndonjë gjë të vogël dhe kam reflektuar pak.

Ndoshta kjo hyn në ato që quhen zakone. Nuk jam ekspert, lavdi Zotit, por nuk besoj që, në këtë rast, të mund të bëhet fjalë për histeri masive.

Së pari, është një aktivitet që praktikohet veçmas, secili blen peshk për vete.

Së dyti, askush nuk manifeston shenja të ndonjë tensioni të veçantë emocional.

E treta, duket se e praktikojnë prej shekujsh. Nuk gjej mënyrë për ta saktësuar dhe jam mjaft skeptik lidhur me këtë.

Me siguri, banorët këtu marrin kënaqësi nga ky ritual dhe ua transmetojnë edhe bijve të tyre. Duket se i qetëson, i lumturon. Mora vesh, gjithashtu, se disa i marrin peshqit të gjallë dhe i vrasin vetë në shtëpi. Pra, nuk është e nevojshme që t'i vrasë një profesionist. Nuk e di, nëse në shtëpi e respektojnë veshjen e ritit, domethënë përparësen e gjatë prej lëkure, çizme llastiku dhe ndonjë tip berete të veçantë, të cilat, siç kam vënë re, bëjnë pjesë në pajisjet e vrastarëve profesionistë të peshqve. Beretat shërbejnë edhe për t'u mbrojtur nga të ftohtit. Nuk kam guxuar ta diskutoj këtë dukuri me miqtë e mi vendas. E di, ata e kuptojnë se ne që jemi gjysmë të huaj, nuk i pranojmë besëtytnitë e tyre, prandaj janë mjaft të kujdesshëm për argumentet që diskutojnë me mua; gjithsesi, të gjithë janë të një mendje se kjo është mënyra e drejtë për të kremtuar festën e qetësisë, të gëzimit e të paqes. Krishtlindjen.

Mirupafshim Sara,

Xhorxhi

16. Alisa në shtëpinë e babait – Vitrina – Përpyjekja për afrim.

1.

Alisa shkoi në Lhotka të premten pasdite. Duhej të kishte arritur me trenin e një e tridhjetë e shtatës, por për shkak të ndërprerjes së linjës hekurudhore, pasagjerëve u vunë në dispozicion autobuzat për këtë rast. Ishin vetëm dy autobuza dhe kishte shumë pak vende për pasagjerët e trenit, prandaj shpërthyen zënka të furishme midis udhëtarëve dhe punonjësit të hekurudhës që këmbëngulte se kjo çështje nuk hynte në kompetencat e tij. Pas njëzet minutash pritjeje u shfaq, më në fund, një autobus tjetër dhe Alisa arriti me dy orë vonesë nga parashikimi. Gjithsesi, nuk do të takonte dot Kristofin dhe Libushen, të cilët kishin ikur që në mëngjes, por i vinte keq për kohën që kishte humbur rrugës.

Duke ecur në këmbë për në shtëpi u ndal në dyqanin e ushqimeve, bleu disa shishe të ndryshme plastike me detergjente të ndryshëm. Nuk e njihte shitësen dhe e kuptoi se nuk ishte nga Lhotka, por u habit, kur dëgjoi, tek arka, një theks të huaj. A është e mundur që dikush të vijë e të kërkojë fatin në Lhotka, mendoi Alisa. Mirë në qytetet e mëdha, po këtu në fshat? Arriti në shtëpi përmes kopshtit dhe, meqenëse dera nuk ishte e mbyllur me çelës, hyri brenda. Babai nuk ishte. Vuri qeset në hyrje, hoqi pallton dhe doli jashtë prapë. Jozefi ishte mbrapa në depon prej druri. Dera ishte gjysmë e hapur dhe babai po lëvizte nga vendi bankën e punës, mbi të cilën ishte fiksuar një morsë nga ana e dritares.

“Mirëdita babi!” tha Alisa. Ai nuk e ndjeu. E përshëndeti

prapë, por ai vazhdonte të tërhiqte tavolinën mbi dyshtemenë me dërrasa të pazdrukthuara. Atëherë ajo qëndroi në këmbë dhe po e shikonte. Kur e solli tavolinën poshtë dritares, u përkul mbi të, mbështeti kokën pas drurit dhe vështroi jashtë, në lartësi, përmes dritares së hapur. Alisa nuk e kapi kuptimin e atij gjesti. U afrua pranë tij duke e kapur për krahun me ëmbëlsi. Ai u kthye i habitur dhe, me një zë pak më të lartë se zakonisht i tha: “Mirëdita bijë”. Alisa ishte pranë tij dhe i shtrëngonte krahun.

“Mirëdita babi” tha ajo duke e puthur në faqe.

“Prit” tha Jozefi. “Më prit këtu një minutë” e urdhëroi dhe vrapoi në shtëpi. Kur u kthye thirri i kënaqur: “Tani të dëgjoj!”

“Mirë” i tha Alisa.

“Po, po është një aparat i mirë ky” i tha Jozefi. “Shikoje”. E hoqi nga veshi, e vuri në pëllëmbën e dorës dhe e ngriti me kujdes deri tek fytyra e saj.

“Mmh” ia bëri Alisa.

“E pe?” i tha, duke e ngritur zërin, përsëri, më shumë se duhej.

“E pashë” iu përgjigj ajo. “Është i vogël, eh?”. Babai e mbajti disa sekonda para syve të saj, pastaj, po me atë kujdes e vuri përsëri në vesh.

“I vogël dhe i lehtë” u shpreh ai me kënaqësi. “Pastaj, e di, nuk e vë re fare, sepse është aq i lehtë”.

“Me të vërtetë shumë i mirë” tha Alisa.

“Ky është progresi? Progresin s’mund ta ndalosh” tha babai me një grimasë. Pastaj i hodhi krahun mbi shpatulla dhe u nisën së bashku për në shtëpi. “Kristofi thotë se e ke tepruar pak me punë, prandaj duhet të kujdesem për ty dhe, mbi të gjitha, mos të të lë të bësh asgjë”.

“Ah” tha Alisa. “Epo” shtoi pas një çasti “në një farë kuptimi, është e vërtetë”.

“Për fat të keq, s’do të kënaqesh me Kristofin, është nisur sot për pushime me bionden e tij”.

“Të paktën do të kënaqem pak me ty!” tha Alisa duke i futur krahun të atit.

Alisa kaloi në fshat dy javë dhe pati rastin të vërente se i ati ishte, çuditërisht, shumë i fortë akoma, megjithëse, herë pas here, sidomos në mbrëmje, kur ishte i lodhur, çalonte me këmbën e majtë. Babai e pyeti për teto Anën dhe për kushëririn dhe, kur ajo e pyeti për Libushen, ai bëri një grimasë dhe i tha: “Mos fillo të luash rolin e vjehrrës, Ali”. Mori pamjen e një maçoku fërshëllyes dhe Alisës iu duk sikur donte të mbronte Libushen. E pyeti çfarë dinte saktësisht për të, pa e kuptuar se po sillej tamam siç kishte bërë mamaja, kur marrëdhënia e saj me Maksimilianin po bëhej serioze.

Jozefi i tha se nuk e kishte kuptuar mirë, cili ishte babai i Libushes dhe as për nënën e saj nuk dinte më shumë. “E rëndësishme është” përfundoi ai “të mos përzihesh. Vajza e shkretë, tri ditët e fundit, vetëm ka larë e pastruar. Nuk thoshte asgjë, por është e qartë se e bëri për ty” i tha. “Me mua s’ka problem, është mësuar me praninë time, ndërsa për Kristofin – ti e di që këtyre gjërave ai nuk u jep rëndësi”.

Alisës i mjaftuan tri katër sekonda, sapo vuri këmbën në korridor, që të kuptonte që dikush ishte marrë me pastrimin. Natyrisht, e dinte se niveli i kujdesit në punët e shtëpisë nuk ishte kriter vendimtar në zgjedhjen e partnerit, megjithatë nuk arrinte ta hiqte mendjen nga breroret në dritaren e katit të parë dhe nga pluhuri i depozituar mbi mobilet e dhomës së babait.

Aty për aty, nuk i kushtoi vëmendje, por telefonata e Kristofit e kishte mërzhitur. Ai i tha se do të ishte mirë që dikush të rrinte me gjyshin gjatë atyre katërmbëdhjetë ditëve që ata do të ishin me pushime, sepse kishte përshtypjen që diçka nuk shkonte mirë, pavarësisht se rezultatet e analizave ishin shumë të mira. Shqetësimin e tij e kuptoi vetëm pas dy ditësh, kur e pa të atin me sytë e saj, me keqardhje, që po bënte një kafe shumë të fortë dhe

vuri re veten, me frikë, duke i bërë atij një predikim absurd. Ai e dëgjoi, pak i habitur, pa thënë asnjë fjalë, pa e kundërshtuar, e priti sa të mbaronte, pastaj u përgjigj: “Kristofi ka pasur të drejtë, ka pasur të drejtë si gjithmonë”. Dhe shtoi: “E kam seriozisht, Alisa, qetësohu dhe përpiku të pushosh, ke nevojë”.

Pastaj piu, i qetë, kafën e tij tepër të fortë dhe shkoi në depo për të riparuar një vitrinë. Vetëm pasdite e kuptoi Alisa sjelljen e saj. Babai ishte pak më i qetë se ai. Të nesërmen në mëngjes vuri re se, për ndonjë arsye, i ati kishte filluar të rruhej me makinën elektrike, gjë që e habiti, sepse ai ato gjërat elektrike nuk i kishte duruar kurrë. Kur ajo e pyeti për shkakun, babai i tha se dhe ai mund të gabonte dhe se po bëhej gjithnjë e më tolerant ndaj së tashmes. Për shkakun e vërtetë nuk foli, ose, ndoshta nuk donte që ajo të vinte re sa shumë i dridheshin duart.

Pas disa ditësh, Alisa filloi të qetësohej pak dhe të përshtatej me përditshmërinë e të atit. Çdo mëngjes ngrihej rreth orës gjashtë dhe shkonte në depo. Punonte atje deri në njëmbëdhjetë. Në njëmbëdhjetë e linte punën, merrte gazetën nga bufeja, pastaj shkonte në banjo të lahej. Sipas motit, ulej me gazetën në dorë në një stol në kopsht, ose në kuzhinë. Në fillim, Alisa përpiquej ta kishte gati drekën në mesditë, por, të martën, babai i tha se, që nga ajo ditë e në vazhdim, drekën do ta hanin bashkë në birrarinë e fshatit. Kur ajo kundërshtoi duke thënë se ushqimi që përgatiste ajo ishte më i shëndetshëm, ai e ndërpreu me një lëvizje të dorës dhe i tha: “Me siguri do të vdes i shëndetshëm, gjithsesi kam dëshirë të të njoh pak me fshatin”.

Kur ishte dita e bukur, uleshin në një tavolinë jashtë, nën gështenjat plot gjethe. Babai, herë pas here, përshëndeste dikë dhe shumë nga ata që përshëndeste, Alisa nuk i mbante mend fare. Ato ditë ajo kuptoi se ishte e papërshtatshme ta quanin shtëpinë e Lhotkës – *shtëpia e fshatit*, sepse babai, në ato njëzet vjet a më shumë, që kishte jetuar atje, e kishte kthyer atë shtëpi fshati në një

shtëpi të vërtetë, në kuptimin e plotë të fjalës. Nganjëherë bisedat e tyre nisnin nga kujtimet e fëmijërisë së Alisë, pastaj kalonin, në një mënyrë a në një tjetër, tek tregimet e Jozefit për burgun. Herët e tjera, sidomos, kur flitej për Libushen, të cilën Jozefi këmbëngulte ta quante *biondja*, bisedat e tyre ndaleshin aty.

Megjithëse Alisa e dinte mirë se Libushe ishte vajzë e mirë dhe e matur, nuk arrinte të çlirohej plotësisht nga shqetësimet e saj. Në ato momente babai e vëzhgonte me vëmendje. Edhe ajo e vëzhgonte me kujdes dhe i thoshte: “Unë e di se nuk mund të bëj asgjë, por kam pak frikë – kjo është e gjitha”. Pastaj, babai i tregonte sa të lumtur kishin qenë, ai dhe nëna e saj, kur ajo i kishte njohur me Maksimilianin. Sa përshtypje të mirë u kishte lënë. “Dhe unë e ti e dimë mirë, si shkoi më vonë, apo jo, Alisa? Meqë ra fjala, ç”bëhet me të?” Qëkur kishte ndërprerë pagesën e ushqimeve, nuk kishin marrë vesh gjë për të, sepse Kristofi nuk e takonte më, pasi kishte mbushur moshën e pjekurisë.

Alisa i tregoi, gjithashtu, se kurrë s’e kishte kuptuar deri në fund marrëdhënien ndërmjet tij – babait të vet dhe djalit. E kishte të qartë vetëm se ata mbronin njëri-tjetrin, në raste të ndryshme. Dhe, më në fund, gjeti rastin ta qortonte që i kishte kërkuar Kristofit të mos i tregonte asaj dhe gjyshes për iktusin. “Është e thjeshtë, Alisa. Me atë kam kaluar gjëra, të cilat nuk kam pasur mundësi kurrë t’i përjetoj me ty. Ai më ka kompensuar gjithçka. E di, kur dola nga burgu, ti, tashmë, ishe bërë grua”.

“Vërtet?” mendoi Alisa dhe me zë të lartë tha “s’e kisha menduar kurrë, babi. Sa vjeç kam qenë? Dhjetë, njëmbëdhjetë?”.

“S’ka rëndësi” tha Jozefi duke tundur krahun. “Nuk ka kurrfarë rëndësie. Por ishe pothuajse e rritur, e kupton? Për këtë më vjen keq më shumë. Por është vetëm faji im. Kur ke fëmijë, duhet ta mbash gojën mbyllur e të ecësh drejt”. Alisa e kundërshtoi duke i thënë se e kishte admiruar gjithmonë për guximin dhe vlerat e tij dhe se ishte krenare për të. “Krenare” përsëriti ai “krenare? E për

çfarë, bija ime”.

Në fund të javës ajri filloi të ftohej, kështu që Jozefi nga depoja prej druri u zhvendos në shtëpi. Aty e montoi vitrinën prej druri dhe qelqi. Kështu filluan të kalojnë bashkë ca orë më shumë. Në fund të javës Jozefit i erdhi për vizitë një burrë me thinja, rreth të pesëdhjetave, nga Bërno. Ishte gazetari që, para pushtimit rus, shkruante artikuj për të burgosurit politikë. Babai kishte harruar t’i thoshte Alisë për takimin dhe u kujtua vetëm një gjysmë ore para arritjes së tij në stacionin e Lhotkës. Jozefi u dorëzua para këmbënguljes së vajzës dhe ndërroi pantallonat, por Alisa nuk arriti ta bindte që këmisha e punës, prej fanellate, nuk ishte veshje e përshtatshme për të pritur një vizitë. Atë ditë, duke bërë një përjashtim, Jozefi e lejoi Alisën të gatuate, gazetari hëngri drekë me ta, pastaj ai me babain u mbyllën në studio.

Gazetari kishte ndryshuar. Mbi të gjitha nuk ishte më gazetar. Ishte kthyer disa vjet më parë nga internimi dhe punonte në një shoqatë, e cila kërkonte të ndihmonte persona si Jozefi. Ai dhe Jozefi kishin këmbyer ca letra dhe, pikërisht, ai e kishte shtyrë t’u drejtohej institucioneve për të hetuar mbi arrestimin, mbi dënimin dhe burgosjen e tij. Burri i kishte flokët të thinjura, ishte shëndoshur, ca rrudha të holla ia rrethonin sytë dhe nuk i ngjante fare atij djaloshit që e kishte vizituar para njëzet vjetësh. Kur e pyeti Jozefi, cili ishte shkaku që merrej akoma me atë histori, ai iu përgjigj se gjysma e familjes së tij kishte pasur fatin e Jozefit.

“Përse nuk më tregove atëherë?” e pyeti Jozefi.

“Sepse më vinte pak turp, zoti Çerni” u përgjigj.

“Ju vinte turp?” pyeti Jozefi.

“Po, më vinte turp. Jo nga njerëzit e mi, por sepse nuk isha mjaft objektiv. Ose i paanshëm, siç thuhet tani” shpjegoi burri.

“Ku keni qenë gjithë këto vite?” e pyeti Jozefi dhe ai i tregoi me siklet për vendet e huaja, ku kishte jetuar. Kur iku ai, Alisa vuri re se i ati ishte me humor të mirë.

“Tani duhet ta mbaroj këtë vitrinën. Ndoshta, më në fund, ky hetim do të nisë dhe, kur të jetë në zhvillim, do ta çoj vitrinën në Pragë, nënës tënde, gruas sime” tha me emocion. Alisa nuk dyshoi për faktin që e kishte kuptuar shumë mirë, por e quajti të nevojshme të shtirej, sikur s’kishte kuptuar, sikur ai nuk i kishte folur fare.

“Çfarë po thua, babi!” shpërtheu më në fund, me një sekondë vonesë. “Çfarë thua?” i ati e vështroi shkarazi, pothuajse pa e parë. “Ti dhe mamaja jeni të ndarë, tashmë, prej më se njëzet vjetësh”

Atëherë babai e vështroi përsëri dhe tha: “Në fakt, janë bërë njëzet e pesë vjet, tre muaj dhe shtatëmbëdhjetë ditë. Nëse doje të thoshe qëkur nuk jetojmë më bashkë”.

“i ke bërë llogaritur, babi?” e pyeti Alisa.

“Mmh, nuk jam shumë i sigurt, sepse nga spitali, e di, ato ditë që kisha humbur vetëdijen, që atëherë, herë pas here më duhet të kontrolloj kalendarin. Ngatërrohem”.

“Domethënë, nuk ke pushuar së llogarituri?” përsëriti, ngadalë, Alisa.

“Kam një jetë të tërë që bëj llogaritje. Jam... inxhinier ndërtimi... Është një deformim profesional” shpjegoi Jozefi dhe vështroi me bisht të syrit Alisën, e cila e ndiqte duke tundur kokën, siç bënte gjithmonë, që e vogël, kur ishte shumë e habitur, ose kur përpiquej të kuptonte diçka.

“Njëzet e pesë vjet, tre muaj e shtatëmbëdhjetë ditë” tha Alisa. Babai u kthye dhe u nis për të dalë nga dhoma.

“Ti, mendon se mamaja do ta pranojë, babi?” Pas gjithë këtyre viteve, që e ke trajtuar me... aq përbuzje. O Zot i madh, po si guxon?! Jozefi u struk në karrige, pa ide të tjera, pa forcë, pa energji, pa autoritet, kishte mbetur vetëm një plak i brishtë e i sëmurë.

“E di, pëllumbeshë ” tha. “E vërteta është, e vërteta është se unë... asgjë, asgjë... nuk e di. Mund vetëm të shpresoj që të arrijë

të më falë, në ndonjë mënyrë, për sjelljen...time. Unë s'kam...nuk kam gjë tjetër”.

“Të të falë...?”.

“Mund vetëm të shpresoj”.

“Mirë, atëherë, babi” i tha Alisa.

“Për më tepër, është vetëm një vitrinë” tha ajo duke pohuar ftohtë me buzë të shtrënguara. “Vetëm një vitrinë” përsëriti edhe një herë dhe ishte e kënaqur që s’kishte asgjë të rëndësishme për të bërë atë ditë, sepse do të kishte dështuar në çdo gjë që kërkonte qoftë dhe një përqendrim minimal. Shpesh, në kujtime, ndiqte labirintin e marrëdhënieve të çuditshme e të pakuptueshme të prindërve të saj. Një labirint i sikletshëm, plot kurthe, tabù, e prita të bezdisshme, të cilat të dy i kalonin gjithë ankth, me virtuoizitetin e dy statujave prej porcelani, të gjymtuara.

“Nuk do t’i thuash gjë për vitrinën, kështu? i kërkoi babai Alisë.

“Dhe nëse nuk do t’ia them?

“Do të doja t’i bëja një surprizë, e di. Nuk do t’ia thuash, Alisa?

“Nuk e di, baba. Nuk e di” iu përgjigj e bija.

“Nuk e di pëllumbeshë?”

“Jo, babi, nuk e di” tha ajo.

2.

Gjatë gjithë kohës që Alisa qëndroi në Lhotka, babai s’bënte gjë tjetër, përveç restaurimit të vitrinës së tij. Fillimisht kishte qenë një vitrinë e vjetër prej druri, plotësisht e shkatërruar, që i përkiste periudhës, në të cilën shekulli i nëntëmbëdhjetë me hap kërcimi, ndryshoi në të njëzetin dhe viti 1900 u gjend i zbukuruar në stilin dell’Art Nouveau. E kishte blerë para shumë kohësh Kristofi për të vënë veglat në të, pastaj ai dhe Jozefi patën montuar rafte të gjata që ishin shumë më të përshtatshëm për të sistemuar pincat, kaçavidat, darët, sharrat çekiçët, vidat.

Vitrina mbahej mbi katër këmbë, të gjata njëqind e njëzet centimetra. Mobilja ishte e thellë pak a shumë pesëdhjetë centimetra dhe e lartë mbi nëntëdhjetë. Anët e brendshme ishin të bëra me një sistem të zgjuar shulash prej druri për fiksimin e rafteve, të cilët mund të vendoseshin, me një diferencë prej pak centimetrash, në lartësinë e duhur. E pistë, e vjetër, e prishur, e shtrembëruar, kishte mbetur për një kohë të gjatë në një qoshe të depos, derisa Jozefi i kishte gjetur një përdorim të ri.

Pasi u kthye nga spitali, duke rregulluar gjërat, kishte hapur ca kuti të vjetra, në të cilat kishte gjetur objekte të ndryshme, të mbledhura, për vite të tëra, bashkë me Kvetën. Enë prej argjile të zbuluara afër Olomoçit. Një çift rubinësh keltë. Guaska dhe valvula, dy monedha të vjetra çeke, katër moldavite, një trilobite, një ekzemplar i madh kuarci rozë, gurë granat të Kozakovit, kupa druri të Bojkovicës, një sëpatë bronzi dhe ca riprodhime të vogla modelesh të ndryshme vulash të ardhura nga India. Ishin të gjitha objekte që i kishin mbledhur bashkë, para se të lindte Alisa.

Jozefi dhe Kveta shkonin nëpër ekskursione, vizitonin dyqane antikuariatesh dhe Kveta gjente kudo ndonjë objekt që i interesonte, që e tërhiqte. Vlera e objekteve ishte e papërcaktueshme, ndoshta, nuk ishte më shumë se vlera e kujtimeve. Jozefit iu duk se ajo vitrinë e papërdorur ishte perfekte për t'i ekspozuar të gjitha ato objekte të vjetra dhe kështu filloi ta restaurojë. Në fillim dogji varakun e vjetër, pastaj përdori stukimin, rrashinimin, i kaloi sipër me dyllë, e lëmoi, preu xhamat dhe i fiksoi, pastaj pastroi dhe rregulloi bravën. Në panelin e pasmë, nga brenda, ngjiti një riprodhim të madh të simboleve të shkrimit në kuneiformë, fshiu mirë pluhurin dhe pisllekun nga objektet, i vendosi në tre kate xhami të vitrinës, pastaj risistemoi objektet nëpër kutia dhe filloi ta paketonte e ta përgatiste për udhëtimin në Pragë.

Kishte bërë punë jo sistematike, shumë të ngadaltë dhe kishte vazhduar disa javë, sikur donte ta shijonte pak nga pak; Alisa pati

rastin të ndiqte vetëm ndërhyrjet e fundit, lyerjen me dyllë dhe lustrimin. Lustrimin e kishte merak, disa herë kërkonte mendimin e Alisë. Por Alisa nuk mendonte për asgjë. Vitrina i pëlqente dhe, pasi babai e kishte pyetur disa herë, nëse i pëlqente druri i lustruar, ajo u përgjigj se nuk e dinte. “Epo çfarë të bëj” i tha asaj “nga - çfarë të pëlqen ty, mund të kuptoj çfarë do të preferonte nëna jote”. “Do të duhej një lyerje me llak, babi” i tha atëherë, kur e kuptoi sa e rëndësishme ishte për të ajo vitrinë. “Ndoshta duhet ta bësh me llak, por për tani, lëre kështu dhe, kur ta çosh në Pragë, do ta pyes mamanë, gjasme ashtu kot, si rastësisht.” Babai nuk u përgjigj, por dukej i kënaqur.

Pas katërmëdhjetë ditësh, kur Kristofi dhe Libushe u kthyen nga pushimet, vitrina ishte e restauruar, e çmontuar, gati për transport. Babait iu deshën edhe ca ditë për të vendosur, ku ta vinte dhe, në fund, e vuri në shtëpinë e Alisë, meqenëse kishte marrë vesh se Kveta ankohej nga gjithë ato rrangulla që ishin në shtëpinë e tetos. Kur Alisa i tha së ëmës se babai do t’i sillte asaj në shtëpi një vitrinë në stilin Art Nouveau me të gjitha objektet përkujtimore, teto Ana bëri komentin e saj: “Edhe Jozefi yt, e dashur Kveta, e ka një dërrasë mangët. Duhet vështruar nga e ardhmja, jo nga e shkuara. Ti dhe ai silleni, sikur të jetoni njëzet vjet më parë, në vend që të jetoni në të sotmen. Jeni, vërtet, të çuditshëm. Në vend që të më vështrosh mua – bëj ndonjë gjë!”.

3.

Ndoshta, që një koincidencë e thjeshtë që, një mëngjes, saktësisht në nëntë e një çerek, Jozefi u paraqit me Kristofin në Vinohrad, në shtëpinë e vajzës së tij. Së bashku me Kristofin mbanin një çantë shumë të gjatë dhe qesharake, ku ishin futur të gjitha pjesët e vitrinës. Kristofi e ndihmoi Jozefin të nxirrte materialet, pastaj i la takim për në mbrëmje. Para se të dilte, Jozefi e këshilloi të shkonte e të shikonte bashki të ndryshme, para e

të bënte celebrimin në Pragë ose në Kostelek, të cilit Lhotka i përkiste si njësi administrative. Ishte hera e parë që flitej për martesë dhe Alisa nuk arriti të kuptonte, nëse bëhej fjalë për një shaka mendjelehtë apo për një sjellje mendjelehtë, aspak delikate të dy burrave më të rëndësishëm të jetës së saj, që kishin vendosur ta informonin kështu për martesën e Kristofit.

Kur doli Kristofi, Alisa filloi ta mbushte me pyetje Jozefin dhe ai i tregoi se kishte dy muaj që përpiquej ta bindte Kristofin të bënte celebrimin në Pragë. Shtoi që, megjithëse edhe ai kthehej në qytet gjithnjë e më i pakënaqur, nuk mund të mohohej mundësia e gjerë e zgjedhjes që paraqitej, sidomos nga bashkitë. Por Kristofi vazhdonte të kundërshtonte. Alisa i tha: “E kupton, baba, se ti e ke bërë një adhurues të fshatit?” Jozefi, duke qeshur, i tha se nuk e kishte bërë për Kristofin, por për bionden, siç e quante akoma Libushen.

Pastaj Alisa e informoi se Kveta do të vinte fiks në mesditë për drekë, Jozefi vështroi orën dhe i tha se, herën e fundit që e kishte montuar vitrinën, i ishte dashur një orë e dyzet minuta, duke përfshirë dhe kohën që kishte kërkuar kaçavidën, të cilën, para ca kohësh, Kristofi e kishte marrë hua dhe kishte harruar ta vinte në vendin e saj në raft. Meqenëse ora ishte nëntë e dyzet e pesë minuta, Jozefi filloi punën.

“Nëna jote, gruaja ime, akoma vjen gjysmë ore më herët, kur është e ftuar?” pyeti.

“Jo, babi, jo më” u përgjigj Alisa. “Ka kohë që s’e bën më këtë, tani vjen vetëm dhjetë ose pesëmbëdhjetë minuta më herët dhe, pastaj, ankohet se askush nuk është i përpiktë”.

“Epo, siç duket, po plakët edhe ajo” tha Jozefi duke nxjerrë nga çanta e shpinës veglat. Kur, në njëmbëdhjetë e gjysmë fiks, Kveta hyri në shtëpi, vitrina ishte, tashmë, e montuar para një çerek ore. Babai vështroi orën e dorës dhe mendoi se gruaja e tij, vinte gjithmonë gjysmë ore para, ka gjëra që nuk ndryshojnë kurrë dhe mendoi, gjithashtu, që, mesa duket, akoma e njihte më mirë se Alisa

gruan e tij. Kur Kveta hyri në dhomë, Jozefi u ngrit nga divani dhe Alisa vuri re që ishte nervoz, siç nuk e kishte parë prej kohësh.

“Mirëdita, Kveta” i tha.

“Përshëndetje, Jozef” u përgjigj. Pak ashpër eci drejt tij dhe i shtriu dorën. Jozefi ia shtrëngoi. Pastaj këmbyen një përqaftim të nxituar, dy puthje të nxituara dhe, po me nxitim, u ndanë. Janë nervozë që të dy, mendoi Alisa përshëndeti të ëmën dhe të tre shkuan të shikojnë vitrinën, të cilën Jozefi e kishte montuar në dhomën e Alisë. Në raftin qendror ishin vendosur enët prej balte. Në atë të sipërmin gurët agatë keltë dhe kuarci i madh ngjyrë rozë. Në atë më poshtë, në qendër, ishte trilobiti, anash kupat prej druri të Bojkovicës dhe sëpata e bronzit. Në fund kishte sistemuar riprodhimet e modeleve të vulave të qytetit Indian Mohenjo-Daro dhe në raftin e sipërm granatët e Kozakovit.

“I gjete agatët?” pyeti Kveta e habitur. “Ndërsa ato janë nga Bojkovica, janë kupat prej druri të Bojkovicës” tha ajo me kënaqësi të dukshme.

“Po” u përgjigj Jozefi i kënaqur. “Ishin të gjithë në dy kutitë që gjeta”.

“Aha” u përgjigj Kveta që po këqyrte objektet e tjera. “E di, Alisa, që këto gjëra i kemi blerë, para se të lindje ti” tha Kveta duke prekur me dorë vitrinën. “Dhe këto, në atë kohë, nuk ishin deshifruar akoma, kështu, Jozef?” tha ajo duke treguar me dorë modelet e vulave të vogla të zgjatura, mbi të cilat ishte paraqitur një dem vetëm me një bri dhe sipër - karaktere të ndryshme të një shkrimi të panjohur. Në stampën e një vule tjetër ishte një anije me një vozitës.

“Si ishte Jozef, si ishte ajo historia? Çfarë kishim lexuar për atë librin? Tre hapa... Jo! Me tre hapa Vishnu mati gjithë universin. Diçka e tillë apo jo?” tha Kveta, pastaj pyeti: “Arrite ta deshifrosh Jozef?”.

“Eh jo, Kveta, nuk arrita” U përgjigj Jozefi. “E di, duhet kohë,

nuk është e lehtë” shtoi pas pak, i menduar.

“Epo, ejani të hani, por ftohen gjërat. Hë mama, eja. Pastaj do t’i shikosh mirë, as unë akoma s’i kam parë” tha Alisa dhe vajti të ulej në tavolinë.

“Po ajo, nga prapa çfarë është, Jozef?” pyeti Kveta para supës.

“Është shkrimi kuneiformë, Kveta” u përgjigj Jozefi.

“Po, po, këtë e di. Shkonim bashkë në ato konferencat në bibliotekë, të kujtohet?”

“Në cilën bibliotekë?” pyeti Alisa.

“Në bibliotekën e qytetit” tha Kveta. “Do të doja ta dija, me të vërtetë, ku i ke gërmuar ato kupat prej druri të Bojkovicës. Më intereson vërtet”.

“Ishin në njërën prej atyre kutive” tha Jozefi.

“Do kisha vënë dorën në zjarr që i kisha marrë me vete në shtëpinë e teto Anës. Kur ike ti”.

“E çfarë kanë gjëje speciale kanë ato kupa?” pyeti Alisa.

“Eh, është një histori shumë e gjatë!” tha Kveta.

“Nuk do të ma thuash, mama. E vërtetë? A kam të drejtë baba?”

“Epo” tha Jozefi “ka kaluar shumë kohë”.

“Një herë tjetër, Alisa, është një histori e gjatë” tha Kveta. Ndërsa mblidhte pjatat e supës dhe vinte në tavolinë gicin e pjekur, Alisa vuri re që babai vështronte jashtë nga dritarja me një pamje të pasigurt, por optimiste, ndërsa nëna buzëqeshte fare lehtë.

“E mor vesh, mama, se Kristofi dhe Libushe kanë vendosur të martohen?” e pyeti Alisa të ëmën për t’i dhënë fund asaj qetësie të zgjatur që ndërpritej vetëm nga tringëllimi i pjatancave, nga birra që hidhej nëpër gota dhe nga buzëqeshjet budallaqe të prindërve të saj. Përmendja e martesës u bë në momentin e duhur dhe, për një çast, e gjallëroi bisedën. Sapo mbaruan së ngrëni, Kveta u ngrit dhe filloi të vishet.

“Ku po shkon mamà?” e pyeti Alisa, së cilës nuk kishte shpëtuar pa vënë re vështrimi i tensionuar i babait. “Nuk mund të

rrish edhe pak?”

“Po shkoj vetëm të marr pastat...” u përgjigj Kveta. “Kalova para se të vija, por nuk ishin të freskëta. Unë di t’i dalloj! Dhe zonja më tha të kaloj më vonë, pasdreke i sjellin ato të freskëtat”.

Pasi doli Kveta, Jozefi doli në ballkon për të pirë një cigare. Pas pak Alisa shkoi tek ai për t’i thënë se kafja ishte gati. E pa që pinte duhen i shqetësuar, shkundte hirin në vazon e barbarozës së lulëzuar, atëherë iu afrua, i hodhi një vështrim kurajues dhe, pasi mbaroi cigaren, u kthyen të dy brenda.

“Bëre mirë baba, që bëre një hap përpara” i tha. Babai vështroi, në fillim atë, pastaj vitrinën, pastaj përsëri atë dhe tha: “Eh...po pse do ta lija atje të kalbej? Këtu, të paktën, shërben për diçka”.

“Mendon” pyeti Alisa “që do të mund të takoheshit, herë pas here, me mamanë, këtu në Pragë?” Jozefi nuk u përgjigj. “Mendoj se mamasë do t’i pëlqente”.

Jozefi qartësoi zërin dhe tha: “E pyete, nëse i pëlqen i lëmuar apo i lyer me llak?” e pyeti Jozefi.

“Jo, akoma nuk e kam e pyetur, babà” u përgjigj Alisa “S’kam pasur kohë”.

“Mendon se i ka pëlqyer?” pyeti Jozefi.

“Çfarë të të them, baba? Nuk e ke parë vetë?”

“Epo, unë mendoj se po”.

“Sigurisht që i ka pëlqyer”

“Vërtet?”.

“Sigurisht”.

“Po ti, Alisa?” e pyeti Jozefi duke rrudhur ballin. “Nuk mendon që është një budallallëk?”. Alisa tundi kokën. “Çfarë mendon të bësh, nëse Kristofi do të martohet me bionden?” e pyeti Jozefi.

“Në të vërtetë, nuk ndryshon asgjë, baba” u përgjigj Alisa. “Për më tepër, ata, tashmë bashkëjetojnë në shtëpinë tënde dhe aty do të rrinë apo jo?”

“Shpresoj se po”.

“Nuk mendoj se do të arrij ta bëj të kthehet në Pragë. E kam provuar, baba”.

“Është një djalë shumë i edukuar” buzëqeshi Jozefi “dhe do të rrijë tek unë” shtoi ai.

“Pra nuk ndryshon asgjë” tha Alisa.

“Jo? Ndoshta ke të drejtë. Po ti çfarë ke ndërmend të bësh?” e pyeti babai.

“E di baba, në një farë mënyre, e kisha parashikuar, e di...për martesën... dhe tani që Kristofi bashkëjeton me Libushen... nuk e di përse, më ndodh shpesh të kujtoj fëmijërinë”.

“Mos u bëj merak, do t’ia dalin” i tha Jozefi.

“Nuk jam e shqetësuar për ata” tha Alisa.

“Po çfarë të kujtohet?”

“Epo, gjëra të ndryshme. Sidomos natën, kur nuk më zë gjumi ... e di që kam kujtuar edhe gjyshen?”.

“Po ti s’mund ta mbash mend atë, Alisa, ke qenë vetëm katër a pesë vjeçe, kur ka vdekur ajo.

“E pse s’mund ta kujtoj?”.

“Nuk besoj... ”.

“Epo ja që më kujtohet... dhe më kujtohet edhe që mamaja mbante funde të gjata dhe bluza me mëngë, të errëta”.

“Janë gjëra që i mbajnë mend vetëm gratë, unë s’mbaj mend as pulovrin që mora vjet për Krishtlindje – jam skandaloz” pranoi Jozefi.

“Në fakt, nuk je dalluar kurrë për kujtesë. Ndërsa unë i mbaj mend të gjitha, edhe kur ka vdekur gjyshja dhe, pas vdekjes së saj – fustanin e gjatë, me mëngë të gjata, ngjyrë të errët që mbante mamaja. Më kujtohet që pati edhe një lloj infeksioni lëkure në atë kohë”.

“Infeksion lëkure?” pyeti Jozefi.

“Po, diçka e tillë. E kisha parë disa herë, kur bënte dush – e kishte gjithë lëkurën me puçrra të kuqe”.

“Po pse?”

“Për shkak të infeksionit pra”.

“Po si ishte?”

“Nuk e mbaj mend mirë – si plagë të vogla të kuqe. Ndoshta ishte ekzemë? Nuk jam e sigurt”. Në atë çast ndjenë të hapet dera dhe hyri nëna me dy tabaka të paketuara. Kaloj nëpër korridor dhe u drejtua për në dhomën, ku ishin Alisa me Jozefin.

“Ja, më në fund, erdhën” tha Kveta. “M’u desh të prisja pak, por tani këto janë shumë të freskëta. Ja ku janë, rrini aty, meqenëse po bisedonit aq shtruar” u tha Kveta dhe shkoi në Kuzhinë të merrte pjatat e vogla. Ndërkaq Jozefi vështronte tavolinën, me ndrojtje. Kveta hyri me pjatat dhe pirunjtë e vegjël, hapi ëmbëlsirat e paketuara dhe filloi t’i vinte nëpër pjata.

“Ne po merreshim me kujtimet, mama” tha Alisa.

“E çfarë po kujtonit?”

“Babai nuk beson se unë e mbaj mend gjyshen” tha Alisa.

“Në fakt, ke qenë shumë e vogël ” tha Kveta, vuri nga një pjatë të vogël para secilit, drejtoi trupin, vuri duart në mes dhe shtoi: “Duhet të kesh qenë pesë vjeç, kur ka vdekur gjyshja. E mban mend, vërtet?”.

“Po e mbaj mend, ajo më lante shpesh, kujtoj edhe atë fustanin e gjatë, blu të errët, që vishje ti, pas varrimit”.

“Një fustan blu i errët” përsëriti Kveta. “Epo, ndoshta, nuk e di”.

“Po, kur ke pasur atë infeksionin e lëkurës, diçka si urtikale, nuk të kujtohet?”.

“Nuk e mbaj mend fare, Alisa!”.

“Nejse, gjithsesi duhet të ketë qenë diçka nervore, sepse u zhduk, kur u kthye babai në shtëpi” tha Alisa dhe filloi të hante ëmbëlsirën. Babai mbante në dorë pjatën me pastat, me një shikim të zbrazët, të fiksuar në të. Befas u ndje një rënkim. Sikur nuk arrinte të mbushej me frymë. Vetëm, kur ndjenë të dytin, pastaj

të tretin, Alisa dhe Kveta e vështruan. Shikimin e kishte të ngulur në pjatën e ëmbëlsirave dhe nga sytë i rridhnin lot nëpër faqe. Për çudi iu deshën vetëm disa frymëmarrje e frymënxjerrje që fytyra t'i njomej plotësisht. Ngashërente dhe nuk arrinte të merrte frymë, edhe pse përpiquej sa mundej. E kishte fytyrën të lagur, lotët i rridhnin nëpër faqe dhe mbi mjekrën e rruar për festë, pastaj pikonin në qilim e në parket ose mbi këpucët e tij të lustruara si pasqyrë.

“Çfarë po ndodh kështu” u tremb Alisa. “Mos thashë ndonjë gjë të gabuar. Unë, gjithmonë, e kam dashur fort gjyshen.

“Alisa, hesht, të lutem. Hesht!” bërtiti nëna. Në atë çast babai u ngrit nga divani, gulçonte dhe përpiquej të merrte frymë. Duke rrëmuar në xhepin e pantallonave, arriti të nxirrte shaminë dhe fshiu gjysmën e fytyrës. Këmba e tij e djathtë, e shkëputur nga pjesa tjetër e trupit, u përpoq disa herë të lëvizte. Kveta e lëshoi përtokë pjatën e saj, u përkul mbi tavolinë dhe ia kapi dorën. Jozefi u lëshua në divan, por, kur Alisa vuri re se po i rrëshqiste dora nga krahu i divanit, duke rrezikuar të rrëzohej përtokë, e mbajti dhe, së bashku me të ëmën e shtrinë ngadalë në divan. Nëna, ia zbërtheu me një dorë kopsat e këmishës, ndërsa, me dorën tjetër u përpoq t'i mbante shpinën që nuk ishte në gjendje të qëndronte drejt.

“Jozef, o Zot, Jozef, më fal, më fal” i thoshte Kveta me zë të ulët, duke mbajtur me zor lotët.

“Po çfarë gabimi bëra, mama?” pyeti Alisa duke i fërkuar të atit tëmthas.

“Pusho Alisa, të lutem! Hesht! Nuk duhet të thuash asgjë, vetëm të heshtësh” i bërtiti Kveta, lotët ia kishin prishur tualetin e lehtë që i kishte rënë mbi bluzën e bardhë duke vizatuar një hartë të pazakontë të trupit të saj. Pastaj të dyja e ngritën Jozefin nga divani dhe e ulën në dysHEME. Alisa vrapoi në kuzhinë për t'i telefonuar ambulancës, ndërsa Kveta qëndroi e ulur në qilim pranë tij. Ia mbante kokën me duar, të mbështetur në prehrin e saj, fytyrën

afer gojës së tij për t’u siguruar se merrte frymë mjaftueshëm dhe duke qarë me ndërprerje, një qarje e thatë tashmë, ia përkëdhelte flokët dhe e thoshte emrin e tij pafundësisht.

Kur u kthye Alisa në dhomë, pa të ëmën që përkëdhelte fytyrën e babait dhe e kuptoi menjëherë se ai nuk merrte frymë më. U mbështet tek ajo dhe tha: “Mama... babai ka vdekur mama, shikoje...”. Pastaj tha: “Babi, babai im”.

Kveta embajti në duar kokën e Jozefit, derisa ra zilja dhe erdhën dy burra me përparëse të bardha. Bënë disa pyetje dhe Alisa u përgjigj. Njëri prej tyre u përkul mbi trupin e Jozefit, ndërsa tjetri u bëri shenjë që të largoheshin. Vetëm, kur, me bisht të syrit pa atë burrin të shkëputet nga trupi i babait duke tundur kokën si shenjë që, tashmë, çdo gjë kishte mbaruar, vetëm atëherë ia plasi të qarit. Në kuzhinë nëna e përqafoi. Njëri nga burrat i futi në dorë një formular, përshëndeti dhe u largua. Ato të dyja mbetën ulur në kuzhinë. Nëna i përkëdhelte së bijës flokët, lotët e saj, tashmë, ishin tharë, lotët e së bijës, sapo kishin filluar të bënin punën e tyre, braktisnin kanalet e lotëve, drejt shpateve të hundës, zbrisnin luginat e faqeve – njomnin shaminë. Kveta kaloi, në mënyrë të pavetëdijshme, dorën e majtë mbi gjoks, sikur donte të pastronte bluzën nga tualeti i prishur, atë tualet që do ta bënte të bukur, të dëshirueshme, tërheqëse për burrin e saj, burrin që, pavarësisht nga të gjitha pengesat që koha, padashur dhe aksidentalisht, kishte vënë në rrugën e tyre, pavarësisht nga grackat e historisë, dëshirat e papritura të trupit të vet, pavarësisht nga ndarja dhe lëvizja e bezdisshme, e pakëndshme, e mundimshme, nga kujtimet therëse – e kishte dashur gjithë jetën e saj.

17. Letër mbi hajdutin

Përschëndetje sis,

dje, më në fund, më besuan një punë të vërtetë. Dëgjo çfarë duhet të bëj. Zoti Verner, në bankën ku punoj, më ka ngarkuar të përgatis shënime dhe raporte të rëndësishme dhe për përgjegjësin e sektorit të investimeve. Do të të tregoj shpejt e shpejt për çfarë bëhet fjalë. Në vitin 1991 në Pragë u organizua një Ekspozitë. Nga rafti i letrave dhe kutive plot me fragmente të prera gazetash që më dhanë, kuptova se ushqenin shpresa të mëdha. Kishte një emërtim të tipit: Ekspozita universale çekosllloake. Se çfarë ishte ekspozuar aty, nuk e di, s'ka rëndësi për bankën. Fakti më i konsiderueshëm ishte se rezultonin borxhe prej qindra milionësh. Nuk jam gabuar në të shkruar – i afrohen miliardit. Dhe, meqenëse Çekoslovakia u nda, si një qelizë, në dy Shtete akoma më të vogla – ato borxhe nuk dëshiron t'i paguajë askush dhe kanë mbetur në bankë, në mes të kokës dhe qafës, siç thuhet këtu. Detyra ime është të ripërshkoj historinë e këtyre Ekspozitave dhe të propozoj një zgjidhje imagjinare të problemit për mediat. Jo një zgjidhje financiare - nuk do të ishte në gjendje ta bëja, sepse unë s'di asgjë, por një zgjidhje imagjinare.

Nuk e kuptoja saktësisht domethënien dhe iu drejtova zotit Verner, i cili m'u përgjigj se, ndoshta, më kërkohej një krahasim me Ekspozitat analoge dhe më shpjegoi se ajo ekspozitë realizua për të festuar Ekspozitën paraardhëse që ishte hapur, në të njëjtin vend, më 1891. E imagjinon dot! Para njëqind vjetësh! Edhe ajo ishte organizuar për të kremtuar një Ekspozitë tjetër të vitit 1791.

E kupton, Moxarti ishte akoma gjallë! Dhe kjo është detyra ime. Kështu që kam filluar punën për këtë. Zoti Verner më këshilloi, në rast se nuk do të dija, ku të vë dorë që do të thotë – çfarë të bëj – t'i drejtohem historisë. Duket se këtu pëlqehet shumë historia dhe se, duke iu referuar asaj – do t'ua dal të gjithave. Kam përshtypjen se, në javët e ardhshme, do të më duhet t'i kushtoj shumë kohë historisë lokale.

Për sa u përket gjërave të tjera – ka vdekur zoti Çerni. Ishte burri i teto Kvetës dhe babai i Alisë, e cila më mban në shtëpinë e vet. Kisha shkuar një dy herë me Alisën për ta takuar. Bënte diskutime të çuditshme për Pragën – nuk i pëlqente mënyra si po zhvillohej. Këtë fenomen, të gjithë këtu e quajnë globalizim, edhe pse, në fakt, bëhet fjalë për amerikanizim. Më duket se nuk e kanë shumë të qartë. Kishte ardhur së bashku me të nipin për të takuar të bijën në shtëpinë ku banoj unë; duhej të montonte një vitrinë të bukur, në të cilën donte të ekspozonte një koleksion, pastaj, nga sa kuptova unë, pasi kishin ngrënë drekë, shumë shpejt, ai kishte vdekur. Alisa kishte thirrur ambulancën, kishin ardhur menjëherë, por ai, tashmë, kishte mbaruar. Nuk pyeta më shumë – di vetëm ato që më tregoi Alisa. Gjithë javën e kam ndjerë Alisën të qajë pas murit.

Por unë, në të vërtetë, doja të të shkruaja për diçka tjetër. Atë javë, zoti Verner më kërkoi të shkoja në një birrari të Pragës, në vend të tij, sepse ai ishte ngarkuar me një punë në Vienë, të cilën nuk kishte mundur ta refuzonte. Duhej t'i jepja numrin e telefonit të vet - një të njohuri të tij, të cilin ma kishte përshtuar me hollësi. Unë e këshillova t'i telefononte, por nuk e kishte numrin e tij. E pyeta prej sa kohësh e njihje dhe më tha – prej më shumë se njëzet vjetësh. Prandaj shkova në atë birrari, ishte një restorant në natyrë, afër një fushe futbolli, të vogël, por, kur arrita, pashë që ishte i mbyllur. Teksa po prisja, aty afër, më zuri syri një burrë të moshuar me flokë të thinjura, të qethura shkurt. E kuptova se ishte

ai personi që duhej të takoja dhe u afrova. E pyeta, nëse quhej Karel – ishte ai, kështu që i dhashë numrin e telefonit. Më ftoi për një gotë birrë, sepse këtu pinë, vërtet, pa masë dhe s'kisha dëshirë të bëja miqësi në modelin sllav, me alkool.

Kur u kthye zoti Verner e pyeta për atë Karelin dhe më tregoi se ishin njohur më 21 gusht të vitit 1968. Gjithsesi, pasi i dhashë numrin e telefonit, eca nëpër Vinohrad, nga sheshi i Paqes, deri në sheshin Shën Vençeslao – doja t'i blija një dhuratë për ditëlindje babait dhe aty hasa në një manifestim të vogël të skinhead – ësve dhe të neonazistëve, të cilët, nga ana tjetër, i filmonte policia. S'kishte kurrfarë feste. Vetëm pas një jave e kuptova se bëhej fjalë për përvjetorin e ditës, si pasojë e së cilës, babai dhe nëna, qenë të detyruar të qëndronin në UK. Këtu me UK, nënkuptohet Anglia – po ta dinin irlandezët dhe skocezët, nuk do t'u pëlqente shumë. Dhe zoti Verner më tregoi se, atë mbrëmje të vitit 1968 ndodhej në shtëpi vetëm. Rreth orës dhjetë kishte rënë të flinte, por nuk po e zinte gjumi. I dukej sikur ndiente zhurmë në shtëpi. Për këtë arsye ndezi dritën, lexoi pak dhe, pastaj, e zuri gjumi.

Papritur ndjeu ta tundte dikush, me shumë kujdes. U zgjua dhe pa mbi kokën e tij një burrë me tuta pune që e tundte duke i thënë: “Zotëri zgjohuni dhe mos u trembni”. Ndërsa përpiqej të kuptonte, ai burri vazhdonte të kërkonte falje dhe të tregonte diçka jashtë nga dritarja. “Çfarë bëni këtu?” e pyeti zoti Verner dhe, befas, ndjeu një zhurmë traktorësh që vinte nga rruga kryesore. Gjithë ata traktorë në pesë të mëngjesit, tha me vete, nuk është e mundur. U afrua të shikonte nga dritarja e hapur, pa një varg tankesh që ecnin përpara në rrugë, në orën pesë të mëngjesit, xhamat e dritareve tringëllinin furishëm dhe tundej çdo gjë.

Ato ishin tanke ruse dhe, sipër tyre, ishin ulur ushtarë rusë me uniformë të gjelbër e me mitraloza. “Çfarë po ndodh” pyeti, i hutuar, zoti Verner “po ju çfarë bëni këtu?”. Burri vazhdonte të kërkonte ndjesë dhe, më në fund, i tha: “Unë jam një hajdut,

zoti Verner. Kisha ardhur për t'ju vjedhur dhe ju kërkoj falje që ju zgjova, por kjo është kolona e tretë e tankeve që kalojnë dhe mendova t'ju zgjoja, sepse, këtu ose ka plasur lufta, ose jemi pushtuar nga rusët. Ato që ju kisha marrë, jua ktheva të gjitha, i lashë pranë tavolinës; tani po iki dhe ju telefonojuni prindërve ose gruas tuaj, mos ma merrni për keq, por pashë fotografinë e familjes tuaj të bukur, pashë dhe një telefon në korridor, merrini në telefon, sepse, po të bëhet fjalë, me të vërtetë, për luftë ose për pushtim... Atëherë unë po iki, ju kërkoj ndjesë prapë, po kush e mendonte një gjë të tillë”.

Në atë moment, Veneri e kapi për krahu dhe i tha: “Për hir të Zotit, nuk mund të dilni tani, do t'ju qëllojnë”. Por hajduti këmbëngulte të largohej, kishte frikë se zoti Verner do të njoftonte policinë. Sapo panë të kalojë edhe një kollonë tjetër tankesh, e kuptuan që të dy se policia, atë ditë, nuk do të merrej me ta. Pastaj hajduti i kërkoi leje të bënte një telefonatë. Pasi telefonoi, u kthye dhe tha duke qarë: “Motra ime, zoti Verner, motra ime thotë se kanë arritur edhe atje dhe ajo banon në kufi me Poloninë. Zoti Verner, na kanë pushtuar”. “Të paktën, ma thoni emrin tuaj” iu lut zoti Verner “nuk di si t'ju drejtohem. Gjithsesi, s'mund të dilni tani”. Ai i tha se quhej Karel. “Karel, merrni gjithçka keni nevojë” e inkurajoi Veneri “nuk do të mund t'i marr me vete në varr”. Dhe ai: “Nuk mundem, zoti Verner “tashmë s'kam nevojë për asgjë”. Dhe Veneri i tha: “Paratë i gjetët, Karel, i gjetët paratë?”. Kareli pohoi: “Natyrisht i gjeta, të gjithë i fshehin në raft, në një filxhan, në rreshtin e dytë. Gjithsesi – i ktheva në vend”. “Epo, merr gjysmën, të paktën” këmbënguli zoti Verner. “Jo, nuk mundem” kundërshtoi ai, por zoti Verner e detyroi të merrte gjysmën.

Në fund, pasi kaluan tanket, e shoqëroi deri tek kryqëzimi dhe së bashku, dhanë kontributin e tyre në ndërtimin e një barrikade të improvizuar. Pastaj Kareli i tha se duhej të ikte që të mos

shqetësohej e shoqja. Dhe aty, në mes të atij kryqëzimi, arritën madje edhe të përqafoheshin. Verner i tha: “Kini kujdes Karel, ata janë rusë, për ta jeta e njeriut, nuk kushton asgjë”. Dhe Kareli i bëri një propozim: “Nëse do të mbijetojmë” kishin frikë se mund të përfundonte si masakrat në Hungari, para dymbëdhjetë vjetësh “nëse mbijetojmë, do të takohemi, pas në viti, në birrarinë Në Ruzhkë, kështu do t’ju kthej edhe paratë, jam pak ngushtë për momentin, nuk kam. Birraria Në Ruzhkë – është gjysma e rrugës për të dy”. Dhe që nga ajo ditë, takohen një herë në vit. 21 gusht. E pyeta zotin Verner: “Nuk e dini akoma mbiemrin dhe adresën e tij, zoti Verner?” Dhe ai m’u përgjigj: “Vëlla, jeta më ka mësuar ta respektoj privatësinë. Kareli s’ma ka thënë kurrë mbiemrin e tij, as adresën dhe unë s’ia kam kërkuar. Fakti që takohemi, tashmë prej njëzet vjetësh – një herë në vit, është më i rëndësishëm, sesa të hetoj në jetën e tij private. Mund të ndodhë që njëri prej nesh të mos mundet të vijë –ka ndodhur tri herë, më duket. Atëherë ai që mungon në takim, dërgon dikë tjetër në vendin e vet që tjetri të mos shqetësohet. Ja, kjo është e gjitha. Meqenëse, para gjashtë muajsh, më kanë ndërruar numrin e telefonit dhe nuk gjendem as në librin e telefonave, të dërgova ty, vëlla”.

Kjo ishte gjithçka për sot, sis.

Të përshëndes,

Xhorxhi

18. Letër dashurie në shkrimin kuneiformë

Kur u kthye në shtëpi, kushëriri gjeti në dhomën e ndenjes, një vitrinë të vjetër në *Art Nouveau* të restauruar, dritaren e hapur dhe disa module administrative të vendosura mbi tavolinë. Vetëm pasi hyri në dhomën e vet, ndërsa po hiqte njëren këpucë, ndjeu Alisën që po qante nga ana tjetër e murit. E veshi këpucën dhe doli në korridor. Por Alisa i njihte zhurmat e çerdhes së saj më mirë se kushëriri. Para se ai të vendoste të trokiste apo jo, ajo hapi derën e dhomës. E kishte fytyrën të thatë, të mpirë dhe të fryrë. I kishte ikur makijazhi nga buzët, kapakët e syve, qerpikët, kishte veshur një fund të zi dhe flokët e mbledhur nga mbrapa, ia linin ballin zbuluar.

Aty e mori vesh Jiri se Jozefi kishte vdekur. Pastaj Alisa e mbylli derën prapë dhe të shfryer dhimbjen, po jo pa e njoftuar më parë se darka ishte mbi sobë, duhej vetëm ta ndizte me një shkrepëse dhe ta ngrohte. Përkushtimi sllav ndaj rregullsisë së vakteve, e habiste, madje nganjëherë e prekte. Jo se i pëlqente të gjitha ato që i serviroshin, por sigurisht respektonin zakonet e të ushqyerit me kujdes të madh.

Kur Kveta u kthye së bashku me Alisën, teto Ana u zgjua nga zhurma derës. Hapi sytë menjëherë dhe lëvizti pak në divan, sapo i pa të hynin në dhomë, i vështroi me vëmendje dhe, me zë të lodhur, pak nervoz, me zërin e një personi që tashmë, prej kohësh, i bie të flasë për vdekjen, tha: “Atëherë, vajza, kush ka vdekur?” Kveta nuk u përgjigj, e zënë me gëlltitjen e lotëve. Alisa tundi kokën dhe pastaj tha: “Babai im, teto, vdiq babai im”.

“O Jezu Krisht!” thirri tetoja “jeni kaq të reja në krahasim me mua!” Psherëtiu dhe me gjeste të ngadalshme, filloi të shpëstjellonte batanijet, në të cilat ishte mbështjellë dhe, akoma më ngadalë, bëri të ngrihej nga divani. Alisa dhe Kveta iu afruan: “Ulur, teto, ulu, mos lëviz” i tha Kveta me një zë të rraskapitur.

“Jo, e dashur” protestoi teto Ana “sot më takon mua të kujdesem për ju”.

“Të lutem teto, kujdes se do të biesh” i tha Alisa.

“Më lër të ulem në tavolinë” tha tetoja “dhe më tregoni si ndodhi”. Në vend që të tregonin për çastet e fundit të jetës së Jozefit, filluan të veçonin nga telajo urgjente e kujtimeve të përgjithshme, kujtimet e tyre të mëshirshme që, me një fluturim të lehtë të një biplani, i kalonin distancat e viteve dhe tabelat e rajoneve. Kveta qante, Alisa i gëlltiste lotët, duke shtrënguar, secila prej tyre, nga një dorë me rrudha e me njolla të teto Anës. Të nesërmen shkuan të dyja në Lhotka ku Kristofi dhe Libushe kishin filluar të organizonin funeralin. Pas një momenti hutimi të madh, u vendos që ceremonia funerale të bëhej në Pragë dhe varrimi i Jozefit – në Lhotka. Libushe qëndronte mënjane gjatë diskutimit të nxehtë, të ndërprerë shpesh nga lotët që gëlltiteshin me zhurmë, që shpëlanin pluhurin e ankthit nervoz.

Asaj iu duk se Kveta dhe Alisa do të preferonin ta kishin varrin e Jozefit në Pragë, ndërsa Kristofi këmbëngulte për në Lhotka. Në fund u arrit një marrëveshje dhe ajo, s’mund të mos vinte re se Kristofi vazhdonte të përsëriste me vete: “Është një kompromis, një kompromis i ndyrë”. Kishin shkuar në Lhotka, sepse Kveta kishte dashur të kërkonte një kostum të bukur për Jozefin. Aty kuptuan se kostumi më i mirë i Jozefit ishte ai që kishte veshur, kur kishte shkuar në Pragë. Para se të niseshin, Kveta dhe Alisa morën ca gjëra të vogla nga dhoma e Jozefit si kujtim.

Të nesërmen Kristofi u ngjit në papafingon e mbushur me pako e kuti dhuratash. Mori kutinë më të bukur, e pastroi nga pluhuri

dhe e çoi në dhomën e Jozefit. Atje ai zgjodhi disa disqe gramafoni – ato që kujtonte se ishin të preferuarat e Jozefit, i vuri në kuti, mbylli kapakun e kutisë dhe e çoi në dhomën e vet. Në mbrëmje, kur Libushe u kthye nga puna, e hapi kapakun e kutisë dhe pa që ishte mbushur me disqe të vjetra. Kristofi i shpjegoi që ishin të preferuarat e gjyshit. “I shikonte gjithmonë, megjithëse, për shkak të problemeve me dëgjimin, nuk mund t’i dëgjonte më” shtoi ai, pas një pauze heshtjeje.

“Po tani, do t’i dëgjosh ti?” e pyeti ajo.

“Jo, nuk është muzika që parapëlqej unë, por kështu më duket sikur, gjithmonë, do ta kem gjyshin shumë afër” i tha Kristofi.

Kristofi ia kishte dhënë Kvetës programin e gjyshit dhe Alisa filloi të përgatiste funeralin. Kvetë e ndihmonte nga pak, por, për herë të parë, iu desh të pranonte që kishin filluar t’i mungonin forcat. E vetmja gjë që arriti të bënte ishte të mendonte për lajmërimin e vdekjes. Agjencia funerale ndodhej në lagjen e spitalit, midis disa institucioneve shëndetësore, afër sheshit Karlovo. Kur hyri në zyrë, i doli përpara një burrë me një pulovër bezhë, i cili u prezantua dhe e ftoi të ulet. Kvetë u ul dhe burri i vuri përpara mbi tavolinë dy tabela të mëdha, të cilat përmbanin shembuj citimesh e modelesh grafike për njoftimet e vdekjeve. Duke vështruar morinë e simboleve, po i merreshin mendtë. “E di, janë shumë” tha burri duke parë hutimin e saj. “Por mos u nxitoni”. A doni një kafe? Apo një çaj?” Kvetë tundi kokën. Burri u ngrit dhe i tha: “Zonja Çerna, zgjidhni me qetësi, unë do të jem këtu, në dhomën ngjitur, më thërrisni, sapo të vendosni. Do ta mbaj derën hapur, gjithsesi”.

Kvetë qëndroi pak aty ulur duke këqyrur me vëmendje simbole të ndryshme funerali. Pastaj u ngrit dhe filloi të ecte lart e poshtë nëpër dhomë. Ndjeu ca zhurma që kushedi nga vinin. Vështroi në dhomën ngjitur. Burri që i kishte shërbyer ishte larguar dhe, nga ana tjetër e zyrës, tamam përballë saj, ishte një derë xhami. Përtej portës dukeshin ca instalime që lëviznin shumë shpejt.

Duhet të jetë tipografi, mendoi Kveta. Sigurisht – tipografi. Kjo po që do t'i pëlqente Jozefit. Makineri, motorë, aparatura - do të ngecte aty brenda. Më në fund vendosi për citimin: *Nuk vdes ai që jeton në kujtimet tona*. Pastaj shtoi: *Bashkëshort, baba, gjysh dhe thirri nëpunësin e tipografisë, i cili kontrolloi gjithçka me hollësi, bashkë me të; pastaj, më në fund, mundi të kthehet në shtëpi*. Duke u kthyer në tramvaj, u ndje përsëri fare e pafuqishme. Çfarë do të jetë kjo, pyeti veten. Ishte e sigurt që nuk varej vetëm nga plakja e trupit, e trurit, e muskujve dhe nga komponentët e ndryshëm dytësorë. Po, kjo është! i erdhi në mendje papritur. Kjo ndodh, sepse s'kam më shpresë! Shpresa! Duhet të jetë kjo! Dhe s'ka asgjë që të më shpëtojë, të më shërojë, mendoi përsëri.

Tri javë pas funeralit, Kveta mori një letër rekomandë voluminoze, në një zarf të ashpër. E kishte tërhequr teto Ana duke vënë firmën e saj, sepse kishte ardhur në nëntë të mëngjesit, teksa Kveta kishte dalë në pazar. Teto Ana e harroi letrën që mbeti e mbuluar me trikon e saj deri të nesërmen, kur, duke rregulluar gjërat e saj, e gjeti përsëri. Vuri syzet dhe pa emblemën e madhe të Shtetit dhe trengjyrëshin. Emblema e Shtetit ishte e praruar. Si ka mundësi që nuk e kishte vënë re ditën e djeshme, mendoi teto Ana duke ia dhënë letrën Kvetës. “Erdhi dje” i tha.

“Dhe ti je zvarritur deri tek dera, teto?” e qortoi Kveta. “Do të kisha shkuar ta merrja në postë – mund të rrëzoheshe”.

“Të lutem, Kveta. Eca shumë ngadalë. Sa llafë për një letër” ia preu shkurt tetoja.

“Dhe postieri të priti?” pyeti Kveta.

“Epo, e pe letrën apo jo? Domethënë më priti. Unë, gjithnjë, sapo ndiej zilen, thërras menjëherë që të më presin, sepse jam e ngadalshme. Kështu që postieri më pret” tha teto Ana dhe me hapin e saj të zvarritur shkoi deri tek rafti, ku e prisnin gazetat e saj, racioni i saj i përditshëm.

Kveta vështroi zarfin, i dukej mëkat ta griste. Mori një palë

gërshtë. Kishte brenda një letër të trashë, të plotë, e bërë me dorë, mbi të cilën shndriste një filigran me emblemën e Shtetit. Para se Kveta të mbaronte së lexuari letrën, teto Ana, tashmë, po kthehej me gazetat e saj, të cilat i shtriu mbi tavolinë, duke studiuar me vëmendje faqen e parë. Ajo ishte faqja që lexohej më mirë, sepse i kishte titujt më të mëdhenj. Tani që shoqëria shkonte drejt modernizimit, imazhet në faqen e parë kishin filluar të shtypeshin me ngjyra dhe teto Ana ishte e lehtësuar. Ishte një progres që asaj i dukej vërtet i dobishëm.

“E di teto, nuk e di, nëse e kam kuptuar mirë, duhet ta lexoj edhe një herë dhe, ndoshta, është më mirë t’u telefonoj Alisë dhe Kristofit”. Teto Ana e vështroi Kvetën, e ngrysur, sepse sapo kishte mbaruar së lexuari një artikull mbi planifikimin e një geni që thoshte se panxhari i sheqerit ka një gen identik me njeriun. Teto Ana ishte pak e hutuar, sepse s’dinte çfarë të mendonte për këtë zhvillim. Artikujt, për të cilët s’dinte çfarë të mendonte, i nënvizonte fort me stilolaps të kuq dhe i rilexonte pasdreke. Zakonisht, në atë periudhë kohe, arrinte të krijonte një mendim. Tetoja qetësoi vështrimin e ngrysur, por vuri re se Kveta nuk po reagonte.

“Hë, çfarë është shkruar?” pyeti.

“E imagjinon dot teto, duket se Jozefit duan t’i japin një medalje”.

“Një medalje?” pyeti teto Ana.

“Një medalje”.

“Çfarë medaljeje?”

“Një medalje vlerësimi”.

“Vlerësimi?”

“Është shkruar” tha Kveta “se do të dekorohet për guximin që ka treguar gjatë burgosjes së tij, sepse ka ndihmuar shokët e burgut duke vënë në rrezik jetën e vet, gjithashtu edhe për kundërshtimin ndaj regjimit totalitar” lexoi Kveta.

Teto Ana vuri me kujdes syzet mbi gazetë dhe pas një çasti heshtjeje, tha: “Epo, janë kujtuar shpejt ata parazitë. Tani që ai i gjori është pranë Zotit”.

“Është shkruar” vazhdoi Kveta “se është një vlerësim i dhënë *post mortem*, pra *in memoriam*, vizë lidhëse, me vlerësim *post mortem*. Po ta pranoj – duhet të kontaktoj me modalitetin e dytë të tyre, të cilën unë e mirëpres më shumë”.

“Çfarë modaliteti, çfarë? Ç’drejqin do të thotë?”

“Këtë e kam kuptuar unë, teto”.

“E kur do të ta dërgojnë?”.

“Nuk besoj ta dërgojnë”.

“Jo?”

“Jo”.

“Po, atëherë, si do ta marrësh?”

“Do të duhet të shkoj ta marr. Jo, në fakt, është shkruar se, po ta pranoj, mund të shkoj ta tërheq unë që jam vejusha e tij, ose një person i deleguar nga unë. Vajza, nipi, ose një mik tjetër i familjes”.

“Një mik i familjes? Mmh?” përsëriti tetoja. “Mmh, e ku?”

“Në Kështjellë, teto, në Kështjellë”.

“Ah...” murmuriti tetoja. “Dhe do të ta dorëzonte... do të ta dorëzonte, e kuptove kush dua të them?” pyeti tetoja.

Kveta ndihej e turbulluar për atë mirënjohje të vonuar dhe nuk arrinte t’i kushtonte tetos vëmendjen e duhur, si gjithmonë. “Ai, si e quaj unë, kur s’më vjen ndërmend emri i tij? Mbreti i skuterit”.

“Personalisht ai, teto” u përgjigj Kveta që, në atë çast, nuk arrinte të kujtonte absolutisht asgjë. Ndihej vetëm e prekur që Jozefit i ishte akorduar një medalje për atë që ai, një herë, e kishte përcaktuar si një lojë skautistësh.

Dimri erdhi shumë shpejt. Festa kombëtare, dita e lindjes së Republikës Çekosllovake dhe dita e Shenjtorëve binin gjithmonë në të njëjtën javë, por deri në vitin e vdekjes së Jozefit, Kveta nuk e

kishte vënë re kurrë. Shkonte tek varri i Jozefit rregullisht, tri herë në javë dhe, kur Kristofi e mori vesh, fare rastësisht, se gjyshja shkonte në varreza, pa kaluar fare nga shtëpia e tij, të paktën, për të pushuar pak, e qortoi dhe e detyroi të merrte çelësat e shtëpisë dhe të qëndronte, të paktën nganjëherë, për të ngrënë darkë e për të pirë një çaj.

Varreza e Lhotkës ishte në faqen e një kodre, në majë ishte kisha dhe, kur me ngricat e para të shkurtra dhe, si gjithmonë, të papritura ranë të gjitha gjethet, Kveta i mbloodhi me grabujë, fillimisht nga varri i Jozefit, pastaj nga gjithë varret e tjera të afërta. Herë pas here ngjitej në kishë, ku ulej mbi mur dhe sodiste peizazhin vjeshtor të dallgëzuar lehtë. Nganjëherë shfaqej ndonjë tufë e vonuar zogjsh që nuk arrinte t'i identifikonte dhe, sa herë që shkonte në varrezë, ishte gjithmonë e më pak e çuditur që Jozefi kishte vendosur të transferohej atje. Vetëm, kur Kristofi ia kujtoi se po afrohej data e dorëzimit të medaljes së nderit *post mortem* të gjyshit, Kveta këqyri kalendarin dhe vuri re se, pikërisht, atë ditë kishte premtuar të rrinte në varrezë, në vend të zonjës Langmajerova, e cila kujdesej zakonisht për të. Kishin takim me mirëmbajtësin e pompës që furnizonte varrezën me ujë. Pavarësisht përpjekjeve për ta bindur, Kveta vendosi të rrinte në Lhotka dhe ia ngarkoi Alisë tërheqjen e medaljes.

Kur u kthye e bija me medaljen, e vendosi përsëri në kutinë e saj, brenda vitrinës që kishin montuar Jozefi dhe Kristofi. Prisnin të gjithë që dekorimi do ta lumturonte Kvetën, por ajo sillej sikur s'kishte fare të bënte me të. Nganjëherë përkëdhelte, instinktivisht, Kristofin në shpinë. Nganjëherë lavdëronte Libushen dhe nipin e saj për mënyrën se si kujdeseshin për shtëpinë në fshat. Por çka e lehtësonte më shumë se çdo gjë tjetër, ishin kujtimet e saj. Në fund të nëntorit, ditën e Shën Çeçilias, u ul mbi një stol të varrezës dhe u zgjua vetëm kur kishte rënë nata. Ishte krejt e ftohur dhe yjet mbi të i dukeshin të mrekullueshme, megjithëse asnjërit prej tyre

nuk ia dinte emrin.

Doli nga varreza dhe vrapoi të kapte trenin, por, kur arriti në shtëpi, e kuptoi se ishte ftohur më shumë nga ç'e kishte menduar. As çaji me rum dhe me qepë të shtrydhur, një recetë që babai i teto Anës e kishte mësuar në frontin Italian, gjatë luftës së Parë botërore, nuk e ndihmoi. Mjeku patolog që erdhi ta vizitonte diagnostikoi një polmonit dhe i rekomandoi të shtrohej në spital. Alisa mori përsipër të kujdesej për teto Anën - ajo duhej të ndahej midis punës, spitalit dhe teto Anës. Teto Ana u trishtua, jo sepse nuk kishte besim tek shkenca mjekësore, përkundrazi, i besonte gjithnjë e më shumë, por, sepse kishte vënë re në sytë e Kvetës dorëheqje, lodhje nga jeta.

Nuk ka asgjë që e kalon përvojën e një gruaje, thuajse, njëqindvjeçare, mburrej dhe shmangej të thoshte se atë dorëheqje, atë lodhje e kishte vënë re edhe në sytë e miqve, të kolegëve, të të njohurve, disa muaj, para se të vdisnin. Kujt nuk do t'i pëlqente të njihje të ardhmen e vet, por disa, po ta imagjinonin çfarë i pret, do të pendoheshin që kishin dashur ta dinë. Teto Ana ndihej e braktisur dhe, kur kushëriri Jiri mori një makinë shërbimi dhe i propozoi të shkonte ta merrte një herë në dy ditë për ta çuar në shtëpinë e Alisë për darkë, u ndje mirënjohëse ndaj tij, më shumë se kurrë. Aq shumë vjet të jetuara, i kishin mësuar se asgjë nuk e largon vdekjen më shumë se marrëzia dhe optimizmi aventuresk i të rinjve. Kështu kushëriri filloi të shkonte ta merrte disa herë në javë.

Dalëngadalë, Jiri u mësua me lëvizjet e saj tmerrësisht të ngadalshme dhe asaj i pëlqente shumë ajo makinë e kuqe, e parkuar para portës. Një herë, pas darkës, në një moment, kur kushëriri nuk mund të dëgjonte, tetoja u kapardis para Alisë, se po i ndodhte përsëri, tani në moshë të vonshme, të zbulojë brenda vetes ndonjë mbeturinë vaniteti. Pas gjithë atyre viteve, që nuk lëvizte nga shtëpia e saj, kur shkonte qoftë edhe në parkun

më të afërt, habitej sa kishte ndryshuar qyteti. Ndërtesa të reja. Fasada të restauruara. Gjithë ato makina dhe ato rrugë me emra të ndryshëm. Dalëngadalë ato shëtitje me makinë u bënë momentet më të rëndësishëm të programit të saj javor.

“E di më të çuditshmen, Alisa” tha një ditë “kam vënë re se kushëriri po rizgjon dëshirën time. Tek unë, një plakë. Natyrisht, jo në kuptimin që mund të mendosh ti, je akoma shumë e re, por unë e di se është e njëjta gjë. Është e njëjta gjë me atë, kur kisha një pamje më të re”.

“E si shfaqet, teto?”

“Eh, mendo vetëm që nuk i marr më pilulat e frymëmarrjes që m’i ka dhënë doktoresha. Nëse ai djalë është diku afër, marr frymë për mrekulli. Dhe nuk më shërbejnë më, i mbaj në sirtar për t’i përdorur, kur ai të kthehet në Angli. Por mos më keqkupto, nuk është për atë. Puna është se ai është një djalë i ri. Një djalosh, kjo është gjëja kryesore. Një grua s’duhet të rrijë kurrë pa një burrë, mbaje mend këtë. Po i afrohej shumë temës së saj të preferuar dhe Alisa u përpoq të gjente shpejt një mënyrë për ta shmangur nga ai argument delikat.

Në atë moment, hyn kushëriri dhe e pyet: “Po ju, teto Ana, keni pasur një mashkull?”

Teto Ana u kthye me fytyrën e rrudhur nga kushëriri, duke i lënë të dy pa fjalë, buzëqeshi duke treguar të gjithë dhëmbët dhe u përgjigj: “Po sigurisht, i dashur djalosh, e kam pasur një mashkull. Quhej Bedriç dhe kishte mustaqet më të bukura në të gjithë rrethinën. Po ta shikoje tani, do të shkriheshe së qeshuri, por atëherë ishin në modë. Eh, kanë kaluar dyzet vjet të mira qëkur ka vdekur”.

Më në fund, edhe tetoja, kur shkoi t’i takonte, mundi të shikonte vitrinën. Ngaqë nuk qëndronte dot gjatë në këmbë, pas darkës, i kërkoi kushëririt t’i nxirrte jashtë objektet e koleksionit të vogël dhe i shikonte në dritën e llambës, para se ai ta çonte në shtëpi.

Objekti i parë për të cilin shfaqti interes ishte medalja. “Është, vërtet, e bukur” ishte komenti i saj, pasi e këqyri me kujdes, me lentën zmadhuese. Jiri mendoi se kishte kohë që s’kishte parë njeri të këqyrte gjërat me aq hollësi. Teto Ana, me lëvizjet e saj të ngadalshme, jetonte në një epokë tjetër. Në një epokë, në të cilën ndienin kënaqësi, kur vëzhgonin me kujdes gjëra dhe persona. E këqyrte medaljen duke u mbështetur në krahun e divanit dhe e gjithë sjellja e saj të linte të kuptoje se po mendohej me kujdes. Pastaj këqyri moldavitet dhe agatët e vegjël keltë. Mbeti shumë e habitur nga riprodhimet e stampave të vulave indiane dhe vuri re se një nga kafshët e paraqitura, ajo e kishte parë gjatë një udhëtimi në Poloni në 1934: “Më duket se quhej bizon european, pra nuk e di se ç’lidhje ka me Indinë” komentoj me një vështrim të emocionuar. I këqyri, dalëngadalë, të gjitha objektet e ekspozuara dhe, në dallim nga Jozefi e Kveta, që i kishin mbledhur shumë vite më parë, ajo ishte e interesuar jo aq për të kaluarën, sesa për të ardhmen dhe shikonte me shumë kujdes për t’i nderuar ato para Alisë.

Si gjë të fundit, Jiri nxori nga vitrina dy fletë të mëdha, të cilat të kapura në panelin e prapmë prej druri të vitrinës, formonin sfondin e saj. Kur ia dha tetos ajo i këqyri me një shprehje kritike dy kartonët me shigjetat që i zbukuronin dhe tha: “Ç’lidhje kanë këto me gjithë të tjerat është një mister”. Pas disa çaste heshtjeje, shtoi: “Gjë e mirë është se shenjat janë mjaft të mëdha, prandaj nuk më duhet lente për t’i zmadhuar si për gurët dhe medaljen, problemi është se nuk e dimë, cili është versioni i drejtë”. Qëndroi duke vëzhguar ato çerekë flete, të mbushura me karaktere në kuneiformë, deri në mbrëmje. Kur Jiri e shoqëroi për në shtëpi, teto Ana, duke ngjitur shkallët, tha: “E di kushëri, besoj se Jozefi i dashur, na ka lënë një surprizë”.

Jiri, në atë moment, e kishte mendjen diku tjetër, kështu që iu deshën pak minuta për ta kapur mendimin e saj. “Çfarë surprize, teto?”.

“Nuk e di me siguri” u përgjigj ajo “por kam vënë re se ato shenja, janë shënuar më parë në mënyrë shumë të hollë me lapës dhe pastaj janë bërë me ngjyra. Nëse Jozefi ka punuar aq shumë, ato duhet të kenë një domethënie”.

“Ju thoni që i ka bërë zoti Çerni?” e pyeti Jiri.

“Po, me siguri po. Ka vënë firmën e tij dhe nga ana tjetër e fletës është shkruar diçka që ka lidhje me Kvetën dhe me njëfarë surprize, tani nuk e mbaj mend mirë” tha teto Ana.

“Javën e ardhshme do ta shikojmë bashkë” i propozoi Jiri. Kishin arritur dhe ai duhej të vraponte për të ndezur çelësin elektrik, që dukej i programuar qëllimisht për t’u fikur kur ndodheshin në mes të shkallëve.

“Natën e mirë Jiri” tha teto Ana, kur, më në fund, u gjend para derës. “Ec me kujdes, mos nxito! Më thuaj pak, ti ke ndonjë vajzë?”

“Eh po, ndoshta e kam një vajzë” u përgjigj.

“Ndoshta? Po ti e di apo jo?”

“Është në Paris”.

“Në Paris? Atëherë është njësoj sikur të mos e kesh. Ose bëje të vijë këtu, ose shko ti, ose është më mirë të gjesh një tjetër këtu. E di mirë për çfarë flas, djalosh” e valëzoi shkopin dhe me hapin e saj të zvarritur, hyri brenda.

Një ditë Alisa takoi në spital doktor Lukavskin, mikun e babait të vet dhe, vetëm duke folur me të, kuptoi sa e shqetësonte mamaja e saj, nuk i pëlqente fare mënyra si reagonte ajo ndaj shtrimit në spital. “Më parë, vazhdimisht, bënte makijazh me kujdes, sidomos vetullat i kishte gjithmonë të rregulluara, po tani, xhaxha. Çfarë po i ndodh tani? Flet shumë pak dhe mendon vetëm për kujtimet e saj” tha Alisa. Takimi me Antoninin i dha mundësinë të shfrente për shqetësimet e saj. Ai e vështroi ngultas. U përpoq ta qetësonte, por as ai vetë, me diplomën e tij në mjekësi, nuk arrinte të kuptonte çfarë komplikacionesh i ishin shtuar sëmundjes së Kvetës që

kishte filluar me një polmonit. As atij nuk i kishte shpëtuar pa vënë re se si ishte mbështjellë Kveta nga një vello apatie, disi në ngjyrë manushaqe dhe nuk mund të mendonte për të si për një paciente.

Të hënën tjetër, pas darkës, Jiri u kujtua për ato që i kishte thënë teto Ana lidhur me fletët e shkruara me karaktere në kuneiformë. I nxori nga vitrina dhe ia vuri përpara, nën dritën e fortë të llambës së tavolinës. Teto Ana i rrotulloi të dy fletët prej letre, i bëri një shenjë Jirit, pa e vështruar fare dhe tha: “Me ty pranë djalosh, s’kam nevojë për syze dhe as për lente zmadhuese. Afrohu dhe lexo atë që është shkruar këtu”. Jiri afroi karrigen, mori njërën prej fletëve, këqyri shkrimin në kuneiformë, pastaj e ktheu nga ana tjetër. Nga ana tjetër, me karaktere të vogla dhe të qarta, ishte shkruar: *Kvetës, nga Jozefi*. Dhe pastaj, më poshtë: *“E dashur Kveta, siç e di, pas pak kohësh, do të jetë përvjetori ynë i martesës. Prandaj kam menduar të të shpreh, në këtë mënyrë, atë që ndiej për ty. Vetëm për sytë e tu. Në të vërtetë, shpresoj shumë se ato që do të të them do të bëjnë të lumtur. Një surprizë e vogël nga ana ime. Jozefi*. Jiri lexoi tekstin dhe teto Ana priti për një moment vazhdimin. Por s’kishte vazhdim.

“Kjo është e gjitha, teto” tha Jiri.

“S’ka gjë tjetër?”

“Jo, mbaroi”.

Pasi shoqëroi teton në shtëpi, Jiri e pyeti Alisën, nëse dinte ndonjë gjë për ato fletët e shkruara me karaktere në kuneiformë. I tregoi anën tjetër, pak rreshta të shkruara me ato karakteret e vogla e të qarta. “Kjo është kaligrafia e babait, është kaligrafia e tij” komentoi Alisa “por s’e kam idenë çfarë ka dashur të thotë”. Pas disa ditësh, Jiri e bindi Alisën të kërkonte, nëse Jozefi kishte lënë ndonjë letër në Lhotka për Kvetën. Alisa, fillimisht, nuk i dha shumë rëndësi kësaj gjëje, pastaj mendoi se, ndoshta, mamasë do t’i kishte pëlqyer, kështu që i telefonoi Kristofit. Ai i tha se së bashku me Libushen kishin përgatitur dhomën e gjyshit me qëllim

që aty të rrinte gjyshja, e kishin lyer, sepse ishte koha tashmë. Nuk kishin hedhur asgjë që i përkiste gjyshit dhe, sigurisht, asnjë letër. Nuk i dukej të kishte parë asnjë letër, gjithsesi do të kontrollonte. Pas disa ditësh Kristofi kaloi nga spitali për të takuar Kvetën dhe i tha Alisë se, midis dokumenteve e shkresave të gjyshit, s'kishte asnjë letër.

Por një ditë, Jiri duke kaluar nëpër sallonin, ku ishte vitrina, për në dhomën e tij, papritur, i erdhi ndërmend një ide dhe, menjëherë, ia tha Alisë me dy fletët në dorë: “Mendoj se kam kuptuar gjithçka, Alisa. Besoj se letra është pikërisht këtu, para syve tanë. Është këtu, por është shkruar në një gjuhë tjetër, me karakteret kuneiformë”. Alisa mbeti pak e habitur nga ajo hipotezë. Kristofi nuk do të arrinte kurrë të bënte hamendje të tilla, mendoi, dhe tha me një zë neutral: “Mirë po...” pastaj heshti e turbulluar.

“Të paktën, t'ia kishe çuar teto Kvetës që ta shikonte” propozoi Jiri.

“E di, Jiri” tha Alisa “marrëdhëniet ndërmjet prindërve të mi, s'kanë qenë idilike, tani që është në spital, ndoshta, është më mirë të mos i kërkojmë asgjë. Duhet të mendojë për veten e saj. Megjithëse, kohët e fundit, më dukej sikur po afroheshin”.

Jiri e vështroi Alisën ngultas: “Çfarë do të thotë – po afroheshin, Alisa?”.

“Po afroheshin, po fillonin ta donin njëri-tjetrin. E di çfarë? Do t'ia çoj nesër”. Të nesërmen, në spital, Alisa ia tregoi së ëmës atë që kishin zbuluar Jiri dhe teto Ana dhe e pyeti çfarë mendonte ajo.

“Babai yt... babai yt ka lindur atë ditë që u njoftua deshifrimi i gjuhës së Hitikëve. Kur ishim të rinj, unë dhe ai shkonim për të ndjekur leksionet e profesor Hroznit, ai e kishte deshifruar” tha Kveta, pa shfaqur më shumë interes për këtë çështje. Dukej se Jiri ishte i vetmi që ishte i interesuar për ato dy fletë plot me simbole.

Një ditë, sapo u kthye në shtëpi Alisa, Jiri i tha: “U krye, Alisa, u krye. Kam verifikuar gjithçka dhe nesër do të shkojmë ta

deshifrojmë ose më mirë – ta përkthejmë”.

Alisa e kuptoi, menjëherë, për çfarë po fliste. “Unë nuk mundem më, Jiri, me të vërtetë. A nuk mund të shkosh ti vetë?”.

Dhe kështu, i qetë, por i eksituar nga shpirti i aventurës autentike, të cilat, tashmë, përjetohen vetëm në Europën Lindore, të nesërmen, kushëri trokiti në derën e doktor Jiri Svobodës. Në pllakën e derës ishte shkruar: *Doktor Jiri Svoboda, orari i pritjes të martën dhe të enjten ora 15.00 – 17.00*. Poshtë ishte shkruar me dorë: *Orari i pritjes nuk duhet kuptuar si një shërbim në funksion të shqyrtimit të provimit*. Para derës ecnin lart e poshtë studentët, të cilët, një nga një hynin në studio. Jiri u prit në orën 16.30. Trokiti në derë dhe e ftuan të hynte. Pas tavolinës ishte ulur një burrë i dobët, me një fytyrë të fshehur nga një mjekër e thinjur. “Përsëndetje” i tha Jiri.

“Përsëndetje ” u përgjigj doktor Svoboda. E vështroi për një çast, pastaj e pyeti: “Çfarë mund të bëj për ju?”.

Jiri u prezantua dhe i tha: “Do të doja t’ju kërkoja një nder, profesor, kam nevojë të më përktheni këtë tekst”.

“Çfarë kursesh ndiqni ju që nuk po ju njoh?”

“Unë jam diplomuar në Historinë e Ekonomisë, një lëndë shumë më pak interesante sesa fusha juaj e studimit” tha Jiri. “Kemi gjetur këto dy fletë në shtëpi dhe nuk e dimë çfarë është shkruar në to. Kam arsye të mendoj se i ka shkruar një kushëri i imi, që ka vdekur para pak kohësh, për gruan e tij që ndodhet e shtruar në spital. Megjithatë... ndoshta s’do të ketë kuptim, a do të keni mirësinë t’i hidhni një sy?”.

“Dhe ky i afërmi juaj ka studiuar në fakultetin tonë?” pyeti zoti Svoboda.

“Jo, nuk e besoj” u përgjigj Jiri. “Madje jo, sigurisht, sepse ai ishte inxhinier ndërtimi. Mesa di unë ai me të shoqen janë njohur në leksionet e profesor Hroznit, por nuk jam i sigurt”.

“Atëherë do të ketë qenë...”

“Tetoja ime sapo i ka kaluar të shtatëdhjetat”.

“M’i jepni t’i shikoj” tha doktor Svoboda. Jiri nxori nga çanta dosjen plastike, ku kishte futur të dyja fletët dhe ia tregoi. Ai i këqyri me vëmendje. Filloi t’i ekzaminonte dhe Jiri pati përshtypjen se, me të vërtetë, po lexonte diçka. Pas nja dhjetë minutash, profesori hoqi syzet, hapi një sirtar, mori një shami dhe i fshiu gjatë lentet e syzeve.

“Ehm” tha duke pastruar zërin. “Në fakt është një letër, një letër, të themi, personale, e natyrës personale, në të vërtetë, shumë personale. Një letër, do të thosha, nëse mundem, dashurie... por nuk më përket mua ta gjykoj”. Pas disa minutash heshtje tha: “Keni letër dhe diçka për të shkruar?”.

“Sigurisht” u përgjigj Jiri duke nxjerrë një stilolaps dhe një letër.

“Ajo s’do të mjaftojë” tha zoti Svoboda “ju lutem uluni këtu” shtoi duke i treguar një karrige bosh. Jiri u bind dhe u ul, profesori i vuri përpara disa fletë të bardha të mëdha me vija. “Pra po jua diktoj” tha. Pastaj, pas një çasti heshtjeje, shtoi: “Shikoni, ka gabime këtu. Sidomos gabime të përsëritura lidhur me aspektin e kryer dhe formën aktive dhe pasive të foljeve. Ka edhe fjalë që nuk ekzistojnë në fjalorin e gjuhës hitike, fjalë të sajura falë një krijimtarie shumë të frymëzuar dhe të tjera, të shkruara në mënyrë shumë interesante që nuk janë me origjinë hitike. Prandaj kam këtë propozim: do të korrigjoj gabimet në heshtje dhe do të përpiqem t’i përktej fjalët e tjera në çekisht duke u përpjekur të respektoj qëllimin e autorit. Jeni dakord?”

“Po, filloni” tha Jiri. “Jam gati”. Doktor Svoboda filloi të lexonte ngadalë, duke i theksuar fjalët:

“E dashur Kveta,

me shumë vonesë e kam kuptuar se të dua akoma. Dhe tani nuk mund të mos ta them: të dua akoma! Turpi, marrëzia që jeta ka rrënjësuar brenda meje, së bashku me dhimbjen për marrëdhënien

tënde të vjetër me Hynekun, më kanë bërë të përziej dhimbjen time therëse, që kam ndier vazhdimisht, me ndjesinë time të poshtërimit. Për këtë arsye jam përpjekur me të gjitha mënyrat ta mohoj e ta asgjësoj dashurinë që kam për ty. Por, kam kuptuar që nuk jam i aftë ta bëj këtë. Dhe e pranoj se nuk kam qenë kurrë, megjithëse e kam provuar shumë herë me këmbëngulje e me vetëdije.

Fillimisht, kur të braktisa, jam përpjekur të të harroj e të të urrej. Por urrejtja ka qenë, gjithmonë, e ndërthurur si një lëmsh në zemrën time, pavarësisht nga dashuria ime për ty. Jam përpjekur të të harroj çdo ditë, për shumë vite me radhë. Pastaj më qëllonte të të shikoja dhe kuptoja, me vuajtje, se urrejtja është zhdukur dhe më duhej, dalëngadalë, ta rindërtoja. Kanë qenë çaste vuajtjeje, plot dëshpërim për ëndrrën e parealizuar që të fshija përgjithmonë nga jeta ime. E kështu e kam shtyrë, ditë pas dite. Por, kur mendova se, më në fund, ia kisha dalë, kur më dukej se, tashmë, të paktën në mendimet e mia, nuk ekzistojë më, fillova të të rigjej në figurën e Alisë. Dalëngadalë, zëri i saj bëhej gjithnjë e më i ngjashëm me tëndin. Një herë, para shumë vjetësh, kur akoma ndihesha mirë, i kërkoja të shikonte në Pragë, sa kushtonte një morsë për të cilën kisha nevojë në Lhotka.

Pas disa ditësh, më telefonoi, ngriti dorezën dhe ndjeva zërin tënd. Nuk më tha, mirëdita babi, si zakonisht, por filloi të më tregonte çmimet e disa artikujve dhe mua më dukej se dëgjoja zërin tënd. Pastaj e mbylla dhe zemra më rrihte aq fort, sa që mendova se nuk do të mbijetoja. Ëndrra ime për të jetuar çka kishte mbetur nga jeta ime, pa të pasur ty, vazhdimisht, në mendje e në zemër u thye. Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e mia, çdo synim i imi shembej si kulla e Babelit. Blloqet prej graniti të dhimbjes sime, të vendosura në mënyrë të përkryer, nuk arrinin ta mbanin atë ndërtesë të tmerrshme. Më është dashur shumë kohë që të kuptoj se shkaku i dështimit tim nuk ishte urrejtja e vogël, por dashuria e madhe që, kurrë, s'kam pushuar së përjetuari.

Këto gjëra, Kveta, do të të duken absolutisht të qarta, por unë nuk i kuptoja. Kurrë nuk jam shqetësuar për ndjenjat e mia, as për të tuat. Një shpërfillje që e paguam shtrenjtë të dy. Mund vetëm të them se të kërkoj ndjesë dhe se më vjen shumë keq. Jam një plak i çmendur, kur bëhet fjalë për të kuptuar ndjenjat, nuk arrij as deri tek konstelacioni i qukave në kaviljen tënde të djathtë. Por duhet ta pranoj që, sapo e kuptova se për ringjalljen e kujtimeve për ty, u bë shkak dashuria dhe jo urrejtja, u ndjeva si një shpikës, një zbulues. Me të vërtetë! Nuk po e teproj! Më fal dhe fali modelet e mia mendjelehta, por u ndjeva, ndoshta, si heroi i fëmijërisë sime Xhejms Vatt, kur makina e tij e parë me avull filloi të funksiononte me kapacitet të plotë.

Nuk di si ta shpjegoj në një mënyrë më të zgjuar, nuk jam poet dhe e di mirë se përpjekja që bëj për të kërkuar ndjesë e për të shpjeguar dashurinë time, s'bën gjë tjetër; veçse tregon, se sa proporcionale, me vitet e mia, janë mendjelehtësia dhe marrëzia ime. Dashuria ime vazhdon akoma, vazhdon, madje është akoma më e fortë. Isha i frikësuar dhe, njëkohësisht, i magjepsur. Por kjo, me sytë e tu, nuk është e vështirë.

E shtrenjta ime, tani do të përpigem ta tejkaloj mendjemadhësinë, krenarinë time boshe që, ndoshta do ta meritonte të quhej kokëfortësi. Nuk ka qenë e lehtë – një punë e rëndë. Tullë pas tulle e kam lëvizur atë mur të madh, i cili ishte vetëm pengesë e nuk shërbente për asgjë. Mund ta imagjinoj, çfarë do të ndienin konstruktorët kur shikonin mbeturinat e kullës së Babelit të pambaruar. Lehtësimi që kam ndier ma ka kompensuar mundimin rraskapitës. Nuk do të doja të jepesha përsëri pas një modeli mendjelehtë, të ngathët e të pakuptueshëm, por kam ndier, me të vërtetë, në mushkëri një aromë të shkrirjes dhe të sythave të sapolindura.

Do të t'i kursej të gjitha fazat e padobishme të gjendjes sime shpirtërore që kam hasur gjatë rrugës. Do të t'i tregoj më vonë,

nëse do të pranosh të më takosh, të paktën, ndonjëherë, do të kemi kohë për këtë. Të kërkoj vetëm një gjë: më fal, të lutem, për egoizmin tim, për mendjemadhësinë time, më fal për dhimbjen që të kam shkaktuar. Të lutem bëje këtë!

Edhe duke qenë akoma i bindur se koha një madhësi fizike fikse dhe i vetëdijshëm që një sekondë është vetëm e tetëdhjetë e gjashtëmijta pjesë e një dite diellore mesatare, e pranoj, Kveta, që besimi im lëkundet. Ndjesitë e mia më tradhtojnë vazhdimisht dhe shikoj si i shtyj ditët përpara si një kope mëzash të arratisur. Madje kam dhe frikë se nuk do të kem kohë të të them se kurrë nuk është zbehur dashuria ime për ty. Asgjë në jetë nuk më ka kushtuar më shumë mundim se ky rrëfim. Pastaj më lindi ideja të shkruaja këtë letër në gjuhën hitike, me karaktere në kuneiformë. Ishin kujtimet e takimeve tona të para që më çuan në këtë marrëzi. E di që kjo është gjëja e vetme që s'ka nevojë të shpjegohet.

Jozefi

Kur arriti në shtëpi Jiri, nxori nga çanta përkthimin e letrës që ia kishte diktuar profesor Svoboda, i cili kishte shtuar dhe ca shënime. Jiri vështroi shkrimin e përkthimit, mendoi se Alisa nuk do ta lexonte dot dhe e kopjoi me kaligrafi të rregullt. Të dy fletët origjinale, të shkruara në gjuhën hitike, me karaktere në kuneiformë, i vendosi në vitrinë. Alisa u kthye nga puna, hëngrën darkë dhe, pas darkës, Jiri ia dha përkthimin e letrës. Ajo i lau duart me sapun, i fshiu dhe e vendosi me kujdes përkthimin në tavolinë. Pasi lexoi atë, lexoi edhe shënimet e doktor Svobodës, kërkoi shpjegimin çfarë ishte një neologjizëm dhe tha se të nesërmen do t'ia çonte letrën nënës së saj.

Atë mbrëmje, Jiri provoi t'i tregonte për letrën dhe të gjithë çështjen motrës së vet dhe i thoshte se ishte ndier siç ndihesh, kur ngjitesh në ashensor me dy të dashuruar marrëzisht që duhet të thonë gjëra aq të rëndësishme, saqë nuk vënë re njerëzit që

hipin e zbresin, kat pas kati. Edhe s'të mbetet gjë tjetër veçse të shmangësh sytë nga vështimet e tyre, nga përkëdheljet e tyre dhe të buzëqeshësh në mënyrë neutrale e të natyrshme, ndërsa ashensori ngjitet lart. Por nuk shpëtoi dot nga ndjesia që ishte treguar i patakt.

Provoi të çlirohej prej saj duke përsëritur se askush, aq më pak ai, nuk mund ta imagjinonte çfarë ishte shkruar në atë letër, por ndjesia që kishte përgjuar përtej ekranit, në banjon ku lahen iluzionet dhe dashuritë lakuriq, të shqetësuar, të moshuara, të turbulluara, të tronditura - nuk ishte aspak e këndshme. E qetësonte mendimi se Alisa, pasi kishte lexuar letrën, dukej më pak e përfshirë se ai. Madje i kishte thënë se, po të donte, të nesërmen mund ta shoqëronte në spital dhe t'ia shpjegonte nënës së saj, si kishte arritur të kuptonte gjithçka dhe çfarë i kishte thënë përkthyesi. Jiri pranoi dhe të dy ranë për të fjetur.

Arritën në spital pak minuta para orës tetë. Ngjiten shkallët që të çonin në katin e dytë dhe u drejtuan përmes korridorit me tavanin e harkuar për tek dhoma e Kvetës. Në korridor Alisa u ndal dhe, me një buzëqeshje të pasigurt, nxori nga çanta letrën e përkthyer. Pastaj arriti me shpejtësi Jirin që kishte kaluar disa hapa para saj. Kaluan para kirurgjisë që e kishte derën të hapur dhe një nga infermieret e thirri Alisën dhe e arriti, pa e vënë re fare praninë e Jirit. “Zonja Çerna, zonja Çerna !” thirri ajo. Alisa ndaloi dhe u kthye nga ajo. “Nuk e keni marrë mesazhin?” e pyeti. Alisa mohoi me kokë dhe vështroi Jirin. Ai kishte një shprehje neutrale sikur ishte i kapluar nga ndonjë shqetësim. Duket që është gjysmë anglez, mendoi Alisa, teksa infermierja i tha të hynte në kirurgji.

Aty një grua me bluzë të bardhë, ulur në një tavolinë, i komunikoi se nëna e saj kishte vdekur atë mëngjes në pesë e gjysmë. Alisa shtrëngoi buzët dhe Jiri vuri re sa i ngjante Kvetës. Alisa i lëshoi sytë mbi një fotografi të madhe të një lugine, varur në mur pas shpinës së gruas dhe vuri re se kalendari ishte i vjetër, i

dy vjetëve më parë. “Më vjen shumë keq, zonja Çerna” tha gruaja e ulur në tavolinë.

“Mendoj” murmuriti Alisa. “Mendoj se duhet të kthehem në shtëpi tani”. Gruaja në tavolinë i tha se duhej të merrte gjërat personale të nënës. I kaloi Alisë një stilolaps dhe i tregoi ku duhej të firmoste. Pastaj hapi një zarf të madh ku ishin unazat, një orë, një zinxhir floriri, karta e identitetit, kuleta, një bllok dhe një zarf që kishte shtatëdhjetë e gjashtë korona dhe disa centë. Alisa nuk deshi të kontrollonte asgjë dhe firmosi, e nervozuar, dokumentin e dorëzimit të objekteve. Jiri i tha gruas që do t’i sistemonte ai gjërat e tjera. Ajo i informoi se po të donin ta shikonin trupin e së ndjerës duhet të telefonojnë më parë dhe i zgjati Jirit një copë letër me numrin e telefonit dhe adresën.

Alisa u ngrit, u kthye dhe doli pa përshëndetur. Jiri e kuptoi se ishte e tronditur dhe e ndoqi nga pas. Bënë disa metra dhe dera e kirurgjisë u hap përsëri, infermierja që i thirri më parë, doli jashtë. “Zonja Çerna” bërtiti “zonja Çerna!”. E arriti Alisën dhe i dha fletën me përkthimin e letrës së Jozefit. “Ju kishte rënë kjo” tha ajo. Alisa e mori letrën, pa thënë asnjë fjalë dhe e falënderoi.

Ndërkohë që zbrisnin shkallët, vështroi Jirin, mori përkthimin e letrës dhe tha: “Pleq budallenj të mallkuar, nuk mund t’i thoshin para shumë vjetësh këto gjëra?! Dy pleq budallenj, që të dy! Të çmendur! Pse nuk kanë folur më parë? A e donin njëri-tjetrin? Atëher përse dreqin babai duhej të shpikte atë pantomimë absurde të shkruar me kod? Të çmendur, ai dhe mamaja! Edhe mamaja, Jiri!”. Pastaj shpërtheu në lot. “Çfarë loje bënin, budallenjtë e gjorë? Ata budallenj të gjorë – prindërit e mi! Çfarë loje bënin? Nuk mund të flisnin më parë? O Zot i madh, a është e mundur që s’kanë arritur t’i rregullojnë gjërat më parë?”.

Infermierja që i dha letrën i vëzhgonte nga larg. Jiri u kthye ta shikonte disa herë, por duke zbritur, e humbi nga sytë. “Ndoshta kanë bërë aq sa mundnin” tha Jiri. Ndihej shumë i trishtuar edhe

ai, sepse i vinte keq për Kvetën. Ndiente keqardhje, megjithëse s'kishte shumë që e njihte, një grua e moshuar, pak mendjemadhe, zakonisht e shqetësuar që vishej gjithmonë me elegancë.

Alisa tundi dorë dhe tha: “Natyrisht ishin kohë të tjera. Kjo është e qartë, por ai e donte akoma dhe ajo e donte atë, atëherë si u ka shkuar ndërmend atyre dy budallenjve”. Ndaloj, vështroi Jirin dhe shtoi: “Sipas teje, unë doja dy heronj gjysmë të luajtur për prindër? Jo, o Zot, dy prindër normalë doja unë, që të jetonin bashkë, që të shkonin pak a shumë mirë me njëri-tjetrin, por ata... e imagjinon dot. Po tani çfarë bën mamaja? Vdes! Jam shumë e zemëruar! Më bëjnë të tërbohem të dy! Që të dy!”. Dolën nga spitali dhe u nisën për në shtëpi. E kishte fytyrën të mbytur në lot dhe ndonjë kalimtar kthehej t'i shikonte.

Alisa ecte drejt, me kokën lart, nuk mbështetej tek Jiri. Ecte shpejt, por, ndonjëherë, ndalej papritur për të marrë frymë e për të rrëmuar në çantë duke kërkuar një shami. Jiri do të kishte dashur t'i blinte, të paktën, shami letre, por kishte frikë se e humbiste. Nuk orientohej mirë akoma në Pragë. Ajo, herë pas here, i buzëqeshte përmes lotësh, por, në pjesën më të madhe të kohës, nuk e vinte re fare praninë e tij. Ishte apo jo në krah të saj, për të ishte njësoj. Alisa qante me zë dhe njerëzit në stacionin e tramvajit ua ngulnin sytë. Me siguri mendonin se qante për shkak të tij. Kjo gjë e vinte në siklet, megjithëse e dinte që s'kishte arsye. E qetësonte vetëm një mendim: deshe aventurë – ja ku e ke tani.

Funerali u bë pak ditë pas Epifanisë dhe të ftohtit, që deri atëherë kishte qenë i përmbajtur, befas u transformua në një ftohtë europianolindor. Nuk është as historia, as politika që e dallon Europën Lindore nga ajo Perëndimore, mendoi Jiri, gjithçka është më e thjeshtë, është të ftohtit që bën diferencën. Midis Londrës dhe Parisit ishte një dallim prej pothuaj njëzet gradësh. Ngrica ishte aq e madhe, saqë të gjithë mendonin se teto Ana do të rrinte në shtëpi dhe nuk do të merrte pesë në varrim, por teton ishte e

pamundur ta bindje dhe ajo shkoi në funeral. Tashmë, pas kaq kohësh, kishte filluar të mendonte që do t'i kishte pëlqyer ta ftonte edhe në dhomën e saj atë shoqe të vjetër, e cila kishte përcjellë shumë miq të saj përtej pragut të heshtjes së zëshme.

Jiri e shoqëroi teto Anën në krematorium, parkoi dhe e ndihmoi të zbriste nga makina. Borën e kishin pastruar, por trotuari ishte veshur me gjuhë akulli, të cilat teto Ana, e mbështetur në krahun e Jirit, përpiquej t'i anashkalonte. Në funeral morën pjesë nga njëzet vetë. Kristofi, Libushe, Alisa, Jiri dhe teto Ana ishin ulur në radhën e parë dhe, pas ceremonisë, kur filloi muzika dhe arkivoli, i vendosur në karrocën e varrimit, u zhvendos prapa, pjesëmarrësit u afruan për ngushëllimet. Jiri ishte ndërmjet Alisë dhe tetos dhe vetëm Alisa arriti ta bindte teto Anën të ulej. “Po vdesin të gjithë – kam mbetur vetëm unë” u ankua teto Ana dhe shtoi: “Tani do të më kesh të tërën mbi kurriz”.

Pas disa ditësh, Alisa kërkoi të takohej me xaxha Antoninin. Pasi u përshëndetën dhe ndanë disa kujtime, ajo, më në fund, mori guximin t'i bënte pyetjen që kishte në mendje. “Xhaxha, ti e di të vërtetën e marrëdhënies së mamasë me atë të dashnorin?”

“Dëshiron, vërtet, të ta tregoj, Alisa?” pyeti ai, i shqetësuar.

“Po, xhaxha. Dua të di gjithçka”.

“Epo mirë” tha Antonini dhe filloi t'i tregonte historinë e tre miqve. Një histori banale e turpshme. Alisa dëgjonte e tmerruar, herë pas here tundte kokën, me dyshim ose pyeste për ndonjë gjë. Në fund Antonini i shpjegoi: “E di, në të vërtetë, është marrëdhënia më e natyrshme. Ai që është i sulmuar, i plagosur, ai që ndodhet në pushtetin e një personi tjetër, viktimë e tiranisë ose e dhunës, kërkon, me të gjitha mënyrat, të ketë lidhje me agresorin e tij. Veçanërisht, nëse ka frikë për të dashurit e vet dhe nëna jote ishte e terrorizuar për ty dhe për Jozefin dhe ndodh shpesh që të vendosë një lidhje me agresorin. Nganjëherë, bie dhe në dashuri me të, duket irracionale, por ndodh. Dhe ndodh, pikërisht, me qëllimin

që torturuesi të mos të kërcënojë me ligësi akoma më të mëdha. Është një dinamikë që është studiuar e analizuar dhe, me kohë, do të arrijë edhe tek ne një terapi që do të mund t'i ndihmojë këta persona. Por njerëzve si nëna jote u është dashur të na bindin për gjithë jetën. Dhe erotizimi i dhimbjes është vetëm njëri nga aspektet e problemit”.

“Mirë, xhaxha” tha Alisa “të paktën kështu, mund të gjendet një justifikim për gjithçka. Dhe ajo, gjithsesi, atë burrë e ka njohur para se të martohej me babain”.

“Shteti ynë është i vogël, Alisa” tha Antonini “pak a shumë njihen të gjithë. Dhe, ndoshta, për këtë arsye është akoma më keq”.

“Epo, për sa u takon... shijeve të saj erotike të përkohshme, të themi, janë gjëra që tashmë nuk i interesojnë askujt. Por s’duhej ta kishte bërë të vuante babain”.

“Ndoshta s’do të duhej ta bëje kaq fajtores, vogëlushe” i tha Antonini.

“Po unë jam shumë e zemëruar me të” shpërtheu ajo. “Tepër e zemëruar”.

“Sepse ajo vdiq e dyta, nëse do të kishte vdekur babai pas saj, ndoshta, do të isha zemëruar edhe me atë” tha Alisa.

Antonini ngriti supet dhe tha: “Të kujtohet ai pastiçeri që të ka bërë tortën e dasmës?”.

“Po, natyrisht” tha Alisa “deri tani ka qenë e vetmja e jetës sime dhe një tortë e tillë nuk harrohet”.

“E kam takuar para pak kohësh. E imagjinon dot, më rrëfeu se kishte sajuar gjithçka”.

“Gjithçka çfarë?” pyeti Alisa.

“Ato histori, me të cilat më ka tronditur, i kishte shpikur të gjitha”.

“Po përse?” pyeti Alisa.

“Është një histori e gjatë” i tha xhaxha Antonini. “Jemi takuar në sheshin Karlovo dhe kemi qëndruar aty më shumë se dy orë,

para se të më tregonte gjithçka. Duhet ta kem diku adresën e tij. Dhe ishte me gruan e vet, ajo që ishte zhdukur në rrethana aq të çuditshme. Ajo ka jetuar për shumë vjet në Gjermani apo në Austri, ndoshta në Salsburg”.

“Në Salsburg?” pyeti Alisa.

“Po, më duket në Salsburg” tha Antonina “por nuk jam shumë i sigurt. Dhe, menjëherë, pas Revolucionit, në vitin 1989, është kthyer tek ai”.

“Aha” tha Alisa, megjithëse mendjen e kishte diku tjetër.

“Meqenëse je këtu, Alisa” tha Antonini “a mendon se kushëriri yt do të më përkthente diçka në anglisht?”

“Sigurisht, xhaxha” u përgjigj Alisa. “Sigurisht. Ai akoma nuk është mësuar këtu në Pragë, por gjithmonë ka qejf të njihet me njerëz. Do të jetë kënaqësi për të që të njihet me ty. Mos kij merak, do ta rregulloj unë këtë. Për çfarë ke nevojë saktësisht?”

“Pak a shumë pas një muaji do të vijë një kolegu im nga Londra. Pak për turizëm, pak për një konferencë të vogël që po organizoj unë. Në të vërtetë, nuk e di fare si e ka marrë vesh. Nuk prisnim që do të na vinin edhe nga jashtë. Edhe unë, gjithashtu, mund ta çoj kushëririn për të bërë ndonjë shëtitje jashtë Pragës, në Krumlov për shembull. Në mënyrë që ai të vizitojë pak Çekosllovakinë”.

“Mos kij merak” i tha Alisa. “Do merrem unë me këtë”.

19. Teologjia e ujkut

Të dy burrat ishin ulur në dhomën e hotelit. Jashtë binte shi. Kushëriri rregullonte diçka mbi krevat dhe, herë pas here, shikonte nga dritarja.

“Nuk po pushon shiu” tha pas pak.

“Duket se jo” iu përgjigj Antonini.

“Kështu që teatër s’ka” vazhdoi kushëriri.

“Mesa duket jo”

“Mund të shkojmë në meshë” tha kushëriri dhe vështroi tjetrin që godiste me majën e stilolapsit mbi komodinën afër krevatit.

“Kam vite që nuk shkoj në kishë”

“Përse?” pyeti kushëriri dhe shtoi pastaj, pa pritur përgjigje: “Ajo kisha, nuk e mbaj mend si quhet, duket se është e shekullit trembëdhjetë”.

“Nuk besoj tek Zoti” tha Antonini “dhe nuk më intereson e cilit shekull është kisha”. Pati një çast heshtje. Kushëriri vuri re se Antonini kishte pushuar së godituri me stilolaps mbi komodinë.

“Po përse? Pse nuk besoni? Mos ka lidhje me profesionin tënd si mjek?”

“Jo, pse? Mmh? Megjithëse, në të vërtetë ... Jo. S’ka lidhje fare” u përgjigj Antonini.

“Nuk e di, ndoshta këto lloj pyetjesh...” hezitoi kushëriri “dua të them, ndoshta janë pyetje pa takt...” shtoi ai dhe u kthye të shikonte në sy Antoninin.

“Epo, për mua nuk është çështje sentimentale... mendoj... gjithsesi, ka kohë që nuk besoj më. Ajo tek e cila unë besoj

tani, është që nuk besoj” shtoi ai. “Është banale... ehm... e trishtueshme...”

“Jo, nuk është kështu, por do të më interesonte...”

“Atëherë shkojmë të hamë ndonjë gjë?” e ndërpreu Antonini.

“Mirë, shkojmë. Shikoni, puna është se unë kam menduar gjithmonë që besimi tek Zoti mund ta ndihmojë mjekun” tha kushëriri.

“Çfarë është kjo? Një mënyrë për të kaluar orët me shi?” iu përgjigj Antonini “S’ka gjë, unë mendoj se ju keni kohë pa luajtur shah”. Ai u drejtua nga dritarja e hapur dhe e mbylli pak. Nxori nga çanta një shishe konjaku, nga rafti – një gotë të vogël, i bëri shenjë kushëririt që të mbushte gotën dhe tha: “Ju keni të drejtë, besimi ndihmon... ndihmon atë që e ka”.

“Po juve ju ndihmon ose më mirë, ju ka ndihmuar më parë?”

“Po, sigurisht, kur e kisha, më ndihmonte. Do të kisha pirë me kënaqësi një cigare”.

“Këtu nuk pihet duhan” tha kushëriri “por mua nuk më bezdis” shtoi ai. “Mund ta lëmë dritaren hapur deri sa të dalim”.

“Kisha menduar të pija cigare rrugës për në teatër dhe në teatër, gjithashtu, sepse teatri është jashtë, i hapur dhe me siguri, lejohet, kam gjithë ditën që pres për të pirë një cigare në teatër. Megjithëse është një trupë teatrale lokale dhe nuk do të jetë ndonjë gjë e madhe”.

“Mmh” psherëtiu kushëriri dhe shtoi “Megjithatë mund të pini duhan gjatë darkës, mua nuk më bezdis kjo”.

“Atëherë çfarë do të bëjmë, shkojmë për darkë?”

“Në fakt unë s’kam shumë uri. Por, nëse doni të pini duhan gjatë rrugës, mund të shkojmë”.

“Mos u shqetësoni, do të rezistoj. Meqenëse, tashmë, nuk mund ta praktikoj fenë, të paktën, do të praktikoj forcën e vullnetit”. Kushëriri nuk u përgjigj dhe filloi të sodiste shiun jashtë dritares.

“Nëse doni të pini duhan, do ta hap prapë dritaren”.

“Jo, jo, mos kini merak” përsëriti Antonini dhe futi stilolapsin në xhepin e këmishës.

“Si ndihesh, kur e humb besimin?” pyeti kushëriri. “Ndodh papritur, apo...”.

“Është një proces gradual, doni të thoni?”

“Nuk e di me siguri, si thuhet” tha kushëriri. “E kuptuat çfarë dua të them?”

“Një vit para se të merrja diplomën kam qenë në Sllovaki për një stazh dhe atëherë kërkoja të emërohem atje. Nuk qe aq e vështirë, sepse askush s’donte të shkonte atje”.

“Çfarë do të thotë të emërohesh?” pyeti kushëriri.

“Kur vendoset zyrtarisht vendi yt i punës. Në fillim doja të kërkoja Ostravën, por më pëlqente shumë natyra dhe shkova atje, në majë të Sllovakisë. I njihja pak ato vende – bëra kërkesën dhe m’u pranua”.

“Pra, nuk do të shkojmë në kishë, kështu?” pyeti kushëriri. Antonini tundi kokën: “Gjithmonë kam menduar për Zotin si një genie relativisht e ndjeshme”.

“Çfarë keni parasysh me – relativisht” pyeti kushëriri.

“Familja ime është katolike prej shekujsh. Dhe, nëse je katolik prej shekujsh, ti beson në atë mënyrë siç kanë besuar prindërit dhe gjyshërit e tu. Beson se Zoti është pafundësisht i mëshirshëm, por vetëm relativisht i ndjeshëm”.

“Po ju nuk besoni më?”

“Hajde tani, dalim, shkojmë të hamë darkë” tha Antonini duke veshur pulovrën e tij të leshtë.

“Po si ka ndodhur pra?” pyeti përsëri kushëriri.

“E mbaj mend akoma që ngjitur me kabinën e pranimit, përpara hyrjes në spital, ishte një dërrasë e zezë e vogël. Një dërrasë e zezë si ato të shkollës, por kurrë nuk shkruhej gjë në të. Një herë e pyeta rojën përse ishte vënë aty ajo dërrasë e zezë dhe më tha se ajo shërbente për raste të jashtëzakonshme. Për cilat raste të

jashtëzakonshme? e pyeta. Për ato që janë aq të jashtëzakonshme, saqë mund të jenë të paparashikueshme. Për ato që askush s'di asgjë. Dhe, për aq sa mbaj mend – gjithmonë ishte bosh. Ndalesha gjithmonë aty për të pirë duhan. Ndodhej tamam në pikën ku unë mbaroja cigaren para se të nisesha, me hapin e përgjumur të mëngjesit, drejt repartit”.

“Pushoi shiu, dalim?”

“Po, dalim”.

“A do të më tregoni si ka ndodhur që ju e keni humbur besimin tek Zoti?” pyeti kushëriri.

“Jam tmerrësisht fjalëshumë apo jo?”.

“Jo, nuk desha të thosha këtë?”

“Njësoj është, gjithsesi unë jam fjalëshumë... Kur beson, siç besoja unë dhe vjen nga një familje ku besimi është një traditë dhe traditat janë gjëra të padiskutueshme, atëherë beson në mënyrë të ngrohtë e të qetë. Edhe besimi im ishte i tillë. Ndoshta kështu besonin edhe prindërit e mi, guxoj ta them. Nëna ime kishte një besim disi snob, ndërsa babai besonte në mënyrë bamirëse”.

“Po pastaj, çfarë ndodhi?”

“Ndodhi që rashë në dashuri. U dashurova pa e kuptuar fare”.

“Si është e mundur të biesh në dashuri pa e kuptuar?”

“Meqenëse ma bëni këtë pyetje, rreziku që mund t’ju ndodhë edhe juve kështu është serioz. Ju këshilloj të... nuk bëhet, më falni. *Ju këshilloj dhe unë jam i rëndësishëm* - janë simptoma të padiskutueshme të një pleqërie të përjetuar keq”. Shiu kishte pushuar.

“Kur e pashë Klarën për herë të parë, në kopshtin e spitalit, punoja atje prej disa javësh. Akoma nuk e dija si quhej, e mora vesh më vonë. Ishin dy gra ulur në një stol. Njëra ishte e moshuar, tjetra ishte e gjatë, bionde, me flokë të gjatë, të lëshuar. Tani, me siguri, do të kishte bërë karrierë në një nga revistat që lexon vajza ime, por atëherë s’kishte revista të tilla. Qëndronte drejt në stol,

pothuajse e palëvizshme. Pastaj, befas, u kthye e më vështroi në sy. Vështrimi i saj më shkoi drejt e në stomak. I kishte sytë gri në blu, flokët i arrinin deri në bel. Ishte aq e bukur, saqë gati më ra cigarja nga goja. E bukur dhe e ngopur me qetësues. Dukej sikur ishte prej gome. Një ditë pyeta një kolegun tim për të dhe më tha se kishte pësuar një *shock* dhe s'dihej se kur do të shërohej. Nuk hetova më tej”.

“Do shkojmë për darkë apo jo? Do të më tregosh gjatë rrugës”.

“Keni të drejtë” pranoi Antonini dhe dolën në rrugë. Qendra e qytetit ishte e mbushur me restorante.

“Çfarë do të dëshironit?”

“Peshk?”.

“Është një restorant ndodhet një restorant peshku në breg të lumit, por dyshoj se është peshk i Moldavës”. Restoranti ishte gjysmë bosh. Zgjidhën një tavolinë dhe u ulën. Antonini mbështeti cigaren në buzën e tavllës dhe filluan të shfletojnë menynë. Porositën.

“Pra ju ratë në dashuri me atë bionden?” pyeti kushëriri pas pak çastesh heshtje, ndërsa hanin supën.

“Po. U dashurova me Klarën dhe me natyrën e atyre vendeve. Që isha i dashuruar me natyrën, fatmirësisht, e dija. E adhuroja. Shëtisja kudo. Pyje të gjelbra e të dendura. Bimësia e errët, e lagësht, e pasur në limfë, me monumente të vogla mbi kodrat”.

“Monumente?” pyeti kushëriri, teksa çonte lugën në gojë me gllënjkat e fundit të supës, duke përkulur pjatën. Antonini shikonte me bisht të syrit manovrat e tij, pastaj i hodhi sytë përreth.

“Ai pjesë e tokës ishte magjepsëse dhe e shkretë. Kishte qenë e shkretë deri në fund të luftës. Ishte diçka, për të cilën s’kisha menduar kurrë më parë – se atje kishte pasur luftë. E dija sigurisht, e dija siç e dija se Kok më 1882 kishte botuar studimin e tij të parë mbi bakterin tbc. Asgjë më shumë. Por, duke vizituar vendet përreth, vura re se banorët lokalë arrinin vetëm deri në fund të

pyllit. Fillimisht mendoja se shkaku ishte afërsia me kufirin e Bashkimit Sovjetik, Ukraina e sotme.

Një ditë mora një hartë të mirë dhe pyeta si mund të shkohej në luginën e afërt. Një grua vendase më shpjegoi se ishte një rrugë që ngjitej në kodër, por ishte përshkuar për herë të fundit, dy-tre vjet pas luftës, nga një kortezh. Në atë kohë kishin kaluar mbi dhjetë vjet që nga fundi i luftës”.

“Po si kalonin nga njëra luginë tek tjetra?”

“Në mënyrë mjaft normale – me autobus”.

“E përse nuk ecnin në këmbë?”

“Pak për shkak të vështirësisë së rrugës, pak prej erës së keqe”.

“Çfarë erë e keqe?”

“Në atë krahinë të vjetër ishte bërë luftë. Me sa kam kuptuar unë, atje në ato male, midis qafash e grykësh, kishin varrosur gjermanët dhe donin ta ndalonin kalimin e Ushtrisë së Kuqe. Ushtarët e quajnë *tërheqje drejt vendeve të parapërgatitura*. Një koleg vendas më shpjegoi se është e pamundur t’u biesh përreth. Malet Karpate e kështu me radhë. Dhe kështu luftuan aty. Një rrip toke si ai, aq i mbushur me çelik. Dhe kishte aq shumë të rënë. Ajo grua më tregoi se pushuan së kaluari andej për shkak të erës së keqe, e cila për shumë vjet pas përfundimit të luftës nuk kishte ikur akoma. Ishte era e mijëra ushtarëve të varrosur”.

“Mmh” tha kushëriri “nuk më shkon peshku poshtë më”.

“Më falni, nuk desha”.

“Isha i interesuar për atë çështjen e fesë e të tjera... por...”.

“Keni të drejtë, më falni. Nuk dija nga do të kisha shkuar me këtë bisedë. Eh, kujtime, kanë kaluar aq shumë vite”.

“Vërtet, nuk e dua më peshkun”.

“Atëherë merrni diçka tjetër”.

“Po, më duhet vërtet... nuk kam ngrënë as mëngjes”.

“Po, e kuptoj, duhet të hash diçka, përndryshe do të kesh rënie sheqeri në gjak”.

“Po, pastaj, u njohët?”

“Një ditë shkova tek një koleg për një konsultë dhe, në fund, nuk di se si, përfunduam duke folur për Klarën”.

“Dhe çfarë morët vesh?”

“Atje njerëzit janë më afër njëri-tjetrit dhe kanë një afërsi të madhe edhe me natyrën. Juve, për shembull, ju ka qëlluar ndonjëherë të shikoni një ujë? Dua të them në natyrë, jo në fotografi ose në televizion”.

“Një herë? Në zoopark. Pse?”

“Ai kolegu më tregoi çfarë i kishte ndodhur asaj. Vinte nga një vend i afërt, nga një familje e mirë, sapo kishte marrë maturën në qytetin kryesor të rajonit. Duket se drejtori e kishte rekomanduar për në universitet, do të mund të shkonte të studionte në Bratislavë. Tani nuk i jepet aq rëndësi diplomës së maturës, por atëherë, nëse ishe një person i zakonshëm dhe vije nga një vend që, çdo njëqind vjet shkatërrohej nga lufta, pastaj, harrohej nga të gjithë për shekullin tjetër, kishte shumë rëndësi. Kishin filluar të flisnin për martesë me të fejuarin. Një natë dimri shkuan të kërcejnë. Dikush më tha se nuk shkonin mirë, dua të them Klara me të dashurin e saj. Ziheshin. Kam dëgjuar edhe se kishte organizuar diçka me kushërirën e saj dhe, pastaj, ishin zënë për diçka, ndërsa të tjerë thoshin se Klara ishte zemëruar, sepse i dashuri i saj kishte kërcyer më shumë se ç’duhej me një të afërmen e vet”.

“Vendosa të marr një *sviçkova* për darkë” tha kushëriri. “Po ju?”

“Unë nuk heq dorë nga peshku...”

“Pra, si arriti ajo vajzë apo grua në spital?”

“Vajzë, atëherë ishe akoma vajzë... Siç po thosha, askush nuk e dinte saktësisht çfarë kishte ndodhur ndërmjet Klarës e të fejuarit të saj. Për t’i rënë shkurt, Klara rreth mesnatës iku nga pista e kërcimit. Jetonte në një vend disa kilometra larg. Ishte dimër gjë që, për ato vende, ishte sinonim i borës. Borë e ngricë

nga ato që ne nuk i imagjinojmë dot. Pas pak i fejuari vë re se ajo ishte larguar, prandaj u përshëndet me të tjerët dhe doli. Por nuk po arrinin në shtëpi. Pas mesnate, e ëma filloi të shqetësohej. Në fshat ekzistonte vetëm një telefon – ai i kryetarit të kooperativës agrare. Kur gruaja e zgjoi, ai telefonoi në birrarinë, ku ndodhej pista e vallëzimit dhe i thanë se Klara me të fejuarin ishin larguar. Por në shtëpi nuk ishin. Miqtë e të afërmit organizuan një kërkim së bashku me rojet e kufirit, me rojtarët e pyllit dhe ato të gjahut.

Ushtarët mbanin me vete pushkë, ndërsa rojtarët e pyllit llamba saldimi. S'ka gjë më të efektshme kundër ujqërve. Zjarri është e vetmja gjë që i tremb. Kontrolluan të gjithë shtegun në dy grupe, duke u nisur nga dy anët e kundërta. Në secilin grup kishte ushtarë me pushkë dhe burra me llamba saldimi e bajoneta. Gjatë rrugës, njërin prej grupeve e sulmuan një tufë ujqish. Fatmirësisht arritën t'i zmbropsnin. I shpëtuan llambat e saldimit të ndezura në maksimum, të cilat si flakëhedhëse, hidhnin zjarr në disa metra distancë, megjithëse sa më e largët ishte hedhja, aq më shumë karburant harxhonin.

Qëndronin të gjithë në grup, ushtarët qëlluan disa herë me armë në errësirë. Gjithmonë është shumë e vështirë të qëllosh në errësirë ujqërit që të rrethojnë, sepse ka rrezik të vrasësh një njeri. Flakët bëjnë dritë, por edhe hije dhe ujqërit mund të përfitonin nga rrëmuja. Kur i gjetën, vajza ishte kapur pas degës së një peme. Trungu e kishte lëvoren krejtësisht të kafshuar, të gërryer. I dashuri i saj ose, më saktë, çka kishte mbetur prej tij, gjendej nën pemë. Provuan ta bëjnë të zbrësë. Dy burra u përpoqën të ngjiten në pemë për ta kapur, por ajo ngjitej gjithnjë e më lart. Nuk bërtiste. Vetëm gulçonte. I kishte duart të fryra nga të ftohtit dhe nga përprjekjet për të shtrënguar degën. Thonjtë i kishte të çarë. Kur arritën ta zbrisnin poshtë u desh ta lidhnin. E lidhën këmbë e duar, sepse nuk bënte më dallim midis njerëzve dhe egërsirave. Sajuan një barelë me degë dhe e lidhën vajzën sipër saj. Tashmë llambat e saldimit

s'kishin më karburant, kështu që duhej të vraponin në fshatin më të afërt. Në të zbardhur të ditës, një skuadër e pajisur më mirë u kthye për të marrë çka kishte mbetur nga trupi i djaloshit – nuk gjetën më asgjë. Ishte e qartë që ujqërit ishin kthyer prapë në atë vend. Familja e të fejuarit organizoi një funeral simbolik, në vend të trupit u varrosën lekat e gjakosura të djalit. Dhe kjo vajzë ishte Klara”.

Kushëriri vuri pirunin në pjatë, pranë thikës, fshiu buzët me pecetë dhe shtyu pjatën më tutje. Për pak çaste qëndruan në heshtje.

“Do pini një kafe?” e pyeti Antonini.

“Po të mund të pija alkool, do të kisha kthyer një gotë, por mendoj se duhet të mjaftohem me një kafe”.

“Nuk pini kurrë?”

“Normalisht po, por sot jo”.

“Pse?”

“Jemi në kreshmë”.

“Ah, s'më kishte shkuar mendja. E di, secili është i bindur se Zoti mban uniformën e tij. Unë, duke qenë tifoz i Spartës, nuk do ta duroja mendimin që Zoti të ishte, për shembull... tifoz i Slavës. Kur isha akoma besimtar, isha i bindur se Zoti ishte katolik. Nuk shikoja asgjë të çuditshme këtu. Por, kur mora vesh historinë që sapo jua tregova, pushova së besuari. Ajo ndodhi e shkatërroi besimin tim”.

“Ky është qëllimi i djallit – të zhdukë besimin”.

“Me sa di unë nga çka kam lexuar prej Injacios të Lojiolës, djalli merr pamje tërheqëse, të këndshme. Ka lidhje me gjëra dhe situata që kurrë nuk të bëjnë të mendosh për Zotin. Këtë jua them menjëherë, pa u lëkundur”.

“Atëherë përse ndodhi, si mendoni ju?”

“Nuk e di, ky është problemi. Nuk kam mundur ta kuptoj. Zoti e lejoi të ndodhë, thjesht, i la vetëm, i braktisi. Nuk jam thelluar shumë, por asgjë tjetër s'kam mundur të mendoj. Zoti im ka

pushuar së qeni mëshirëplotë dhe është bërë pafundësisht i egër”.

“Nganjëherë nuk arrijmë dot t’i kuptojmë rrugët e Providencës hyjnore”.

“Gabim! Nuk e kuptojmë kurrë! Të përpiqesh të pajtosh Quinto Settimio Tertulliano me eunukun Origen është një punë e ndyrë”.

“*Credo quia absurdum, unë besoj, sepse është absurde*, ka thënë Tertuliani dhe *Credo ut intelligam, unë besoj që të kuptoj* – ka thënë Shën Anselmi i Kantërbërit, jo Origeni” u përgjigj kushërirri.

“Vërtet? Nuk e mbaj mend” “E si thotë?” e pyeti pa e lënë të reagojë. “Dhe vdiq i biri i Zotit, që është plotësisht e besueshme, pse është e pabesueshme. Dhe, pasi u varros dhe rilindi, është diçka e natyrshme, pse është e pamundur?”

“E saktë, është një gjë e sigurt, sepse është e pamundur: *credo quia absurdum*”.

“Në të vërtetë, fjalë për fjalë do të ishte: besoj, sepse është absurde. Pikërisht këtë dua të them: më ka privuar Zoti im nga besimi. Në mënyrë absurde i privuar nga një besim absurd”.

“Ndoshta keni menduar në mënyrë të gabuar”.

“Si mund të mendosh ndryshe përveç se në mënyrë të gabuar... dhe të pasaktë...?”.

“Sigurisht kështu është, por...”.

“Në fund, duke pasur parasysh si shkoi jeta e vajzës, m’u desh t’i jap të drejtë xhaxhait tënd”.

“Kujt?”

“Jozefit”.

“Ç’lidhje ka ai me fenë?”

“Me fenë- shumë pak, por, në atë rast, diti të më këshillonte”.

“Herën e fundit që kam folur me të ishte i lodhur nga pleqëria, fliste gati pa lidhje dhe dukej i sëmurë”.

“Epo, në atë kohë ne ishim të rinj. Jozefi ishte një person tjetër, ishte joshës dhe entuziast, por burgu dhe... të gjitha gjërat e tjera

e ndryshuan ashtu”.

“Po çfarë ju këshilloi ai?”

“Kur ishte i ri, përveç punës së tij, merrej edhe me logjikë”.

“E?”

“Ato kombinimet me të cilat më mundte në shah. Në finalen e torres ishte një mjeshtër i vërtetë, por ndoshta ju nuk e kuptoni?”

“Jo” u përgjigj kushëriri duke qeshur “vërtet s’kuptoj gjë fare”.

“Finalet e tij të torres kombinonin bukurinë me një logjikë blu çeliku. Ishin humbje të paharrueshme. Humbjet e mia më të bukura”. Antonini heshti. Zërat përreth sikur po lageshin dhe jashtë në rrugë po fillonte një rrebesh tjetër.

“Dhe ç’lidhje kishte ai me logjikën?”

“Kalonte kohën e lirë duke u marrë me logjikë... atëherë më këshilloi dhe më këshilloi mirë. Më tha që duhej të kisha një qasje jo të personalizuar ndaj problemit, ta trajtoja nga këndvështrimi i logjikës së pafundësisë. Para së cilës dridhet edhe Zoti, thoshte”.

“E çfarë ju këshilloi?”

“Më këshilloi ta nënndaj problemin në hapa të thjeshtë logjike. Si lëvizjet e shahut”.

“Nuk mund të luhet shah me Zotin. Kjo është, vërtet, herezi”.

“E dija se herët a vonë do t’ju fyeja”.

“Më shpjegoni!”

“Një nga cilësitë e Zotit është mirësia e tij e pafund, apo jo?”

“Po, sigurisht”.

“Atëherë Jozefi më shpjegoi se Zoti ka në dispozicion vetëm një njëfarë numri mundësish, nëse shikëputemi nga skemat teologjike dhe nga shkurtoret mendjelehta në lidhje me moskuptimin e Providencës hyjnore”.

“Çfarë mundësish janë?”

“Jozefi, atëherë, ma përcaktoi kështu. Cilësitë më të rëndësishme të Zotit janë: një - gjithëfuqia, dy - gjithëshkenca, tre - gjithëprania dhe katër - dashuria dhe mirësia e pafund. I lë

mënjatë cilësitë më pak të rëndësishme, ato, për të cilat nuk bini dakord as ju kristianët me njëri-tjetrin. Çështja është: nëse midis cilësive të Zotit është edhe mirësia, si e shpjegon shëmtinë dhe varfërinë e botës? Apo Zoti yt katolik mëshirëplotë nuk shikon, prandaj s'bën asgjë, por kjo është në kontrast me pohimin tuaj në lidhje me gjithëpraninë e tij të fuqishme katolike. Apo nuk është në gjendje ta dallojë të mirën nga e keqja dhe, në këtë rast, do të bënte më mirë të qëndronte në Parajsë së bashku me çimkat e krevateve, me brontozaurët dhe me atë gjarprin e shkretë. Kjo mundësi bie plotësisht, sepse Ai i madhi, Zoti yt i mirë katolik është i gjithëpranishëm dhe, siç e kemi thënë, vlen edhe pika e katërt – dashuria dhe mirësia e pafund.

Një mundësi tjetër është që Zoti është, ekziston, që shikon gjithçka, që është i gjithëfuqishëm dhe i pëlqen çka shikon. Në këtë rast ajo krijesë e gjithëfuqishme, e gjithëpranishme, nuk do të ishte pafundësisht e mirë. Do të bënte diçka apo jo? Kundër shëmtisë që ekziston në botë, kundër varfërisë... e kështu me radhë. Në qoftë se kjo qenie e gjithëfuqishme dhe e gjithëpranishme ekziston, atëherë nuk është Zoti, përderisa i lë të gjitha ashtu siç janë. Në fakt, mund të jetë djalli, siç është e logjikshme të mendohet. Nga mundësia e parafundit gjykojmë se Ai, pra Zoti hipotetik katolik, shikon gjithçka, nuk i pëlqen, por nuk mund të bëjë asgjë. Atëherë është, praktikisht, si unë dhe ti. Si përfundim mbetet e pesta, e fundit”.

“Cila?”

“Që nuk ekziston”.

“Nuk ekziston?”

“Pikërisht”.

“Por, por, kështu e bëni shumë të thjeshtë!”

“Ndoshta e thjeshtësoj shumë, por, sigurisht, nuk i mungon logjika”.

“Po nuk mund të reduktohet Zoti në një argumentim logjik!”.

“Të gjitha herët, kur dikush provon të bëjë pyetje të thjeshta, për shembull si ka mundur Zoti të krijojë universin, ose ku shkon të pushojë e të flejë Zoti, të gjithë besimtarët kundërshtojnë duke thënë se është pyetje e gabuar ose me argumente jo të thella. Mund të pyesja, thjesht, përse brontozaurët nuk u pranuan në Arkën e Noes dhe do të më përgjigjesht se po bëj pyetje të gabuara. Se gjërat që kërkoj nuk janë të drejta”.

“Po unë nuk i di përgjigjet, përpiqem vetëm të kuptoj”.

“Epo atëherë, në krahasim me të tjerët, jeni një hap përpara”.

Ndjenë një maçok të mjaullinte, vinte nga jashtë. Kishte pushuar shiu. Maçoku mjaulliu akoma më fort, por tani vinte nga kuzhina. Antonini porositi dy kafe dhe një dopjo konjak për vete. Vështroi kushëririn dhe i tha duke kërkuar ndjesë: “Kreshma”. Ndezi një cigare, e thithi. Dhe kështu vazhdoi. Kushërimi lëvizti në karrige, me siklet. Ndoshta nuk donte të shqetësonte Antoninin, i cili vazhdonte - thithte cigaren dhe e nxirrte. Pastaj tha: “Ai maçok, ajo mjaullimë, ndoshta vinte nga lumi”.

“Shpresojmë” shtoi Antonini “shpresojmë të mos ketë qenë në kuzhinë”.

“Ndoshta e ka tërhequr era e peshkut”.

“Ndoshta”.

“Nuk do të jetë i vetmi”.

“Ka mundësi që jo” u përgjigj Antonini. Në atë moment, në kuzhinë, diçka u thye. U ndje një përplasje enësh prej argjile. Të gjithë mysafirët e restorantit u shtangën. Kamerieri i barit buzëqeshi i sikletosur, i pasigurt nëse duhej të shkonte të shikonte apo të shtirej se gjithçka ishte në rregull. Brenda një sekonde vendosi të mos lëvizte nga vendi i tij. Nga kuzhina u ndjenë hapa të shpejtë dhe disa zëra të shqetësuar.

“Për një maçok duhet të jetë një lloj opiumi” tha kushërimi. Miku vështroi nga dritarja dyshtemenë e lagur të rrugës.

“Çfarë do të thotë - për një maçok është një lloj opiumi”.

“E kam fjalën për peshkun, për peshkun” .

“Peshku është opium?”

“Për një maçok është si opiumi”.

“Ah” tha Antonini. Si të gjithë klientët e tjerë dëgjonte kakarisjen dhe zërat, tashmë, grindavecë që vinin nga kuzhina. Grindjes iu shtua edhe një zë tjetër dhe, në atë moment, kamerieri nuk u përmbajt më dhe vuri veshin të dëgjonte edhe ai me vëmendje të dukshme. Papritur doli nga rrëmuja një tingull i ri që dukej si një mjaullimë e zgjatur, me frekuencë të ulët.

“Atëherë është pikërisht në kuzhinë”.

“Çfarë ka në kuzhinë?” pyeti kushëri.

“Maçoku apo jo?” tha Antonini, pastaj shtoi: “Për sa u takon normave të higjienës, nuk premtom asgjë të mirë”.

“Epo, ju thashë, për një maçok është një lloj opiumi”.

Papritur dera e kuzhinës u hap dy kanatesh dhe dy burra, njëri me këmishë e pantallona kadife, tjetri me xhaketë e kravatë, u sulën në restorant. Burri me këmishë i bërtiti diçka atij me xhaketë e kravatë. Të dy vraponin pas një fluturuesi që bënte zigzage të shpejta midis tyre pa pushuar së kuisuri.

“Është një pallua” tha Antonini dhe, para se kushëri të mund të përgjigjej, palloi u zhduk nën një tavolinë në anën tjetër të restorantit – dy klientët që ishin ulur atje, tashmë të nervozuar, kërcyen në këmbë.

“Ti e ke marrë për të përdorur trurin dhe gjuhën” bërtiti burri me xhaketë e kravatë.

“Jo, thjesht, ka ikur. Nga kështjella”.

“Ka ikur, eh, nga kështjella, do të ta tregoj unë kështjellën” i bërtiti burri me xhaketë e kravatë. “Provo ta prekësh dhe do të shikosh do të të bëj të paguash”. Papritur u ndje një kuisje nën tavolinë dhe palloi u sul duke u përplasur nëpër këmbët e klientëve e të tavolinave. Ndoshta i shtyrë nga një instinkt i fortë i pagabueshëm i palloit ose ndoshta rastësisht, fluturuesi u drejtua

nga dera prej xhami që një mesoburrë, sapo ia kishte hapur shoqes së tij, e cila, kur pa zogun, u zmbraps me britmë. Palloi u hodh jashtë duke gërthitur në rrugët e qytetit të rilindjes. Burri me këmishë vrapoi pas palloit dhe, pa u ndalur, vështroi gruan dhe thirri: “Budallaqe je ti, e di sa kushton ky zog?” Burri me xhakëtë e kravatë ndaloi për një çast, u përpoq të gjente fjalë ndjese, por pastaj vendosi të vazhdonte edhe ai gjahun dhe i bërtiti burrit me këmishë: “Ishte një rast, Marek, vetëm një rast!”. Nga një cep i restorantit, një grup klientësh, të ulur në dy tavolina duartrokitën dhe thirrën diçka tri herë.

“Do të jenë të huaj” tha Antonini.

“I huaj jam edhe unë” tha kushëri. “Pak”.

“Jo, jo, ju flisni çekisht”.

“Ah, s’kisha menduar për këtë”.

Kamerieri dukej sikur donte të mbante një fjalim të gjatë, por, në fund, pyeti vetëm, nëse ndonjëri kërkonte llogarinë. Kushëri tha: “Dhe unë që isha i bindur se ishte një maçok, gjithë kohën, derisa e pashë”.

“Edhe unë” pranoi Antonini.

“U shfaq fare papritur”.

“Po, e çfarë do të bënin me të në kuzhinë, është më mirë të mos flasim”.

“Të bënin me të? Në kuzhinë?”

“Po. Por më mirë të mos flasim për këtë”.

“Mmh. Atëherë më tregoni si përfundoi pastaj... e kuptuat? Me Klarën?”

“Me Klarën?” përsëriti Antonini. “Si përfundoi puna me Klarën”.

“Më në fund, si arritët të njiheshit me të?”.

“Kishte periudha kur ndihej më mirë, kishte edhe që ndihej më keq, provoi të vetëvritej disa herë... Kishte një depresion të fortë”.

“Nuk habitem” tha kushëri “pas gjithë asaj që kishte kaluar”.

“Natyrisht. Pastaj filluan goditjet me *elektroshock*”.

“Kjo ishte e vetmja zgjidhje?”

“Jo, kishte edhe leukotomi, por kjo është një ndërhyrje akoma më drastike”.

“Çfarë është?”

“Zakonisht quhet lobotemi. Ose ndarja e lobeve të përparme të trurit nga pjesa tjetër e tij”.

“O Zot, kjo është barbari”.

“Është një operacion i pakthyesëm”.

“Është një akt barbar”.

“Nuk kam ndërmend të diskutoj me ju që nuk keni njohuri lidhur me këtë, për faktin se koncepti i terapisë bazohet mbi njohuritë që ekzistojnë ose janë arritur në momentin e dhënë”.

“Vlen edhe për logjikën?”

“Nuk e di”.

“Nuk ju dukej e çuditshme të ndanit trurin?”

“Por nuk bëhej fjalë vetëm për ndarjen e trurit”.

“Po ai person, pastaj, nuk humbiste vetveten?”

“Një pjesë të vetvetes, shpresonim të ishte pjesa më e keqe e vetvetes, ajo që e dëmtonte”.

“Një pjesë?”

“Po, edhe pse, të thuash të vërtetën, nuk ka qenë kurrë e mundur të përcaktohej në çfarë mase”.

“Dhe kjo nuk kishte rëndësi për ju?”.

“Nuk është e vërtetë që nuk na dukej e rëndësishme”.

“Po, atëherë, si mund ta lejonit një gjë të tillë?”.

“Ne donim të ndihmonim pacientët. Vetëm t’i ndihmonim”.

“Dhe nuk mendonit se i dëmtonit?”

“Pa dëmtuar pak, nuk do të ekzistonte mjekësia”

“Pa dëmtuar pak?”

“Mos më kap në fjalë”.

“Ju e thatë këtë”.

“Përdorej si plazhi i fundit”.

“Dhe pastaj, do të mund të dashuroheshit me të?”

“Po nervozoheni shumë”.

“Do të mund ta donit akoma, pastaj?”

“Ta ndjekim hap pas hapi”.

“Do të mundeshit apo jo?”

“Hap pas hapi, ju lutem, hap pas hapi. Nuk e di. Është e qartë se nuk e di. E... e... gjithsesi nuk ia bënë”.

“Asaj jo, këtë e kuptova. Asaj jo”.

“Natyrisht, pacientë të tjerë e kanë bërë – unë, në atë periudhë, përpiquesha të merresha me diçka tjetër”.

“Dhe nuk kishe dyshime?”

“Sigurisht që po, por kisha edhe besim. Ndoshta jo pse ishte absurde, por për të kuptuar. Jam përpjekur të kuptoj dhe kam kuptuar. Të paktën, atëherë, mendoja që, në një farë mase, të gjithë ishin në duart e Zotit”.

“Tani nuk beson më?”

“Pas asaj që i ndodhi Klarës, kam pushuar së besuari”.

“Ajo që më treguat është, vërtet, diçka e rëndë, por nuk duhet të ngatërrojmë natyrën me Zotin. Ndoshta vetëm e ka lënë të ndodhë”.

“Ku e shikoni këtu vullnetin e Zotit? Në gjithë këtë vuajtje? Kur uria i shtynë ujqërit të dalin nga pylli... Kur është njeriu ujë për njeriun? Dhe kur ujku është Zoti ynë i mirë?”

“I yni?”

“Natyrisht, i yni. Edhe ai që nuk beson nuk mund ta përjashtojë veten. Një Zot i mirë shkon ku është vendi i tij në atë moment”.

“Ku është vendi i tij?”

“Po të jetonte në hotel, sigurisht, do t’i jepja një dhomë më të keqe se atë të Kokut”.

“Kush është Koku?”

“Eduard Kok tani nuk rron më, por, të paktën ai u përpoq

të gjente një zgjidhje për tbc-në. Në fakt, desha të thosha se elektroterapia funksionoi për depresionin, por pati efekte anësore që na habitën”.

“Efekte anësore?”

“Nuk e kuptuam menjëherë, që një infermiere që e vuri re, më parë se ne mjekët”.

“Çfarë?”

“Klara filloi të priste shumë vizita. Gjithmonë e më shumë. Një ditë kryemjeku më thirri dhe më tha çfarë kishte zbuluar. Kishte konstatuar një rritje vizitash në ditët pas elektroterapisë”.

“Pas elektroterapisë?”

“Të gjithë ata që hynin në repart duhej të firmosnin në librin e vizitave dhe, duke krahasuar kartelën mjekësore të Klarës dhe librin e vizitave, kryemjeku gjeti një lidhje. Iu drejtua kryeinfermieres dhe ajo u lëkund pak, por në fund tha të vërtetën. Klara bënte parashikime”.

“Bënte parashikime? Po për çfarë?”

“Parashikonte të ardhmen?”

“Parashikonte të ardhmen?”

“Po, Klara parashikonte të ardhmen”.

“Po si? Si mundej të parashikonte të ardhmen?”

“Dy tri ditë pas elektroshokut filloi të ankohej për dhimbje koke dhe në mëngjes nuk ngrihej nga krevati. Nuk kishte asgjë të çuditshme këtu, vetëm se një ditë djali i kryeinfermieres duhej të shkonte në Koshiçe dhe ajo, në prani të Klarës, i tha dikujt se mezi priste të nisej i biri, në mënyrë që të bënte një pastrim të mirë të shtëpisë. Në atë moment, Klara ndërhyri në bisedë duke thënë se djali i saj nuk do të nisej dhe se ajo do të ishte e kënaqur për këtë. Kryeinfermieres i bënë përshtypje këto fjalë. Pas disa ditësh u përplasën dy trena lokalë. Asgjë serioze, por ca të plagosur i sollën edhe tek ne. Kryeinfermierja rrinte si mbi gjemba, sepse në njërin prej atyre trenave duhej ië kishte hipur edhe i biri. Por as në listën

e të plagosurve, madje as në listën e udhëtarëve nuk figuronte emri i tij. Derisa në mesditë djali erdhi në spital – thjesht nuk i kishte dalë gjumi. Nuk dinte asgjë për aksidentin. Kryeinfermierja u emocionua dhe e përqafoi fort. Pastaj u kujtua për çka i kishte thënë Klara. Të nesërmen e pyeti si ishte e mundur që ajo e dinte, por Klara nuk mbante mend asgjë. Nuk e dinte – për ndonjë arsye e kishte nxjerrë nga mendja. Kryeinfermierja ua tregoi këtë rast infermiereve të tjera dhe kështu u hap lajmi. Tani shpjegoheshin edhe kërkesat e tepruara për ta bërë turnin në ditë të caktuara. Të gjithë filluan t’i bëjnë pyetje asaj”.

“Pyetje për çfarë?”

“Për gjithçka. Një nga infermieret e pyeti, nëse vjehrrit do t’ia jepnin paratë e premtuara. Tjetra – nëse procedura e adoptimit do të përfundonte mirë. Një tjetër donte të dinte për njëfarë trashëgimie”.

“Dhe... me çfarë rezultatesh?”.

“Gjithçka ishte e saktë”.

“Vërtet?”

“Vërtet. Efekti zgjaste dy ose tri ditë pas elektroshokut, pastaj zhdukej. Mund t’i bëje edhe një, dy, maksimumi tri pyetje, pastaj ajo lodhej, pothuaj gjithmonë, e zinte gjumi dhe nuk funksiononte më”.

“E çfarë bëtë?”

“Çfarë bëmë? U përpoqëm ta studionim dukurinë, sepse elektroterapia, gjithsesi, e ndihmonte dhe shmangëm rrezikun e përdorimit të leukotomisë”.

“Gjithsesi është një barbari”.

“Më falni, po kishte pacientë që vuanin nga një depresion aq i fortë, të cilët na luteshin në gjunjë që t’ua bënim”.

“Fakti që ato kohëra më duken barbari, nuk do të thotë se unë dyshoj në vullnetin tuaj të mirë apo për gjykimet tuaja prej specialisti mbi rastet e pacientëve”.

“Më habit gjithmonë pastërtia e panjollësor e të rinjve, ashtu si dhe pastërtia e diletantizmit, pastërtia e Ngjizjes së Papërlyer”.

“*Credo quia absurdum!*” Kjo është absurde, ju lutem, absurde... e pakuptimtë, do të thotë pa një kuptim të dukshëm, por e pakuptimtë s’do të thotë barbari!”.

“Natyrisht, *credo quia absurdum*, në fakt edhe kjo më ndihmoi atëherë!”.

“E...”.

“Atëherë, akoma po... Më vonë, kjo aftësi e Klarës i vajti në vesh sekretarit të Partisë Komuniste lokale”.

“E...?”.

“Fillimisht bëri një takim me kryemjekun. Kryemjeku ishte një tip i ashpër, por dinte të luftonte për pacientët e vet. Atëherë sekretari i partisë përpunoi mirë e mirë drejtorin e spitalit, i cili i siguroi kryemjekut një bursë të gjatë studimi në një institut kërkimesh që ia kishin mohuar disa herë më parë dhe, sapo iku ky, vuri në vendin e tij, në krye të repartit një njeri të besuar të sekretarit”.

“Përse nuk u mbrojtët?”.

“Me mjekun që kujdesej për të kisha miqësi, kështu që e di se bëri të mundurën e të pamundurën. Sekretari i partisë urdhëroi të intensifikonin numrin e elektroshokeve në mënyrë që rriteshin vizionet e saj parashikuese, por miku im nuk pranoi”.

“E çfarë ndodhi?”

“U caktua, përkohësisht, në një repart tjetër, ku kishte mungesë mjekësh”.

“Mund të bëhej kjo?”.

“Mund të bëhet pothuaj gjithçka. E di çfarë ka shkruar Taciti: *rara temporum felicitate, ubi sentire quae velis, et quae sentias dicere licet*” tha Antonini.

“Çfarë do të thotë?”

“Do të thotë: është i rrallë fati i kohëve, në të cilat lejohet të

mendosh atë që do dhe të shprehësh atë që mendon. Ne ishim shumë afër kufirit rus... ”.

“Është e çuditshme...”.

“Është një justifikim i çuditshëm, doni të thoni”. Kushëriri mblodhi supet. “Ndoshta keni të drejtë, kishim frikë, prandaj vetëm gjenim justifikime. Ndërkaq... si ta them, fama e Klarës arriti në gjithë institucionin dhe ajo filloi të fitonte njëfarë konsiderate”.

“Në ç’kuptim?”

“U vu re se infermieret e repartit të saj filluan të marrin dhurata të vogla nga njerëzit. Edhe Klara merrte dhurata dhe lule, shumë lule, të cilat, pastaj, ua dhuronte pacientëve të tjerë. Dhe njerëzit filluan të mbulojnë edhe prindërit e saj, nuk po them me lavdi, por me konsideratë. Kurrë më s’më ka ndodhur një gjë e tillë”.

“Një lloj histerie masive”.

“Kështu mendonim edhe ne. Por... ”.

“Por?”

“I kishim të gjitha të dhënat. Para se ai sekretari komunist të ndërhynte, kishim bërë testim”.

“Çfarë kishit bërë?”

“Testime”.

“Çfarë testimesh?”

“Mjeku që e kishte nën kujdes, kryemjeku dhe unë kishim bërë të gjithë nga një pyetje, pastaj i shkruam pyetjet dhe përgjigjet dhe i mbyllëm të gjitha në një kuti sigurimi”.

“Çfarë pyetjesh ishin?”

“Kryemjeku pyeste çfarë notash do të merrte i biri. Martini, mjeku, e pyeste, kush do ta zinte vendin bosh në repartin tonë dhe unë e pyesja, kur do të martohej motra ime”.

“Dhe...?”

“Tha që djali i kryemjekut nuk do t’i mbaronte studimet, gjë që ishte e habitshme, sepse ai ishte shumë i zoti. Por, në një moment, u mor vesh marrëdhënia e tij me një grua, i ati nuk e pranonte,

prandaj djali iku nga shtëpia, e la universitetin dhe nuk e vazhdoi kurrë më. Lidhur me vendin e punës në repartin tonë, e fitoi një mjek shumë i mirë që ishte ndarë nga gruaja dhe donte një punë me banim të siguar. Kjo nuk habiti asnjëri, sepse ishte kandidati më i mirë, epo, edhe çka tha për motrën time, fund, u realizua”.

“Po pastaj?”

“Pasi u largua kryemjeku me bursë studimi dhe Martini, mjeku, u transferua në një repart tjetër – unë nuk mund të shkoja më tek Klara. Më thërrisnin vetëm, kur kishin nevojë për mua, por nuk isha i dëshiruar. Mjeku i ri që merrej me të, më bëri ta kuptoj qartë”.

“Epo, duhej të bënit diçka!”.

“Po, nuk më pëlqente, dëgjoja që po i jepnin edhe substanca të tjera për të rritur ato efekte dhe askush s’dinte asgjë të saktë. Pastaj mora vesh se ajo asaj i kishin filluar kriza epilepsie. Dhe vinin ta takonin miq e të njohur të ndryshëm të anëtarëve të partisë, përfaqësues të nomenklaturës komuniste, sigurisht, të gjithë për ta pyetur për të ardhmen. Dhe ajo, pastaj, zgjohej e nuk mbante mend asgjë. Për ta ishte një situatë ideale, megjithëse shëndeti i saj, më vonë, do ta ndiente këtë”.

“E çfarë bëtë atëherë?”

“Një ditë e prita në kopshtin e spitalit. U ula pranë saj dhe qëndrova gjatë në heshtje, pa ditur nga ta filloja. Nuk doja të ndreqja gabimin me një tjetër gabim. Nuk doja t’i shkaktoja asaj një traumë tjetër. Pastaj fola sipas njohjes dhe vetëdijes sime, në mënyrë të përmbytur. Fillova duke i kërkuar të më thoshte si quheshin lulet në atë leh. M’u përgjigj. Tani që isha ulur aq afër saj e kuptova për herë të parë pas gjithë asaj kohe, sa e bukur ishte. Në atë moment ndjeva të gjitha simptomat e njohura jo të infarktut të miokardit, por të një shqetësimi emocional të pashërueshëm, kundër të cilit nuk ekziston akoma një vaksinë”.

“Po ajo?”

“Ishim ulur afër njëri-tjetrit në një stol dhe ajo, në një moment, më tha: “Përse? Pse e gjithë kjo?” Dhe në atë çast unë e ndjeva se ajo e kuptonte atë që mendoja dhe ndieja unë. Unë akoma nuk e kisha të qartë, ndërsa ajo sigurisht – po. Sepse, pas një çasti, ajo vazhdoi: “Këtë jo doktor, harrojeni! “Çfarë?” pyeta unë. “Vërtet është kaq keq situata, doktor?” më tha, pastaj shtoi: “O Zot, pse janë njerëzit kështu? A nuk kam vuajtur mjaft?”.

Pastaj u ngrit dhe u largua. Bëra përpjekje që ta nxirrnin nga spitali. Doja që ta shpëtoja nga elektroterapia, por më kot. Më në fund iu drejtova sekretarit komunist. Mendova që do të më dëbonte menjëherë, por nuk e bëri. Më dëgjoi pak, më bëri disa pyetje dhe më tha se do të merrej ai vetë me këtë çështje. Mbeteja i habitur. Pas dy ditësh më thirri drejtori i spitalit, i cili më ulëriti për gjysmë ore të tërë – nëse do të ankoheja përsëri tek sekretari, karriera ime në ngritje do të rrokullisej poshtë – do të kujdesej ai vetë për këtë. Pastaj në kulmin e zemërimit më tha se Klara kishte dalë nga spitali dhe mund të bëja ç’të doja me të. Midis britmave më pyeti, nëse sekretari i kishte kërkuar informacion për pavijonin numër shtatë. “Jo” i thashë. Ndiheja i lumtur.

Klara doli të nesërmen nga spitali dhe, gjatë disa javëve, e binda ta fillonte kurën diku tjetër. Njëpërmjet të njohurve të mi arrita, më në fund, t’i gjej një vend në Bratislavë. Kur kryemjeku i repartit, në të cilin ishte shtruar Klara u kthye nga studimet, ia tregova të gjitha dhe ai më tha: “Po ju e dini çfarë ndodh në të shtatin?” Ia numërova ato që dija nga dokumentet e brendshme të spitalit, por ai më ndërpreu: “Ky është version zyrtar, koleg”. “Pse, ka një tjetër?” e pyeta. “Jo, është vetëm një” u përgjigj ai dhe ngriti supet. Të nesërmen, gjatë vizitave në spital, më ndaloi në shkallë, vështroi përreth dhe, pasi pa që s’kishte njeri, më tha: “Mos pyet për të shtatin. Ndodhin gjëra të tmerrshme. I çojnë pacientët deri në... në... bëjnë gjëra të frikshme. Ndoshta janë trembur se Klara juaj, me simptomat e saj të çuditshme, mund t’i

trazojë keq ujërat dhe e kanë lëshuar, prandaj ju ka folur drejtori për pavijonin shtatë”. “Po çfarë ndodh aty?” pyeta pa mundur të përmbahem. “Mos pyesni kurrë askënd” e përsëriti. “Janë gjëra të tmerrshme. Askush prej nesh nuk do të donte të përfundonte aty brenda. Dhe kanë gjithçka në dorë ata – sekretari, drejtori e me radhë...”.

Për disa vjet unë dhe Klara vazhduam të takohemi, pastaj, kuptova se i kujtoja shumë atë që i kishte ndodhur në pyll. Prandaj u detyrova të mos e takoja më. Duhej ta bëja. Ishte gjëja më e mirë për të”.

“Mendova se ishte një dashuri e madhe”.

“E madhe? Nuk kam njohur kurrë një më të madhe. Që nuk kemi jetuar kurrë bashkë, që nuk ka pasur ndërmjet nesh këmbim lëngjesh trupore – nuk ka asnjë rëndësi”.

“Po pastaj? Çfarë ndodhi pastaj?”

“Asgjë nuk ndodhi më. Pas disa vitesh u martova me gruan time. Dhe jemi bashkë akoma”.

“Po ajo? Klara?”

“Më duket se kam pirë konjak më shumë seç duhet. Por do të arrij deri në hotel. Ndoshta, kushëri, herë pas here, do të mbështetem tek ti”.

“Po Klara?”

“Kam treguar më shumë seç duhet. Po mbyllin lokalin dhe duhet të kërkojmë llogarinë”.

20. Letra e fundit, kronikë mbi ekspozitën dhe ca karrige të thyera

Përsëndetje sis,

në letrën tënde të fundit doje të dije çfarë përshtypjesh kam nga çekët dhe nga Bohemia, më ke kërkuar, gjithashtu, të mendohem para se të kthehem në Londër. Jam menduar, por është “for your eyes only” ose, siç thuhet këtu, rreptësisht e rezervuar. Meqenëse unë e ti jemi gjysmë çekë, ndihemi më afër tyre, sesa një i huaj normal dhe, për këtë arsye, ndoshta, duke dhënë një gjykim - favorizoj ata.

Shënim: kërko në fjalor foljen favorizoj, s’ka të bëjë fare me - bëj favor. Është një nga fjalët që kam mësuar në Pragë, ose në Hodonin apo në Krumlov. Pra çekët janë kafshë të çuditshme. Thelbi i tyre çek, më duket, rrjedh nga kushti i të qenit pjesë e një populli të vogël, të bashkuar nga historia dhe nga një eksperiencë historike e përbashkët dhe nga gjuha çeke. Kanë një sjellje, për shembull, tepër të ftohtë. Janë, pa dyshim, më të ftohtë se anglezët. Është e paimagjinueshme që në Hodonin apo në Pragë të të buzëqeshë dikush rrugës. Edhe sjellja e shitësve ose e kamerierëve është, vërtet, diçka emblematisht. Nuk e imagjinon dot sa të pacipë e të paedukatë janë, madje edhe vulgarë me klientët. Kur e kisha lexuar në guidë – nuk e besoja, por është shumë më keq nga sa mund të mendohet. Shkon të blesh diçka, për shembull – patate dhe duhet të jesh gati të presësh një sharje nga shitësi i fruta-zarzavateve! E imagjinon dot? Është fantastike! Ia vlen të bësh një shëtitje apo jo?

Por ka dhe më mirë: pavarësisht nga qëndrimi i tyre, janë radikalisht të bindur që janë një prej popujve më të edukuar e të kulturuar të botës. Sensacionale! Gjëja e parë - nuk i paguajnë mësuesit ose i paguajnë, siç kam pasur rastin ta konstatoj, si në Shqipëri; e dyta, paratë që japin për kulturën, janë për frymë, më pak se ato që jepen nga Rusia. Si rezultat, numri i turistëve që vizitojnë Budapestin, për shembull, është çdo vit katër herë më i lartë se i atyre të Pragës, megjithëse Praga është shumë më e bukur. Por ata besojnë se këtë, tashmë, e dinë të gjithë dhe se nuk është e nevojshme të përhapet lajmi. Madje e konsiderojnë veten, në njëfarë kuptimi, kërthizën e botës.

Nuk e kanë kuptuar akoma se kjo bindje çon e do të çojë gjithmonë e më shumë, në lloje të ndryshme diskriminimi të pakicave dhe në racizëm. Me pak fjalë, këtu, informacionet dhe faktet nuk kanë rëndësi ose fare pak. Ndoshta kjo është shenja dalluese e këtij Shteti. Nëse diçka nuk përputhet me përfytyrimin e tyre – aq më keq për faktet.

Përshtypja ime është se ata konsiderohen edhe cinikë, ndoshta për shkak të kalimit të shpejtë nga komunizmi në kapitalizëm. Siç ka thënë Oscar Wilde: cinik është ai që njeh çmimin e çdo gjëje, por nuk njeh vlerën e asnjërës. Por ti e di mirë mendimin tim. Si të gjithë popujt e Europës Lindore (me përjashtim të polakëve) në publik janë shumë të ndrojtur e të përmbajtur. Janë edhe të bindur se kush është në depresion – është një mendimtar më i thellë.

Nuk dua ta reduktoj bisedën shumë, do të të shpjegoj, por për t'i rënë shkurt, sipas tyre, ata që flasin për vdekjen ose për universin janë persona të jashtëzakonshëm, ndërkohë që, në shumicën e rasteve, janë vetëm mjeranë që do të kishin nevojë për një psikiatër (të çmendurit). Kanë dhe një lidhje kurioze me psikologjinë dhe filozofinë. Mendo që psikologjia është lënda më e studiuar prej të gjithëve në universitet. Duket se vazhdon kështu prej shumë brezash. Dhe më vjen ndërmend, a ke dëgjuar

ndonjëherë të përmendet ndonjë shkollë psikologjie çeke? Pak a shumë si të kërkosh: më thuaj emrat e tre Belgëve më të famshëm.

Gjithsesi. Ndoshta varet nga fakti se çekët janë Shteti më ateist i Europës dhe i botës. Në ndonjë vend duhej të manifestohet. Edhe në lidhje me filozofinë ka diçka të bukur për të thënë. Dje lexova në një të përditshme lokale nekrologjinë e një regjisorit skandinav. Artikulli përmendte dy herë Platonin dhe një herë Aristotelin, por as edhe një fjalë për mjeshtrin dhe ose për ndjekësit e regjisorit. A njeh, të paktën, tre filozofë çekë të famshëm? Ndoshta Masaruk? Por ai hynte në sferën e asaj që sot quhet sociologji. Për sa i përket mungesës së fesë, këtu ekziston një lloj plebeizmi natyral. Nga sa kam pasur mundësi të vërej, për shembull, askush nuk vishet bukur për Krishtlindje ose për ditëlindje. Nuk ekziston këtu që një grua të vishet bukur dhe një burrë me xhaketë e kravatë vetëm ashtu, për një darkë familjare. Në shtëpi, shumë herë, rrinë me tuta, megjithëse nuk kanë praktikuar kurë ndonjë aktivitet sportive! Për njëfarë kohe kam menduar se ishte simpatike kjo mungesë formaliteti, por, pastaj, vura re se, për veç ndonjë përjashtimi, askush nuk vesh gjëra të bukura për një drekë feste në shtëpi. Ajo që në të gjithë Europën është normale, këtu nuk bëhet.

Dhe tani anët më të mira: kur njihesh me dikë arrin të bësh me të biseda vërtet të këndshme, kanë një prirje për humor të zi dhe një qëndrim të mirë ndaj të moshuarve. Mendo që, kur në autobus ose në tramvaj s'ka vende të lira, ngrihen për t'u liruar vendin të moshuarve dhe kjo duket shumë normale. Kam vënë re, gjithashtu, se kanë shumë konsideratë për marrëdhëniet familjare, pothuajse si në Itali, megjithëse çekët dhe italianët, në vështrim të parë, duket se s'kanë asgjë të përbashkët. Bashkëmoshatarët tanë (s'ka të bëjë fare me kohezionin ose ndoshta pak po, do të thotë ata që kanë moshën tonë) ndoshta nuk ngajnë me anglezët ose me holandezët, pra me të rinjtë e asaj moshe (deri në tridhjetë vjeç), me çfarëdo prejardhje. Janë shumë të ngrohtë në privatësinë e tyre

dhe janë të aftë të tregojnë të gjithë jetën e tyre, përveç hollësive intime, para një filxhani me kafë. Diçka që një anglez s'do ta bënte kurrë. Këtu ka një çiltërsi të madhe. Është vështirë të kuptohet, por çdo ditë zbuloj diçka të re për ta.

Në kushte të përshtatshme, çekët janë pak si gjermanët, por, absolutisht, nuk duhet t'ua thuash. Do të ishte njësoj si t'i thuash dikujt që duhet të lahet, megjithëse ke të drejtë, do ta merrnin si një fyerje të madhe. Por ngjashmëria me gjermanët është ndoshta më e fortë se me çdo popull tjetër fqinjë. Me ta kanë një marrëdhënie të veçantë – i simpatizojnë pak, i urrejnë pak, ndoshta si gjithë pjesa tjetër e Europës. Kanë dhe mënyra të çuditshme në lidhje me – çfarë të thonë dhe çfarë të mos thonë, kur dhe si ta thonë në mënyrë që tjetri të mos e marrë për keq. Nganjëherë e bënte edhe babai, megjithëse tek ne s'kishte kuptim. Mendo pak, fqinji lë mbeturina që zënë sheshpushimin e përbashkët. Dhe unë e pyes, përse nuk i thua t'i heqë? Dhe më përgjigjet se nuk është mirë, gjithsesi, mund të kalohet, megjithëse duket që kjo gjë e bezdis. Nganjëherë më duket vetja si në një film me samuraj të Japonisë mesjetare. Ka një etiketë të ndërlikuar dhe të arsyetuar deri në detaje. Megjithatë tani të rinjtë nuk tregojnë më një kujdes të tillë.

Kjo është, me pak fjalë, përgjigja për pyetjen tënde, para se të nisem nga Praga. Pjesa tjetër e letrës ka lidhje me punën për bankën, për të cilën të kam shkruar herën e fundit, burimet i kam mbledhur unë, por, në fakt, shefi im, Kareli, i ka bashkuar të gjitha.

Lexim të mbarë.

P.S. Nuk e kam shumë të qartë. Më shkruaj çfarë mendon ti.

*Garanton vlefshmërinë e dokumentit. Përgjegjësi i repartit
Karel Verner*

Studimi i të dhënave: Jiri Novak

Statusi i lajmit: Konfidencial

Objekti: *Shënime mbi historinë e Ekspozitave në Republikën Çeke, të dobishme në kërkimin e një zgjidhjeje për borxhet, akoma pezull, si pasojë e Ekspozitës Universale të Çekosllovakisë në vitin 1991.*

Ekspozita e parë e Veprave të Industrisë ishte organizuar nga Shoqata e Promovimit të arteve, të manifakturave dhe të Tregtisë në Londër në vitin 1756 dhe 1757, në pjesën tjetër të Europës, rekordi i takon Pragës. Këtu u organizua Ekspozita e parë në vitin 1791, në hapësirat e Karolinumit aktual me rastin e kurorëzimit të mbretit çek Leopoldi II. Ajo ekspozitë nuk kishte marrë akoma emrin Ekspozitë, por emërtohej Koleksion i Prodhimeve. Ndoshta ia vlen të kujtojmë se, me rasti, e kurorëzimit, kompozitori austriak W.A. Moxart u ngarkua nga Shtetet e Bohemisë për të kompozuar një opera. Opera është titulluar *Mëshira e Titos* dhe u kompozua për tetëmbëdhjetë ditë.

Ekspozita Jubilare e Pragës në 1891 u organizua në kujtim të asaj të vitit 1791 dhe qe një event me një entitet krejt tjetër. Ekspozita Jubilare u nda në njëzet e shtatë njësi dhe ekspozuesit fituan gjithsej 6348 çmime. Nga pikëpamja financiare, gjë për të cilën është më shumë i interesuar institucioni ynë bankar, është e rëndësishme të theksohet që, megjithëse Ekspozita Jubilare u vizitua nga 2.432.356 persona pagues dhe buxheti origjinal ishte 1.132.000 forinta, në të vërtetë, u shpenzuan 1.606.522. Nga këto të dhëna të pakta arrijmë në përfundimin se u shpenzuan rreth gjysmë milioni forinta më shumë nga ç' ishte në projekt, saktësisht 474.122. Këtë eksperiencë historike duhej të kishin pasur parasysht organizatorët e Ekspozitës Universale Çekosllovake të vitit 1991.

Më duket shumë e rëndësishme të nënvizohen parimet mbi të cilat u bazua organizimi i Ekspozitës. Pallati qendror u quajt Katedrale çeke e punës. Hapësira e ekspozimit mbikëqyrej nga statuja që paraqisnin Bujqësinë dhe Industrinë. Një poet çek (Jan

Neruda) shkruante se Ekspozita kishte për qëllim të “largonte çdo lloj varfërie morale e materiale, t’u garantonte të gjithëve realizimin maksimal të shpirtit njerëzor, të stimulonte një garë midis popujsh të ndryshëm në përpjekjen për të nxjerrë përfitime, mirëqenie e rehati për të gjithë komunitetin”. Ky ekstrakt shpreh, me një gjuhë artistike, një entuziazëm afër ekstazës që, megjithëse për motive të tjera, frymëzoi Ekspozitën Universale të vitit 1991. Në krahasim me atë të 1791-shit, nuk u thirr ndonjë artist i kalibrit të W.A.Moxart.

Tridhjetë vjet pas Ekspozitës Jubilare (1891) ose në 1920, filluan të organizohen në të njëjtin vend, ose në parkun Stromovka të Pragës, Panairët Tregtare. Panairi i parë tregtar në Pragë u përrua me 12 shtator të vitit 1920, në nëntë të mëngjesit, në Pallatin e Industrisë (në brendësi të parkut të Stromovkës). E përuroi kryetari i atëhershëm i bashkisë së Pragës, doktor Baxa dhe pas fjalimit të tij të hapjes, e mori fjalën Presidenti i qeverisë, Tuzar. Duhet thënë se qeveria e tij, të nesërmen, dha dorëheqjen, kështu që ishte fjalimi i tij zyrtar i fundit. Këto Panaire ishin të destinuara për tregtinë me shumicë dhe tregtarët me këtë qëllim, i blinin mallrat nga prodhuesit para sezoneve tregtare të pranverës dhe të vjeshtës. Synimi ishte të shmangej qëndrimi i gjatë i mallrave nëpër depo dhe Panairët bëheshin në muajt mars dhe shtator.

Për shumë vite me radhë, këto Panaire e përmbushnin funksionin e tyre dhe, deri në krizën ekonomike, patën një sukses të madh tregtar. Numri më i madh i vizitave u regjistrua në vjeshtën e vitit 1929 – rreth 560.000 vizitorë. Para disa vitesh, në 1925, filluan punimet për ndërtimin e Pallatit të Panaireve, tani - Galeria Kombëtare. Kjo ndërtesë duhej të kishte përfunduar në vjeshtën e vitit 1927. Projekti origjinal parashikonte ndërtimin e katër godinave, një për 40.000.000, dy për 50.000.000 dhe një për 26.000.000 korona. Pra shpenzimet e parashikuara për katër godinat arrinin në shumën rreth 166.000.000 korona, por,

kur u shtuan, kosto të tjera të ndryshme arriti në një total prej 190.000.000 koronash.

Pastaj ndodhi që, për godinën e parë, u harxhuan më shumë se dyfishi, për këtë arsye nuk u vazhdua me ndërtimin e tri të tjerave. Kriza e shitjeve që pasoi luftën e Parë botërore provokoi krizën financiare të menjëhershme të Panaireve të Pragës, të cilën, drejtorja e Panaireve u përpoq ta zgjidhte me fillimin e një hekurudhe drejt Ballkanit, ku shpresonin të tërhiqnin klientë të rinj. Treni special iu dha për menaxhim një të afërmi të drejtorit të panaireve, Kamil Vrana dhe, nga tetori deri në dhjetor përshkoi Sllovakinë dhe Rusinë në jug të Karpateve për të arritur në Rumaninë dhe Bullgarinë e atëhershme. Stacionet e trenit ishin, në njëfarë mënyre, të lidhura me promovimin e panairit të Pragës dhe gjendeshin në qytetet: Oradea, Kluj, Timishoara, Krajova, Bukuresht, Ruse, Varna, Stara Zagora, Sofia, Galashi dhe Lashi. Por kjo nismë nuk pati sukses, prandaj nuk u përsërit më. Gjatë krizës ekonomike të viteve Tridhjetë, drejtorja u përpoq të mbështeste Panairin sa mundej. Për shembull në 1929 Panairi Tregtar i Pragës bashkëpunoi në zgjedhjen e Miss Çekosllovakisë, në Pallatin e Panaireve u organizuan koncerte dhe u mendua edhe për të mikpritur në brendësinë e tij një ekspozitë të thesareve të carit.

Në kohën e luftës së Dytë botërore, në 1941, ndërtesat e zonës së re të ekspozitave u konfiskuan nga *Geheime Staatspolizei*, *Statsspolizeistelle Prag*, edhe e quajtura *Gestapo*. Për pasojë disa pavijone u zunë nga *Zentralstelle für jüdische Auswanderung*, ose Zyra Qendrore për Emigrimin e Hebrenjve. Që këtë nisësin hebrenjtë e Pragës drejt kampeve të përqendrimit. Ekziston vetëm një dokument që vërteton këtë histori, në të cilin flitet për dhjetëra e dhjetëra karrige jashtë përdorimit, “të thyera nga hebrenjtë”. Në 1942 Gebels, Ministri i Propagandës dha urdhër të prisheshin të gjitha Panairin në territorin e Rajhut të Madh Gjerman. Pas luftës,

Panairot e Pragës u rikthyen për një periudhë të shkurtër. E fundit u përurua me 19 maj të vitit 1951 nga Antonin Zapotocki, Presidenti i atëhershëm i qeverisë. Supozohet që me atë rast të kenë ardhur në Pragë 122 trena speciale dhe 208 punëtorë. Pas kësaj Panairot u ndërpreu.

Siç del nga kjo histori e shkurtër që arritëm të shkruajmë, mund të nxjerrim nga e shkuara vetëm një informacion - që e ardhmja do të jetë komplekse. E vetmja gjë që mund të kuptojmë, me sa duket, do të jetë e paparashikueshme siç ka qenë e shkuara jonë. Nëse institucioni ynë bankar, ashtu si dhe struktura jonë shoqërore, do të vazhdojnë të ekzistojnë, pak a shumë, në formën aktuale, sipas mendimit tonë ka shumë mundësi që Ekspozita Jubilarë Universale do të jetë në 2091. Me siguri do të ushtrohen presione shoqërore të rëndësishme derisa tradita, tashmë, treshekullore të ndërpritet. Prandaj, sugjerojmë të transferohen borxhet e Ekspozitës së vitit 1991 në një llogari bankare speciale për ta vendosur, në njëfarë mënyre, në lidhje me Ekspozitën e ardhshme të vitit 2091. Duke marrë në konsideratë përhapjen popullore të Ekspozitave të vitit 1791, 1891, 1991 dhe faktin që dy të fundit u vendosën në hapësirën e parkut të Stromovkës, pak a shumë, mund të nxjerrim përfundimin edhe Ekspozita e ardhshme e mundshme e vitit 2091 do të organizohet në atë vend.

Pra këshillojmë që të ndiqen të gjitha aktivitetet që i përplasnin kësaj zone deri në 2091, sepse, sipas supozimeve tona, me afrimin e vitit 2091 do të rriten, proporcionalisht, aktivitetet politiko-tregtare. Kështu institucioni ynë do të përfitojë në raport me konkurrentët dhe do të mund të shpresojë, megjithëse me pak vonesë për mbuluar humbjet e pësuar. Urojmë vetëm që kjo hapësirë ekspozitash të përdoret, mirëfilli, për qëllime tregtare dhe që, në të ardhmen të mos bëhet vend klasifikimi për dëbimin e ndonjë pjese të popullsisë çeke. Por, hipoteza jonë e detajuar parashikon edhe këtë mundësi eventuale. Megjithatë ky skenar

negativ ndodhet jashtë fushës së analizave të repartit tonë dhe të institucionit financiar. Në çdo rast, nëse do të paraqiteshin sinjale negative në atë kuptim, instituti ynë financiar do të transferohej në një Shtet tjetër demokratik duke hequr dorë nga zona interesante e Europës qendrore.

21. Sukthankari

Lajmet e fundit mbi kongresin triditor, në organizmin e të cilit kishte dhënë kontributin e vet doktor Antonin Lukavski, arritën vonë. Kolegia doktoreshë Kadlecova, e cila kishte bërë programin së bashku me të, kishte këmbëngulur për t'i dërguar atij çdo detaj nëpërmjet postës elektronike. Doktor Lukavski, në të vërtetë, ishte krenar që kishte arritur të mësonte, në moshën e pensionit, të përdorte email-in, por, kur para dy ditësh, mirëmbajtësi i rrjetit informatik i shpjegoi, në një mënyrë tepër të ndërlikuar se kompjuteri i tij funksiononte përsëri shumë mirë, megjithëse bëhej fjalë për një – shumë mirë – pak më të ndryshme se më parë, pati ndjesinë se ishte mjaftueshëm për të, prandaj nuk e lexoi as mesazhin e koleges së tij lidhur me referuesin që vinte nga Anglia.

Vetëm duke shkuar në aeroport, ku duhej ta priste atë, filloi të lexonte mesazhin që e kishte printuar shumë shpejt. Ajo që e habiti më shumë ishte emri i referuesit: doktor V.S. Sukthankar. Nuk duket aspak anglez, mendoi doktor Lukavski, duket më shumë një emër... indian. Vazhdoi të lexonte. Në tekst ishte shkruar se doktor V.S. Sukthankar ishte një *Consultant*, duhet të jetë ajo që tek ne quhet kryemjek, përktheu me vete Antonini. Më tej, lexoi se doktor Sukthankar ishte tridhjetë e pesë vjeç. Shumë i ri për të qenë kryemjek, mendoi Antonini, tek ne s'do të ishte e mundur, para dyzet vjetësh askush s'do ta kishte marrë në konsideratë, megjithëse kohët po ndryshonin dalëngadalë. Kur autobusi mbërriti në aeroport, doktori zbriti, hyri në terminalin e mbërritjeve, u ul në një stol dhe nga ana tjetër e fletës, ku ishte printuar e-mail, shkroi

me shkronja të mëdha: Dr. SUKTHANKAR. Me letrën në dorë u bashkua me grupin që priste. Pas disa minutash i kaluan përpara të gjithë udhëtarët e avionit që vinte nga Londra. Ishin nja tridhjetë dhe asnjë prej tyre nuk reagoi ndal fletës me emrin Dr. Sukthankar të Antoninit. Avioni duhej të kishte qenë gjysmë bosh, mendoi Antonini duke vështuar përreth. Jo vetëm udhëtarët ishin të paktë dhe nuk ishte e mundur që t'i kishte shpëtuar, por asnjëri prej tyre nuk i ngjiste as larg e larg një indiani. Edhe kjo më duhej, mendoi, jam i mbytur në punë deri në fyt dhe ai ka humbur avionin. Dhe do të më duhet të vij edhe një herë tjetër. Lavdi Zotit që jam në pension dhe bëj vetëm çerekun e orëve të punës. Javën tjetër filloj pushimet dhe do të plotësoj orët e humbura të gjumit. Sikur të mos mjaftonin këto! Mosardhja e dr. Sukthankarit e kishte mërzitur. Eci pak lart e poshtë nëpër terminal dhe pastaj doli. Priti autobusin dhe u kthyen në studion e vet. Sapo kishte përgatitur çajin e tij dashur me lule bliri kur ra telefoni. Ishte doktoreshë Kadlecova, e cila i tha se doktor Sukthankari sapo i kishte telefonuar nga aeroporti, kishte pasur problem me bagazhin dhe kishte shkuar drejt në hotelin që i kishin prenotuar. Ky lajm nuk e përmirësoi humorin e tij, por në fund u mor vesh me doktoreshë Kadlecovën që të shkonte ta merrte doktor Sukthankarin në hotel në orën pesë pasdite.

Pak minuta pas orës pesë, Antonini hyri në hollin e vogël që ishte zënë nga njëra anë prej recepsionit dhe nga ana tjetër ishin vendosur disa kolltukë. Nga njëri prej tyre u ngrit një burrë një burrë i zakonshëm, i cili iu prezantua në anglisht si doktor Sukthankari. Antonini priste që anglishtja e tij ta vinte në vështirësi, por vuri me kënaqësi që kuptonte çdo fjalë. Shqiptimi i tij ishte nga librat. E vetmja gjë që binte në sy nga pamja e tij ishin flokët e dendur të zinj në blu. Doktor Sukthankari shprehu dëshirën normale për të huajt – të shëtiste nëpër Pragë dhe, meqenëse ishte pikërisht ajo që priste Antonini, mori rolin e guidës.

Akoma pa arritur në Qytetin e Vjetër mori vesh se doktor Sukthankari ishte mbajtur në aeroport, ku e kishin kontrolluar me imtësi, ia kishin marrë valixhen e pasaportën dhe e kishin mbyllur për rreth gjysmë ore në një dhomë pa dritare. Antonini po mendonte për ndonjë pyetje lidhur me kontrollin që i kishin bërë, kur kolegu, i parapriu: “Çfarë është *sikn*?”.

“Çfarë është *sikn*?” përsëriti pyetjen Antonini. “Epo, nuk e di” iu përgjigj në anglisht, pastaj mendoi pak dhe shtoi “është një fjalë që nuk ekziston në gjuhën tonë”.

“Ah” tha Sukthankari “me siguri e kam kuptuar gabim. Policët vazhdonin ta përsërisnin midis tyre”.

“A mund ta thoni përsëri, koleg?”

“Sikn. Sikn. Skan”. Antonini tundi kokën dhe po përpiquej ta deshifronte shqiptimin e huaj. “Sikn. Sikn. Skan”.

Papritur i erdhi ndërmend diçka dhe i tha: “*Do you think tshikan?*”

“Oh, yes” tha doktor Sukthankar. “*That’s exactly is!*”.

“Tani e kuptoj” i tha Antonini në anglisht.

“Nëse është diçka shumë e pasjellshme preferoj të mos e di” reagoi Sukthankari duke parë sikletin e Antoninit.

“Çikan do të thotë rom” tha Antonini pas pak sekondash.

“Ah” komentoi Sukthankari “prandaj më kanë mbajtur, sepse dukem si rom?”.

“Po, siç duket” iu përgjigj Antonini.

“Kam lexuar diçka në gazetë në lidhje me kombin tuaj” tha Sukthankari “por nuk i kam kushtuar shumë vëmendje. Shpresoj se të jesh rom, nuk është ndonjë krim?” dhe ia plasi të qeshurit.

“Do të bëj një reklamim” tha Antonini. “Zyrtarisht ju jeni këtu për të marrë pjesë në konferencën tonë”. Sukthankari e pa kolegun e vet të moshuar të skuqej.

“Jo, jo!” tha menjëherë. “mos e bëni. Për mua është njëlloj pushimi, sepse vite më parë kam pasur një pacient me origjinë

prej këndeje, pastaj dua të vizitoj Austrinë dhe Hungarinë. Jam mësuar. Është thjesht një formë zyrtare ngacmimi. Ra një heshtje e sikletshme që ndërpritej vetëm nga tramvajet në kalim.

“A mund të më tregoni, ju lutem, si mund të shkoj në sheshin Shën Vençeslao? Kam dëgjuar të flitet shumë për të” tha Sukthankari pas pak çastesh dhe ishte e qartë për të dy se ishte një tentativë për të thyer atë heshtje të pakëndshme.

“Natyrisht, do t’ju shoqëroj unë” tha Antonini. “Pastaj ulemi në ndonjë vend për një kafe, kështu do t’ju tregoj edhe për konferencën që fillon nesër”.

“Jeni shumë i sjellshëm” e falënderoi Sukthankari.

Pasi mysafiri e pa sheshin, Antonini gjeti një kafene, në një rrugicë ku u ulën dhe biseda, më në fund, u gjallërua. Dr. Sukthankari ishte psikiatër dhe psikolog, drejtonte repartin e psikiatrisë në një spital në veriperëndim të Londrës. Kishte ardhur për motive turistike. E përsëriti disa herë me kënaqësi. “Gjatë gjithë vitit depërtoj në thellësinë e shpirttrave të pacientëve, por gjatë pushimeve kam gjithmonë kohë të çlodhem, të jem sipërfaqësor, të shikoj botën me sytë e një konsumatori”. Antonini nuk kuptonte, nëse në fjalët e kolegut kishte ironi për shkak të zotërimit jo të plotë të gjuhës së huaj, për të qenë i sigurt nuk qeshi dhe e pyeti: “Si duhet t’ju drejtohem? Kam përshtypjen se gaboj në shqiptimin e emrit tuaj”.

“Më thërrisni Vish” u përgjigj Sukthankari “është shkurtim i Vishnu”.

“Vishnu, Vishnu, Vishnu” përsëriti Antonini “a nuk është emri i një Perëndie?”

“Po” pohoi Sukthankari. “Prindërit e mi janë induistë, edhe unë gjithashtu”. Vuri re që Antonini po e shikonte me vëmendje, pa thënë asgjë, prandaj vazhdoi: “Vishnu është Zoti që, në fenë tonë, me tre hapa krijoi universin”.

“Është një traditë krejt e ndryshme nga ajo europiane” komentoi

Antonini. “Krejtësisht e ndryshme. Këtu në Europë vihen emra shenjtorësh, jo perëndish”.

“Kam lindur në Angli, në qarkun e Surreit, afër Londrës dhe, kur isha i vogël frekuentoja një shkollë katolike” tha Vishnu Sukthankari. “Jam anglez, european, por me rrënjë indiane”.

“Po, po, sigurisht” tha Antonini dhe mendoi si ta shmangte atë bisedë që po merrte një rrugë që nuk ishte i sigurt se donte ta ndiqte.

“Po atëherë, vizita juaj?” e pyeti Antonini.

“Para disa vitesh kam pasur një pacient që vinte nga Republika Çeke” iu përgjigj ai. “Jetonte në Londër dhe për një kohë të gjatë nuk kishte mundur të kthehej, prandaj kishte shumë mall për Pragën. Më thoshte që është qyteti më i bukur në botë, kështu që mendova të vija ta shikoja.

“Dhe po ju pëlqen?” e pyeti Antonini.

“Një qytet i bukur. Vërtet i bukur” tha doktor Sukthankari. “Aq e bukur, sa që më kujton disa vende indiane”.

“Ah, ashtu” tha Antonini me një ton zëri, sa mundej më të përmbajtur.

Doktor Sukthankari i kushtoi një ditë të tërë konferencës dhe katër ditët që i mbeteshin nga qëndrimi në Pragë i kaloi si një turist i vërtetë. Vizitoi kështjellën, urën Karlo, Kampën, Sheshin e Vjetër, shijoi birrën, hyri në disa librari dhe kaloi një gjysmë dite në bibliotekën e universitetit. Një natë para se të nisej për në Vjenë, doktor Lukavski e ftoi për darkë. I kishte mbetur edhe pak energji dhe e dinte se kontaktet me të huajt duhen mbajtur. E pyeti prapë, nëse i kishte pëlqyer qëndrimi i tij i shkurtër në Pragë.

“Po” tha doktor Sukthankari “ai pacienti çekoslovak që unë e kam kuruar, shpesh shikonte të njëjtën ëndërr: të gjendej në jetën e përtejme. Para portës takonte një burrë gjigand, të hipur mbi një dem gjigand. Burri bllokohej, demi rebelohej, por kavalieri i tij arrinte të zbuste dhe i thoshte pacientit tim: “Haji ato që mbeten

nga demi im. Haji ashtu siç bënte, dikur, babai yt”. Pacienti im, do ta quajmë Maks, u lëkund pak, por, në fund, bëri ashtu siç i tha gjigandi. Kaloj portën drejt botës së përtejme. Prapa tij shtrihej një shesh që i ngjante shumë një sheshi të Pragës. Në trotuare ecnin njerëz normalë. Maksi u ndal për një çast që të orientohej, por papritur pa një endacak që vraponte drejt tij. Endacaku sillej në një mënyrë vërtet të çuditshme, për një çast dukej, në çastin tjetër zhdukej. Ai u përplas me Maksin pikërisht në momentin, kur ishte i padukshëm dhe, para se Maksi të vinte në vete, ai kishte ikur. Maksi vuri re se ai endacak i çuditshëm i kishte marrë lejekalimin, ku ishin shkruar emri i tij dhe qëllimi i udhëtimit në botën e përtejme. Pra do të thoshte që ai s’do të kthehej më mbrapsht. Maksi vazhdoi rrugën i nervozuar. Ndonjëherë humbiste, ngatërronte rrugën. Nuk dinte ku të shkonte. Kaloj në disa rrugica dhe u gjend në krahun e pasmë të një pallati, brenda një kopshti të madh. Ishin dy gra që endnin në një kornizë. Njëra endte me fill të zi, tjetra me fill të bardhë. Jo shumë larg prej tyre pa një rrotë të madhe, të cilën e rrotullonin katër vajza. Rrota kishte treqind e gjashtëdhjetë e pesë rreze dhe në qendër ishte një burrë me këmbë të hapura që i ngjante burrit të hipur mbi demin, të cilin e kishte takuar para portës së botës së përtejme. Por ishte pak më i ri dhe i buzëqeshte. Më në fund e gjeti rrugën që të nxirrte jashtë qytetit. Kur kapërceu muret, pa një liqen të vogël me disa nimfa. Mori një dhe, sapo arriti në shtëpi, i tregoi të atit ato që kishte parë. Ai i tha: “dy gratë thurnin të tashmen dhe atë që do të bëhet histori. Njeriu në mes është Mbrojtësi i së vërtetës dhe gënjeshtërs dhe duhet të vigjilojë që ato të rrinë të ndara. Rrota, sigurisht, është përfaqëson vitin, treqind e gjashtëdhjetë e pesë rrezet e katër vajzat – janë ditët dhe stinët. Mbetjet e demit gjigand që ke ngrënë ti janë eliksiri i pavdekësisë, ai të ka shpëtuar jetën, pasi vëllai nga njerka i Mbrojtësit të së Vërtetës dhe Gënjeshtërs, emri të cilit është Mbrojtësi i Miteve dhe i iluzioneve, të ka vjedhur lejekalimin”. “Kjo është e gjitha”

përfundoi doktor Sukthankari.

Antonini lëvizi pak në karrige dhe pastaj tha: “Natyrisht, po ta shikojmë ëndrrën nga pikëpamja e Jungut dhe e modifikojmë pak me Adlerin, atëherë...” por pa që doktor Sukthankari tundi kokën.

“Jo, koleg. Ëndrra është gati identike me një tregim të Mahabharatës. Në poemë ka një lloj Odiseje Indiane, edhe pse rreth pesë herë më e gjatë. Dje e kam gjetur këtë histori në katalogun e kompjuterit të një biblioteke që ma ka rekomanduar një kolegu juaj. Bibliotekarja u tregua e sjellshme duke më përkthyer një pjesë të vogël në anglisht. Ka shumë mundësi që pacienti im ta ketë marrë prej andej. Nga një libër. Dhe, pastaj, pas disa vitesh e ka parë ëndërr”.

“S’ka asnjë mister, atëherë?”.

“Asnjë mister”.

“Është ajo që e quajmë globalizim apo jo?”

“Të themi po” u përgjigj Subkthankari.

“Dhe a e dini një gjë? Me siguri ju e dini. Përse në Indi zambaku i ujit është aq i rëndësishëm?”

Doktor Suthankari u mendua pak, pastaj tha: “Ndoshta sepse simbolizon pastërtinë dhe bukurinë. Zambakut të ujit nuk i ngjitet kurrë balta, megjithëse lind prej saj”.

“Epo mirë” tha Antonini. “Gjithsesi, juve ju ka pëlqyer qëndrimi këtu?”

“Është një qytet i bukur” tha Sukthankari. “Vërtetë i mrekullueshëm. Ato statujat mbi urë... Ura Karli quhet?”

“Po” iu përgjigj Antonini “Ura Karli, megjithëse shumica e statujave, ndoshta të gjitha, janë statuja shenjtorësh. Shenjtorë të krishterë. Çfarë mendoni ju për krishterimin?”

“Nuk e di” tha Sukthankari. “Ndoshta ju thashë që kur isha i vogël ndiqja një shkollë katolike”.

“Dhe, cili është mendimi juaj, meqenëse jeni pjesë e dy kulturave?”

“Nuk kam një mendim të caktuar lidhur me këtë” tha Sukthankari. “Megjithëse themeluesi i Indisë moderne, Gandhi, një herë ka thënë, nëse krishterimi do të realizohej me të vërtetë, do të ishte një gjë e mrekullueshme”.

“Ah” iu përgjigj Antonini “po, siç, jua thashë, historia jonë nuk është fushë më lule, as optimiste, përkundrazi është plot hije e intriga”.

“Nuk habitem” komentoi Sukthankari. “Një qytet kaq i bukur nuk mund të shfaqej nga asgjëja”.

“Si zambaku i juaj i ujit!” tha duke qeshur Antonini.

“Po, si zambaku i ujit” pohoi Sukthankari me buzë në gaz dhe shtoi: “Gjyshi im në Indi, në fund të një ceremonie, ka thënë: “Rrota e ekzistencës rrotullohet në një botë pa fillim e pa fund. Rrotullohet për shkak të lindjes dhe të vdekjes. Rrota e ekzistencës rrotullohet e do të rrotullohet pa fillim e pa fund”.

“Pra, globalizimi” tha Antonini.

“Në njëfarë kuptimi” shtoi doktori. “Në njëfarë kuptimi”.

22. Vrapimi në pyll

Në mendjen e Jozefit, gjatë vrapimit, përshndriti një ide: bota është e ndarë në dy pjesë. Superiore dhe inferiore. E majta dhe e djathta. Herë në lëvizje, herë të ndalura. Një pjesë e botës që është e vjetër, e vjetër sa vetë bota dhe një e re me gjak, arterie dhe tru. Bota është e ndarë nga lart poshtë në botë të gjelbër dhe të kuqe. Bota e insekteve, e kafshëve, bota e përgjakshme njerëzore dhe bota e gjelbër, me rrënjë të thella, të forta dhe me ato sipërfaqësore. Bota e barit, e pemëve, e bimëve, bota e limfës, e rrëshirës dhe e lëngut, e gjithë kjo është bota e tokës që ka paraprirë botën e insekteve të pakëndshëm dhe të muskujve njerëzorë që pompojnë gjak – zemrat.

Por në faktin që Jozefi rrotullohej nga e djathta ose nga e majta – kishte diçka që nuk shkonte. Ose bota ishte e tredhur, ose pasqyra e realitetit ishte përmbysur mbi vetveten deri në pikën që e bën të dyshimtë sensin e natyrës. Por nuk është e mundur, jo, nuk është, mendoj Jozefi. Është absolutisht dhe thjesht e pamundur që këtu, ndërmjet dyzet dhe pesëdhjetë gradë në veri të ekuatorit dhe të gradës së trembëdhjetë e katërmëdhjetë në lindje të observatorit të Grinuiçit, natyra të jetë përzier aq shumë, sa bota të humbasë çdo sens. Bota e limfës dhe bota e gjakut nuk mund të qepen, të lidhen, të shartohen me njëra tjetrën sa të bëjnë të mundur që ndërmjet këtyre gjerësive e gjatësive të sillen lirisht dy gjirafa, dy rinoqerontë dhe tri ekidne.

Nuk është e mundur, deri para ca muajsh ishte gjithçka e mbuluar me borë. Çfarë po i ndodh botës, ka dalë nga pikëlidhjet

apo është vetëm një kaviļje e përndrydhur që me pak uthull dhe një thupër mund të kthehet në vend, pak a shumë? Jozefi bëri një xhiro përreth vetes, u rrotullua edhe pak duke lëvizur këmbën e majtë në një degë kërcitëse që u thye më shumë, sepse ishte e thatë, sesa nga pesha e tij. Kërceu përsëri, i trembur nga retë e pluhurit dhe të sporeve që shkëlqenin krenare në diellin e mëngjesit duke u ngritur nga ultësira e myshqeve gjysmë të tharë deri në lartësinë syve të tij plot ankth. Pas një piruete, trupi i tij u lëkund dhe ai vështroi prapa, në drejtimin nga kishte ardhur. Njëra nga gjirafat po e vështronte ngulazi. Vetëm tani e kuptoi sa të bukur e të mëdhenj ishin sytë e gjirafës së lartë dhe, teksa thërriste “Nuk është e mundur” “pesëdhjetë gradë në veri të ekuatorit” dhe “Në Bohemi? Në bohemi!” dhe “në Bohemi, o Zot” u hodh me vrap në anën e kundërt nga vinin gjirafat. Rinoqeronti, ndoshta, kishte mbetur prapa ose kishte marrë një drejtim tjetër.

Ishte e mërkurë. Një mëngjes i nxehtë – viti 1945. Vendi: juglindja e Plzenit.

Jozefi ikte, vraponte, pengohej. Kapërcente me një kërcim trungjet e dala, pa u përpjekur të shmangte degët. Ishte një njeri në ikje. Por forcat po e linin. Nuk e dinte se sa mund të rezistonte akoma dhe kishte frikë të vështronte pas. Kafshë, kafshë të çuditshme mu në mes të Bohemisë. I rridhte djersa çurkë dhe s’dinte sa kohë i kishte mbetur për të vrapuar. Pylli sikur po rrallohej dhe, pasi ishte rrëzuar disa herë duke u rrokullisur poshtë, papritur, ndaloi dhe mbajti vesh. E ndjeu, para se ta shikonte – një përrua. Atëherë vrapoi që të arrinte atje, u ul në gjunjë dhe, duke vështruar përreth, spërkati fytyrën me ujë. Pastaj e zhyti në ujë të gjithë fytyrën dhe filloi të pinte. Herë pas here kthehej, por pinte, pinte. U ngrit. Mbajti vesh fort, vështroi përreth përsëri – egërsirat nuk ishin më atje. Po ta kishin ndjekur, ose, thjesht, të kishin ndjekur drejtimin e tij, do të kishin arritur shumë shpejt. Priti se mos shfaqeshin prapë, të paktën, në majë të shpatit. Përreth tij nuk lëvizte asgjë. Vazhdoi

të shikonte, veshët të ngrehur. Tani kishte kujdes të mos pengohej. Asgjë, vetëm qetësia, drita e diellit që depërtonte përmes trungjeve të pemëve, pluhuri i ngritur në ajër. Vetëm tani e kuptoi se gjatë gjithë kohës kishte mbajtur frymën, u mbështet tek një pemë dhe mori frymë thellë. Përkuli shpinën nga prapa dhe ngriti kokën për të parë kurorat e pemëve. Nuk ishte, menjëherë, i vetëdijshëm për ato që po shikonte, që po vështronte. Nga pema përballë, atë e vështronte një majmun i vogël, me sy të mëdhenj dhe gishtërinj të gjatë. Kurrë s'më kishte ndodhur diçka e tillë, mendoi. Jozefi, përsëri, ishte një njeri në ikje.

Pasi eci pak, ishin këmbët, jo sytë që kërkonin me ngulm përreth për të perceptuar një sinjal të vogël shtegu. Degët reja, halat e thata, degët e thyera ishin gjithnjë e më të pakta. Këmbët lëviznin gjithnjë e më shpejt, megjithëse dridheshin nga lodhja. Edhe mendja e tij filloi të bëhej e vetëdijshme për butësinë e shtegut që shtrihej para tij. Trupi i tij u përkul në tokë. Sytë hetonin të trembur format e perceptuara. Koka u mbështet në pluhurin e halave dhe koret e forta. Sytë kërkonin t'u vinin zjarrin formave dhe të qëllonin trurin. Pastaj, vërtet, dalëngadalë filloi të ravijëzohej një shteg. Syri e kapi, kur filloi të maste këndet, të gjente shkallën, të vizatonte format.

Një rrugë fare e vogël e shtegut përvijojë midis pluhurit të nxehtë. Por ajo çka shikonte kushtëzohej nga fakti se koka ishte e zhytur në halat e pishës, në mënyrë që kocka e tëmthave të furnizonte bazën e fortë të syrit dhe milingonat, tashmë duke vdekur, të mund t'i rregullonin kafshimet e fundit në agoni asaj kafshe të madhe që i kishte dhënë vetes emrin e njeriut. Jozefi u ngrit. Por trupi i tij, i kafshuar nga lodhja si nga një qen gjahu, e kishte humbur koordinimin. Pasi kërceu në këmbë, ndjeu se ishte gëzimi ai që i jepte energji. Gëzimi! Gëzimi! Jo forca, tashmë, prej kohësh është e harruar dhe e trembur për vdekje. Trupi i tij kërceu lehtësisht më lart se ishte e nevojshme dhe këmbët filluan më parë

se të prekte terrenin. Ishin akoma të varura në ajër. Pastaj aderuan në tokë dhe trupi, sapo u ul në tokë, u drodh pak nga goditja dhe, shumë shpejt, mori rrugën.

Pema e shpërndarjes, tashmë plotësisht e sinkronizuar, filloi të vraponte drejt shtegut që sapo kishte dalluar. Pas disa minutash shtegu u bë i dukshëm edhe me një vështrim të thjeshtë. Edhe disa frymëmarrje akoma dhe filloi të ravijëzohet edhe fundi i pyllit. Duke rrudhur sytë edhe pak dukej një rrugë e gjerë fshati. Për atje u drejtua Jozefi. Fillimisht duke vrapuar, pastaj me hapa të shpejta, kur ndërhyri lodhja. Vazhdoi duke ndryshuar ritmin e hapave, duke vështruar vazhdimisht prapa, derisa filloi të ecte aq shpejt sa mundej. Aq sa forcat që, tashmë prej kohësh e kishin lënë, e lejonin. Eci më shumë se një orë. Është e pamundur ta thuash me saktësi. Nuk arrinte të kuptonte se, në një gjendje të tillë lodhjeje dhe dobësie, koha kalonte më ngadalë ose më shpejt. U përpoq të gjente distancën që kishte përshkuar. Më kot. Duke qenë pre e konfuzionit, mendoi se nga takimi me gjirafat dhe rinoqerontin nuk kishte kaluar më shumë se një orë.

Pastaj, saktësisht, siç mund të imagjinohej, u shfaq një ndërtesë e shkatërruar. Një fermë. Jozefi mendoi se ndodhej afër ndonjë fshati, por nuk po e shikonte. Rruga kalonte anash fermës dhe vazhdonte më tej. Vetëm tani Jozefi vuri re qetësinë që e rrethonte. Nuk ishte më në mes të pyllit, por në një ultësi të hapur. S'kishte asnjëri dhe pylli me erën e rastësishme që frynte mbi halat e pishave, tashmë, ishte larg. Hyri në oborr ose, më mirë të themi, në atë çka kishte mbetur. Një strukturë që shtrihej në gjatësi. Nga njëra anë një stallë, nga ana tjetër një hangar, nga prapa – një pus. Pjesa e fundit e drejtkëndëshit ishte e kufizuar nga hunjtë që kishin mbetur nga gardhi i lyer me gëlqere. Nuk ndiheshin kafshë.

Jozefi hyri në oborr. Deshi të thërriste dikë. Në të vërtetë, donte vetëm të ndihej prania e tij. Por, në fakt, nuk ishte as ky qëllimi i tij – kishte nevojë të lahej, të pinte e të mendohej për gjithçka i

kishte ndodhur, gjithashtu, të urinonte qetësisht. E përshkoi disa herë oborrin nga njëra anë në tjetrën. Vështroi në stallë dhe në hangar. Mbajti vesh, por nuk ndiheshin as njerëz, as kafshë, asgjë. U mbështet tek pusi dhe vuri re që merrte frymë me vështirësi, jo, nuk merrte frymë – gulçonte si një tren mallrash. Vështroi pusin, mori kovën dhe e hodhi brenda. Vuri re se litari i kovës ishte i këputur dhe i rilidhur.

Në atë moment, dikush apo diçka e kapi për këmbësh dhe, para se të kuptonte ç'bëhej, fluturoi me kokë poshtë. Instinkti e bëri të bërtiste. Ulëriti me atë pak ajër që i kishte mbetur në mushkëri, thirri, bërtiti, ulëriti... Fluturoi poshtë për një kohë të gjatë, fluturoi me mijëra vjet, derisa ndjeu trupin e vet të shkundej dhe mbeti i varur. Ishte errësirë e plotë. Këmba e tij e majtë kishte ngecur në litarin e kovës. Duart i kishte kaq të gërvishitura, sa i pikonin gjak për shkak të përpjekjeve që të mbahej në murin e pusit. Një spazmë ia shkundi të gjithë trupin. Rënia e tij ishte ndërprerë dhe ai kishte mbetur i varur me kokë poshtë.

Me duart e gjakosura, provoi disa herë të mbahej dhe, kur ulërima e tij nxori jashtë nga mushkëritë mbeturinat e fundit të ajrit, filloi të gulçonte dhe u përpoq të vështronte në drejtim të dritës. Atje, në majë, ku, pak më parë, shtriheshin breza blu të qiellit të magjepsur nga dielli, tani ishte... universi. Rrethi i vogël i zi i grykës së pusit ishte plot me yje. Atje ku duhej të ishte kaltërsia, tashmë, ishte qielli i natës. Truri i tij i lodhur filloi të gruponte yjet në konstelacione të pafundme, ndërsa përpiqej të kuptonte cili spektër i dritës së dukshme ishte errësuar nga pusi dhe në ç'thellësi ndodhej. Tani po fillonte t'i dhimbte edhe lëkura e rrjepur në gurët e pusit. Tashmë filloi ta mundonte gjithçka.

Pyeste veten si e kishte merituar gjithë këtë, pastaj mendoi se në një situatë të tillë, kishte pak për të menduar mbi meritat. Këmbën e majtë e kishte zënë gjumin, flukse gjaku ia përshkonin kokën. Zemra i rrihte aq fort, saqë duhej të ndihej deri në kraterin e pusit.

Jozefi kishte frikë se do t'i pëlçisnin venat aq të tendosura i ndiente dhe se, nga një çast në tjetrin, gjaku do të shpërthente jashtë nga trupi i tij, do të mbushte pusin dhe ai do të mbytej brenda. Do të pinte deri sa të mbytej, do të pëlçiste, do të shpërthente në gjakun e vet. Jo, qetësohu. Qetësohu. Tha me vete, kushdo apo çfarëdo të ndodhej atje lart – ai duhej të dilte që andej me çdo kusht.

Dalëngadalë filloi të ngrinte pjesën e sipërme të trupit. Ishte e vështirë. Sepse e ndiente që atje lart në majë ishte dikush që vigjilonte, u përpoq të mos bënte kurrfarë zhurme. Të ishte i heshtur si një mi, në mënyrë që, kush ishte atje lart ta harronte atë dhe të mos e mbyste. I kishin shterur forcat fare, u lëshua përsëri, ishte akoma i varur me kokë poshtë. Pastaj e provoi prapë. Ngadalë. Edhe një herë tjetër. Nuk ia doli. Përsëri. Ngadalë. Akoma. Dhe gati ia arriti. Jo. Akoma. Dhe... të heshtë. Të kapet. Edhe një përpjekje tjetër. Përsëri... E kapa. Jo, po. Ngadalë, të mos merrte frymë. Të tërhiqet lart edhe pak. Një çikë. Edhe një çikë. Me kujdes. I qetë. Pothuajse ia arrita. Lart, e kam, e kapa. Jozefi tërhiqej lart ngadalë. Fillimisht u kap me dorën e majtë. Tërhoqi. Arriti të kapte litarin, por ai filloi të valëzonte.

O Shën Maria mëshirëplotë! Jo! Do të donte të bërtiste, por heshti. Litari rrëshqiste, pastaj ndaloi dhe ai e kapi me dorën tjetër. Filloi të tërhiqej lart. As frymë nuk merrte. Përpiquej të mos merrte frymë, të mos ekzistonte. Litari filloi të tundej përsëri. Jo! Do të donte të ulërinte, por s'pati guxim. Tani e kishte kokën në lartësinë e kaviljeve, mund të mbështetej fort tek duart. Gjaku i pulsonte në duar e në këmbën e ngatërruar në litar. Gëlltiste pështymën, merrte frymë ngadalë. Ia doli. Këmba që kishte ngecur në litar, tani ishte në vendin e saj. Këmbët poshtë, koka lart. Jozefi ndaloi për një çast, i varur në litar dhe mendoi, jo në formë fjalësh, por me britma në paretet e kafkës së vet: synon të më vrasë! Dëshiron të më vrasë! Diçka do të më vrasë! Diçka ose dikush. Më hodhi në pus. Duhet të kem kujdes nga gjithçka. Do të më vrasë. Duhet të

arrij lart. Kujdes. Shuumë kujdes. Shumë kujdes, Jozef, shumë kujdes. Po kacavirrej gjithnjë e më lart, por, si masë paraprake, nuk mbahej më pas litarit dhe u mbështet në murin e pusit. Me këmbë e duar.

Ngadalë, po, shumë ngadalë dhe akoma më ngadalë ngjitej në lartësi. Duke u kapur pas gurëve, me të cilët ishte ndërtuar pusi. Në fillim shikonte vetëm yjet në rrethin e zi të grykës së pusit. Por, sa më shumë ngjitej, aq më shumë ajo copëz qielli bëhej më e ndritshme. Në fund yjet u tretën dhe universi i zi u transformua në një qiell të kaltër të blasfemuar. Kishte arritur në mes të pusit, kur gjithçka u errësua. Vështroi lart dhe pa një formë. Asgjë tjetër, veç një formë. Dhe ndjeu një ulërimë: “Nuk të mjaftoi kjo, o i mallkuar! Do të ngjitesh lart, eh! Bastard, prit atëherë!”

“O Zot” mendoi Jozefi, tashmë me zë të lartë. “Vërtet, duan të më vrasin” dhe filloi të kacavirrej e të ngjitej më me vendosmëri. Para se të errësohej gjithçka përsëri, ndjeu një rrebesh guralecash në flokë. U përpoq të kapej sa më fort në murin e pusit dhe pa në grykën e pusit një gur të madh. “Joo!” bërtiti. “Ju lutem, joo. Unë s’ju kam bërë asgjë, më lini, mos më vrisni. Më lini të ngjitem. Ju lutem më lini të ngjitem” ulëriti Jozefi përmes vrimës përmbi kokë. Tani dallonte qartë një hije njeriu. Hija pushoi së lëvizuri.

Ndaloj. “Kush je ti?” ndjeu nga lart.

“Do t’jua shpjegoj të gjitha!” thirri Jozefi. “S’kam bërë asgjë! Asgjë s’kam bërë!”

Pas pak, njeriu thirri: “Thuaj: mbi stol!”

Jozefi s’kuptoi gjë, por e tha. Bërtiti me kokë lart: “Mbi stol!”

“Jo, jo kështu” ulëriti ai. “Thuaj: mbi stol dhia jeton... të tërën, nëse e di, thuaje të tërën”.

“Mbi stol dhia jeton” thirri Jozefi “nën stol dhia ngordh. Mbi stol, dhia jeton, nën stol dhia ngordh”.

“E çfarë do të thotë?”

“Çfarë do të thotë?” thirri Jozefi. “Ka të bëjë me një dhi që

jeton e që vdes e që...”.

“Epo mirë, mirë” tha zëri nga lart. “Ngjitu, por ngadalë. Shumë ngadalë, e kupton?”. Dhe, pas një çasti heshtjeje, vazhdoi: “Pastaj përdor litarin”. Por Jozefi nuk pati guxim ta bënte këtë - duke u mbajtur pas litarit e duke ngulur këmbët në murin e pusit, u ngjit lart.

“Ee” ndjeu nga sipër “thuaj edhe një herë mbi stol dhia...”.

“Mirë” bërtiti Jozefi dhe filloi të recitonte prapë: “Mbi stol dhia jeton, nën stol dhia ngordh” dhe kështu pafundësisht, derisa arriti tek gryka e pusit. Kur rrethi i pusit mund të arrihej me dorë, zemra e tij pompoi gjakun në veshë. Ndiente vetëm t’i ziente gjaku. Asgjë më shumë, vetëm gjakun. U përpoq të tregojë i kujdesshëm e i vëmendshëm, por tashmë, prej kohësh, nuk e kishte më këtë aftësi. Nxori kokën jashtë dhe trupi u rrokullis mbi grykën e pusit. Rà përtokë dhe vështroi përreth. Tek ai u afrua, ngadalë, një plak i gjatë, duke i drejtuar një pushkë në bark. Me flokë të thinjur, me syze dhe mbi supin e tij qëndronte një majmun i ngjashëm me atë që Jozefi kishte parë në pyll dhe që i kishte ngjallur panik. Majmuni kishte sy të mëdhenj, të kuq, fëmijorë dhe gishtërinj tepër të gjatë. Mbahej rreth qafës së plakut me një putër dhe lëpinte treguesin e putrës tjetër. Edhe ai, si plaku, ia kishte ngulur sytë Jozefit. Jozefi, në fillim, vështroi armën, pastaj atë. Plaku mbante pushkën dhe nuk ia shqiste sytë.

“Atëherë, je çek?” tha plaku, pa ia ndarë sytë.

“Natyrisht. Natyrisht. Çfarë tjetër duhet të jem?” iu përgjigj Jozefi. Plaku e vëzhgonte me kujdes. Majmuni vazhdonte të lëpinte gishtin tregues.

“Unë e kam parë atë!” tha Jozefi.

“Çfarë ke parë?”

“Atë” tha Jozefi duke treguar me gisht majmunin. “Atë majmunin”.

“Është një majmun mashkull” tha plaku. “Çfarë kërkon këtu?”.

“Kisha dalë për të mbledhur kërpudha” u përgjigj Jozefi.

“Të duket moment i përshtatshëm të dalësh për kërpudha?” e pyeti plaku. “Në maj dhe në kohë lufte!”

“Eh, në të vërtetë, jo, por unë, tashmë, e bëra këtë. Doni të më vrisni?”

“Jo” u përgjigj plaku.

“Atëherë, përse më hodhët në pus?”.

“Mendova se ishte njeri prej atyre”.

“Njëri prej cilëve?”.

“Prej atyre”.

“Vërtet, nuk e di për kë e keni fjalën”.

“Njëri prej gjithë atyre ushtarëve dezertorë që vërtiten këtej përreth dhe përpiqen të bashkohen me amerikanët. Kanë krijuar probleme në fshat”.

“Po unë jam çek, zotëri”.

“Mirë, tashmë e di”.

“Atëherë përse doni të më vrisni!” thirri Jozefi.

“Nuk dua të të vras”.

“Po atëherë, përse e drejtoni këtë armë mbi mua?”

“Ah mos u bëj merak, është e zbrazur” tha plaku. “Mos bërtit më dhe eja brenda”. Ndërsa ecte drejt shtëpisë para Jozefit, majmuni ktheu kokën pas dhe vështroi Jozefin me sytë e tij të mëdhenj. “Eja brenda” e thirri plaku.

“Po, po, erdha, faleminderit”. Pastaj u kthye dhe vrapoi drejt gardhit. Ndërsa vraponte u zbërthye dhe filloi të urinonte mbi hunjtë, pa u ndalur akoma. Plaku ndaloi në shkallë, sapo ndjeu urinën e Jozefit, u kthye ta shikonte, edhe majmuni gjithashtu. Plaku tundi kokën me pështirosje, priti që Jozefi të mbërthente pantallonat dhe hyri në shtëpi. I tregoi Jozefit një karrige dhe u ul. “Mendova se ishe ushtar”. Jozefi mohoi me kokë. “Dje dhe pardje ka pasur të shtëna në pyll. Të kemi ndjekur me sy qëkur dole me vrap nga pylli. Unë dhe ai” shtoi plaku, duke treguar me

gisht majmunin. “Atij nuk i shpëton asgjë. Kur ndodh ndonjë gjë, bëhet nervoz”.

“Po si ka arritur ai këtu?” pyeti Jozefi. “Nuk është e mundur. Kam hasur në pyll dy gjirafa dhe një rinoqeront. Po ne s’jemi në Afrikë!” Plaku buzëqeshi.

“Aha, prandaj vrapoje si çmendur dhe ishe bërë jeshil në fytyrë. Ky qenka shkak”. Plaku buzëqeshi përsëri.

“Dhe ajo gjëja në pyll nuk m’i shqiste sytë” tha duke treguar majmunin.

“Djalosh, ky nuk është gjë, por është Jindrishek”.

“Jindrishek?”

“Po, Jindrishek ” përsëriti plaku dhe vazhdoi: “Dhe, nëse ke parë një majmun tjetër si ky në pyll – ajo është e fejuara e tij”.

“E fejuara?” u habit. “Po nga vijnë? Nga janë shfaqur këtu?”

“Epo ti nuk je nga këto anë, kështu?”

“Po të ishe nga këto anë, do ta dije se këtu afër, në një kështjellë, jetonte një kont që mbante kafshë. Kishte një lloj kopshti zoologjik privat”.

“Një kopsht zoologjik? ”

“Po, një kopsht zoologjik” përsëriti plaku. “Kur ishte i ri kishte udhëtuar nëpër botë dhe kishte studiuar kafshët, pastaj, çdo vit sillte nga një ”.

“Po si përfunduan në pyll ato kafshë ?”

“Këtë nuk e di. Por banorët e fshatit fqinj thonë se konti duhet të kishte vdekur, përndryshe nuk do t’i linte t dilnin”. Gjatë gjithë luftës, në njëfarë mënyre, kishte mundur t’u siguronte ushqim kafshëve të veta. Thoshte se njerëzit mund të përpiqen për veten e tyre, por një gjirafë në Bohemi është vështirë t’ia dalë”.

“Çfarë kafshësh kishte? Çfarë egërsirash ishin?” pyeti Jozefi.

“Për një farë kohe kishte edhe një luan, por vdiq para luftës”

“Pas një çasti shqetësimi Jozefi i tha: “Si do të bëj unë për t’u kthyer në shtëpi, prindërit e mi dhe Kveta do të vdesin nga

meraku, por unë s'mund të kaloj nëpër atë pyll”.

“Atëherë kam frikë se ti duhet të rrish këtu” tha plaku “derisa të mbarojë. Për fat të mirë, ke hasur vetëm ato kafshë, ato, të paktën s'kanë armë” shtoi ai. Pastaj u ngrit dhe vuri një tenxhere të vogël prej kallaji në zjarr. Kur uji filloi të ziejë, hodhi brenda kafën prej çikoreje, pastaj i zgjati një filxhan Jozefit. Ai filloi ta rrufiste.

“Duhet të iki?” pyeti Jozefi pas pak.

“Epo, askush s'të ka ftuar. Nga ana tjetër, nuk është se ke zgjedhje të tjera” komentoi plaku. “Edhe ne kemi pasur frikë, unë dhe Jindrishek”. Jozefi nuk dinte si të përgjigjej, kështu që u kufizua me një murmuritje.

Kur e mbaroi kafënë e çikores, e kuptoi se ishte kafja më e mirë që kishte pirë që nga viti 1939, pra gjatë gjithë kohës së luftës. E vështroi plakun, do të donte ta falënderonte, por majmuni, tani ishte gjallëruar, rrinte ulur mbi tavolinë dhe e vëzhgonte me kujdes. Bëri ca hapa në drejtim të tij, zgjeroi vrimat e hundëve, merrte e nxirrte frymë fort, e shikonte dhe i merrte erë nga larg.

“Largohu që këtej, monstër” shfryu Jozefi.

Plaku vështroi në drejtim të majmunit dhe i tha: “Mos mendo, se ti je aromatik” dhe pas pak, shtoi: “Ndoshta duhet t'i fashosh, do të marrësh ndonjë infeksion”.

“Mmh” murmuriti Jozefi. Plaku shkoi në dhomën ngjitur. U ndje një grisje dhe, kur u kthye, kishte në dorë një copë pëlhurë të hollë me një njollë të madhe që mbante erë të ëmbël alkooli. I bëri shenjë Jozefit dhe ai i vuri duart mbi tavolinë. Plaku filloi t'i pastronte një plagë. Jozefi fishkëllente nga dhimbja çdo çast, por era e alkoolit e qetësonte.

“Është mëndafsh?” pyeti, kur pëlhura u ngjyros nga gjaku i tij.

Plaku drejtoi shpinën, vështroi Jozefin dhe i tha: “Vazhdo vetë, tani unë duhet të bëj diçka tjetër, dezinfektoji” përsëriti ai. “Dezinfektoji plagët dhe zhduku. Nuk të ka ftuar njeri!”. Me një anë të gojës i fishkëlleu majmunit, ai i hipi mbi sup, mori pushkën

dhe shkoi në dhomën ngjitur. Kur Jozefi mbaroi së dezinfektuari plagët, e palosi pëlhurën e mëndafshhtë që tashmë kishte marrë ngjyrë të errët nga gjaku i oksiduar dhe e vuri në tavolinë. Qëndroi ulur aty, priti. Pas pak, u ngrit dhe trokiti në derë ku ishte zhdukur plaku. U hap dera dhe doli plaku me pushkë në dorë.

“Ehm” turfulloi dhe pastaj heshti. “Atëherë mendoj... Atëherë po iki” tha Jozefi.

“Mirë” tha plaku. “Do të të tregoj rrugën”. Dolën. “Po të mos duash të kalosh nëpër pyll duhet të ecësh, thjesht, nëpër këtë rrugë deri në fshat dhe atje do të gjesh rrugën për në fshat.

“Faleminderit!” i tha Jozefi.

“Si e ke emrin ti?”

“Jozef. Po ju?”

“S’ka rëndësi si quhem unë ” tha plaku. “Unë tashmë, jam i vjetër, s’ka rëndësi ”. Mori frymë thellë dhe vazhdoi: “Në rast se ti do të marrësh trenin, megjithëse dyshoj nëse funksionon, atëherë duhet të shkosh deri në qytezën tjetër. Vërtet është më gjatë, por aty ka postë dhe ti mund të lajmërosh njerëzit e tu”.

“Faleminderit” tha Jozefi dhe vështroi armën që plaku e kishte mbajtur gjithë kohën në dorë.

“S’ka gjë, Jozef” iu përgjigj plaku.

“Atëherë, unë po iki” tha Jozefi.

“Mirë” tha plaku. “Ik, tani”. Jozefi mori rrugën që vinte nga pylli, siç e kishte këshilluar plaku - ecte shpejt, me hap të përmbajtur. Herë pas here kthehej dhe vështronte plakun para stacionit të vogël, me një dorë mbështetëj dhe me dorën tjetër mbante pushkën. Pas kishte ecur me hap të shpejtë disa minuta, ndjeu një krismë që vinte nga shtëpia. I ndaloj zemra, u kthye. Në largësi dalloj formën e plakut me pushkën e drejtuar nga retë e ulëta dhe imagjinoi, më shumë se e pà me të vërtetë, mjegullën e lehtë të tymit që ngrihej. Jozefi nuk humbi kohë më dhe filloi të vraponte. Pas pak arriti në qytezë. Lule nëpër dritare dhe një rrugë

gjithë pluhur. Para se të arrinte tek sheshi pa një kryqëzim. Trokiti në derën e shtëpisë së parë dhe hyri. “Përshëndetje!” tha.

“*GruB Gott*” u përgjigj një grua rreth të pesëdhjetave dhe ngriti sytë nga makina qepëse. Jozefi kaloi në gjermanisht dhe i shpjegoi se kishte nevojë për një telegraf ose telefon. Gruaja e çoi në shtëpinë ngjitur. Pas një bisede të shkurtër i treguan, cilën rrugë duhej të merrte dhe e informuan se pjesa më e madhe e ushtrisë gjermane në rrethina u ishte dorëzuar amerikanëve. Para se të dilte nga shtëpia, Jozefi pyeti për atë plakun që jetonte në atë banesën e vetmuar, pa e prekur historinë e pusit.

“Ka qenë një plak vasal” iu përgjigjën “ka punuar në kopshtin zoologjik, merrej me kafshët, thonë se disa i ka marrë edhe në shtëpi”.

Për disa vjet me radhë, në pyjet përreth vazhdonin të ndiheshin tinguj e zëra të çuditshëm. Lufta kishte mbaruar dhe, pa dijeninë e kafshëve, fuqitë botërore kishin ndarë pyllin me një vijë imagjinare, por që ekzistonte realisht, e cila ndante ushtrinë amerikane nga ajo ruse. Kafshët e liruar kundër vullnetit të tyre, nga plumbat amerikanë dhe nga një kujdestar në panik, bënë pjesë në sferën e influencës sovjetike, por kurrë nuk e morën vesh. Akoma, disa muaj pas luftës flitej për gjarpërinj të fortë si këmbët e njeriut, për majmunë të çuditshëm, të mëdhenj e të vegjël, që kërcenin degë më degë, për gjirafa e rinoqerontë, por kurrë nuk u bë e mundur të ndahej realiteti nga frytet e fantazisë.

Flitej gjithashtu edhe për ushtarë rusë të uritur që organizonin gjueti të vërtetë kundër tyre, por, kur kapiteni i madh e mori vesh qëllimin e tyre u skuq i tëri, mblodhi gjithë ushtrinë dhe filloi të ulërinte duke u shpjeguar ushtarëve se as fitorja e madhe e Ushtrisë së kuqe, nën komandën e Josif Visarionoviç Stalinit, nuk i jepte askujt të drejtën të pinte e të dehej pa kufi dhe se kodi penal ushtarak ishte akoma në fuqi. Ulërimat e tërbuara të oficerit rus në vendin ndëshkues të improvizuar në jug-lindje të Plzenit

u dhuruan kafshëve ekzotike disa muaj ndoshta një vit jetë. Në fakt, më vonë, pas ca dimrave të ashpër, tregimet emocionuese mbi kafshët e pazakonta, pushuan. Më në fund erdhi paqja. Paqe dhe qetësi.

Kur arriti në stacion Jozefi mori vesh se trenat kishin ndaluar, nuk dihej për sa kohë dhe, siç komentoi punonjësi i hekurudhës, nuk ishte mirë të hipte në ta, sepse me ata trena udhëtonte ushtria dhe kjo ushtri, ndoshta, nuk do ta vazhdonte të udhëtonte për një kohë të gjatë. Telegraf-telefoni nuk funksiononte. Ai e këshilloi djaloshin të gjente strehim në ndonjë vend në fshat. Në atë çast Jozefit i erdhi një ide. Do të kthehej në shtëpi përmes pyllit. Ndërsa shkonte në qytezë, i kishte peshuar gjërat në mendjen e tij dhe duke folur me punonjësin e hekurudhës, në fakt ishte ndier i kënaqur që trenat nuk lëviznin që telat telefonikë nuk dërgonin sinjale dhe që e vetmja mundësi ishte të qëndronte.

Iu desh pak kohë të kuptonte motivin e asaj kënaqësie, por më në fund, vuri re që nuk ishte më i terrorizuar, as i trembur. Në vena nuk i pulsonte gjaku me erëza i egërsirave. Ideja për t'u kthyer i erdhi, jo menjëherë pasi punonjësi i hekurudhës i tha ato që duhej t'i thoshte. Në qytezë bleu pak ushqim, hëngri dhe eci nëpër rrugën nga kishte ardhur, duke u përpjekur të shmangte vendet ku mund të haste njerëz me të cilët kishte biseduar, kur kishte arritur. Nuk ndiente nevojë të bisedonte me ta dhe as nuk do t'ua shpjegonte dot në gjermanisht se kishte ndërmend të kthehej në pyllin nga i cili kishte ikur para disa orësh. Kështu që u kthye mbrapsht. Nuk kaloi nga rruga, sepse rreziku që të haste ushtarët, nuk kishte kaluar akoma, por u përpoq të mos e humbte nga sytë, siç kishte bërë më parë.

Kaloi rreth qytezës, preu përroin, iu desh të kthehej nganjëherë mbrapsht, sepse humbiste orientimin, por, në fund, e gjeti drejtimin e saktë dhe shtegun nga kishte ardhur. E kuptoi qartë se për kthimin do të donte shumë më pak kohë se për vajtjen. Duke

iu afruar shtëpisë ku jetonte plakun, u përpoq të qëndronte sa më larg të ishte e mundur, duke u përpjekur të kapte ndonjë zhurmë, por nuk ndjeu asgjë. Kur kaloi përtej shtëpisë, u kthye disa herë ta shikonte. Nuk e pa plakun, as nga shtëpia nuk vinte asnjë tingull, madje as kur pushoi era. Më në fund Jozefi iu afrua pyllit. Ndihej i sigurt. Tani e dinte shkakun e pranisë së kafshëve. Hyri brenda në pyll, herë pas here iu desh të kthehej mbrapsht, por, pas pak, e gjeti shtegun, nëpër të cilin kishte kaluar në ardhje. Ngadalësoi hapin, vështroi përreth. Shpesh ndalonte, vëzhgonte, dëgjonte, thithte aromat dhe tingujt.

Tani do të kishte dashur t'i shikonte prapë ato kafshët që e kishin trembur aq shumë, sikur shikimi i tij kureshtar donte të riekulibronte tmerrin dhe frikën që i kishin pushtuar trupin dhe mendjen. Nuk arriti t'i shikonte. Përveç erës, fëshfërimës së gjetheve dhe rrahjes së zemrës së tij, pylli ishte i shkretë. Kur e kuptoi se kafshët nuk ishin, Jozefi vendosi të ndërronte rrugë. Mendoi thellë, duke u përpjekur të shkëputej nga emocionet. Problemi është, tha me vete, ku duhet të jenë kafshët. Ishte i vetëdijshëm se nuk dinte absolutisht asgjë për ato kafshë. Nuk di as çfarë hanë, tha. Nuk di çfarë u pëlqen atyre. Nuk di as me çfarë ushqehen në ambientin e tyre natyral, lëre pastaj këtu, në këtë tokë plotësisht ekzotike për to, pak a shumë, në jug-lindje të Plzenit. Çfarë mendojnë ato për gjithë këtë, për praninë e tyre këtu.

Pas pak e kuptoi se ishte e pamundur të mësonte, ku ndodheshin ato kafshë, por çka e acaronte më shumë ishte që nuk e dinte çfarë u pëlqente të hanin. Ndjeu etje. Kujtonte turbull vendndodhjen e përroit, ku kishte pirë ujë gjatë ardhjes. Solli ndërmend imazhin e njëqind e tetëdhjetë gradëve dhe, pas pak minutash, arriti aty pa u gabuar. Freskoi fytyrën me ujin e burimit, piu dhe, vetëm në atë çast, mendoi se, cilado të jetë origjina e atyre kafshëve, natyrisht do të kishin nevojë për ujë, do të kishin etje, si ai vetë, si është e mundur që nuk i kishte shkuar ndërmend më parë? Ndoqi

rrjedhën e ujit dhe, dalëngadalë, ndërsa i afrohej qytetit, përroi u transformua në një rrëke. Duke ndjekur shtratin e drejtimit të ujit arriti deri në një fabrikë të qytetit, pa mundur të shikonte asnjë kafshë, përveç dy ketrave të kuq.

Qyteti ishte përsirë nga rrëmuja dhe festimet. Hasi në një trupë ushtarësh amerikanë që po përparonin. Çamçakëzët, tashmë, ishin shpërndarë dhe, përveç së fejuarës së tij, askush nuk e kishte ndier mungesën e Jozefit. Mori vesh që, para se disa trupa të vogla gjermane të tërhiqeshin, kishte shpërthyer në pyjet prapa qytetit, një shkëmbim zjarri i ashpër. Në fillim Jozefi nuk i kushtoi vëmendje, por më vonë, mendoi se i ati që shkonte shpesh në ato vende, ku kishin shtëpinë verore, i njihte pothuaj të gjithë banorët dhe merrte vesh çdo gjë tërë, i kishte folur disa herë për pyjet që ai kishte përshkuar dy herë atë ditë.

Megjithatë Jozefi s'kishte hasur askënd, përveç atyre kafshëve ekzotike, gjatë vajtjes dhe dy ketrave që vraponin, në kthim. I treguan, gjithashtu, se në atë shkëmbim zjarri ishte përfshirë edhe një kopsht zoologjik privat në afërsi të kështjellës dhe, ndoshta, kafshët ishin gjendur në mes të zjarrit të kryqëzuar ndërmjet amerikanëve që përparonin, gjermanëve që tërhiqeshin dhe rusëve që i ndiqnin. Për njëfarë kohe e mbajti për vete aventurën e tij të një dite, më vonë ai ia tregoi vetëm Kvetës, e cila kishte shoqëruar prindërit në shtëpinë e tyre në fshat. Ajo u zemërua dhe i tha se ishte një i çmendur, i pavetëdijshëm për çka mund t'i ndodhte.

Por Jozefi nuk ia vuri veshin shumë zemërimit të saj, sepse akoma ndiente keqardhje që nuk i kishte parë kafshët gjatë kthimit. Fakti që ai e kishte kaluar dy herë vijën e kufirit, nuk i dukej i konsiderueshëm. Pastaj i tha Kvetës që, sapo të qetësoheshin ujërat, më në fund, do të mund të martoheshin, siç kishin premtuar në fillim të luftës. Si gjithmonë, Kveta vuri re se nuk mund të rrinte gjatë e zemëruar me të, s'do të kishte kuptim, sepse s'do të shërbente për asgjë. Kur, pas disa ditësh, ua bënë të ditur

prindërve vendimin e tyre, mamaja e Kvetës, pasi mori veten nga surpriza, u mbajti një fjalim të gjatë të dyve, duke nënvizuar se ishin të rinj, të dashuruar, plot energji, gjë që, sigurisht, nuk ishte një zbulim dhe se, falë Zotit, të gjithë kishin shpëtuar nga lufta, një realitet absolutisht i pakundërshtueshëm dhe se, nga dy luftërat e përjetuara prej brezit të saj, bota dhe Europa me siguri do të kenë nxjerrë mësim - një pohim optimist i guximshëm.

“Ju pret një jetë e lumtur, fëmijët e mi” vazhdoi vjehrra e ardhshme e Jozefit. “Lufta mbaroi, ushtritë ruse dhe amerikane e mposhtën fashizmin dhe, shumë shpejt, të gjitha problemet do të zgjidhen. Ju pret një jetë e mrekullueshme. Burrat, me siguri, do të kenë mësuar diçka nga gjithë kjo. S’ka dyshim! Dy luftëra në dyzet vjet – një absurditet i madh. Është e pamundur të përsëritet. Pra, ju pret një jetë e bukur”.

Mamaja e Kvetës, duke folur, u emocionua pak, pastaj pa Jozefin që i pëshpëriste diçka Kvetës dhe Kvetën që buzëqeshte qetësisht - shikonte vetëm atë. Atëherë e kuptoi se asnjëri prej tyre s’po e dëgjonte.

**Lista me titujt e librave të përkthyer
nga znj. Xhemile Zyka**

- Carl Gustav Jung: Kujtimet, persiatjet.
- Sandra Brown: Çmimi i lumturisë. 2009.
- Osho: Rruga e dashurisë. 2012.
- Sandra Brown: Kurora e nuses. 2010.
- Meg Cabot: Princesha pret. 2011.
- Osho: Meditimi. 2015.
- Osho: Ketu dhe tani. 2015.
- Osho: Lufta dhe paqja e brendshme. (Pjesa e parë)
- Evgenij Vodollazkin: Laurus. 2015.
- Dato Turashvili: Brezi i xhinseve. 2015.
- Natasha Kramberger: Qielli me manaferra

Në proces:

- Dostojevski: Vellezerit Karamazovë. (Vëllimi 1 dhe 2).
- Osho: Lufta dhe paqja e brendshme. (Pjesa e dytë)
- “Doktor Zhivago”, Boris Pasternak

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Zmeškal, Tomáš

Letër dashurie në shkrimin kuneiformë Tomáš Zmeškal ;
përkth. Xhemile Zyka ; red. Rexhep

Hida. – Tiranë : Fan Noli, 2017

... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Milostny dopis pismen

ISBN 978-9928-203-97-7

1.Letërsia çeke 2.Romane

821.162.3

-31